



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 16 DHE 20 MAJ 2019**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 16. I 20. MAJA 2019. GODINE**

**MAJ - MAJ  
2019**

## **Rendi i ditës**

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i Propozim-Rezolutës për gjenocidin, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës të ish-regjimit shtetëror serb në Kosovë,
4. Formimi i Komisionit shtetëror për krijimin e Tribunalit për gjenocidin serb në Kosovë,
5. Vendimi për ndërtimin e Muzeut të Gjenocidit, tek ish - Fabrika e Tjegullave,
6. Vendim për ndërtimin e Memorialit të Dëbimit, te Stacioni Hekurudhor i Prishtinës,
7. Caktimi i Ditës së Gjenocidit.

## **Dnevni red**

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Razmatranje Predloga rezolucije o genocidu, zločinu protiv čovečnosti i ratnih zločina bivšeg režima srpske države, počinjenih na Kosovu,
4. Formiranje Državne komisije za osnivanje Tribunala o počinjenom srpskom genocidu na Kosovu,
5. Odluka o izgradnji Muzeja genocida, kod bivše Fabrike cigala,
6. Odluka o izgradnji Memorijala proterivanja, kod Železničke stanice u Prištini,
8. Utvrđivanje datuma genocida.

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.**

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Shumë të nderuara familje të personave të pagjetur, përkatësisht shoqatat e të pagjeturve dhe gjenocidit serb në Kosovë.

Unë do t'i hap punimet e kësaj seance plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 13 maj 2019.

Para se të fillojmë me procedimin e rendit të ditës, pasi që i kemi edhe shoqatat e goditura nga gjenocidi serb, familjarët e tyre, dëshiroj të bëj një qartësim për hir të korrektësisë.

Ne do të vazhdojmë ashtu siç ka vendosur Kryesia e Kuvendit pikat e rendit të ditës, vetëm për njoftim të kolegëve deputetë.

Ju po e shihni, një pjesë e deputetëve, veçanërisht e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës shumica nuk janë këtu, për faktin se pjesa tjetër pastaj mund të vazhdojë në Prizren, është dita e zhdukjes së mendimtarit, politikanit dhe një nga ideologëve të kombit tonë në Republikën e Kosovës, i zhdukur pikërisht këtë ditë, do të thotë sot është një akademi, e cila zhvillohet në Prizren.

Do të thotë, ne do të shkojmë në bazë të rendit të ditës dhe seanca vazhdon pastaj në orën 14:00, ta kenë parasysh edhe familjarët, edhe shoqata, për arsye se mund të jenë të munduar, se ka pyetje parlamentare, të cilat marrin një kohë, janë 60 minuta në bazë të Rregullores, po ashtu Deklarimi jashtë rendit të ditës 30 minuta, pasi të përfundojnë këto dy pika të rendit të ditës kalojmë në pauzë për të rifilluar në orën 14:00, të kihet parasysh dhe familjarëve u kërkojmë falje.

Fjala ishte për Ukshin Hoti, se ndoshta edhe për shkak edhe ngarkesës nuk ia thashë emrin, është akademia përkujtimore në orën 12:00 sot.

Do të thotë po e vazhdojmë seancën me këtë pjesën të cilën e kemi.

Tani aktualisht janë 65 deputetë të Kuvendit. Dauti po e kërkon fjalën para se të futemi në pikat e rendit të ditës. Urdhëro, zoti Daut Haradinaj!

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Meqenëse është temë shumë e ndjeshme, unë kisha propozuar që ta kemi një mocion dhe të kalojmë në rendin e ditës dhe t'i hyjmë temës për të cilin mendoj që është shumë e rëndësishme sot edhe i kemi palët këtu.

Jam i bindur që edhe kolegët e mi deputetë pajtohen, kështu që të mos e lëmë deri në orën 14:00, po të vazhdojmë direkt me pikën e rendit të ditës për çka edhe është thirrur kjo seancë.

**KRYETARI:** Është një propozim, mund të shkojmë me mocionin përmbajtjesor në këtë çështje, sido që të jetë, seanca do të vazhdojë edhe pas orës 14:00.

A dëshironi ta vë në votim mocionin procedural, në fakt. Zoti Gashi, po urdhëro! Për. Po.

Atëherë po e nxjerr si mocion procedural propozimin e deputetit Daut Haradinaj. Urdhëro, zoti Elmi Reçica!

**ELMI REÇICA:** Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për përfaqësuesit e familjeve të të pagjeturve,

Të nderuar kolegë deputetë,

Dhe qytetarë të nderuar,

Realisht te ne një pjesë e deputetëve, edhe ashtu e kemi planifikuar dhe një nga deputetët është i biri i Ukshin Hotit, janë në Prizren.

Për kundër mirëkuptimit për familjarët që janë këtu që kanë ardhur edhe propozimi i zotit Haradinaj, mendoj që do të duhej vërtet që të fillojë seanca ashtu si është planifikuar, ndërsa për atë që ishte si propozim që në orën 14:00 të kthehemi të gjithë këtu, se vijnë edhe deputetët e tjerë, është çështja më e rëndësishme dhe besoj që kjo seancë është prej çështjeve që do të duhej të vendosej aty për aty. Ka nevojë të kemi edhe kuorum për fillim dhe do të duhej të kemi kuorum për t'i votuar ato çka janë si propozime. Faleminderit!

**KRYETARI:** Jemi në këtë situatë, ne mund të shkojmë në orën 14:00 rifillimin e seancës drejtpërdrejt në bazë të propozimit të mocionit procedural të deputetit Daut Haradinaj, në qoftë se pajtohemi, futemi drejt në rezolutë dhe pjesën tjetër në orën 14:00.

Po, urdhëroni zoti Kurteshi, fjala për ju. Nuk prish punë, jemi në diskutim, si të vendosim, në fund të fundit është votimi.

**SAMI KURTESHI:** Faleminderit për fjalën e dhënë, zoti kryesues!

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit,

Ne e kemi një rend të ditës, rendi i ditës na ka ardhur me kohë dhe si zakonisht gjatë ditës ka agjenda të ndryshme dhe këtu janë mysafirët.

Unë mendoj se rruga më e mirë dhe puna më e mirë do të ishte ne ta fillojmë seancën me kohë, me pikat e rendit të ditës, sepse gjatë ditës do të ketë agjenda të ndryshme, edhe personale, edhe

grupore, po është një takim për Ukshin Hotin edhe në Prishtinë, do të thotë njerëzit janë të angazhuar nëpër takime të ndryshme në lidhje me këtë çështje.

Prandaj, unë kisha propozuar, me gjithë mirëkuptimin për propozimi e deputetit Haradinaj, që të vazhdojmë me agjendën që e ka caktuar Kryesia. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Zeka, Dauti në fund dhe shkojmë në votim.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Qëllimisht dola se s'mund të flas me kurriz prej familjeve që janë këtu.

Unë mendoj që si Parlament dhe deputetë, nderimin më të madh Ukshin Hotit ia bëjmë me një minutë nderim heshtje.

KRYETARI: Zoti deputet, po ndërhyj me mirëkuptim, më fal! A ka mundësi të më lejosh veç një minutë. Po ndërhyj në mirëkuptim. Po e di që e ke qëllimin shumë të pastër e të sigurtë. Por nuk guxojmë të bëjmë një minutë heshtje për njerëzit që nuk e dimë fatin e tyre.

MILAIM ZEKA: Në rregull. Unë propozoj që të nxirret në votim propozimin e deputetit Daut Haradinaj dhe për nder e respekt të gjithë këtyre njerëzve që kanë ardhur, edhe të mediave, ta vazhdojmë seancën për atë që jemi thirrur, t'i kalojmë të gjitha procedurat e tjera.

Kaq, kryetar, të lutem, të kesh mirëkuptim.

KRYETARI: Islami po insiston, ai e ka kërkuar i pari fjalën, edhe deputeti Daut Haradinaj dhe shkojmë në votim. Urdhëro, zoti Pacolli, për këtë çështje.

ISLAM PACOLLI: Faleminderit, kryetar!

I përshëndes familjet që gjenden sot pranë nesh këtu dhe juve të gjithë deputetë të nderuar, Sigurisht që po e gjej këtë seancë pak sa të çrregulluar, duke marrë parasysh që Ukshin Hoti ka qenë një ideolog i pavarësisë së Republikës së Kosovës dhe nuk ka qenë partiak. Natyrisht që edhe ne kemi pasur dëshirë të jemi pjesë e asaj, po seanca nuk ka qenë e koordinuar.

Prandaj, edhe unë jam për që ne t'i nderojmë familjet që gjenden sot këtu që të përshpejtojmë me propozimin e Daut Haradinaj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Haradinaj, edhe po shkojmë në votim. Përkufizo propozimin tuaj, që ta vë në votim menjëherë.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Unë mendova që këto dy pikat që i kemi, edhe treshin, edhe katërshin, do të marrin kohë dhe do të ketë diskutime, do të ketë debat edhe unë jam i bindur që shumica prej kolegëve të mi e konsumojnë kohën. Në këtë aspekt e pata idenë për atë arsye edhe thashë që ta qesim në mocion.

Meqenëse një pjesë e mirë e deputetëve po mendojnë të vazhdojë seanca e rregullt, unë e tërheq mocionin.

KRYETARI: A po e vëmë në votim, e tërhoqe.

Atëherë shkojmë në seancë. U kërkojmë falje familjarëve të të pagjeturve, shoqatave të luftës, shkojmë me skenar.

*(Ndërhyrje)*

Po, bre, po tash po hapet prapë debati. Ka nga pak rregulla, megjithatë.

Driton, pastaj Saranda, në fund, po mos e hapni debatin, për faktin se veç po e stërzgjatni. Megjithatë, ta respektojmë edhe një procedurë sipas Rregullores, tri herë ju thashë a ka dikush tjetër prej deputetëve.

Urdhëro, zoti Driton Çausi, pastaj Saranda, edhe është familjare e personave pikërisht që ka pësuar një gjenocidi serb dhe ta përfundojmë me kaq.

DRITON ÇAUSHI: Faleminderit!

Nuk do të zgjatem, unë besoj që të gjithë e kuptojnë ndjeshmërinë e kësaj çështjeje, e kuptojnë që tashmë në një mënyrë janë ftuar përfaqësuesit e shoqatave, familjarët e të pagjeturve dhe besoj që është më se e natyrshme që ne si Kuvend t'i përshtatemi kësaj rrethane dhe pikat e rendit të ditës kemi mundësi t'i vazhdojmë më tutje, pasi të trajtohet kjo çështje.

Kjo është dashur të organizohet më mirë dje, nëse kemi pasur një ditë përkujtimore siç është kjo që e përmendët, por nuk besoj që është arsye për të mos bërë një mocion dhe për ta ndryshuar rendin e ditës.

Shpresoj që do të ketë mirëkuptim të deputetëve.

KRYETARI: Zonja Saranda Bogujevci e ka fjalën, edhe do ta përfundojmë që të mos e hap diskutimin, futemi ose në seancë, ose në mocion procedural.

SARANDA BOGUJEVCI: Disa gjëra duhet të sqarohen, nuk jemi duke mësuar prej kësaj. Sot ka qenë përvjetori i Ukshin Hotit, është e padrejtë në dy aspekte.

E para që tash të vendosim a është me rëndësi të marrim pjesë në organizime që janë bërë për zotin Ukshin Hoti, apo tash që kemi familjarët këtu, domethënë që po presin për të filluar seanca. Temat që janë caktuar këtu sot janë tepër serioze dhe nuk mund t'i kalojmë dosido, duhet diskutim i mirëfilltë dhe kohë për t'i diskutuar këto gjëra. Nuk guxojmë veç hajt t'i kryejmë shpejt këto çështje, ka deputetë prej secilit subjekt politik që kanë shkuar në ceremonitë përkujtimore që janë sot edhe organizimet që janë bërë. Nuk është serioze kjo sinqerisht, është duke u bërë hajgare që 20 vjet me këto çështje, thirr familjarët këtu, jo tash hajde ta ndërrojmë seancën, jo tash e kemi pjesën atje të përkujtimeve dhe akademitë përkujtimore.

**KRYETARI:** Vetëm pak, akademitë përkujtimore janë gjërat, të cilat kanë ndodhur që 20, 21 ose 30 vjet dhe do të ndodhin, kur është marrë vendimi i Kryesisë, është diskutuar atë ditë edhe për këtë çështje, vetëm pak, proceduralisht në qoftë se ka një grupim propozim, që është në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, ajo shkon, propozuesi u tërhoq, e vazhdojmë seancën.

E pyeta disa herë edhe sekretarin, po e the, idenë e përkrah, a do ta propozoni ju tash, atëherë Driton formulo propozimin tuaj për mocion procedural. Edhe menjëherë, ju lutem, e vëmë në votim, pastaj vendos seanca.

**DRITON ÇAUSHI:** Atëherë, po e qartësoj edhe një herë, unë kërkoja mocion, e mbështeta idenë fillestare, pra kërkoj mocion për ndërrim të rendit të ditës të vazhdojmë me pikat që kanë të bëjnë me gjenocidin dhe me drejtësinë në lidhje me krimet e luftës.

**KRYETARI:** Faleminderit! Se më herët nuk ishe i qartë vetëm shkarazi idenë e zotit Haradinaj, po shkojmë në votim, pastaj e vazhdojmë.

Shkojmë në votim: mocion procedural është i propozuar nga deputeti Driton Çausi, a është i qartë mocioni procedural, besoj s'kam nevojë ta qartësoj. Hiqen këto pikat e para të rendit të ditës, kalohet drejt nga pika e tretë, nga rezoluta: Shqyrtimi i Propozim-rezolutës për gjenocidin, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës të ish-regjimit shtetëror serb në Kosovë, pastaj vazhdohet tutje. Votojmë tash!

57 deputetë kanë votuar. Unë edhe një herë do ta vendos, se është praktikë, po a po punon teknika, së pari? Sa vetave nuk po ju punon? Me dorë? A pranon seanca me dorë, se edhe kjo është një çështje, a ka mundësi votimin për prezencë, e kemi një rregull tjetër, për këtë e kemi sekretarin. Votimi për prezencë, ju lutem, votojmë tash!

E falënderoj administratën profesionale të Kuvendit! Votimi për prezencë është i saktë, deputetët nuk kanë dashur të votojnë, ata që s'kanë dashur. Jo, s'është me rëndësi. Shkojmë në votim elektronik edhe një herë, vetëm për korrektësi, megjithëse edhe s'ka nevojë të shkojmë fare, për

faktin se ai ishte rezultati i cili ishte, s' shkojmë më fare, vullneti ka qenë në prezencë. Jo, jo unë jua sjell në mënyrë elektronike publikisht, ftoj administratën, vendosni, me dy mendje nuk ka.

## **1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës**

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta, diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në 5 minuta, ndërsa diskutimi i deputetit zgjat deri në 3 minuta. Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën. Valentina Bunjaku-Rexhepi e ka fjalën!

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Përshëndetje! S'ka kushte.

KRYETARI: Zonja Bunjaku-Rexhepi, fjala është për ju! Ju kisha lutur, për hir edhe të mysafirëve, çdo veprim të bëhet me dinjitet.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: I nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju deputete,

Unë do të deklarohe në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës për garën e diturisë, e cila është mbajtur ditëve të fundit dhe ky është skandali më i madh që ka mundur t'u ndodhë nxënësve dhe fëmijëve tanë.

Ajo garë është organizuar si është më së keqi nga organizatori apo koordinatori joprofesional, me dëme të pakthyeshme për efektet negative të nxënësit. Janë shpenzuar mjete financiare krejt koti, është bërë organizimi nga Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe nuk është bërë organizimi nga Ministria për Arsim, Shkencë, Teknologji. Janë diskriminuar shkolla, nxënës, edhe minoritete nëpër komuna. Janë shfaqur mijëra gabime teknike e lajthitje në përmbajtje të teksteve, janë shprehur po mijëra ankesa në mënyrën e furnizimit me materiale të shkollave, me vonesa, joserioze e të papërgjegjshme, kjo është bërë nga një i ashtuquajtur "koordinator nacional". Nuk do t'i kishte hije asnjë OJQ-je të bënte këso gabime, e lëre më një koordinatori nacional. Ne do t'i tregojmë disa defekte, të cilat janë paraqitur gjatë garës dhe shqetësimin e fëmijëve dhe prindërve tanë. Testet e garës së diturisë u shpërndanë me shpejtësi në të gjitha rrjetet sociale. Testet, përveç problemeve teknike akoma është edhe më keq, ka pasur edhe probleme përmbajtjesore. Probleme ka pasur edhe në çelësin e përgjigjeve, shumë gabime kanë ndodhur edhe në vlerësimin e pyetjeve të gabuara si të sakta apo edhe si të pasakta dhe anasjelltas, e fëmijët kanë pas huti se për cilën përgjigje do të votojnë.

Fëmijët e vegjël në shumë vende notohen me shenja apo me figura stimuluese, ndërsa në fëmijëve tanë u japim stres dhe i ngarkojmë psikikisht me këto gara të diturisë vetëm për përfitime të një koordinatori. Ankesa ka pasur shumë edhe të drejtorive komunale, të prindërve, të nxënësve, nuk janë marrë parasysh këto ankesa as nga Ministria e Arsimit dhe as nga



koordinatori, i cili i ka organizuar këto gara. Përgjegjësia bie mbi Ministrinë e Arsimit, e cila është përgjegjëse për të gjitha proceset, të cilat ndodhin në shkollat tona. Në media kosovare është raportuar edhe për diskriminim partiak, këto gara janë shpërndarë në mënyrë më të rregullt në komunat aty ku koordinatori ka pasur interes dhe në komunat ku nuk kanë qenë fitues partia e të ashtuquajturit në fjalë “koordinator profesional” e ka vonuar shpërndarjen e testeve.

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju deputete,

Ne do të rekomandojmë si Lidhje Demokratike e Kosovës të shkarkohet menjëherë koordinatori i programit nacional, Rexhep Hoti. Të ndërpritet menjëherë programi nacional për rini që kohë më parë është miratuar nga Qeveria, të mos vazhdohet në asnjë mënyrë shpenzimi kot i mjeteve financiare, por të kthehen mjetet financiare dhe të dedikohen për drejtoritë e komunave dhe shkollat tona, këto mjete financiare të ndahen edhe për bursa për studentët e dalluar. Të ndalohet gara e këtij lloji skandaloz të fëmijët e vegjël, të kërkohet hetim për mënyrën e shpenzimit të parasë publike nga koordinatori për program nacional dhe më pas të vendosë prokuroria të merret me këtë hetim. Të mos miratohen projekte të tilla me dëme të pariparueshme për nxënësit nga Qeveria, e aq më pak këto projekte skandaloze. Të marrë përgjegjësinë e saj Ministria e Arsimit për aktivitetet brenda shkollave, e jo të përzihen kompetencat në mes të Ministrisë së Kulturës dhe asaj të Arsimit. Programet nacionale për rini duhet të jenë mësim i aftësive profesional, bursa, e jo gara me gabime shumë të mëdha. Nuk ka lidhje programi nacional me një garë që mund të organizohet me bashkëpunimin e MASHT-it nga ndonjë qendër e dëshmuar profesionalisht për arsimin dhe identifikimin e talentit të nxënësve tonë. Këto gara është dashur të organizohen në mënyrë më profesionale dhe të organizohen në kuadër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Prandaj, unë në emër të Lidhjes Demokratike e paraqita disa rekomandime dhe në vazhdim do të thërrasim në interpelancë kryeministrin dhe ministrin e Arsimit, të cilët besoj që do të vijnë dhe do të raportojnë për dëmet e shkaktuara për prindërit dhe nxënësit tanë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Do të shkojmë në bazë të radhitjes dhe partive këtu, të cilat janë paraqitur. Liburn Aliu, në emër të Grupit Parlamentar, pastaj të bëhet gati Donika Kadaj-Bujupi.

**LIBURN ALIU:** Të nderuar deputetë,

Të nderuar familjarë të të pagjeturve në Kosovë, sot bëhen 20 vjet që disa nga dhe shumë qytetarë e pamë për herë të fundit Ukshin Hotin. Kemi pasur, edhe unë personalisht privilegj që bashkë me shumë shokë të tjerë të burgosur ta njohim për së afërmi në vitin 1999 në Burgun e Mitrovicës së Sremit, të Nishit dhe të Dubravës.

Pra, kemi pasur privilegjin që ta njohim, të dëgjojmë fjalën e tij dhe të shohim guximin e tij përgjatë atyre muajve të rëndë, si për gjithë popullin e Kosovës, e po ashtu edhe për ne të burgosurit që gjendeshim në burgjet e Serbisë. Ne patëm mundësinë që në ato pak javë sa

qëndruam bashkë të shohim shumë dimensione të bacës Ukë, e që sot shpesh i dëgjojmë në përshkrimet për të. Patëm privilegjin ta kemi profesor përgjatë leximit të përbashkët të ndonjë libri në dhomën e burgut të Mitrovicës së Sremit, ta njohim nga afër mendimin e tij, ta dëgjonim të na fliste dhe të diskutonim për shumëçka që nga historia e zhvillimeve në vitin '81 e më tej, e po ashtu deri te zhvillimet që ndodhnin atyre javëve. Do të më mbetet përherë në kujtesë zëri i tij në një dhomë të errët, në një natë gjatë bombardimeve të NATO-s. Ne të burgosurit shqiptarë na shpinin shpesh në një bodrum të errët gjoja për siguri, jashtë dëgjoreshin sirenat e alarmit, e ndonjëherë edhe detonime. Aty ishte një errësirë e plotë, sa që nuk mund të shihnim fare njëri-tjetrin, vetëm mund ta dëgjonim zërin e njëri-tjetrit, e atë natë të gjithë ne po dëgjonim me vëmendje ligjëratën e bacës Ukë, e për mua ajo mbetet ligjërata më e veçantë në jetën time.

Bacën Ukën e pamë të gjithë duke mos u përkulur fare as gjatë torturave që përjetuam në Burgun e Nishit, e në fundin e prillit të vitit '99 ishte po i njëjti, ashtu me kokën lart si kudo. Shembull të tillë bënë që për ne të burgosurit shqiptarë në ato vjet burgu të mos ishte aspak i rëndë, të burgosurit qëndruan shumë mirë dhe e ruajtën dinjitetin e tyre edhe atje në Serbi, por për këtë ama ndihmonin njerëzit me karakter të fortë, siç ishte baca Ukë. Në përvojën tonë përgjatë këtyre dekadave të themi kemi rastin shumë shpesh të dëgjojmë shprehjen “guxim intelektual apo intelektual i guximshëm”, duke nënkuptuar gjithmonë njeriun që ka dijen, definon të vërtetën dhe nuk heziton ta thotë atë të vërtetë, edhe përkundër pasojës që mund të ketë. Meqenëse e tërë kjo do të mjaftohej vetëm me një shprehje të thjeshtë intelektual, mbiemri i guximshëm na e bën që disa intelektualë të jenë pra përjashtim, pasi jo të gjithë po e thonë të vërtetën, pra paskemi të tillë që janë vetëm intelektual, që e dinë të vërtetën, por nuk guxojnë ta thonë dhe mbase thonë në vend të saj diçka tjetër.

A është guximi i vetëm i Ukshin Hotit fakti që ai ishte njeriu që asnjëherë nuk hezitoi ta thotë të vërtetën. Madje, që refuzoi të thoshte diçka tjetër përpos të vërtetës. A kufizohet guximi i tij në atë që refuzoi, ta zëmë, të përqeshte Shqipërinë, ndonëse ishte në modë, refuzoi të nënçmonte popullin e tij, apo që refuzoi që dijen e tij ta vë në shërbim të ndërtimit të një farse që maskonte shtypjen dhe pushtimin, natyrisht jo. Dija e tij e shoqëruar edhe nga cilësitë e tjera të dëshmuara ndërtoi një bazë teorike të filozofisë politike të shqiptarëve, e që unë sot nuk po flas për këtë, pastaj ajo gjendet nëpër librat e tij. Ukshin Hoti shkoi edhe më tej se të menduarit dhe të thënit të vërtetën, ai veproi, nuk u ndal së punuari me të gjithë nga punëtori e fshatari i thjeshtë deri tek intelektualët, prandaj përpos Ukshin Hoti, ai njihej edhe si baçi Ukë nga njerëzit e thjeshtë që kishte pranë. Guximi i tij, pra nuk ishte i momentit, guxim impulsiv në një betejë apo ballafaqim, guximi i tij ishte prezent aty përherë pranë tij, i njëtrajtshëm dhe afatgjatë, pasi ishte pjesë e të menduarit të tij. Por, ka diçka që i parapriu atij guximi, diçka për të cilën as që nuk do të arrinte të kishte nevojë ta shfaqte guxim, ajo është refuzimi ndaj joshjes. Ukshin Hoti para se t'i rezistonte presionit, i rezistoi joshjes. Ai me bindjet e tij, dijen e tij qëndronte lart mbi çfarëdo joshje, kjo veti e tij bashkë me guximin ia fuqizuan edhe ia bënë shumë të kuptimtë dhe frytdhënëse dijen e tij.

Baca Ukë na mungon, pikërisht tani në këto momente të vështira për vendin. Do të ishte tejet i nevojshëm në këto momente karshi Serbisë, e po ashtu na mungojnë të gjithë të pagjeturit sot në këtë ditë, që i përkujtojmë të gjithë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Donika Kadaj-Bujupi e ka fjalën. Të bëhet gati zoti Faton Topalli.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë kisha pyetje parlamentare, disa. Mirëpo, për shkak të audiencës së respektuar, familjarëve të të pagjeturve që janë sot me ne, do t'i tërheq të gjitha në mënyrë që t'i vijë radha sa më shpejt pikave që i kemi paraparë në seancë. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Topalli, fjala për ju!

FATON TOPALLI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar familjarë të të pagjeturve,

Po filloj këtë deklaram jashtë rendit të ditës duke shprehur pakënaqësinë e Partisë Socialdemokrate karshi veprimit të kryetarit të Kuvendit, i cili shumë votime i ka paraqitur nga një herë, dy herë, e tri herë me radhë, ndërsa kësaj radhe, kur ishte një çështje bukur e ndjeshme, kundërshtoi që ta hedhë edhe një herë në votim, për shkak të agjendës së disa deputetëve. Unë kam mirëkuptim edhe për agjendën e deputetëve, mirëpo kësaj radhe ka qenë vërtet një situatë kur do të duhej t'u jepnim përparësi mysafirëve këtu.

Tema të cilën unë sot dua të shtroj ka të bëjë me 800 000 mërgimtarë, të cilët sa herë vijnë në Kosovë vazhdojnë të mbushin xhirollogaritë e shoqatave të sigurimit vetëm për interesat e tyre, që i bie njëfarë plaçkitje e vazhdueshme për vite me radhë, për të cilën ne kemi reaguar disa herë dhe deri më tani nuk është arritur asnjë zgjidhje.

Së paku unë në cilësinë e deputetit të Lëvizjes Vetëvendosje dhe më vonë të PSD-së, kam shtruar së paku pesë herë këtë çështje, qoftë përmes pyetjeve parlamentare, qoftë duke iu drejtua kryeministrave, qoftë edhe me rezolutën e fundit që është bërë më 5 qershor të vitit të kaluar e nga e cila nuk kemi asnjë rezultat.

Dua t'ia përkujtoj Kuvendit të Kosovës, se cilat kanë qenë rekomandimet e Qeverisë. Kuvendi i Kosovës mbështet Komisionin për Buxhet dhe Financa si komision funksional që t'i koordinojë hapat mbikëqyrës dhe organizativ të institucioneve kompetente në vend, në radhë të parë të Bankës Qendrore të Kosovës, Byrosë Kosovare të Sigurimeve, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Financave, me qëllim të zgjidhjes së shpejtë të çështjes në fjalë, duke

mos përjashtuar zgjidhje alternative deri në anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Byrove të Kartonit të Gjelbër.

Komisioni për Buxhet dhe Financa si dhe grupet punuese që derivojnë nga ai ka për detyrë që t'i koordinojnë dhe ndajnë detyrat për institucionet relevante të vendit, si dhe t'i përcaktojnë veprimet konkrete brenda detyrave për secilin aktor.

Mjerisht deri më tani, asnjëra nga këto dy pika dhe ne nuk kemi asnjë informacion se çfarë është bërë deri më tani. Pra, përveç disa veprimeve në fillim, ku është konstatuar se mund të bëhet një zgjidhje me Austrinë, për të cilën Komisioni për Financa nuk ka asnjë meritë, sepse kjo çështje ka qenë duke vazhduar gjithsesi edhe pa ta. Pra, nuk kemi asnjë rezultat, nuk kemi asnjë raport.

BÇK-ja, thuhet në rezolutë, në rolin e saj mbikëqyrës mbi Byronë e Sigurimeve të Kosovës, të kërkojë nga Byroja e Sigurimeve të Kosovës që deri më 30 qershor 2018 të analizojë lartësinë e “primit” të policës kufitare për të shikuar mundësinë e uljes së çmimit të saj prej datës 1 korrik 2018. Mjerisht, edhe kjo nuk është bërë.

Brenda një muaji Ministria e Punëve të Brendshme obligohet të dalë me plan veprues për reduktimin e automjeteve të peregjistruara që qarkullojnë brenda Republikës së Kosovës. Kjo pikë nuk është realizuar asnjëherë. Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka raportuar asnjëherë. Brenda periudhës tremujore Ministria e Punëve të Brendshme ta reduktojë numrin e automjeteve të peregjistruara nga 20 në 5%, as kjo pikë nuk është realizuar.

Komisioni për Buxhet dhe Financa si dhe grupet punuese që dalin nga ai më së largu deri më 1 dhjetor 2018 t'i paraqesin Kuvendit raportin për ecurinë e angazhimeve të secilit institucion. Nëse deri atëherë nuk arrihet zgjidhje e përkohshme apo e përhershme për kartonin e gjelbër t'i paraqesë Kuvendit koston financiare të njohjes së njëanshme të kartonit të gjelbër.

Pra, asnjë nga pikat e paraqitura në rezolutë nuk janë realizuar. Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk ka raportuar asnjëherë. Çfarë do të thotë kjo? Në deklaratimet e mia rreth kartonit të gjelbër kam thënë disa herë që nuk është problemi vetëm te Byroja e Sigurimeve, por politika nuk është e interesuar që kjo çështje të zgjidhet. Pra, në njëfarë mënyre politika dëshiron që shoqatat e sigurimeve të vazhdojnë të pasurohen edhe më tutje, ndërsa në këtë mënyrë mërgimtarët e Kosovës, pra qytetarët e Republikës së Kosovës, të vazhdojnë të plaçqiten edhe më tutje.

Fakti që asnjë nga pikat e paraqitura në rezolutën, e cila është miratuar nga shumica e deputetëve, pra nga 78 deputetë, tregon që supozimi im se politika e mbështet moszgjidhjen e problemit të kartonit të gjelbër e vërteton këtë. Faleminderit!

KRYETARI: Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit!

Unë sot në këtë pikë të rendit të ditës do të ju drejtohem juve në shërbim të interesit të qytetarëve të Çikatovës së Vjetër të komunës së Drenasit. Ata kanë një problem me pronat e tyre, të cilat pas privatizimit të Ferronikelit i kanë kaluar në pronësi Ferronikelit e në ndërkohë nuk janë shpronësuar. Bëhet fjalë për 40 - 60 hektarë tokë të pashpronësuar të këtij fshati, të cilën Ferronikeli do ta eksploatorë. Ndoshta Ferronikeli në këtë rast nuk ka faj, për arsye sepse kështu e ka privatizuar, por ky problem po vazhdon të mbetet ende për banorët e Çikatovës së Vjetër, të cilët gjenden para situatës krejt të palakmueshme.

Pra, atje bëhet fjalë për disa toka, jo për të gjitha tokat, por për disa toka të cilat nuk janë shpronësuar. Banorët nuk kanë marrë asnjëherë, asnjë lloj shpronësimi, me gjithë negociatat e vazhdueshme që ka pasur në mes banorëve të fshatit, komunës, AKP-së apo edhe vet Ferronikelit. Prandaj, kërkoj që menjëherë me këtë çështje të merret Qeveria e Kosovës dhe madje, kërkoj që pikërisht kryeministri personalisht të merret me këtë çështje, duke qenë i bindur se nëse e trajton mirë Qeveria dhe nëse e trajton këtë çështje kryeministri, atëherë edhe mund ta zgjidh, sepse bëhet fjalë vetëm për disa parcela që nuk janë shpronësuar asnjëherë. Në ndërkohë, banorët atje gjenden në një presion të vazhdueshëm, qoftë nga ana e Policisë, qoftë nga ana e investitorit, në këtë rast nga ana e Ferronikelit, për të vazhduar eksploatimin e tokave.

Unë i kam vizituar personalisht këta banorë dhe kam parë nga afër, që atje tokat që janë shpronësuar nuk ka pasur asnjëherë problem për t'i eksploatuar Ferronikeli. Po bëhet fjalë thjesht për disa parcela që akoma nuk janë shpronësuar. Ata në reagimin e tyre nuk kanë diçka kundër, as Ferronikelit, as Policisë, por në këtë situatë janë të detyruar që të qëndrojnë, edhe në formën e protestës, edhe në formën e rezistencës para ekskavatorëve, që ta mbrojnë tokën e tyre në këtë fshat. Prandaj, një qasje e mirëfilltë, një qasje konstruktive, një qasje shumë më serioze do ta zgjidhte këtë çështje serioze. Në këtë rast, nëse do të kishim një angazhim të duhur të komunës dhe të Qeverisë mund ta zgjidhni këtë punë. Prandaj, në këto pak minuta që kam unë i bëj thirrje Qeverisë dhe komunës që të kalojë në anën e qytetarëve, t'i shohë ata, t'i ndejë ata dhe të bëjë punën e tyre sa më të drejtë që është e mundur. Nëse fillojnë punimet në këtë zonë, atëherë jo vetëm se do të mbeten pa toka këta njerëz për një periudhë të gjatë, por njëkohësisht edhe vetë banimi në këto zona do të bëhet i pamundur.

Kështu që le të merret si thirrje nga ana jonë që t'u dalë në ndihmë dhe në anën e interesit të qytetarëve, qoftë Qeverisë, qoftë komunës dhe në këtë rast kërkojmë edhe mirëkuptimin e menaxhmentin të Ferronikelit, derisa kjo çështje të zgjidhet në shërbim të së drejtës. Faleminderit!

*(Drejtimitin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Myfera Shinik.)*

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Milaim Zeka. Urdhëroni!

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesuese!

Në radhë të parë e falënderoj deputetin Rexhep Selimi, që e paraqiti problemin e tokave, për të cilën kam pasur të flas edhe unë. Rexhë, faleminderit! Këtë temë e kam ngritur si shqetësim edhe me kryeministrin, sepse Ferronikeli familjes Morina, që i ka 41 anëtarë të familjes të vrarë, nuk dëshiron t'ia kompensojë tokën dhe Ferronikeli, e kisha lutur edhe Ministrinë e Ambientit që ta ketë parasysh që është duke i helmuar ujërat në Drenicë, sepse nuk është duke zbatuar kurrfarë kriteresh. Kjo e para.

Po kaloj, kryesuese, në temën e dytë. Shumë shkurt, nuk do marr kohë.

Kam dashur ta ngre në Parlament shqetësimin e Fabrikës së Gypave në Ferizaj dhe kam vetëm një pyetje. Si ka mundësi që Gjykata ka marrë vendim, Gjykata Supreme ka marrë vendim për kompensimin e punëtorëve për kompensim dhe nuk zbatohet vendimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.

Zoti Kurteshi, po ma aprovon, si Avokat i Popullit që ka qenë. Gjykata Kushtetuese dhe e di që zoti Kurteshi ka qenë në mbështetje absolute të këtyre punëtorëve. Ne kur është fjala për Z-Mobilin çdo vendim që e vjen Z-Mobili ne e çohemi, domethënë “araz” edhe themi “duhet...”, po tutemi na prej gjykatave, kur është puna te Z-Mobili i tutemi gjykatës, kur është puna te Fabrika e Gypave hiç, as s'i tutemi gjykatës, as kurrkujt. Se sa në mënyrë të padrejtë funksionon ky shtet i quajtur “Republika e Burdushit” e tregon fakti se ne nuk kemi respekt për asnjë vendim të gjykatave, ato që i kemi.

Dhe krejt e fundit, si deputet desha edhe një herë të shpreh protestën time publike, edhe si deputet, edhe si qytetar, ndaj veprimeve të prokurorëve të Republikës së Kosovës, të cilët shkojnë pa asnjë arsye dhe arrestojnë deputetë, siç ka qenë rasti me deputetin Dardan Molliqaj, që Gjykata kanë thënë “... jo kanë marrë vendim gjykata dje”, “ ka qenë ditë e shtunë, gjykatat nuk punojnë të shtunën...” edhe i kanë shkuar deputetit të Republikës së Kosovës Policia të dielën edhe e kanë arrestua. Nuk di unë a mendojnë këta prokurorë, më së pari a e dinë çka është deputeti i një vendi dhe e dyta, a kanë këta prokurorë familje, a kanë fëmijë, a mendojnë te shqetësimet e familjarëve tanë apo veç u teket, se dikush u jep urdhër politik, “shko gjuajuni filanit” edhe i gjuhen.

Ishalla, Dardan, kështu nuk të kanë tut shumë e vazhdon me fol, po sidoqoftë unë si deputet edhe koleg i yti e shpreh indinjatën time të thellë ndaj veprimeve dhe kërkoj nga kryetari i Parlamentit, të cilit i kam kërkuar edhe në zyre, po më ka thënë, “mbasi s'ju kam çua letra për këta të Vetëvendosjes, nuk po mund t'i çoj as për ty”. E tash, kryetari i Parlamentit duhet me ia drejtua një letër kryeprokurorit të shtetit edhe me i thënë tekstualisht, se nuk munden organet e shtrembësisë, se këtu nuk ka organe të drejtësisë, po këto janë organe të krimit dhe të

shtrembësisë, me prek asnjë deputet të Republikës së Kosovës pa paralajmërim paraprak që ia bën Kryesisë së Kuvendit edhe personalisht kryetarit Kadri Veseli. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Driton Selmanaj. Urdhëroni!

DRITON SELMANAJ: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Shumë të nderuar familjarë të personave të pagjetur.

Në fakt, para disa ditësh ne ishim në një takim, me disa deputetë, me njerëz që jetojnë në komunën e Dragashit. Dhe, çka kuptuam atje? Kuptuam që në një pjesë të Dragashit, që janë diku 16 fshatra, shteti i Kosovës pothuajse nuk ekziston fare. Kjo më nxiti që të bëj pak hulumtim, të shoh çka po ndodh atje, në fakt të pyes njerëz dhe shkova edhe vet atje. Unë pash që 16 fshatra të Gorës nuk kanë lidhje me Republikën e Kosovës. Ata atje realizojnë sistem paralel të arsimit. Kurrikulat e shkollave të tyre janë të Republikës së Serbisë, nuk janë të Republikës së Kosovës. Pagat nuk i marrin prej shtetit të Kosovës, i marrin në fakt edhe prej shtetit të Kosovës, po i marrin edhe prej shtetit të Serbisë.

Sistem paralel shëndetësor, mjeku në ambulancën në rajonin e Gorës në njërin xhep e ka vulën e Republikës së Serbisë, në xhepin tjetër vulën e Republikës së Kosovës, varësisht se çfarë pacienti është ai e ka vulën dhe sillet ashtu.

Sistem paralel të sigurisë. Së fundmi, Qeveria e z.Haradinaj diku dyzet persona u ka lejuar që ata të shiten si roje të pyllit, po njerëzit atje thanë se ata sillen edhe me armë të gjata, që në fakt janë të ngjashëm me rojet e urës deri vonë që i kemi parë në Mitrovicë.

Çfarë po ndodh kështu? Nëse ne kemi pasur telashe me pjesën veriore dhe po provojmë të ushtrojmë sovranitetin atje, si është e mundur që në një rajon të Kosovës, krejt në jug atje të mos kemi qasje fare? Dhe për çudi, kur mora informata që ish-kryetari i Komunës paralele të Gorës, Opshtina Gora, ka qenë njëri prej deputetëve të Republikës së Kosovës, Adem Hoxha. Dhe çka ka prej shtetit të Kosovës ai? Një makinë zyrtare të Qeverisë së Kosovës, me tabela 3Z-003-DHE. Këto i gëzon prej shtetit të Kosovës, shkon çdo ditë në vizitë kur shkon në zyrën e tij në komunën paralele Opshtina Gora (Komuna Gora), e në fakt Komuna e Dragashit është përballë. Dhe krejt kjo çfarë po bëhet, pse po bëhet, nuk mund të bëhet kjo pa mbështetjen e liderëve në Prishtinë. Nuk mund të bëhet kjo pa liderët e disa subjekteve politike nga komuniteti goran ose boshnjak.

Unë mendoj që është koha e fundit. Unë nuk them që kjo po ndodh sot. Kjo ka ndodhur besoj në njëzet vjetët e fundit, po ne do të bëjmë çmos, Kryeministri i vendit, Ministri i Arsimit, ministri i Shëndetësisë, ministri i Punëve të Brendshme, urgjentisht të shtrijë autoritetin në mandatin e tyre

që e kanë me Kushtetutën e Kosovës. Përndryshe, pjesë të Asociacionit të Serbisë nesër i cili po...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESJA: Faleminderit deputet! Fjalën e ka deputeti Ali Lajçi.

ALI LAJÇI: Të nderuar qytetarë të Republikës,

Familje të të vrarëve nga pushteti serb,

Këtu si përfaqësues,

Unë desha t'i ngre disa çështje, por pa tentim replike me një parafolës që tha është Republika e Burdushit kjo. Kjo është Republika e Kosovës dhe ka status juridik politik dhe nuk mund të emërtohen si të tilla, emërtime të cilat e degradojnë edhe statusin, po njëkohësisht, ani pse jeta jonë shoqërore-politike e institucionale është e mbuluar me krim të organizuar, korrupsion e allishverish e nepotizëm e të tjera, po statusi i Republikës nuk preket. Faleminderit.

Diçka tjetër dua të shtrojë. Në zonën e Rugovës atje, ose krahinën e Rugovës ka disa projekte të cilat vazhdimisht e cenojnë komunitetin atje, siç ishte më herët mund të flasim rreth Parkut Nacional i shpallur, i cili faktikisht për nga kriteret dhe analizat nuk është bërë në nivelin e duhur. Aq më tepër edhe nuk është komunikuar drejt e mirë dhe debat të mirëfilltë që të mund të flasim me komunitetin atje. Dhe ai park nacional është shpallur në 2003, 2014, 13, i cili faktikisht e ka marrë nën vete edhe pronën private, sepse ajo krahinë karakterizohet me pronë private të patundshme. Në këtë rast, pa vullnetin e pronarëve është shpallur parku nacional, i cili po ashtu edhe kriteret e tjera, siç është edhe definimi i kufijve në zonën ku shpallet parku nacional, sidomos me Malin e Zi nuk ka qenë dhe ende s'është mendoj çështje e definimit të kufirit dhe hapësirat ku shpallet parku nacional, faktikisht ka qenë e padefinuar dhe si kriter e zhbënte atë veprim të asaj kohe.

Madje, atje kërkohet që, dhe unë them në emër të tyre, sepse ne kemi marrë pjesë në këto procese, që të bëhet revidimi i pronës private nga ai park nacional. Të tjetërsohet, t'u kthehet pronarëve, që në fakt edhe e kanë, por të mos përfshihet në planifikimet e tyre zonale, apo të kësaj qasjeje të gabuar të parkut nacional. Sepse në një mënyrë, krejt ajo është një uzurpim i pronave dhe në këtë rast pronarët kërkojnë që të hiqet prona private nga parku nacional.

Disa minicentrale të cilat po ashtu kanë zgjuar pezëm te ajo krahinë, faktikisht Qeveria është shprehur se mund të tërhiqet nga ai vendim, e që është shumë i drejtë. Por eventualisht...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Ka kaluar koha. Fjalën e ka deputeti Islam Pacolli.



ISLAM PACOLLI: Faleminderit, kryesuese!

Sigurisht që sot e treguam edhe një herë një zhgënjim para familjarëve këtu. Mua më vjen keq, por megjithatë tani është koha për deklaramë, është që duam ta ndërrojmë temën.

Unë kisha dashur të bëjë një kërkesë te ministri i Infrastrukturës se çka po ndodh me rrugën Veternik-Graçanicë, që edhe vitin e kaluar pjesa nga Maksi, apo lloja e cila është bërë, nuk është përfunduar. Edhe për këtë vit është ndarë një milion në buxhetin e Kosovës, po ende nuk ka filluar asgjë.

Një kërkesë tjetër që edhe për rrugën e Podujevës, është që nga viti 2014-2015, e deri më sot ende nuk ka vazhduar ajo rrugë, nuk është përfunduar ajo rrugë dhe natyrisht qytetarët janë të dëmtuar dhe të irrituar. Kisha kërkuar nga ministri që ta japë një përgjigje dhe sigurisht më shumë kisha dashur ta lus që kjo të vazhdojë me një intensitet më të fortë.

E treta që po dua fare të them, i kisha bërë ftesë Kryeministrit, ministrit të Ambientit dhe të gjithë ministrave të tjerë të cilët janë përkatës, ta japin arsyen pse nuk po merret nën kontroll teleferiku i Brezovicës. Qe njëzet vjet pas luftës, ende kontrollohet prej një kompanie fantome, e cila nuk është fare e regjistruar në Kosovë, nuk paguan asnjë taksë në Republikën e Kosovës. Si mund të veprojnë kështu një formë kontrabande? Dhe nuk ka një asnjë insistim apo sqarim rreth kësaj për ta rregulluar. Pasi që gjithë kjo taksë, edhe gjithë kjo pagesa që bëhen në këto shërbime janë pranë Republikës së Kosovës, janë taksa të Republikës së Kosovës, është ekonomia e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit deputet! Fjalën e ka deputeti Danush Ademi.

DANUSH ADEMI: Faleminderit për fjalën!

Në fillim, dua që të gjithë qytetarëve t'ua uroj muajin e shenjtë të Ramazanit. Po e ngre si shqetësim sepse vazhdimisht kemi komunikim me qytetarët në orët e vona, nuk kanë ujë qytetarët prej orës 1 deri në ora 3, bash kur është koha e syfyrit, qytetarët ballafaqohen për mungesë të ujit.

Unë kërkoj nga të gjitha kompanitë e ujësjellësit që së paku në këtë muaj ta kenë parasysh, mos të merren me reduktime në ato orë të vona, po le të merren gjatë ditës, po në orët e vona të mos merren me reduktime të ujit.

Një shqetësim tjetër dua ta ngris. Po në këtë Kuvend, ne shpeshherë edhe shumë projekte kemi aprovuar në ato zona ku jetojnë komunitetet dhe asnjë projekt deri më tani nuk ka filluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës të zbatohet. Mendoj që Qeveria e Republikës së Kosovës dhe ministrat duhet ta kenë parasysh që projektet dhe ato mjetet të cilat i kemi ndarë po nga ky Kuvend që të fillojnë të zbatohen, mos të na shkojnë në deficit, sikurse na kanë shkuar në vitet e

tjera. Kjo kërkesë shkon drejtpërdrejt të gjithë ministrave të Qeverisë së Republikës së Kosovës, që së paku të fillohet edhe me projektet e komuniteteve, jo vetëm me projektet të cilat i kanë ata, elektoratin e vet apo votuesit e vet.

**KRYESUESJA:** Faleminderit, deputet! Kaloj koha 30 minuta për deklaratimet jashtë rendit të ditës.

Kalojmë në pikën e dytë:

## **2. Koha për pyetje parlamentare**

Për këtë seancë janë 42 pyetje parlamentare.

Deputetja Mimoza Kusari-Lila, pyetje për ministrin Uran Ismajli. Deputetja nuk është prezent.

Deputeti Naser Rugova, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Zoti deputet pasi nuk është prezent Kryeministri a doni ta lexoni pyetjen. Faleminderit!

Deputetja Drita Millaku, pyetje për ministrin Uran Ismajli. Deputetja a po doni ta lexoni pyetjen. Urdhëroni. Regjia të lutem fjalën! Drita Millaku.

**DRITA MILLAKU:** Faleminderit nënkryetare!

Meqenëse pyetja është parashtruar para disa muajsh dhe në secilën seancë ministri nuk po është prezent, atëherë për shkak të korrektësisë me qytetarët më duhet ta them. Çështja është me repartin e radiologjisë në Spitalin e Prizrenit. Këtë pyetje e kam ngritur edhe disa herë, mirëpo asnjëherë nuk kam arritur ta marrë asnjë përgjigje prej ministrit. Edhe pse ministrit i jam drejtuar me pyetje a ke qenë ta vizitojë të paktën Spitalin Regjional të Prizrenit, ai ka marrë pjesë, e ka vizituar, mirëpo në bazë të gjendjes aktuale e cila është në Spitalin Rajonal të Prizrenit, ajo është gjithnjë duke u rënduar, për shkak sepse aparaturat janë shumë të vjetra dhe në dëm të pacientëve, të cilët edhe me buxhetin i cili është ndarë prej Ministrisë së Shëndetësisë është një shumë e pamjaftueshme prej 150 mijë euro, për të cilat asnjë prej aparaturë më elementare nuk mund të riparohet apo të rregullohet me ato mjete.

Meqenëse ministri nuk është prezent, unë vetëm po e potencoj dhe po shpresoj që do ta përsëris edhe në seancën e radhës. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit deputete! Fjalën e ka deputeti Glauk Konjufca. Nuk është i pranishëm.

Deputeti Xhelal Sveçla, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj.

XHELAL SVEÇLA: Faleminderit, kryesuese!

Unë nuk do ta lexoj pyetjen meqenëse as Kryeministri nuk është këtu. Po të ju them të drejtën edhe mënyra sesi po veprohet në rastet e pyetjeve parlamentare, ka sjellë një situatë qesharake për Kuvendin, por edhe për temat të cilat ne po duam t'i diskutojmë. Këtë pyetje unë e kam bërë me 28 janar të vitit 2019. Tash jemi në mes të majit. Kështu që është fare, fare qesharake është, edhe jorelevante tash përgjigja e Kryeministrit, i cili edhe në këtë rast po mungon. Kështu që unë pres që Kryeministri të vijë, e pastaj diskutojmë edhe për pyetjen, edhe për komplet çka ka ndodhur prej momentit kur unë e kam shtruar pyetjen, meqenëse edhe ka pasur një seancë e cila ka folur për këtë çështje. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit deputet! Fjalën e ka deputeti Korab Sejdiu, pyetje për ministrin Uran Ismajli.

KORAB SEJDIU: Faleminderit, kryesuese!

Kjo pyetje në fakt është që nga 28 janari, por po e bëj pavarësisht që nuk është ministri këtu, se nuk po e shohim prezent as ata as shumë ministra të tjerë.

Ligji nr. 04/L-156 për kontrollin e duhanit që ka hyrë në fuqi më 22 maj 2013, ndër të tjera, në nenin 11 ndalon pirjen e duhanit në hapësira publike, që definohen në nenin 2, pikë 1.11 si hapësirë e mbyllur e cila i dedikohet qëndrimit të dy apo më shumë njerëzve dhe përfshin hapësirat në të cilat kryhen aktivitetet nga lëmi i shëndetësisë sociale, edukative, arsimore, sportive dhe rekreative, kulturore, artistike, lokaleve hoteliere e shërbyese, hapësirave për pritje, mbledhje, takime, vende të punës me pronësi publike ose private, të gjitha sallat për tubime të njerëzve dhe mjetet e transportit publik.

Me përjashtim të shumë pak hapësirave publike, kjo ndalesë ligjore nuk zbatohet pothuajse askund, përfshirë këtu edhe Kuvendin e Republikës së Kosovës, e veçanërisht lokalet hoteliere dhe shërbyese. Ky problem bëhet edhe më evident gjatë muajit të dimrit, duke e rritur dukshëm dëmin që i shkaktohet personave të pranishëm në këto hapësira publike.

Pyetja ime zoti ministër edhe pse nuk je këtu edhe nuk kthyer përgjigje ende është: Duke e pasur parasysh se pjesa kryesore e zbatimit të këtij obligimi ligjor bie mbi ministrinë që ju drejtoni, çfarë hapash konkretë keni ndërmarrë ose do të ndërmerrni që të siguroheni që ligji në fjalë të zbatohet në plotëni?

Me shpresë që përgjigja e juaj të mos inkorporojë ankesën se nuk keni inspektorë të mjaftueshëm, pasi që përgjegjësia e juaj përfshinë edhe sigurimin e kapaciteteve të mjaftueshme për funksionim adekuat të ministrisë që drejtoni.

Cilët janë ata hapa edhe brenda çfarë afatesh kohore? Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti, Bekim Haxhiu. Pyetje për ministrin Uran Ismaili. Pse nuk është prezent deputeti Haxhiu?

Deputeti Korab Sejdiu, pyetje për ministrin Pal Lekaj. Urdhëroni, deputet.

KORAB SEJDIU: Edhe kjo pyetje është nga 5 shkurti. Do të thotë po shihet qartë që ka injorim total të pyetjeve tona.

Ndonëse ka kaluar më shumë se një dekadë nga shpallja e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, shumë agjencione udhëtimesh vazhdojnë që ta listojnë Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës ‘Adem Jashari’, si aeroport me lokacion në qytet në Serbi.

Këto agjenci arsyetohen ngase informatat lidhur me lokacionin e aeroporteve IATA, që është Shoqata Ndërkombëtare e Transportit Ajror, dhe kjo shoqatë i ka informuar se aeroporti në fjalë, pra ‘Adem Jashari’ gjendet në Serbi.

Kështu që pyetja ime është: Zoti Ministër, a mund të na e shpjegoni pse shteti ynë lejon që kjo shoqatë dhe organizatat e tjera të mos kenë tash e më shumë se 10 vjet të dhëna të përditësuara. Pra, duke e pasur parasysh se ju drejtoni ministrinë përgjegjëse lidhur me këtë çështje, na tregoni ju lutem, se çfarë hapash konkretë keni ndërmarrë ose do të ndërmerrni që të kërkonti që tash e tuje lokacioni i Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës ‘Adem Jashari’ të listohet si Prishtinë, Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputetja Dorontinë Maloku-Kastrati. Pyetje për ministrin, Abelard Tahiri. A dëshironi që ta lexoni pyetjen, deputet? Urdhëroni!

DORUNTINË MALOKU-KASTRATI: Faleminderit, kryesuese!

Unë do t’i bartë të dyja pyetjet, një për ministrin Uran Ismaili dhe një tjetër për ministrin Abelard Tahiri, për seancën e radhës.

KRYESUESJA: Faleminderit! Deputeti Armend Zemaj, pyetje për ministrin Ekrem Mustafa. Deputeti nuk është prezent.

Deputetja Besa Baftiu, pyetje për ministrin Uran Ismaili. Urdhëroni, deputete.

BESA BAFTIU: Faleminderit, kryesuese!

Edhe grupi ynë parlamentar nuk do t'i paraqesë sot pyetjet. Kështu që do t'i bartim për në seancën e radhës. Kuptohet për hir të prezencës së familjarëve të të pagjeturve, t'ju mundësojmë që sa më parë tema për të cilën janë ftuar të diskutohet. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Nënkryetarja e Kuvendit, Aida Dërguti, pyetje për ministrin Ekrem Mustafa. Nuk është prezent.

Deputetja Sala Berisha-Shala, pyetje për ministrin Shyqeri Bytyqi. Nuk është prezent deputetja.

Deputeti Haxhi Avdyli, pyetje për ministrin Uran Ismaili. Deputeti nuk është prezent.

Deputetja Mexhide Mjaku-Topalli, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. A dëshironi që ta lexoni pyetjen, deputete? Urdhëroni!

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Pasi që i kemi prezent edhe familjarët e të zhdukurve këtu dhe mungesën e kryeministrit, e tërheq pyetjen dhe e vendosi për seancën e radhës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Deputeti Salih Zyba, pyetje për ministrin Abelard Tahiri. Urdhëroni, deputet!

SALIH ZYBA: Meqenëse ministri nuk është prezent, pothuajse asnjëri prej kabinetit e duke pasur në konsideratë edhe prezencën e mysafirëve dhe rendin e ditës, edhe unë e tërheq pyetjen. Por, duhet cekur ngase nuk e di sesi do të diskutohet kur mungon kabineti i Qeverisë këtu.

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Deputetja Besa Baftiu e ka fjalën. Nuk dëshiron.

Deputeti Arbër Rexhaj, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Urdhëroni, deputet!

ARBËR REXHAJ: Faleminderit, nënkryetare!

Nuk është hera e parë që andej, pra ku është Qeveria, vendi është i zbrazët. Kjo, për arsye se janë të papërgjegjshëm përballë qytetarëve e po ashtu edhe përballë deputetëve. Kjo papërgjegjshmëri, një ditë do t'i ndëshkojë.

Kemi një ministër aty, dhe çuditërisht që e kemi një, sepse kjo po ndodh rrallë, ngase ndodhë që shumë shpesh të mos e kemi asnjë fare.

Meqenëse, këto pyetjet të cilat i kam bërë kanë qenë shumë kohë përpara dhe janë i janë drejtuar kryeministrit, e kryeministrit nuk po është këtu që t'ju japë përgjigje qytetarëve, unë do të detyrohem që t'i përmend si çështje këto të cilat kam pasur për t'i përmendur, edhe për shkak, mendoj, të interesit të qytetarëve.

Pyetja e parë që i drejtohet kryeministrit, ka qenë rreth çështjes së cenimit të integritetit territorial të vendit. Në fshatin Karaçevë të Kamenicës, në rrugën që i lidhë fshatrat lokale hynë xhandarmëria serbe.

KFOR-i dhe Policia e Kosovës kanë krijuar një rrugë alternative nga arat e këtyre fshatrave për të mos e kaluar atë rrugë të cilën, de facto e njohin, pra Serbi.

Fatkeqësisht unë kam qenë këtu, dhe ajo çfarë dua t'ju them së pari qytetarëve, sepse kjo Qeveri është e papërgjegjshme, është se me sytë e mi e kam parë sesi xhandarmëria serbe, pra hynë në territorin e Republikës së Kosovës, madje jam përballur me veturë ballë përballë me ta.

Pyetja ka pasur të bëjë rreth demarkimit. A do të ndodhte në analogji delimitimi i kufirit edhe në këtë pjesë të...?

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Deputeti Arbër Rexhaj, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Urdhëroni! Regjia, fjalën deputetit.

ARBËR REXHAJ: Edhe kjo pyetje, ka të bëjë prapë me çështjen e cenimit të integritetit territorial të Republikës së Kosovës. Ajo që më mbeti pak anash e që po dua ta potencoj e nuk mjaftoi koha, ishte se a do të ndodhë e njëjta gjë edhe me këtë pjesë të Kosovës, me këto hektarë tokë, siç ndodhi me demarkacionin.

Ndërsa, kjo pyetje ka pasur të bëjë me delimitimin e kufirit me Malin e Zi, me ç'rast Ramush Haradinaj së bashku me Hashim Thaçin dhe shokët e tjerë, ia dhanë Malit të Zi 8 200 hektarë tokë.

Meqenëse kjo Qeveri nuk do ta ketë jetën e gjatë fatmirësisht, unë pata për ta pyetur atë, se kur do ta rishikon këtë marrëveshje, sepse ka pretenduar se do t'ia kthejë 8200 hektarë tokë Kosovës.

Kthimi i 8 200 hektarëve tokë kur bie kjo Qeveri, sigurisht që është sikur në ata filmat e Kinostudios së Re, në kuptim bardhezi, dhe se përnjëmend është këngë në kuptimin e njëllonj iluzioni që ai fort po i ka për dëshirë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Faleminderit!

Deputetja Fatmire Kollçaku, pyetje për ministrin Uran Ismaili. Faleminderit. Deputetja Arbërie Nagavci, pyetje për ministrin Valdrin Lluka. Faleminderit!

Deputeti Avdullah Hoti, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. As deputeti Hoti nuk është prezent. Deputeti Dardan Sejdiu, pyetje për ministrin Ekrem Mustafa. Faleminderit!

Nënkryetarja e Kuvendit, Aida Dërguti, pyetje për zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Punëve të Jashtme, Behgjet Pacollin. Faleminderit! Nuk është prezent. Deputetja Shqipe Pantina, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Faleminderit!

Deputetja Shqipe Pantina, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Deputeti Xhelal Sevçla, pyetje për ministrin Rustem Berisha. Urdhëroni, deputet!

XHELAL SVEÇLA: Përderisa për pyetjen e parë, mund të themi se fajin e ka Kryesia e Kuvendit, për keqorganizim të seancave. Pyetjen e dytë, prapë nuk do ta shtroj, për shaka se ministri i Mbrojtjes tash, nuk është këtu.

Kështu që e shty për radhën tjetër.

KRYESUESJA: Faleminderit! Vazhdojmë me pyetjet parlamentare për herë të parë. Deputetja Mimoza Kusari-Lila, pyetje për ministrin Skender Reçica. Deputetja nuk është prezent.

Deputeti Avdullah Hoti, pyetje për ministrin Kujtim Gashi. As deputeti Hoti nuk është prezent. Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Fatmir Matoshi. Nuk është prezent.

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi, pyetje për ministrin Ekrem Mustafa. Faleminderit! Deputetja Donika Kadaj-Bujupi... Faleminderit!

Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministrin Ekrem Mustafa. Urdhëroni, deputet!

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit! Edhe unë do t'i tërheq pyetjet, por vetëm dëshiroj të them diçka.

Pyetjet e deputetëve zakonisht janë jashtë kontekstit kohorë, jo për shkak të deputetëve, po për shkak të papërgjegjësisë së Qeverisë dhe papërgjegjësisë së Kryesisë së Kuvendit, e cila i thërret mbledhjet jo sipas planit të punës që vet e ka propozuar, po sipas dëshirave të saj, e që papërgjegjësi totale.

Thërrisni mbledhjet e Kuvendit ashtu siç e keni planifikuar. Sot, i tërheq këto pyetje për shumë arsye. Pra, i shtyjë për mbledhjen tjetër për shkak të prezencës së familjarëve të dëshmorëve.

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Deputeti Ismajl Kurteshi. A dëshironi ta merrni fjalën? Faleminderit!

Deputeti Haxhi Avdyli, pyetje për ministrin Uran Ismaili. Nuk është prezent as ministri dhe as deputeti. Deputetja Doruntinë Maloku-Kastrati, pyetje për ministrin Uran Ismaili. Nuk është prezent.

Deputeti Fidan Rekaliu... Nuk është prezent. Fidan, më fal të lutem! Pra, deputeti Fidan Rekaliu, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. A dëshironi që ta lexoni pyetjen? Urdhëroni!

FIDAN REKALIU: Faleminderit, e nderuar kryesuese! Jo, dua ta shtyjë deri kur kryeministri të jetë prezent këtu. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Deputeti Naser Rugova, pyetje për ministrin Uran Ismaili. Urdhëroni!

NASER RUGOVA: Faleminderit, zonja kryesuese! Edhe unë dua ta shtyjë këtë pyetje për seancën e ardhshme dhe kisha kërkuar edhe nga të gjithë kolegët e tjerë deputetë, që të procedojmë me rendin e ditës.

Kjo për hir të korrektësisë, sepse i kemi ftuar familjarët e personave të pagjetur dhe të vazhdojmë tutje, dhe besoj që të gjithë kolegët pajtohen me këtë propozim. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare, do të publikohen në Revistën e Kuvendit dhe faqen zyrtare elektronike të Kuvendit. Faleminderit! Pauzën e kemi deri në orën 14:00. Faleminderit!

\* \* \*



*Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës*  
*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.*

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,  
Jemi në vazhdimin e seancës.

Jemi te pika: Shqyrtimi i propozim Rezolutës për gjenocidin e kryer serb në Kosovë

Po, zonja Donika po e kërkon fjalën, edhe paraprakisht ka kërkuar diçka për seancë, të lutem.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, kryetar!

Të nderur kolegë deputetë,

Është mocion procedural,

Ju kisha lutur të gjithëve që ta votojmë bashkë dhe të jemi pro propozimit si në vijim:

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65, paragrafi 1 të Kushtetutës mbi kompetencat e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe nenit 6, paragrafit të Rregullores së Kuvendit të përkrahim që në rend dite tani ta fusim edhe një propozim-rezolutë në lidhje me krijimin e ‘Këndit të kurajës’.

Gjatë luftës së fundit në Kosovës ka ndodhur rreth 20 mijë raste të përdhunimit dhe abuzimit seksual. Në mars të vitit 2014, Kuvendi i Kosovës ka miratuar ndryshimet e nevojshme ligjore, në mënyrë që viktimave t’u rregullohet statusi dhe përmes ligjit.

Komisioni i Qeverisë për pranim dhe verifikim të statusit të viktimave të dhunës seksuale e ka njohur statusin e grave të dhunuara gjatë luftës.

Shumë burra dhe gra u përdhunuan, u torturuan dhe u abuzuan nga Policia dhe ushtria serbe. Shumica e të mbijetuarve hezitojnë dhe shumë syresh ende nuk kanë treguar rrëfimet e tyre në lidhje me atë se çfarë u ndodhi gjatë luftës. Ato vazhdojnë të vuajnë në heshtje.

Vasfije Krasniqi-Goodman është një prej të mbijetuarve të dhunës seksuale nga lufta e fundit, e cila ka treguar publikisht historinë e saj, pa e fshehur identitetin. Ajo ka marrë mbi supë detyrën sublime për të fuqizuar viktimat e rasteve të tilla përmes tragjedisë personale.

Zonja Goodman së fundit është paraqitur edhe në Kongresin Amerikan, ku ka rrëfyer ngjarjen e saj përballë kongresistëve dhe përballë gjithë botës.

Kjo kategori e njerëzve, këto gra dhe këta burra kanë nevojë për mbështetjen e të gjithë qytetarëve dhe sidomos kanë nevojë për inkurajimin edhe më të madh institucional.

Si rrjedhojë e kësaj, propozoj si në vijim:

1. Qeveria e Kosovës, Presidenca dhe Kuvendi i Kosovës të mbështesin një hapësirë brenda institucioneve, ku pasqyrohen punimet e viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovës. Këto punim dore do të mundësohen nga qendra të ndryshme, siç është Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës dhe Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave në Drenas, Medika Gjakova dhe qendra të tjera, të cilat tani e 20 vjet me vullnet të mirë angazhohen dhe i përkrahin këto gra dhe rrëfimet e tyre të tmerrshme.

Hapësira e dedikuar për ekspozimin e punimeve artizanale të quhet “Këndi i kurajës”.

Punimet e prodhuara nga viktimat e dhunës seksuale të ekspozohen në këto tri hapësira institucionale, në mënyrë që edhe të ardhurat nga shitja e këtyre punimeve të ndihmojnë ekonominë familjare të këtyre grave. Ndërkaq ekspozimi i punimeve është treguesi më i mirë i tmerrit që ato kanë përjetuar.

Kjo rezolutë të hyjë në fuqi sot, pra në ditën e miratimit të saj.

Unë ju thërras që në minutat në vijim të më përkrahni në këtë mocion procedural dhe pas saj, së bashku ta votojmë dhe ta nxjerrim edhe rezolutën përkatëse. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Është mocion procedural, shkojmë në bazë të Rregullores, e nxjerr në votim.

Ju kisha lutur, do të votojmë në rend të parë për prezencën, pastaj për mocionin procedural.

Regjia dhe deputetët, të përgatiten për votim, votojmë tash për prezencë.

79 deputetë kanë votuar. 85 fizikisht janë prezentë në sallë.

Votimi procedural, tash shkojmë në votim.

Përgatitemi për votim, votojmë tash:

83 deputetë kanë votuar, nga 85 prezentë në sall për, do të thotë futet pikë e rendit të ditës.

Për mbarëvajtjen e seancës kisha pasur dëshirë, në qoftë se ka mundësi, nuk di a do të harmonizohet ajo deklarata, të ulen edhe grupet parlamentare të merren vesh edhe për votimin e të gjitha këtyre çka i kemi, edhe këtyre propozimeve të tjera, në të njëjtën formë pas debatit. Po flasim pas debatit, pas përfundimit të debatit, shikoni a dëshironi që t'i vejmë në votim pastaj bashkërisht, të keni parasysh, veç kur takohen në konsultim.

Po urdhëro, zonja Bogujevci.

SARANDA BOGUJEVCI: Faleminderit!

Së pari, kisha kërkuar nga mediat që të hiqet fotografia që u paraqit më herët, është kërkesë e familjarëve, janë të shqetësuar, kanë kontaktuar Qendrën KRCD, të cilën e udhëheq zonja Feride, sa më njoftoi janë të gjithë tepër të shqetësuar, kështu që kisha kërkuar të respektohen dhe të largohet ajo fotografi.

Tjetra, zonja Brovina, më vjen shumë keq, po është komplet e padrejtë që u bë ajo. Shihet viktima, po thua që është gjallë, imagjino nëpër çfarë traume kalon ajo kur e sheh nëpër krejt media veten e saj dhe familja e saj, edhe familjarë të tjerë, domethënë që kanë kaluar nëpër trauma të njëjta, ta shohin atë fotografi. Kjo i bie të mos trajtohet me dinjitet ai person.

Po flas edhe vetë nga përvoja ime që nëse dikush e kishte postuar një fotografi të ngjarjes në momenti kur ka ndodhur, çfarë traume do të ishte për mua. Është e padrejtë dhe është e padinjitetshme, po flas për viktimat, e di qysh është, nuk e di a ke qëlluar ti të të ndodhë një diçka e tillë dhe ta shohësh veten edhe krejt mediat në atë gjendje. Përveç tjerash, ajo mund të identifikohet, dhe çka nëse si rezultat i postimit të asaj fotografie i ndodh diçka viktimës, këto gjëra duhet të merren me shumë përgjegjësi.

KRYETARI: Faleminderit!

Një nga heroinat e Kosovës pas lufte është Vassije Krasniqi, e cila e ka mundur në çdo aspekt dhe ka dëshmuar botërisht atë çka ka ndodhur.

Po të vazhdojmë me seancën, të koncentrohemi në seancë, të mos shkëputemi se po më vjen edhe rëndë.

Kjo është futur si pikë e rendit të ditës, ky propozim. Faleminderit!

### **3. Shqyrtimi i Propozim-rezolutës për gjenocidin, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës të ish-regjimit shtetëror serb në Kosovë**

Komisioni ad hoc për hartimin e Projekt-rezolutës për gjenocidin e kryer serb në Kosovë, i formuar në seancën plenare të mbajtur më 15 prill 2019, e ka hartuar projektrezolutën dhe Kuvendit i propozon për miratim.

Ftoj deputetin, përkatësisht kryetarin e Grupit Parlamentar, zotin Bilall Sherifi, që në emër të Komisionit ad hoc ta paraqesë projekt-rezolutën.

BILALL SHERIFI: Të nderuara përfaqësuese të familjarëve të viktimave të pagjetura,

Në nderuar qytetarë,

Të nderuar familjarë të viktimave anekënd Kosovës,

I nderuar kryetar,  
Kryeministër,  
Kolegë deputetë,

Jam sot para jush që të prezantoj rezolutën apo projekt-rezolutën, të cilën e kemi përgatitur të gjitha grupet parlamentare, përfaqësues të të gjitha grupeve parlamentare.

Kemi bërë një punë të përbashkët në funksion të miratimit të një rezolute me qëllimin më të mirë që t'i jepet fund pandëshkueshmërisë së krimeve të shtetit të Serbisë në Kosovës.

Ne e dimë që rezoluta nuk është hapi i fundit, por, po, gjithsesi që është hapi i parë. Hapi i parë drejt ndërtimit të një rrëfimi të përbashkët të shkruar të të gjithë neve, se çka është dhe si quhet i tërë ai krim që ka ndodhur në Kosovë, i tërë ai krim, të cilin e kanë kryer forcat e aparatit represiv shtetëror të Serbisë në Kosovë.

Pra, ne me qëllim e kemi quajtur Rezolutë për gjenocidin e kryer serb në Kosovë, pra bëhet fjalë për një rezolutë, përmes së cilës përderisa për 20 vjet me radhë kemi pasur tendencë që të ndërrohen rolet, në vend që të lexohet ashtu siç ka qenë agresori është Serbia, shteti i Serbisë, regjimi i Serbisë, aparati shtetëror i Serbisë me mënyrën se si është trajtuar lufta në Kosovë gradualisht filluan të ndërrohen rolet, thuajse populli i Kosovës në krye me Ushtrinë Çlirimtare të saj ka bërë krime në Kosovë dhe jo ushtria dhe Policia e Serbisë, jo aparati shtetëror dhe jo regjimi i Serbisë, jo shteti i Serbisë.

Përderisa për 20 vjet krimet e pretenduara të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë trajtuar nga katër nivele, duke filluar nga Gjykata e Hagës, gjykatat e UNMIK-ut, Gjykata e EULEX-it dhe tani në fund edhe Dhomat e Veçanta, tash të quajtura Gjykata Speciale, në Serbi thanë se ajo do t'i gjykojë vetë, ajo do t'i dënojë vetë krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë.

Dhe për 20 vjet në vend që të dënohen krimet, Serbia filloi t'i mohojë, shteti i Serbisë filloi t'i mohojë. Pra, përmes mohimit të krimeve të kryera në Kosovë ajo synon mosndëshkimin, përmes mosndëshkimit të krimeve të kryera në fëmijë, në gra, në pleq, në ekonomi, në kulturë, në objekte kulturore, në të gjitha, ajo synon të amnistojë të gjithë ata individë, qofshin ushtarë, policë, oficerë dhe, duke i fshehur këta, të fshehtë edhe krimin që e ka kryer si shtet.

Prandaj, është koha e fundit që Kuvendi i Kosovës siç thashë përmes deputetëve, populli i Kosovës përmes deputetëve të saj të ketë një rrëfim të përbashkët.

Unë këtu falënderoj secilin anëtar të komisionit veç e veç të LDK-së, zotin Armend Zemaj, të VV-së zonjën Saranda Bogujevci, të PDK-së zotin Mërgim Lushtaku, të AAK-së Muharrem Nitaj, falënderoj gjithashtu deputetin Sami Kurteshi, i cili edhe pse nuk ishte anëtar formal, ka punuar me një zell të jashtëzakonshëm në punimin e kësaj projekt-rezolute.

Do të më lejoni që ta falënderoj edhe zonjën Duda Balje, si anëtare e komisionit, e cila ka marrë pjesë në mënyrë aktive. Për fund, por jo siç thuhet për nga rëndësia, edhe deputeten Aida Dërguti, kërkoj falje nëse e ngatërrova radhën e përmendjes së kolegëve anëtarëve të komisionit, po në fund do të kisha pasur dëshirë të përmend edhe kontributin në këtë projekt-rezolutë të ish-përfaqësuesit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, zotin Bardhyl Mahmuti, i cili besoj që ka qenë i angazhuar jo vetëm në këtë rezolutë, por edhe përmes një libri jashtëzakonisht të dobishëm për demantimin dhe demaskimin e propagandës të shovinizmit të Serbisë kundër luftës së drejtë të popullit tonë të udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Tani unë këtu nuk do të lexoj në tërësi rezolutën, për faktin se kjo rezolutë do t'i nënshtrohet debatit nga ju, deputetë të nderuar dhe në bashkëpunim edhe me sekretarin e Kuvendit, e parapamë këtë procedurë që së pari të hapet debati, të prezantojë kështu në fund të rezymsë, siç e bëra deri më tani, edhe një pjesë që do të mund ta shtoj për 2-3 minuta, jo më gjatë dhe pastaj të hapet debati dhe në fund, kur deputetët të kenë thënë, secili grup parlamentar dhe secili deputetë veç e veç, fjalën e tyre, fjalën e saj, atëherë si rregull procedurale të lexohet në tërësi rezoluta, e cila sot e sa do që do të kërkojë kohë, do të obligojë institucionet e Kosovës, Parlamentin, Qeverinë, Presidencën, institucionet e drejtësisë që të kërkojnë drejtësi, deri sa drejtësia të vihet në vend.

Dhe, të gjithë ata që mendojnë dhe thonë se kriminelët po vdesin, prandaj qenka vonë të ndiqen krimet e luftës, ju them se kriminelët, të cilët janë gjallë, do të përpiqemi t'i vëmë para drejtësisë. Por, shteti i Serbisë do të jetë aty dhe ajo gjithsesi, ai shtet, gjithsesi do të vijë para drejtësisë herë do kurdo.

Krimet e gjenocidit, krimet që kryhen gjatë luftës nuk vjetërsohen kurrë, edhe shteti do të mbajë përgjegjësi kushdo që do të vijë në krye të Serbisë pas 5, 10, 15 apo 20 vjetëve, ne do të jemi këtu dhe do të ndjekim drejtësinë deri në fund, ashtu siç e bëjnë të gjithë popujt e qytetëruar që nuk heqin dorë nga kërkimi i drejtësisë dhe të së vërtetës. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Armend Zemaj e ka fjalën.

**ARMEND ZEMAJ:** Të nderuar kolegë deputetë,  
Familjarë të të pagjeturve dhe të gjithë të tjerëve, të cilët kanë pësuar nga regjimi i Serbisë dhe ish-Jugosllavisë gjatë viteve të '90-a dhe në kohën e luftës.

Më lejoni që në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës t'i jap përkrahje kësaj projekt-rezolute, ashtu siç e potencoi edhe kolegu im, për gjenocidin serb të kryer në Kosovë në vitet 1998/99, duke renditur së pari dhe duke pasur parasysh konventat ndërkombëtare, të cilat janë të miratuara nga bota demokratike për parandalimin dhe dënimin e krimeve të gjenocidit. Duke u bazuar në bazën juridike, përmes raporteve dhe rezolutave, po ashtu ndërkombëtare për krimet dhe

aparteidin e ndodhur në Republikën e Kosovës gjatë viteve të '90-ta, duke renditur faktet relevante të krimeve të kryera monstruoze dhe masakrave gjatë viteve '90-ave dhe duke kërkuar simbolikisht një ditë, një datë të përkujtimit të gjenocidit dhe duke kujtuar dhe kërkuar që ky gjenocid, përpos që do të kërkohet të njihet nga institucionet e Republikës së Kosovës si pjesë e legjislativit, të jetë obligim edhe për botën demokratike si kërkesë drejtuar atyre që i kanë kryer këto krime, Serbisë dhe pjesa tjetër që radhitet si obligim shtetëror joni dhe institucional për t'i rikthyer sado pak vuajtjet dhe dhimbjet, e sidomos zbardhjen e fatit të pagjetur e mijëra shqiptarëve ë sot e asaj dite akoma nuk dihet për fatin e tyre.

Kolegë deputetë,

Është e vërtetë që simbolikisht ndoshta nuk do të duhej të ishte si temë puna jonë dhe përkushtimi ynë me hartimin e kësaj draft-rezolute. Ajo çka na ka bashkuar është fakti jo për të dëshmuar diçka e cila nuk është e njohur, por për të kryer një obligim, të cilin institucionet e Republikës së Kosovës, organi më i lartë legjislativ nuk ka arritur që 20 vjet nga përfundimi i saj ta sjellë para të zgjedhurve të popullit dhe para qytetarëve të saj një rezolutë të tillë. Kjo është arsyeja e parë.

Arsyeja e dytë është që, sado pak apo sado shumë të jetë një thirrje për të gjithë ata që çfarëdo forme, çfarëdo mënyre përdorin, keqpërdorin dhe njëherësh minimizojnë apo mohojnë krimet e kryera në vitet '90-ta në Republikën e Kosovës.

Dhe, pjesa tjetër, obligimi që del për të zgjedhurit, ata që kanë përgjegjësi institucionale ekzekutive që duhet sa më pak fjalë, por sa më shumë punë për të rikthyer në vepra atë që e kërkon bota demokratike, dënimin dhe gjykimin e të gjithë atyre që kanë kryer krime gjatë asaj periudhe.

Kolegë deputetë,

Përfaqësues të tjerë,

Lidhja Demokratike e Kosovës ka propozuar, përtej kësaj, edhe një propozim, i cili ndërlidhet me atë që quhet 'gjenocid'.

Duke marrë parasysh që gjenocidi nuk është vetëm shkatërrim i menjëhershëm i një kombi, përkundrazi ka për qëllim shkatërrimin e bazave thelbësore të jetës së grupeve etnike, në këtë aspekt grupit shqiptar.

Një ndër objektivat e planit gjenocidal të Serbisë ka qenë edhe shpërbërja e institucioneve politike, sociale e kulturore, gjuhësore, ndjenjave kombëtare, mbijetesës ekonomike të grupit etnik shqiptar në Republikën e Kosovës.

Ligji ndërkombëtar për parandalimin dhe dënimin e gjenocidit obligon të gjithë nënshkruesit, por edhe ata që i përkasin botës demokratike, ta pengojnë dhe ta dënojnë aktet gjenocidiale si në kohë paqe, ashtu edhe në kohë lufte. Dhe, për këtë arsye unë kam propozuar që një ndër referenca të jetë viti 1989-1999, duke marrë për bazë që për 10 vjet populli shqiptar në Kosovë ka qenë i nënshtruar dhe pjesë i një apartheidi nga regji serb, ushtarak, policor, i udhëhequr sigurisht nga kasapi i Ballkanit Slobodan Milosheviq dhe të mos harrojmë se në mars të vitit 1990 dhe prill kemi pasur më shumë se 7 mijë nxënës, fëmijë të helmuar dhe kjo ka qenë akti më makabër për të filluar atë që ne sot po kërkojmë dhe për të dënuar gjenocidin në Republikën e Kosovës. Kështu që kjo mund të pyesni pse nuk është pjesë e kësaj rezolute, pjesë e këtij dokumenti dhe dakordimit tonë të përbashkët, mendoj që ndoshta do të duhej të japim hapësirë e një momentum, por për këtë e kemi lënë të vendosë dhe Kuvendi dhe për të mirëkuptuar apo për të mos thënë, për të mos e prolonguar miratimin e kësaj rezolute në bashkëpunim edhe me botën demokratike dhe me partnerët e tjerë, të cilët e konsiderojnë më të ngushtuar këtë periudhën '98-'99, si pjesa më gjenocidiale që ka ndodhur dhe krimet makabre që janë kryer ndaj popullsisë etnike shqiptare.

Më lejoni që të përfundoj me këtë dhe të kërkoj njëherësh miratimin e kësaj rezolute, në mënyrë unanime dhe si akt më i vogël që ka mundur të bëjë Kuvendi i Kosovës për familjet, për popullin shqiptar dhe për kërkesën për të dënuar dhe gjykuar krimet e ish-pushtetit serb dhe jugosllav të asaj kohe ndaj popullsisë shumicë shqiptare në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

**KRYETARI:** Mërgim Lushtaku, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

**MËRGIM LUSHTAKU:** I nderuar kryetar, zoti Veseli!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar anëtarë të familjeve të prekura nga gjenocidi dhe masakra barbare serbe në Kosovë, Fillimisht, dua t'i falënderoj të gjithë ata që kanë kontribuar në arritjen deri në këtë pikë ku jemi sot, të diskutojmë për gjenocidin serb të kryer në Kosovë dhe dua t'i falënderoj ata që kanë kontribuar në Kuvendin e Kosovës, në grupin punues, ata që janë në Kuvend dhe ata që janë jashtë Kuvendit. Faleminderit të gjithëve!

Konsideroj se është një shpagim, në njërën anë dhe, mirënjohje në anën tjetër, për të gjithë ata që kanë sakrifikuar në Kosovë në çfarëdo forme apo mënyre, nëse arrijmë që përmes kësaj rezolute si një proces që Serbia të marrë dënimin e merituar për krimet, shkatërrimet dhe gjenocidin që ia ka shkaktuar Kosovës. Bashkë me kolegët e tjerë deputetë kemi punuar që të arrijmë deri këtu që Kuvendi i Republikës së Kosovës të dalë me një rezolutë për gjenocidin e kryer serb në Kosovë.

Duke u mbështetur në kartat dhe konventat ndërkombëtare të organizatave të Kombeve të Bashkuara dhe institucioneve relevante që flasin për të drejtat e njeriut dhe dënimet e krimeve dhe gjenocidit, pastaj në raport dhe me rezoluta të shumta që ndërlidhen me këtë temë, përmes kësaj rezolute të Kuvendit kërkojmë që shteti serb të pranojë krimet e gjenocidit e kryer në Kosovë, duke dëshmuar së pari se Serbia ka ndryshuar mendësinë politike dhe ka qasje tjetër në raport me Kosovën, në kuadër të fqinjësisë së mirë si dy shtete fqinje.

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Kuvendi i Kosovës, nisur nga faktet që janë numëruar edhe në rezolutë për krimet dhe gjenocidet për masakrat e shumta të kryera nga Serbia në Kosovë, përmes një fushate të planifikuar, të institucionalizuar dhe të orkestruar shtetërore, Serbia ka pasur qëllim zhdukjen e shqiptarëve në Kosovë, duke vrarë rreth 12 mijë civilë të pafajshëm, të pambrojtur, duke i dëbuar nga shtëpitë e veta dhe nga territori i Kosovës mbi 1 milion shqiptarë, duke kryer rreth 100 masakra kolektive, rreth 20 mijë persona të dhunuar seksualisht nga Kosova, kryesisht gra, vajza shqiptare dhe shkaktuar tek ato trauma dhe plagë të pashlyera psikologjike. Serbia, edhe 20 vjet pas përfundimit të luftës, vazhdon të fshehtë çështjen e 1 mijë e 600 të pagjeturve, duke tentuar kështu të humbasë gjurmët e krimit të gjenocidit të kryer. Duke tentuar që Kosova të shndërrojë në një tokë të djegur, Serbia ka shkaktuar ekonomikisht e ka tentuar të zhdukë kujtesën historike të shqiptarëve në Kosovë, duke shkatërruar mbi 100 mijë shtëpi, mbi 80 mijë objekte të tjera përcjellëse dhe rreth 700 shkolla të shkatërruara ose të dëmtuara ndjeshëm, 215 objekte fetare, mbi 100 spitale e shtëpi shëndeti dhe afro 200 shtëpi kulturore, biblioteka e ndërtesa të tjera administrative.

Pa u ndalur në detaje të tjera, përmes kësaj rezolute Kuvendi i Kosovës, ne të zgjedhurit do të përfaqësojmë interesat e qytetarëve të Kosovës, deputetë të këtij Kuvendi, duke miratuar këtë rezolutë kërkojmë që Serbia përpos pranimit të fajit siç e përmenda edhe në fjalën time hyrëse, të ndryshojë fatin e të pagjeturve të vë para drejtësisë përgjegjësit e krimeve të gjenocidit dhe spastrimit etnik të shqiptarëve dhe të paguajë dëmshpërblimin e luftës, duke kompensuar të gjitha shkatërrimet e dëmet e shkaktuara ekonomike të Kosovës, përfshirë këtu edhe kthimin e kontributeve pensionale që ka vjedhur ajo gjatë luftës 1998-1999 në Kosovë.

Të nderuar deputetë,

Ne u përkasim subjekteve të ndryshme politike dhe përfaqësojmë interesa të caktuara politike, por kjo temë, raporti i Kosovës kundër Serbisë, ne të gjithë duhet të bashkohemi dhe t'i lëmë divergjencat anash, si një vend me përgjegjësi, legjislativi, ekzekutivi dhe mekanizmat e tjerë shtetërorë duhet të grumbullojmë energjinë tonë, kapacitetet tona intelektuale e çka tjetër që ne përballë Serbisë të flasim njëzëshëm. Kjo rezolutë është dëshmia më e mirë që ne si Kuvend i Kosovës të dërgojmë unitetin tonë në raport me Serbinë. Përmes një akordimi të veprimeve tona si institucione shtetërore që t'ia arrijmë që Serbia të paguajë për gjenocidet e kryera në Kosovë.



Serbia, duke marrë dënimin e merituar, të rënë do të jenë më të qetë në varret e tyre. Sakrificat që e kanë bërë shqiptarët e Kosovës në njëfarë mënyre do të ishin më të lehta për t'u kujtuar. Do të marrë kuptim të plotë përkujtimi i shënimit të ditëve të të rënëve, të masakrave dhe çdo datë tjetër që do të shënojë në Kosovë si shenjë e përkujtimit të luftës, i tmerreve që kanë përjetuar. Dëshmorët do të ishin më të qetë, amaneti i tyre do të çohet në vend.

Ne si Grup Parlamentar e mbështesim këtë rezolutë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Sami Kurteshi, nga Lëvizja Vetëvendosje.

**SAMI KURTESHI:** Faleminderit për fjalën e dhënë, zoti kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Të nderuar mysafirë,

Sot e kemi tekstin e një rezolute që merret me çështjen kryesore, edhe me krimin më të tmerrshëm që është bërë në Kosovë gjatë periudhës së luftës.

Unë i dëgjova të gjitha fjalimet, natyrisht që fjalimet ishin pjesë dhe janë pjesë e tekstit të kësaj rezolute, edhe janë përfshirë këtu. Natyrisht që kjo rezolutë, unë si jo si pjesë formale e komisionit, por si anëtar i komisionit bashkëpunues, ashtu siç e përmendi edhe zoti Sherifi, kam bërë përpjekje që të ndihmoj me gjithë përvojën time, me gjithë njohuritë e mia që të bëjmë një rezolutë, e cila ka mbështetje të plotë faktike, ka mbështetje të plotë të dokumentuar nga dokumentet ndërkombëtare dhe nga të gjitha zhvillimet e mundshme që kanë mundur të ngjajnë, që kanë ngjarë gjatë asaj kohe. Unë nuk do të merrem me analizën e fakteve, dëshmive, por do të përpiqem të tregoj cila është baza edhe ligjore, edhe faktike e kësaj rezolute. Në tekstin e rezolutës janë marrë parasysh të gjitha dokumentet kryesore, instrumentet kryesore ndërkombëtare që kanë të bëjnë edhe me të drejtat e njeriut, edhe me të drejtën humanitare, duke filluar nga Karta e Kombeve të Bashkuara, mandej Deklaratën universale dhe Konventat e Gjenevës, protokollat e saj, statuti i Tribunalit Ndërkombëtar për Krime të Luftës, edhe konventat për moszbatimin e kufizimeve ligjore në dënimin e këtyre krimeve nga Tribunali i Nyrnbergut, edhe të gjitha rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara që kanë të bëjnë me këtë çështje.

Natyrisht, teksti i rezolutës u referohet të gjitha raporteve ekzistuese ndërkombëtare, të gjitha niveleve edhe të OKB-së, por edhe atyre evropiane dhe që kanë të bëjnë me çështjen e krimit të gjenocidit, krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit. Dokumentet, të cilave u referohet rezoluta, përmbajnë elementet konstituive të krimit të gjenocidit, edhe ato janë raporte të reporterit special, raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, deklaratat e përgjithshme në sesionet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, janë rezolutat e Këshillit të Sigurimit, janë rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, deklaratat e Planit Aksional të Konferencës Botërore të Drejtave të Njeriut dhe rekomandimet e

Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës që më vonë, natyrisht duke u bazuar në përvojat e luftës dhe përvojat e dy tribunaleve ndërkombëtare për dënimin e krimit të gjenocidit, krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit në ish-Jugosllavi dhe në Ruandë, kanë mbështetur këto pjesë dhe elemente konstituive, me të cilat është bërë përpjekje që të dëshmohet krimi i gjenocidit i kryer nga forcat serbe në Kosovë.

Megjithatë, nuk ka asgjë perfekt, por unë kam bindjen se teksti i rezolutës është mbështetur dhe ka marrë parasysh të gjitha instrumentet relevante ndërkombëtare që kanë të bëjnë me këtë çështje. Sa i përket çështjes faktike, kjo ka qenë pjesa më problematike, unë e them këtu qartë, sepse ne duhet të votojmë diçka, për të cilën duhet të dimë çka përmban. Unë kam bërë përpjekje të shfletoj të gjitha dokumentet, gjithë literaturën e të gjitha institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës që janë marrë me hulumtimin e krimeve të luftës në Kosovë. Fatkeqësisht, po e them edhe një herë, këtu kemi vërejtjet me të drejtë, janë disa vërejtje të cekura, fatkeqësisht së pari nuk janë bërë, domethënë nuk janë shteruar të gjitha hulumtimet. Çështja tjetër është se nganjëherë kemi të dhëna që nuk janë të njëjta, edhe çështja e tretë është se në të vërtetë nëse bëjmë përpjekje që pjesa faktike të mbështetet në të dhëna shkencore të bazuara, ajo pjesë është jashtëzakonisht e varfër, këtu në këtë rast ka qenë e mundur të bazohemi vetëm në të dhënat e Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës që nuk janë shteruese, nuk janë të plota.

Këtë po e them për arsye se është çështja së pari te numri i masakrave në Republikën e Kosovës të kryera nga forcat serbe. Këtu ne kemi thënë, edhe pse e kemi shënuar se nuk janë shteruese, rreth 100 masakra, përmenden disa shifra dhe unë mendoj, jam i bindur se numri i masakrave është shumë më i madh, mirëpo ka qenë e pamundur që me gjendjen e tashme të hulumtimeve dhe të mbledhjes së fakteve të nxirren më shumë dhe kjo është një çështje për të cilën duhet të diskutojë në një moment të caktuar Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Çështja tjetër është se ky Kuvend duhet ta ketë si obligim, natyrisht duke rikujtuar të gjitha vendimet e gjykatave të ndryshme ndërkombëtare, si Gjykata Penale Ndërkombëtare për Ruandën, ish-Jugosllavinë, mandej pjesë të ndryshme të Konventës për parandalimin e dënimit të krimit e gjenocidit, është e obliguar dhe ka konstatuar se janë një varg dëshmish që përputhen dhe janë në përputhje të plotë me definicionin e dhënë nga Konventa Ndërkombëtare për Gjenocidin që plotësojnë të gjitha elementet konstituive të krimit të gjenocidit në Republikën e Kosovës.

Përpjekja për të rikujtuar disa pjesë dhe disa krime që kanë qenë më monstruoze, por që nuk janë shteruese dhe nuk janë të vetmet, është bërë pjesa e kërkesave që dalin si obligime për institucione të Republikës së Kosovës edhe ato janë krejt në fund. Unë edhe pas diskutimit me sekretariatit e Komisionit ad hoc, kam edhe disa vërejtje teknike në tekstin, për të cilat do të diskutojmë, unë jam në gjendje t'i paraqes edhe këtu, mendoj se mund t'i shihni. Janë të natyrës

teknike, janë gjëra që kanë shpëtuar në aspektin drejtshkrimor, në aspektin teknik dhe ato mund të përmirësohen lehtë, dhe në qoftë se pajtoheni, për të mos u detyruar që t'i nxjerr në seancë, unë kisha kërkuar që ato përmirësime teknike t'i bëjmë pas seancës, janë disa minuta kohë dhe nuk janë ndryshime të mëdha që prekin përmbajtjen e tekstit të rezolutës. Tash në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje e përkrah dhe do ta votojë këtë tekst të kësaj rezolute për krimin e gjenocidit të kryer nga forcat serbe në Kosovë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Blerim Kuçi, nga Grupi Parlamentar i AAK-së.

**BLERIM KUÇI:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë,

Po kësaj radhe po ju drejtohem juve, kryetar, pak më shumë, sepse kjo seancë pikën bosht e ka pikën e tretë të rendit të ditës, pra Shqyrtimi i Propozim-rezolutës për gjenocidin, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës të ish-regjimit shtetëror serb në Kosovë. Donika e propozoi një rezolutë tjetër, patëm një intencë edhe nga ana e LDK-së për të propozuar rezolutë tjetër. Në qoftë se ne sot votojmë edhe rezoluta të tjera, atëherë e humbim peshën e kësaj pike të rendit të ditës. Po propozoj që propozimet, të cilat i dhanë të futen në harmonizimin e kësaj rezolute, por sot të mos votojmë asnjë rezolutë tjetër, sepse tema bosht dhe më e rëndësishmja është pika e tretë e rendit të ditës.

Në qoftë se ne votojmë ndonjë rezolutë tjetër, atëherë humb kuptimi edhe pesha e kësaj rezolute. Zoti Sami Kurteshi e potencoi pak edhe vërtet është një material shumë profesional, duhet pasur kujdes në harmonizimin e kësaj rezolute. Edhe rezoluta e Donikës që propozoi, unë e votova vetë, por duhet të jetë pjesë ndoshta edhe me emërtim të kësaj rezolute, po jo rezolutë në veti. Pati aty edhe një vendim, mund të nxirret edhe një vendim nga ajo rezolutë, po assesi sot të mos ketë në votim dy a më shumë rezoluta. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Shqipe Pantina nga Partia Socialdemokrate.

**SHQIPE PANTINA:** Faleminderit, kryetar!

Në fakt, sa i takon përmbajtjes së rezolutës ne të gjitha vërejtjet, rekomandimet tona që i kemi pasur i kemi përcjellë në komision përmes përfaqësueses tonë, nënkryetares së Kuvendit, Aida Dërguti dhe ato janë përfshirë, janë marrë parasysh nga komisioni, kështu që ne i japim mbështetje tekstit të rezolutës dhe do ta votojmë atë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Zafir Berisha nga Nisma.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryetar!

Po mendoj se rezoluta, të cilën zoti Sherifi e elaboroi dhe për të cilën edhe kolegët e tjerë folën, është një hap i vogël në drejtim të shërimit të një plage të madhe që quhet 'gjenocid serb në Kosovë' dhe çdo ide tjetër është për t'ia humbur kuptimin kësaj rezolute, edhe pse e vonuar.

Natyrisht se përmes një rezolute, sado faqe të ketë, është e pamundur të përmblihet ajo që ka ndodhur në Kosovë, por sido që të jetë, unë mendoj që rezoluta do ta ketë edhe efektin pozitiv në situatën për të cilën po kalon Kosova, në kthjellen e njerëzve, të cilëve u janë mbuluar nga pluhuri i harresës lidhur me atë që ka ndodhur në Kosovë. Natyrisht ata që lexojnë me vëmendje mund të nxjerrin edhe ndonjë lëshim, por gjithsesi brumi i kësaj rezolute është shumë domethënëse për ndërgjegjësimin e shoqërisë në raport me të kaluarën e hidhur dhe natyrisht në përballje me të ardhmen, që edhe qytetarët e Kosovës e presin. Prandaj, edhe ne si Nisëm Socialdemokrate, natyrisht edhe si ideatorë të kësaj rezolute, presim që të miratohet dhe thjesht kjo të jetë siç e thashë hap i vogël karshi plagës së madhe të hapur që e kemi nga Serbia. Faleminderit!

KRYETARI: Albert Kinolli e ka fjalën nga Grupi 6+.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Familjarë të nderuar,

Ne si Grup Parlamentar 6+ siç e dimë kemi pasur përfaqësuesen tonë në grupin punues dhe kemi dhënë kontributin tonë përmes zonjës Duda Balje.

Ne e mirëpresim këtë rezolutë, e cila shpresojmë, edhe pse pak e vonuar, do të bjerë drejtësinë e vonuar në vend dhe sadopak vuajtjet e familjarëve do t'i zbutë. Ne e përshëndesim grupin punues dhe të gjithë ata, të cilët kanë kontribuar në këtë projekt-rezolutë. Ne e përkrahim, e mbështesim dhe do të votojmë për të. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Vjosa Osmani-Sadriu!

VJOSA OSMANI-SADRIU: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Natyrisht, të nderuar edhe përfaqësues të familjeve të të pagjeturve dhe të viktimave, ne mund të themi sa të duam që është vonë, edhe pse kjo temë, në fakt, shumë shpesh ka qenë e diskutuar edhe në Kuvendin e Kosovës, edhe jashtë Kuvendit, megjithatë përtej diskutimit ne duhet të sigurohemi që sot ky Kuvend të dalë me propozime konkrete, të cilat jo vetëm respektohen, por edhe implementohen. Pra, janë të bëshme, në mënyrë që edhe kjo rezolutë të jetë e tillë unë i kam disa pyetje dhe disa propozime.

E para, para për afërsisht një muaj ose dy në Kuvendin e Kosovës është miratuar platforma për dialogun me Serbinë dhe, ndër të tjera, kjo platformë në faqen e parë të saj thotë: “Ky është qëndrimi i vetëm zyrtar i Republikës së Kosovës”, duke i dhënë edhe fuqi obliguese ligjore, pastaj për të gjitha çështjet që janë trajtuar këtu. Meqenëse qëndrimi i vetëm zyrtar i Republikës së Kosovës, pra të gjitha institucioneve, përfshirë edhe Kuvendin, qenka vetëm ky në platformë, unë kam tentuar në Komisionin për Punë të Jashtme dhe pastaj në çdo mënyrë tjetër që kjo platformë ta thotë të vërtetën lidhur me krimet e kryera në Kosovë.

Fatkeqësisht, platforma thotë që në Kosovë janë kryer vetëm krime lufte dhe shkelje të së drejtës humanitare. E dinë kolegët nga komisioni që kjo ka qenë bregua themelore dhe kanë tentuar në çdo mënyrë që këtu, përveç kategorisë së krimeve të luftës dhe shkeljes të së drejtës humanitare, që prapë është e drejtë e luftës, të futet edhe gjenocidi, nën një, dhe krimet kundër njerëzimit nën 2. Pra, kuptimi themelor dhe fundamental që ne duhet ta kemi sot, është se këto janë tri kategori të ndryshme dhe duhet të përmenden që të tria.

Tash, në qoftë se një dokument i Kuvendit të Republikës së Kosovës i propozuar nga qeveria e i miratuar në këtë Kuvend me 62 deputetë, pra vota të tyre, e mohon gjenocidin dhe krimet kundër njerëzimit dhe aty shkruan se ky qenka qëndrimi i vetëm zyrtar i Republikës së Kosovës, kurse sot e kemi para nesh Projekt-rezolutën që me të drejtë dhe në mënyrë të shkëlqyeshme trajton, edhe gjenocidin, edhe krimet kundër njerëzimit, edhe krimet e luftës, pyetja ime është si mund ta eliminojmë këtë kolizion, sepse rezoluta juridikisht është dokument më i dobët se sa platforma që e kemi miratuar, në të cilën nuk përmendet, as gjenocidi, as krimet kundër njerëzimit, përkundër insistimit tonë, përkundër propozimeve që pastaj janë dhënë nga disa deputetë edhe në Kuvendin e Kosovës nuk janë futur.

Propozimi do të ishte ky, që në tekstin e kësaj rezolute të shtohet që nëpërmjet kësaj rezolute, edhe pse tash administrata mund të tregojë po qe se një gjë e tillë është e mundshme, amendamentohet edhe pjesa në këtë dokument zyrtar të Republikës së Kosovës dhe amendamentohet çdo dokument tjetër zyrtar i Republikës së Kosovës, sa i përket kualifikimit të krimeve të kryera në Kosovë, sepse përndryshe, të nderuar deputetë, të jeni të sigurt që rezoluta që e miratojmë sot do të jetë vetëm llaf. E llafe qytetarët e Kosovës kanë pasur mjaftë. Në qoftë se, dëshironi me pas efektivitet nuk mundemi dokument tjetër të miratojmë këtu për vetveten tonë e dokument tjetër me miratua kur të shkoni në Bruksel. Pra, në Bruksel me e marrë me vete një dokument, i cili nuk e përmend as gjenocidin, as krimet kundër njerëzimit, kurse në Kuvendin e Kosovës përmenden që të tria.

Propozimin e parë pra, e dhashë dhe shpresoj që të gjithë deputetët do të pajtohen që nëpërmjet kësaj rezolute të amendamentohet edhe referimi në këto krime në platformë dhe çdo dokument zyrtar tjetër të institucioneve të Kosovës, në mënyrë që t'i jepet fuqi më e madhe juridike këtij dokumenti.

Çështja e dytë, mendoj se rezoluta patjetër duhet ta ketë një fjali në të dhe ajo është, që pjesëtarë të regjimit serb që kanë kryer këto krime në Kosovë janë akoma në pushtet në Serbi. E di që është fakt, e di që e dinë të gjithë, prandaj edhe duhet të konstatohet në këtë rezolutë, ashtu siç konstatohet çdo gjë tjetër me të drejtë, ashtu siç përmenden krimet duhet të flasim qartë, në veçanti para bashkimit evropian, në mënyrë që këta që sot janë në pushtet në Serbi mos të trajtohen si fëmijë të privilegjuar e të lazduar të BE-së, sepse janë po të njëjtit dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk duhet ta ketë asnjë hezitim për ta thënë këtë gjë.

E treta, në tërë tekstin e këtij dokumenti, përfshi titullin, duhet t'i përmendim të tri kategoritë, pra jo vetëm gjenocidin. Kjo duhet të jetë projekt-rezolutë për gjenocidin serb, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës në Kosovë. Është e domosdoshme, në mënyrë që të mos përjashtohet asnjëra. Prandaj, ndryshime të tilla kërkoj që të bëhen, qoftë nga komisioni që do të vazhdojë punën, qoftë nga administrata, në tërë tekstin. Sepse, për shembull, në faqen 5 nuk mund të konstatohen vetëm veprimet që konstituojnë gjenocid, por po ashtu duhet të konstatohen edhe veprimet që konstituojnë krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Po ashtu, në faqe 5 duhet të shtohet një element thelbësor. Të gjithë ata që janë specializuar në fushën e të së drejtës ndërkombëtare, në veçanti të drejtës humanitare dhe lëndëve të ngjashme, e dinë se në mënyrë që një krim të kualifikohet si gjenocid duhet patjetër të konstatohet që krimet sistematike në Kosovë janë bërë me qëllim të shfarosjes. Elementi i qëllimit të shfarosjes është elementi themelor...

Ju lutem, mjaftë, sepse duhet së paku për një temë të tillë me pas pak respekt për njëri tjetrin. Mjaft më, mjaft! Hiç me kurrkënd s'keni punoj. Dëgjoni me vëmendje, në qoftë se doni me krye punë qysh duhet e mos na shitni llafe. Në qoftë se, doni me e pas një dokument si duhet.

KRYETARI: Zonja deputete...

VJOSA OSMANI-SADRIU: Zoti kryetar, duheni me e tërheq pak vërejtjen, sepse unë jam duke dhënë propozime tepër konkrete, të cilat mundet me i rregullua administrata. Janë propozime profesionale, nuk kanë të bëjnë fare me politikë.

KRYETARI: A kish pas mundësi dy palët, në rend të parë vëmendja ajo çka flet është...

VJOSA OSMANI-SADRIU: Janë propozime shumë konkrete, kështu që nuk ka nevojë askush me i gjuajt në ujë automatikisht edhe munden shumë lehtë me u marrë parasysh.

KRYETARI: Po e vërej sensitivitetin e kësaj çështjeje. Ju lutem, qetësisht i bisedoni. Kemi me shkua pikë për pikë. Nuk do të ketë as ngutje, as mohim, as nënvlerësim. Do të thotë, koncentrohuni në pjesën e seancës, ju lutem.

VJOSA OSMANI-SADRIU: Prandaj, në pjesën e seancës po koncentrohem dhe në dokument faqe për faqe po jap propozime konkrete.

KRYETARI: Urdhëro, jepi për faktin se...

VJOSA OSMANI-SADRIU: Jam duke i dhënë, atë jam duke e bërë.

Në faqen 5 pra, të shtohet fakti që krimet sistematike në Kosovë janë bërë me qëllim të shfarosjes së popullit të Kosovës, prandaj konstituon krim të gjenocidit, sepse nuk mjafton të konstatohet vetëm krimi, pa u konstatuar elementi i qëllimit. Secili që e ka studiuar këtë fushë e dallon këtë dhe, në qoftë se po flasim për gjenocid është e domosdoshme që kjo të konstatohet.

Në aspektin teknik, te faqja e 6-të...

KRYETARI: A ka mundësi pak qetësi dhe vëmendje?

VJOSA OSMANI-SADRIU: ...kërkoj që kërkesat ndaj shtetit të Serbisë të ndahen prej kërkesave për Kuvendin e Kosovës, sepse i keni shti në një vend. Keni thënë “kërkon nga shteti i Serbisë...” e pastaj nën kategorinë e Serbisë janë vënë edhe kërkesat për Kuvendin e Kosovës, por kjo është çështje teknike, që mundet shumë lehtë të realizohet.

Shpresoj shumë, sidomos për çështjen e parë, që ka të bëjë me eliminimin e kolizionit, sepse në platformë keni thënë ky është qëndrimi i vetëm zyrtar. Është mohuar gjenocidi, është mohuar krimi kundër njerëzimit, duhet domosdoshmërisht që ai dokument t’i përfshijë që të tria në mënyrë që të merremi seriozisht edhe për rezolutën që po e miratojmë sot. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nait Hasani. Nuk qenka. Atëherë, e presim Naitin. Shkojmë te Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Kolegë deputetë,

Të nderuar miq,

Familjarë të personave të zhdukur,

U tha se është vonë, por një shprehje popullore thotë “Më mirë vonë, se kurrë!”.

Kështu që, ne sot e kemi një rezolutë. E përpunuam jashtëzakonisht mirë, por që në rast se vlerësojnë kolegët tanë deputetë dhe ekspertë edhe mund të ndërhyhet në të. Ne si AAK nëpërmjet përfaqësuesit tonë i kemi dhënë përkrahje gjatë hartimit dhe e pash këtu edhe sot si grup parlamentar do të japim mbështetje.

Unë për të mos hyrë në detaje, sepse siç e thash është një rezolutë jashtëzakonisht voluminoze, e trajtuar mirë, e specifikuar me detaje për secilin vend, për secilën ngjarje veç e veç, jam munduar

me e bë një kronologji të cilën e kam ndarë në faza, se çfarë ka ndodhur në Kosovë, të paktën prej Luftës së Dytë Botërore e këndeje. Nuk do ta zgjas shumë dhe nuk do të ju marr shumë kohë.

Nëse e shohim vetëm historinë e Mulla Idriz Gjilanit dhe Shaban Polluzhës në të '44-ën dhe '47-ën, vetëm në Gjilan i kemi 7854 qytetarë të vrarë. Në Drenicë i kemi 4820, në qytetin e Tetovës i kemi 4100. Historia e Bihorit, 3820, në Prishtinë 3675, në Pejë 3540. Të gjitha këto janë të përlllogaritura dhe të marra edhe në shënime të shumë artikujve e botimeve të ndryshme historike, jo vetëm vendore por edhe ndërkombëtare.

E kemi periudhën e Info-Byrosë, se dikush ndoshta e di edhe më mirë se unë, në vitin 1948 i kemi 1000 të vrarë, të paktën, në masakrën e Tivarit dhe i kemi nja 100 000 të tjerë të torturuar. Në vitin 1952 - 1966, qysh është njohur ajo marrëveshja e famshme me Turqinë, shpërngulja e shqiptarëve arriti të shkojë në numër deri në 414 000 shqiptarë. Demonstratat e vitit '68 u shuan me tanke dhe u përgjakën sheshet tona, në demonstratat e '81-ës kur gati sa eskaloi në konflikt, po ashtu pati shumë të vrarë e qindra të burgosur, aktivistë tanë të popullit të Kosovës.

Për të dalë te periudha '85 - '97, pra koha e Milosheviqit. Vetëm në '89 - '92 dhjetëra e dhjetëra ushtarë në shërbimin e ish-Jugosllavisë u kthyen në arkivole në familjet tona. Në vitin 1990 mbi 7 000 nxënës ne i kemi të helmuar, në vitin 1990 rreth 90% të shqiptarëve u dëbuan nga puna vetëm e vetëm pse ishin shqiptarë. Në të '91-tën u mbyllën shkollat, universitetet dhe pothuajse gjithçka që ishte shqiptare.

Nuk po jap lajme të historisë, por me fillimin e luftës '98 - '99 janë vrarë 11 843 kosovarë civilë, në këtë rast shumica shqiptarë. Prej tyre 1 370 fëmijë, janë 1 739 femra, prej tyre 1 648 edhe sot e kësaj dite janë të pagjetur, që shumicën prej tyre edhe sot e kësaj dite i kërkojmë. Shkatërrimet e luftës i tejkalojnë pothuajse 1 000 vendbanime, janë mbi 100 000 shtëpi të rrënuara, ka shkolla, ka dëme në ekonomi, në qytete, në familje, ka dëme në gjithçka çka ka qenë vlerë kombëtare është rrënuar.

Nëse flasim për dëshmorë të luftës së UÇK-së, i kemi 3 003 dëshmorë. Kemi invalidë të luftës 6 213, disa mijëra robër të luftës, vetëm në Burgun e Dubravës ne i kemi mbi 200 të vrarë. Pra, gjithsej në bazë të një statistike që unë e kam nxjerrë, vetëm robër lufte i kemi 3 350 shqiptarë. Po flasim gjithmonë për këta që kanë luftuar për ta marrë të drejtën. Pra, kur e shohim në tërësi, jo vetëm nxjerrja e kësaj rezolute sot, po edhe komisioni shtetëror i cili do të mbledhë dokumente, do të mbledhë fakte, do ta ketë mbështetjen tonë dhe jam shumë i bindur që do ta ketë mbështetjen edhe të faktorit ndërkombëtar, sepse gjithë këto që i thash ende deri sot nuk kanë marrë drejtësi. Faleminderit!

**KRYETARI: Faleminderit! Naser Rugova, urdhëro!**



NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Përfaqësues të familjeve të asociacioneve të prekura nga gjenocidi serb në Kosovë, Konsideroj që është një moment shumë i përshtatshëm që në përvjetorin e '20-të tani për pakë ditë të çlirimit të Kosovës, vërtet institucioni më i lartë i shtetit të Kosovës ta thotë fjalën e vet, ta themi të gjithë bashkë me një zë, me një konsensus të gjerë edhe politik edhe nacional edhe profesional, që pushteti serb këto tri dekadat e fundit, po edhe nja shtatë të tjera më herët, ka ushtruar gjenocid ndaj popullit shqiptar në Kosovë. Po ka tendenca edhe për barazime të xhelatit me viktimën. Duhet t'u dërgojmë mesazh të qartë, edhe partnerëve tanë strategjikë, edhe miqve tanë ndërkombëtarë, por ne si të zgjedhur të popullit, si institucione, pa marrë parasysh në cilën anë të Parlamentit jemi të ulur, duhet t'u themi edhe miqve tanë se Serbia, pushteti serb, ka ushtruar gjenocid ndaj popullit më të vjetër dhe mazhorancë në Republikën e Kosovës.

Ka pasur dhe ka tendenca që edhe të barazohemi në këtë segment, që është goxha i ndjeshëm. Bota demokratike më 24 mars të vitit 1999 intervenoi që ta shpëtojë një popull nga shfarosja, prandaj zëri i të zgjedhurve të popullit bashkë me komplet mekanizmat, institucionet dhe instrumentet e tjera, duhet të artikullohet drejtë.

Zoti kryetar, si kryetar i Kuvendit po edhe kryeministri, edhe presidenti, edhe liderët politikë që janë këtu, duhet ta dërgojmë një mesazh të qartë te Brukseli. Nuk ka qetësi, nuk ka pajtim në mes dy shteteve dhe dy popujve, pa fituar drejtësia, pa e thënë drejtësia fjalën e vet. Unë kam punuar mbi një vit me Komisionin Qeveritar për Persona të pagjetur, me asociacionet e familjarëve që janë këtu dhe shpesh tani si i zgjedhur i popullit ndjehem i turpëruar kur i takoj, sepse nuk kemi çfarë t'u themi. 13 535 viktima, 1 650 persona të pagjetur, 1 230 fëmijë të masakruar, mbi 20 000 femra të dhunuara, mbi 1 000 000 njerëz të deportuar, që nënkupton rreth 70% të substancës kombëtare. Nuk ka emër tjetër, pos gjenocid i një shteti, i një pushteti, i një regjimi ndaj një populli.

Prandaj, insistoj që edhe në pikat tjera që do t'i kemi në rendin e ditës të dërgojmë njerëz profesionalë, dërgojmë njerëz që janë marrë me vite të tëra me këtë çështje, të marrim shembuj nga vendet që i kanë kaluar në mënyrë profesionale këto plagë, që kurrë nuk shërohen.

Dhe tani, po e mbyll fjalimin tim me një fjalë të presidentit Klinton "Ju duhet të falni, por kurrë mos harroni çka ju ka ndodhur!" Faleminderit!

KRYETARI: Zonja Flora, urdhëro!

FLORA BROVINA: Faleminderit, kryetar!

Ju përshëndes, kolegë!

Ju përshëndes, mysafirë të nderuar që merrni pjesë në këtë seancë aspak të lehtë!

Kur po flasim për herë të parë me fakte për gjenocidin dhe ngritjen e akuzës ndaj Serbisë. Sigurisht, të gjithë jemi pak të emocionuar dhe ndoshta kjo edhe shihet në debatet tona, por argumenti më i mirë është rezoluta e nxjerrë që unë pajtohem plotësisht.

Dola këtu që të plotësoj një pikë, që nuk dua ta anashkaloj e kjo është se gjenocidi ndaj popullit tonë nuk ka ndodhur për herë të parë gjatë kësaj lufte. Ne duhet ta kujtojmë gjenocidin e ndodhur në regjionin e Nishit, të Vranjës e gjithandej ku kanë jetuar shqiptarët dhe me projekte shtetërore janë shpërngulur, janë masakruar e dhunuar dhe kjo është vetëm një vazhdim i këtij lloji terrori.

Falënderoj, sidomos kolegët Vjosa Osmanin dhe Daut Haradinaj, me të cilët plotësisht pajtohem se rezolutës duhet shtuar edhe disa fakte tjera e në rend të parë s' duhet harruar se në Kosovë ka ndodhur helmimi masiv ndaj fëmijëve shqiptarë pas segregacionit në shkolla. Dhe për këtë kam sjellë shumë argumente, sepse edhe disa këtu në sallë nuk besojnë se ka ndodhur një helmim i tillë. Kam të drejtë të flas, sepse gjatë gjashtë vjetëve kam përcjellë fatin e këtyre fëmijëve dhe ja edhe argumentet nga studiuesit ndërkombëtarë në gjuhët e tyre dhe këto le të jenë dëshmi për ata që duan ta dëshmojnë gjenocidin në Kosovë.

Studimi tash i plotëson të gjitha këto. Gjenocid ose krim ndaj njerëzimit gjithashtu është mbyllja e shkollave shqipe dhe vetëm një fakt ju solla juve, kryetar, sepse këtu në sallë kam edhe më shumë argumente. Vetëm nga familja e juaj, pra, Veseli kam një rend të tërë qytetarësh e nxënësish, që nga Mitrovica po edhe nga Presheva e Bujanovci solidarizohen me nxënësit shqiptarë, janë me mijëra e mijëra nënshkrime që janë deponuar në Kombet e Bashkuara, në UNICEF e në shtetet tjera, që e kanë të njohur tanimë se mbyllja e shkollave ka qenë një formë gjenocidiale kundër popullit tonë, sikur që është edhe përjashtimi masiv i atyre që kanë qenë në marrëdhënie pune, sepse mos mundësia që të jetohet shkakton shpërnguljen masive që edhe e ka shkaktuar, pastaj kryerja e vetëvrasjeve në shojza të ushtarëve shqiptarë pas marrjes së rezolutës e me qindra e mijëra, saktësisht e di numrin e saktë por ja që në këtë moment nuk e paskam me vete, të ushtarëve që kinse kanë bërë vetëvrasje, vijnë në arkivole. Edhe kjo është një formë që duhet shtuar kësaj rezolute, që të jetë e plotë me të gjitha masakrat, sepse u tha, masakra nuk harrohet dhe kur të bëhet e tëra kuptohet se nuk është dy vjet të terrorit dhe dhunës, por janë shumë më shumë.

Tani, sa i përket kësaj thash se kemi mjaftë dëshmi dhe unë nuk desha t'i përgjigjem koleges sime, gjithashtu humaniste, por mendoj se argumenti dhe e vërteta janë jo vetëm kur flasim të huajt, por kur flasim ne vetë. Ndoshta, mjaftoi njëzet vjet që s' kemi folur për të vërtetën dhe kur ta themi atë e themi qoftë edhe në këtë Kuvend, qoftë edhe me lejen e familjarëve, le të jetë më e fuqishme se sa e huaja, sepse para vetes kam edhe dokumentin për helmimet, që të tjerët kanë shkruar për helmimet, por ne jo. Nuk na është mundësuar gjithherë që të flasim zëshëm për këto çështje.

E njëjta ka ndodhur edhe me personat e dhunuar dhe më lejo, vetëm një moment... mjeke jam... mjeke jam dhe mjeke e fëmijëve jam. Hiç mos u tut, edhe çmimin e mjekëve të Botës e kam, mos u tut, se s'ka problem. Ky fëmijë me lejen e prindit, nënës dhe familjes, e dëshmoj se ka vdekur gjatë dhunimit, 7 vjeçe vajzë. Nuk është... le të traumatizohet kush të dojë, por e vërteta le të mbërrijë atje ku duhet. Ajo është akuza për gjenocid. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Kisha pasur dëshirë që në raste të rënda kur janë, unë i kuptoj përjetimet, po edhe me e lëshua sallën nuk është keq, në kuptimin... në momente të caktuara. U kthye, eh...

*(Zëra në sallë...)*

A ka mundësi për qetësi se dikush... Vetëm pak, A ka mundësi, se mos të zhvillohet debat i brendshëm, për faktin se këtu veç Serbia ka interes me e shkëputë vëmendjen nga kjo. Në qoftë se, dikush ka marrë pak interes prej asaj pune le të dalë jashtë Kuvendi, se e qes prej Kuvendi, po e jap fjalën. Edhe pastaj, e merr atë njollë pa pikë nevoje, tani ankoheni te unë.

A ka mundësi të vazhdojmë? Rasim Selmanaj...

E nxjerr prej Kuvendi, po jua jap fjalën. E largoj e tani le të ankohet me protestë e me çka të dojë. Në qoftë se e ka sjellë dikë Serbia të dalë këtu e të flasë në foltore e të thotë çka të dojë, për të votuar do të votojë kush çka të dojë, por të flitet e vërteta dhe të votohet lirshëm, kam për të shkuar deri në fund, deshi a s'deshi dikush. Çka keni argumente, nxirrni këtu!

**RASIM SELMANAJ:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Drejtësia vendore dhe ndërkombëtare ka dështuar në ndëshkimin e krimeve të luftës në Kosovë. Pra, për ta dënuar gjenocidin të cilin e ka bërë Serbia ndaj shqiptarëve. Kriminelët kanë emër e mbiemër. Të gjitha dëshmitë ekzistojnë, por krimi dhe kriminelët nuk e kanë marrë dënimin e merituar. Është ndoshta koincidence që kjo seancë po mbahet sot më 16 maj, pikërisht në ditën kur është liruar nga burgu i Dubravës veprimtari Ukshin Hoti. Me urdhër të Qeverisë serbe, përkatësisht të Ministrisë së Drejtësisë të Serbisë, pesë ditë para se të ndodhë masakra në burgun e Dubravës, u zhduk pa gjurmë Ukshin Hoti. Deri më sot asgjë nuk dihet për fatin e tij dhe po ashtu askush nuk ka dhënë asnjë përgjigje.

Unë dhe të gjithë ata që i mbijetuan burgjet e Serbisë dhe masakrën në burgun e Dubravës, i dimë emrat dhe mbiemrat e atyre që i ekzekutuan të burgosurit politikë shqiptarë. Mirëpo, për këtë do të flasë në seancën e datës 21 maj.

Të nderuar deputetë,

Ky Parlament ka votuar Gjykatën Speciale Ndërkombëtare vetëm për shqiptarët, apo pjesëtarët e UÇK-së për krime të pretenduara, por Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare asnjëherë nuk ka bërë asgjë për krimet që Serbia i ka bërë në Kosovë. Kur dihen krimet dhe masakrat si Reçaku, Belegu, Meja, Lybeniqi, Qyshku, Izbica e dhjetëra masakra të tjera në Kosovë. Kur dihen urdhërdhënësit, madje kur dihen edhe kriminelët me emër e mbiemër, që vranë dhe kryen dhunime në Kosovë. Mirë që po debatojmë sot dhe gjithsesi se do ta votojë këtë rezolutë, por mendoj se me këtë rezolutë nuk mund t'i nxjerrim para drejtësisë kriminelët serbë. Le të mbetet si një nisje dhe kthesë serioze rezoluta e sotme. Por unë propozoj që ta bëjmë një plotësim-ndryshim të Ligjit nr. 05/L-053 për dhomat e specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Meqenëse ky ligj ndërlidhet vetëm me ato që janë raportuar në Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, por që nuk janë përfshirë krimet dhe gjenocidin që e ka bërë Serbia ndaj shqiptarëve, unë propozoj që në këtë ligj të vendoset një amendament i veçantë. Nuk po propozoj të ndërhyjë ose në këtë ligj, por gjithsesi është e drejtë e jona që ta kemi një amendament ose një propozim-amendament të ri, që pas rezolutës të kemi veprime konkrete që shkojnë në drejtim të dënimeve të krimeve serbe. Faleminderit!

**KRYETARI:** Ismajl Kurteshi, urdhëro!

**ISMAJL KURTESHI:** Faleminderit!

Unë s'po flas për rëndësinë e rezolutës, sepse konsideroj që rezoluta është kryesisht e mirë. Ndoshta ka mundësi që të shqyrtohen edhe propozimet e tjera, sepse vetëm do ta pasurojnë dhe ne të gjithë jemi të interesuar që ta kemi një rezolutë sa më të mirë. Po ajo që më bëri ta marrë fjalën, është teksti që e kam para vetes dhe që përshkruan qëllimin e këtij Komisioni, ku përveç tjerash thuhet që qëllimi i Komisionit shtetëror është mbledhjet e të dhënave dhe dokumentet e krimeve të luftës që ka bërë Serbia gjatë luftës së fundit në Kosovë. Me këtë, në njëfarë mënyre i lëmë jashtë trajtimit gjenocidin, shkatërrimet, krejt çka ka bërë Serbia prej 1912 e deri 98-ën, bile edhe pas 99-ës ato çka i ka bërë në Mitrovicë. Unë jam shumë i sigurt që këtë pa dashje, në njëfarë mënyre e bëjmë një amnisti të madhe ndaj Serbisë, kështu që këtë farë përkufizimi kohor unë do ta kisha hequr dhe do të kisha lejuar që të grumbullohen, fakte natyrisht që nuk kemi me pas mundësi të mbledhim fakte të shumta për atë që ka ndodhur në vitin 1912 e '13, siç janë masakra e Kumanovës ku janë vrarë mbi 20 mijë njerëz, edhe ato të Luftës së Dytë Botërore ku janë vrarë nga 7-8 mijë njerëz nëpër qytetet tona. Por, megjithatë ende ka njerëz të cilët mund të dëshmojnë ose me ndonjë argument, me ndonjë dokument, ose edhe ta thonë atë që e kanë dëgjuar nga paraardhësit e tyre. Kështu që kisha propozuar që kjo ku thuhet gjatë luftës së fundit, të ndryshohet me gjatë tërë periudhës që Kosova ka qenë e pushtuar nga Kosova.

Edhe sa i përket kësaj fazës së dokumentimit, mendoj që edhe këtu duhet të jemi shumë të kujdesshëm, sepse ndonjëherë njerëzit tanë vetëm nëse s'u krijohen kushte të mira për të dokumentuar, heqin dorë nga dokumentimi. Kështu që do të ishte mirë, sigurisht se e kanë

menduar Komisioni, po këtu s'po thuhet, që nëpër qendrat regjionale t'i kemi zyrat ku njerëzit mund të shkojnë dhe të dokumentojnë. Po ashtu t'u krijohen kushte që individët të cilët dëshirojnë që dokumentimin të mos e bëjnë publik, sidomos bëhet fjalë për dhunimet, t'u krijohen kushtet që atë ta bëjnë në kushtet që ata i dëshirojnë, ose ato i dëshirojnë. Kaq faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Nait edhe më herët, por nuk ishte. Nait Hasani e ka fjalën.

**NAIT HASANI:** Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje të gjithë kolegë,

Ne këtë tekstin e rezolutës mendoj që është kujdesur për të bërë një përshkrim të ngjarjeve, të krimeve të gjenocidit serb në Kosovë nga programi ose programet serbe, po gjenocidi nuk është vetëm i tashëm. Gjenocid, kuptimi i fjalës krim, vrasje, përdhunim, torturë, mbytje me dhunë, të gjitha janë pjesë të krimeve që ka bërë Serbia, deri te djegiet, therjet, prerjet e kokave, nxjerrjet e syve, matjet me kandar për të marrë trofe.

Atë që e ka bërë Serbia nuk ka një det i tërë që mund ta lajë, mund ta shfajësojë, po a mund ta gjunjëzohet Serbinë në këtë drejtim, mendoj që pas njëzet vjetësh kur ne kemi krijuar Gjykatë Speciale për të dënuar shqiptarët, kur në 2013-ën kemi miratuar një rezolutë dhe një platformë për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, kur ne shkojmë në dialog me Serbinë dhe bëjmë koncesione, lëshime, bëjmë krejt çka kërkon bashkësia ndërkombëtare, krejt çka kërkon Serbia jemi OK, kemi krijuar dhe kemi pajtuar me asociacione, zona të mbrojtura, me liri të ndryshme.

Rezoluta më duket që është pas asaj platforme të 2013-ës. Njëra duhet ta anulojë tjetrën. Nëse miratohet kjo rezolutë, duhet që në bisedime me Serbinë nuk mund të shkojmë derisa nuk e pranon krimin, nuk kërkon faljen dhe nuk e njeh gjenocidin që ka bërë në Kosovë, jo vetëm '98-'99, por prej vitit 1835, me platformën e parë për gjenocid për shtrirjen e territorit, për shtrirjen e Serbisë në gjithë territorin e Ballkanit. Prandaj, mbytjet me dhunë të gjitha herave. Me këto rezoluta, Kuvendi i Kosovës si në bazë të një Kushtetute, tregon që janë formale. Kushtetuta jonë rezolutën e njeh formale, nuk e njeh detyruese. Nëse ne bëjmë vetëm rezoluta formale dhe ta kënaqim veten, edhe njerëzit, ose familjarët e tyre, viktimave të krimeve që i ka bërë Serbia, është një tjetër gjë.

Por, nëse ne do të miratojmë këtë, cili është rezultati. Cila është fuqia e kësaj rezolute? Në bazë të Kushtetutës, kjo rezolutë ka vetëm karakter formal, jo fuqi politike. Në bazë të Rregullores së Kuvendit, që e ke edhe aty përpara, gjithashtu.

Për mua, ne kemi shti në Kushtetutë vendimin, akt vendimmarrës dhe jo rezolutën. Nuk po merrem me të tjerat këtu në rezolutë çfarë janë, po edhe në faqen e fundit, këto që thotë do të ndërmarrë nismë për t'i vendosur në Kodin Penal. Kodi Penal i dënon të gjitha krimet. Mjaft

ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë dënuar për krime lufte, mbas cilit Kodi, në bazë të cilit ligj. Pa këtë rezolutë, pa këtë janë. Janë ato të sistemuara. Ata që e kanë hartuar këtë duhet ta kenë parasysh, ose nuk e njohin, nuk e kanë dhënë provimin e jurisprudencës ende.

Sot, unë prapë e kujtoj që, unë i kam shkruar Lunaçekut pikërisht për krimet dhe gjenocidin. Nuk kemi marrë një përgjigje. I kam shkruar edhe miqve tanë ndërkombëtarë që Kosova thirret, ambasadorit Delawie, asnjë përgjigje. Më 22. 2. 2017. Asnjëri s'kanë qarë kokën për neve dhe ne tani mendojmë të bëjmë një formë.

Unë kam materiale, plaçkitje dhe shkatërrim i fondit arkivor të Kosovës nga Serbia para dhe gjatë luftës '98- 99, me mija dëshmi, të dhëna nga Arkivi. Kam po ashtu, nëse Rasimi e përmendi Burgun e Dubravës, jemi të rezervuar që të kemi seancën e radhës për këtë çështje. Këtu kemi një fotografi me emër me mbiemër të vrarë. Serb i burgosur i vret të burgosurit. Po, çka ka bërë Ministria e Drejtësisë e jona për dhjetë vjet. Para kësaj kohe janë thirrur që nuk kemi ne, ose nuk jemi ne përgjegjësit, ose i kemi UNMIK-un, edhe e kemi EULEX-in. Pikërisht për masakrën e burgut të Dubravës.

A u tregua i përgjegjshëm ndonjë ministër i drejtësisë i joni të thotë që nuk kemi fuqi të tregojmë, nuk kemi mundur ta bëjmë, nuk mund ta bëjmë, nuk mund t'i dënojmë. Përkundrazi, Shoqata e të Burgosurve ka dorëzuar në Prokurorinë e Qarkut në Pejë, me dt. 19 janar 2007. I dashur Kryetar, prej 2007-ës bëjnë 12 vjet, është ky kallëzim penal me krime, me emra, me mbiemra të të vrarëve, me emra dhe mbiemra atyre që i kanë vrarë. Asnjë ministër nuk e ka qarë kryet për këtë punë. Kanë ardhur, kanë shkuar, me përjashtim të ministrit të mëparshëm që një libër e botoi të paktën ta dëshmojmë dhunën dhe krimin në burgun e Dubravës. Mendoj që mund të miratojmë rezoluta, ta kënaqim veten, t'i plotësojmë dëshirat edhe të familjarëve, që të paktën flitet, bisedohet, diskutohet, debatohet, po për ta arritur qëllimin u desh të kujtohemi në 2015-ën kur e kemi krijuar Gjykatën Speciale. Atëherë kam thënë që, këtij Kuvendi i kam folur, pikërisht duhet të hyhet të trajtohet krimi në tërësi, jo etnik. Edhe atëherë Kryeministri, tash Presidenti kanë folur, kanë debatuar, besa edhe e kanë kërcënuar Kuvendin në kuptimin e thjeshtë të fjalës, që ta miratojmë këtë gjykatë, sepse kjo do ta zgjidhë problemin. Po e shohim që kjo gjykatë nuk na e ka zgjidhur problemin. Kjo ka ngjallur konfuzitetin. Kjo ka ngjallur frikën. Kjo po i tmerron njerëzit.

Prandaj me këtë rezolutë, edhe një herë po them që nuk mund ta zgjidhim. Nuk është krimet vetëm sa janë prezantuar aty. Ne kemi veç një fshat i vrarë, po sa fshatra janë në Kosovë të vrarë, sa janë të shkatërruar, sa janë të djegur, diku thuhet 130 e sa mijë shtëpi janë të shkatërruara, po sa janë pjesë e të kaluarës.

Kemi kërkuar që jo vetëm kjo është e mjaftueshme. Krimi nuk është bërë vetëm jashtë, po krimi është bërë edhe nëpër burgje. Kemi kërkuar edhe nga ministri i Drejtësisë, i cili është sot këtu, pa

një fije përgjegjësie, si Komision, që burgu i Prishtinës të shpallet burg muze. Pikërisht në këtë burg janë bërë krime, dhuna, tortura, zhdukje dhe vrasje, djegie ndaj të burgosurve dhe pa fije përgjegjësi thotë jo ne nuk mund ta bëjmë këtë, do të çojmë agjenci, do të bëjmë atje. Po pas dhjetë vjetësh, pas njëzet vjetësh ju ka rënë ndërmend të shpallen për gjykata, po të formojnë tribunale, o kryetar! Vonë është. Nëse e zhdukim burgun e Prishtinës, kur ne do t'i dëshmojmë dëshmitë, ku do t'i marrim ato dëshmi? Ku do t'i çojmë ato dëshmi? Fëmijët tanë nuk do të dinë që ka pasur një luftë në Kosovë. Fëmijëve tanë duhet t'u dëshmojmë, duhet t'ua japim atyre dhe duhet t'i çojmë, t'u tregojmë se nëpër këto burgje, prej këtu nëpër burgje ka dalë liria e Kosovës, nga njerëzit që kanë vuajtur. Sot e kujtojmë Ukshin Hotin, Ukshini ka qenë në Burgun e Prishtinës.

**KRYETARI:** Regjia, të lutem ua vazhdon deputetëve. Kur nuk ka polemika, askujt s'ia ndal fjalën.

**NAIT HASANI:** Ukshini ka qëndruar në burgun e Prishtinës, Adem Demaçi ka qëndruar në burgun e Prishtinës. Fazli Grajçevci para do ditësh e keni fotografinë të shtrirë të vvarë, me amanet të vetin, i kanë thënë pështyje flamurin, ka thënë nuk e pështyj. Mund të të vrasim, vritmëni! Në Burgun e Prishtinës ka qëndruar Rexhep Mala. Në burgun e Prishtinës kanë qëndruar plot njerëz të cilët sot është bërë ministër, ose je bërë Kryetar Kuvendi, a ne jemi deputetë këtu. Shteti i Kosovës nga njerëzit që kanë vuajtur, nga ata që e kanë dashur vendin, nga ata që kanë luftuar, në forma të ndryshme edhe sot ne jemi këtu. Prandaj burgu i Prishtinës nuk është nëpër këto dokumente që i ke sjellë nëpër këto rezoluta.

Burgu i Dubravës është shkatërruar, është rindërtuar burgu i Dubravës, gjithë ai krim është zhdukur. Askush nuk e ka marrë përgjegjësinë të thotë çka është bërë atje.

Kryetar, me këto rezoluta, unë mendoj që duhet t'ia ndërroni karakterin jo rezolutë, po vendim. Në bazë të Kushtetutës së Kosovës. A, në anën tjetër, rezolutat e shteteve të tjera janë obligative. Nuk shkojnë njëra me tjetrën. Prandaj, ose duhet të ndërrohet vendim e që të jetë pjesë e rezolutës, që ne të jemi të obliguar të marrim vendime në bazë të asaj, ose kjo është formale që e bëjmë, dhe nuk kam qejf ta kënaqi veten me një rezolutë që nuk ma zgjidh problemin për ata që debatojmë, diskutojmë edhe marrim vendim. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Për hir edhe të shoqatave, familjarëve të të pagjeturve, të falënderoj për prezencën. Edhe opinionin publik, ta kemi parasysh jemi duke folur, pse janë disa iniciativa. Ju e patë u fut edhe një iniciativë në fund. Po ashtu të gjitha janë pozitive. Por e kemi edhe rezolutën, po i kemi edhe vendimet të cilat do të jenë të bazuara në ligj dhe në Kushtetutën e vendit, të cilat janë vendime konkrete të cilat do t'i marrë besoj shumë sot Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Po ministër, urdhëro!

MINISTRI ABELARD TAHIRAJ: Sa për korrektësi se përmendi deputeti në fjalë, në rastin në lidhje me burgun e Prishtinës. Ato hapësira tashmë janë të pashfrytëzuara dhe realisht ju e keqpërdorët një bisedë që e kemi pasur ne. Unë e kam dërguar në Qeverinë e Republikës së Kosovës pikërisht për ta trajtuar dhe për ta marrë një vendim konform kërkesës të cilën ju e keni parashtruar. Ato tashmë nuk shfrytëzohen, janë hapësira boshe. Nuk shfrytëzohen nga Ministria e Drejtësisë, sepse Qendra e re e Paraburgimit në Prishtinë, është ndërtuar në periferi të Prishtinës dhe pikërisht pra edhe vullneti i Qeverisë së Republikës së Kosovës është që të jetë konform kërkesës suaj. Pra, ajo është e pavërtetë që ju e thatë dhe ditët në vijim, do ta keni vendimin e Qeverisë sa i përket çështjes në fjalë. Nuk është mirë të abuzosh me çështje e biseda që mund t'i kemi, qoftë në kafe, qoftë në rrugë. Ditët në vijim do ta keni vendimin e Qeverisë, po je mësuar ti të abuzosh.

KRYETARI: Urdhëro z. Hasani. Deputeti Nait Hasani e ka fjalën. Regjia! Regjia, deputeti Nait Hasani e ka fjalën për kundër-replikë. Nait në qoftë se s'punon ajo, lëvize kartelën tjetër, në ulësen afër teje.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Të paktën njihem që nuk jam abuzues, as keqpërdorues. Atë që e the, më mirë mos të kishte folur, më mirë kishte qenë për ty. Nuk jam keqpërdorues as i fjalës. Nuk jam keqpërdorues, as s'dua të të keqpërdor ty, po sjellja u tregua fëmijërore shumë e jotja.

KRYETARI: Muharrem Nitaj. Bëhet gati Besa Gaxherri. Edhe një deputet e kemi.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë,

Përfaqësues të familjeve të viktimave,

Unë kam përshtypjen që pjesa dërrmuese e deputetëve, as që e kanë lexuar projekt-rezolutën, ose një numër i tyre e ka lexuar e s'e ka marrë vesh fare. Ne nuk e kemi për qëllim që të miratojmë një rezolutë për dialogun. Po e përsëris rezoluta është për gjenocidin serb në Kosovë. E dëgjova Naitin, po thotë rezoluta është formale. Çka duhet të bëjmë ne? Nuk duhet të miratojmë një rezolutë për gjenocidin serb. Nuk besoj për shembull që Naiti ka të drejtë ta zhvillojë këtë tezë.

Unë dua të them se rezoluta është përpiluar me shumë kujdes. Është e mbështetur në fakte, është e mbështetur në të dhëna, është e mbështetur në argumente dhe ka marrë për bazë disa rezoluta të ngjashme që trajtojnë materie të ngjashme. E veçanta e kësaj rezolute është se për të parën herë, Kuvendi i Republikës së Kosovës, po e përsëris Kuvendi i republikës së Kosovës për të parën herë konstaton gjenocidin serb të kryer në Kosovë. Unë besoj për shembull që me një rezolutë ne



nuk mund t'i zgjidhim të gjitha problemet, as problemet e krimeve serbe në Kosovë, as problemet kundër krimeve të njerëzimit, as ndëshkimin e kriminelëve. Ne po flasim për një rezolutë e cila konstaton një gjenocid të kryer në një kohë të caktuar në Kosovë dhe unë besoj që teksti mund të mos jetë perfekt, mund të korrigjohet, mirëpo besoj që është një bazë e mirë që deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës për të parën herë ta votojnë një rezolutë me të cilën konstatohet se shteti i Serbisë ka kryer gjenocid në Kosovë. Besoj që kjo është detyra e kësaj legjislature të Kuvendit tani. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Besa Gaxherri e ka fjalën. Bëhet gati Veton Berisha. I kemi pastaj edhe dy deputetë janë lajmëruar.

**BESA GAXHERRI:** Faleminderit!

Të nderuar familjarë të dhembjes tonë që sot jeni bashkë me ne,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë vërtet pajtohem deri diku me këtë rezolutë. Ani pse është e vërtetë që rezolutat nuk janë obligative, unë konsideroj se kjo rezolutë përveçse duhet të jetë në aspektin e përgjegjësisë sonë diçka ndryshe, unë mendoj se ndoshta ne sot mund ta formalizojmë që vërtet kjo të jetë obligative. Pse duhet të jetë obligative? Që duhet të ketë mekanizma, të ngrihen menjëherë mekanizma për të shkuar tutje dhe të arrihet në atë qëllimin që e kemi.

Për të mos u zgjatur shumë, paraprakisht dua të them se unë pajtohem me vërejtjet apo sugjerimet të cilat i dha kolegja ime Vjosa Osmani. Faktikisht pajtohem edhe me diskutimin e kolegut Nait Hasani, dhe po mundohem të shtoj edhe këtë: mbi kombin shqiptar është ushtruar dhunë sistematike deri në gjenocid për shumë decenie, apo për shekuj.

Të nderuar kolegë deputetë,

Pozicioni ynë, pra i Kosovës, nuk kemi qenë, ose nuk kemi pasur mekanizma institucionalë për t'i ngritur këto çështje, deri në vitin 2008 kur e kemi shpallur pavarësinë e Republikës së Kosovës, e që tani kemi obligim kombëtar e kushtetues që gjenocidin ndaj kombit shqiptar ta adresojmë saktë, jo vetëm gjenocidin me rastin e luftës së fundit të vitit 1998-1999, po duhet të fillojmë e të kërkojmë llogari prej Luftës së Dytë Botërore e deri në fund të luftës së fundit, dhe të urojmë që të jetë lufta e fundit.

Siç e thanë disa kolegë, s'kemi asnjë qytet në Kosovës ku nuk janë kryer masakra gjatë Luftës së Dytë Botërore, krime këto që kanë përfunduar me masakrën e Tivarit, e cila nuk është ngritur asnjëherë.

Jo për ta arsyetuar vetën tonë sepse edhe ne këtu jemi të vonuar, por natyrisht që neve na janë dashur mekanizma institucional, shtetërorë për t'i ngritur këto çështje. Nuk mund t'ia fillojmë që ta ndrisim gjenocidin e luftës së fundit, duke i harruar të gjitha viktimat nga viti '45 e tutje dhe

duke filluar me viktimat e fundit ose dhunën sistematike që ka filluar në vitet '90-ta me helmimin e fëmijëve tanë.

Nuk ka argument më të fuqishëm se kur armiku pretendon që ta mbysë të ardhmen duke t'i mbytur fëmijët. Ne kemi një dëshmi dhe argument sot, sepse atëherë nuk kemi pasur mundësi dhe mekanizma për ta argumentuar, pra në vitet '90.

Unë kam faktin ose shembullin që veprimtarja Nurie Zekaj së bashku me shokun e saj Naserin, s'po më kujtohet mbiemri kërkoi falje, ata janë vrarë në Beograd duke i dërguar mostrat e analizave të fëmijëve tanë të helmuar për t'i dërguar në Evropë e për të dëshmuar se çfarë po ndodhte në Kosovë.

Nuk guxojmë ta harrojmë edhe atë pjesë, sepse e fuqizojmë argumentin para faktorit ndërkombëtar që fatkeqësisht edhe pse e kemi pasur ndihmën edhe përkrahjen e tyre, sot nga mospuna jonë ka filluar Serbia që të kthehet në viktimë.

Prandaj, ne duhet ta pasurojmë mirë këtë rezolutë dhe duhet t'i qëndrojmë me mekanizma prapa për ta shtyrë tutje.

Natyrisht, unë mendoj se u pa këtu edhe disa foto që u prezantuan sot, që vërtetë ishin të vështira. Mbase mendimi im tash për momentin mund të jetë gabim, por mendoj kështu edhe po them. E di që për çdo familje dhe për çdo njërin nga ne është dhimbje dhe trishtim që të shohim skena të tilla, por fatkeqësisht edhe 20 vjet pas luftës neve po na duhet ta argumentojmë me argumente dhe fatkeqësisht e në aspektin tjetër ne de facto kemi argumente, ato duhet t'i prezantojmë.

Por, e lus secilin prej nesh, edhe mediat edhe çdo qytetar të këtij vendi që argumentet, faktet të mos mundohemi që t'i politizojmë ose përvetësojmë, por ato duhet të prezantohen. Duhet gjetur formën dhe duhet të prezantohen.

E di, janë dhembje, por duhet ta sheh bota. Ata që nuk e kanë ditur fare ose s'kanë dashur që ta dinë ose sot kanë filluar që të harrojnë, duhet t'i shohin argumentet tona se mbi popullin tonë, mbi fëmijët, gratë e burrat shqiptarë ka pasur gjenocid. Ka pasur dhunë sistematike, ka pasur gjithçka që është e papranueshme.

Këto, të nderuar kolegë, më pak dëshmohen me fjalë sesa me argumente.

Argumente kemi mjaft, por s'mundem pa e thënë edhe këtë, që ne si institucione për 10 ose 11 vjet të këtij shteti, të kësaj republike të re, nuk kemi bërë mjaftueshëm. Nuk kemi bërë mjaftueshëm. Ju lutem, krerët e institucioneve ta marrin përgjegjësinë e vet. T'i mbledhin

argumentet, faktet. Të flasim më pak, sepse kemi pasur që 10 ose 11 për të folur. Por, ato t'i sistemojmë dhe të fillojmë që me mekanizma kushtetues të veprojmë dhe të ecim tutje.

Gjenocidi duhet të pranohet nga faktori ndërkombëtar e në radhë të parë nga Serbia, që është bërë mbi popullin shqiptar në Kosovë dhe jo vetëm në luftën e fundit.

Ky gjenocid i ka rrënjët një shekull me radhë. Faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Veton, fjala për ju. Veton Berisha e ka fjalën.

VETON BERISHA: Të nderuar familjarë,

I nderuar kryetar,

Ministër,

Kolegë deputetë,

Qytetarë të republikës,

Më lejoni që sado pak të jap kontributin edhe unë lidhur me çështjen për të cilën po flasim. Me këtë rast shfrytëzoj rastin të shpreh mirënjohje dhe të shpreh vlerësimin ndaj komisionit për punën.

Vet fakti për iniciativën e ndërmarrë tash, mendoj që është sadopak një lehtësim për të gjitha familjet të cilat janë të prekura nga çështja në fjalë.

Po flasim për gjenocidin serb të kryer në Kosovë. Unë si përfaqësues i komunitetit egjiptian e dëshmoj edhe e argumentoj që vet veprimet dhe vet argumentet e prezantuara edhe përjetimi ynë në këtë situatë e dëshmon se vërtetë ka pasur gjenocid, dhe shteti serb ka qenë i përkushtuar dhe i përqendruar ndaj popullsisë me shumicë shqiptare dhe i përqendruar pikërisht në popullin shqiptar.

Por, gjithashtu e dëshmoj që në këto raste nuk janë kursyer as të tjerët dhe në këtë rast as komuniteti im egjiptian.

Unë dëshmoj se në secilin veprim, në secilën kategori të trajtuar si kategori, qoftë të vrasjeve, dhunimeve, qoftë largimin nga Kosova, qoftë anëtarëve të zhdukur, në një masë të caktuar numërojmë edhe pjesëtarë të komunitetit egjiptian.

E për këtë fakt unë i referohem Fondit për të Drejtën Humanitare, pra statistikave të tyre të cilat janë të publikuara. Mbi këtë bazë, dëshmoj dhe argumentoj se pjesë të pakursyer nga gjenocidi serb ka qenë edhe komuniteti im egjiptian.

Unë e falënderoj komisionin që në faqen 3 të paragrafit të parë, domethënë duke u nisur nga faktet, ka paraparë që në kuadër të 12 mijë civilëve të pambrojtur, kanë qenë edhe komunitete të tjera, e në këtë rast edhe komuniteti egjiptian.

Por, në deshifrimin, domethënë në vlerat në shifrat, në faqen 5 të dokumentit ku jepen shifrat, në këtë pjesë mendoj që do duhej të merren informata të sakta apo të thuhet me një fjalë të përgjithshme që ka edhe të tjerë, ku në shifra përmenden vetëm persona ose familje shqiptare, në këtë rast 20 mijë femra shqiptare të dhunuara.

Ndërkaq në periudhën '98-'99, pra për kohën kur po flasim, unë numëroj mbi 1 milion shqiptarë të dëbuar nga shtëpitë e tyre, po ashtu rreth 80% e familjeve të komunitetit egjiptian janë dëbuar bashkërisht me shqiptarët dhe ishin viktimë e të gjitha veprimeve të tjera.

Tash, unë nuk kam qenë pjesë e komisionit. Nuk e di sa ka mundësi dhe aftësi ligjore dhe bazuar edhe në konventat mbi gjenocidin që të trajtohen bashkërisht në kuadër të këtyre veprimeve që Serbia nuk ka kursyer asnjërin këtu, e sidomos ato familje ose ata persona që nuk kanë dalluar shumë nga shqiptarët.

Mendoj që edhe në deklaratimet publike, zoti kryetar, edhe çdoherë është mirë që ne t'ju referohemi statistikave sepse ka pasur edhe deklarime edhe në Këshillin e Sigurimit që flet vetëm për shqiptarët.

Serbia në këtë rast, duhet ta dimë këtu që nuk ka kursyer asnjërin përveç popullit të vet.

Unë bëj thirrje nga këtu që secili zyrtar i shtetit tonë të Kosovës, duhet të marrë informata të sakta edhe ta dijë saktë.

Kam obligim që ta përmend Krushën e Madhe, ka pjesëtarë nga komuniteti egjiptian, po ashtu, Llaushë, Landovicë, Hoçë e Madhe, Celinë, Poterq i Klinës, Pejë, Gjakovë, Fushë Kosovë kudo.

Unë mendoj që është mirë që të kemi kujdes në trajtimin e rasteve të tilla. E kuptoj shumë fuqishëm që gjenocidi duhet trajtuar ndaj popullsisë me shumicë, në këtë rast shqiptare, por nuk duhet harruar sepse vërtetë sot po u shkaktojmë ndjenja të mira familjeve, e në këtë rast edhe familjet e komuniteteve të tjera kanë nevojë për ndjenja të tilla. Pra, që ne të kujdesimi dhe të kërkojmë drejtësi.

Sigurisht, e mbështes rezolutën. Do ta votoj rezolutën. Do ta votoj tribunalin dhe çdo gjë që e sjellë në këtë vend drejtësinë dhe do ta dënojë secilin keqbërës që i ka bërë keq këtij vendi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Elmi Reçica e ka fjalën.

ELMI REÇICA: Faleminderit, kryetar Veseli!

Të nderuar dhe shumë të respektuar përfaqësuese të shoqatës së familjeve të personave të pagjetur,

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të respektuar të këtij vendi,

Realisht jam përgatitur që të flas për pikën pasuese, për formimin e Komisionit Shtetëror për Dokumentimin e Krimeve të luftës nga regjimi serb.

Dua vetëm t'i jap disa sqarime. Kryetare e komisionit, e kemi diskutuar platformën, asnjë propozim konkret nuk e ke dhënë për ta futur si pikë të rendit të ditës brenda platformës një çështje të tillë.

E marrim procesverbalin. E kemi diskutuar. E kemi refuzuar dhe s'ka kaluar herën e parë. Nuk e keni deklaruar saktë.

Nuk e kisha ndërmend ta marrë fjalën për hir të familjeve të cilat na presin atje. Kam menduar se të gjitha partitë politik, edhe ju, e keni një përfaqësues. Unë çfarë kam pasur për t'i thënë i kam thënë Mërgimit, i cili ka qenë përfaqësues i Grupit Parlamentar të PDK-së, dhe atë çfarë ia kam thënë është pjesë e rezolutës.

Do duhej dhe kam besuar që kjo rezolutë do të diskutohet shumë shpejt, votojmë shumë shpejt dhe pastaj kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës e cila është e rëndësishme dhe që faktikisht është e ndërlidhur me të.

Për rezolutën, më 27 mars, këtu së basku me juve, e kemi propozuar një rezolutë për gjenocidin serb dhe opozita e atëhershme ka dalë jashtë sallës dhe nuk është votuar. Ndërsa, Gjykata Speciale është votuar më 2 gusht 2015. Është një diferencë shumë e madhe kohore në muaj.

Sikur të donim ne, para Gjykatës Speciale do ta kishim rezolutën për dënimin e gjenocidit serb, dhe kjo është e vërteta. Ky është realiteti.

Janë faktet Albulenë, s'keni dashur të votoni. Votojeni tash. S'keni çfarë të tregoni as më vonë dhe as më herët dhe as tani. Asgjë s'keni për të treguar. E di që ju i gëzoheni më shumë Gjykatës Speciale, ju personalisht, se sa një rezolute që e dënon krimin serb. Që e dënon gjenocidin serb. E keni dëshmuar dhe jo vetëm ju.

Po i shkojmë deri në fund. Por, me rëndësi është që tash ta votoni rezolutën, votojeni komisionin edhe lëreni luftën politike këtu në Kuvend për këtë çështje.

**KRYETARI:** A ka mundësi që së pari të qetësohet seanca? Në qoftë se ka mundësi. Urdhëroni, e ka fjalën Vjosa.

**VJOSA OSMANI-SADRIU:** E vërteta është që në mbledhjen e parë të komisionit kur është trajtuar platforma, për mesë një orë kemi dhënë propozime konkrete sesi duhet të duket kjo platformë më mirë. Përgjigja që kemi marrë ka qenë, ky është dokument kompromisi.

E vërteta tjetër është që ka deputetë të këtij Kuvendi që i kanë dhënë po këto propozime në këtë Kuvend dhe asnjëri nuk është marrë parasysh dhe platforma është miratuar pa asnjë ndryshim. Kjo nuk do të thotë megjithatë, që kjo nuk mund të bëhet tani.

Është një propozim konkret. Është një fjali e thjeshtë e cila thjeshtë sqaron që nëpërmjet këtij dokumenti, pra rezolutës, ndryshohet çdo dokument tjetër zyrtar. Përndryshe, platforma thotë që ai është qëndrimi i vetëm zyrtar edhe mbizotëron pastaj rezolutën.

Në qoftë se dëshironi, kjo veç e përmirëson këtë dokument. Në qoftë se nuk dëshironi, mund të votohet edhe kështu. Problemi është që kjo rezolutë duhet të ketë efekt në praktik. Ndryshe, llafe i kemi thënë njëri-tjetrit mjaft që 20 vite.

Kjo rezolutë duhet të shkojë në Bruksel siç e thashë, dhe jo tjetër dokument në Bruksel e tjetër dokument në Prishtinë. Ky është dokument para botës. Ne duhet t'ia dëshmojmë botës këto krime, sepse të gjithë i kemi parë vet me sy.

Pra, është përpjekje që të përmirësohet rezoluta. Nuk ka rëndësi se a është bërë më herët apo më vonë. Mendoj që administrata apo edhe në qoftë se pajtohemi ne, për pesë minuta mund ta rregullojmë, në mënyrë që të mos krijojmë kolizion. Ngase për momentin ajo platformë nuk lejon që ndonjë dokument tjetër të jetë mbi të. Kaq.

**KRYETARI:** Ali Lajçi e ka fjalën.

**ALI LAJÇI:** Unë desha të shikoj kornizën e kësaj rezolute, e cili për mendimin tim paraqet një bazë të mirë në kuptim të hartimit të saj. Mbështetjes së saj në vija dhe në të drejtën ndërkombëtare.

Njëkohësisht kisha edhe dy propozime. Propozimi do të ishte se si do ta vendosim këtë rezolutë kohësisht, në periudha kohore të trajtimit të gjenocidit serb.

Kur ne drejtohem me rezoluta e të tjera të shikojmë se kë po e akuzojmë në kuptim të të drejtës ndërkombëtare. Pra, Jugosllavinë, Serbinë apo ndoshta një Jugosllavi që do duhej të ishte shumë herët, menjëherë pas Perandorisë Osmane më 1878, 1912, 1944, 1945 dhe këto të mund të formulohen mirë që të jenë kompaktibile me të drejtën ndërkombëtare.

Pra, në mënyrë që institucionet do të mund ta pranoin si kredibile të trajtim të mëtejshëm, respektivisht që do të mund të bëhej diçka me ekzekutimin e kësaj rezolute. Prandaj, shpesh mund të mendohet se kur themi se gjenocidi serb duhet të kihet parasysh se cili shtet ishte ai.

A është anëtar i OKB-së, a është i Këshillit të Sigurimit e tjera dhe a shkojnë konventat ndërkombëtare në harmoni me këtë akuzë të cilën ne faktikisht, pra me fakte e kemi shumë të bazuar.

Prandaj, po qe se njihen krimet nga viti '45 e këtej ose në vitet '99, '90 e deri në 2000 e këtej, do të thotë ne duhet të shohim se kë po e akuzojmë me rezolutë. Pra, Republikën Federale të Jugosllavisë, i cili ishte shtet i pranuar ndërkombëtarisht, por më theks të veçantë Serbia, e cila më vonë kur e ka karakterin e saj të Këshillit të Sigurimit dhe të drejtës ndërkombëtare.

Në këtë mes do të mund ta kisha shtruar edhe një çështje. Jo krejt punktet apo qendrat e gjenocidit a të krimit makabër të Serbisë, që i kemi të evidentuara në kuadër të rezolutës, janë të përfshira.

Andaj, kërkoj që të lihet mundësia e hapur për zbulime të reja të qendrave të krimit të Serbisë brenda kësaj rezolute, që pastaj të plotësohet me fakte konkrete dhe me argumente të cilat janë në pajtim me normat dhe standardet e pranueshme të gjenocidit.

Në këtë mes u fol edhe për çështje të tjera të nxitjes së rezolutës, veprimi institucional e tjera. Nuk duhet të bëjmë garë këtu rreth këtyre çështjeve. Ne e dimë se kur është krijuar shteti i Kosovës.

Ne e dimë se kush ka menaxhuar në të gjitha sferat e jetës me këtë shtet e institucione. Prandaj, përgjegjësia bie mbi atë që duhet. Faktikisht vonesat janë, por tash duhet ta kryejmë këtë punë, sepse është obligative.

Ndërsa sa i përket rezolutave, ka pasur rezoluta edhe prej subjekteve të tjera, siç është ajo e Vetëvendosjes në 2014 e tjera, e specifikuar mirë, e trajtuar, por nuk ishte aprovuar, gjë që për këtë edhe duhet që tani t'i lëmë këto.

S'ka nevojë që ta trajtojmë këtë politikisht, po institucionalisht dhe të kërkojmë mekanizma pas rezolutës të cilat do të ishin do të mund të na shtynin në drejtim të zbatueshmërisë. Kurse

rezolutat për fat të keq, në kuadër të Kuvendit të Republikës sonë, kanë mbetur deklarata politike.

Jetoj me shpresën që kjo rezolutë të mos jetë e këtij karakteri, por të jetë e një karakteri të zbatueshëm.

Ju lutem, të gjenden mekanizmat edhe ligjor, edhe kushtetuese edhe të gjitha sanksionet që mund të ndodhin dhe i duhen kësaj rezolute të mund të jetësohen. Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën e ka Sami Kurteshi.

**SAMI KURTESHI:** Faleminderit për fjalën e dhënë zoti kryetar!

Unë u përpoqa që me vëmendje t'i dëgjoj të gjitha diskutimet për të bërë përpjekje që të ndihmoj që teksti të bëhet sa më i mirë.

Natyrisht që kishte shumë propozime, sugjerime, vërejtje konstruktive, edhe unë mendoj se këto mund të merren parasysh të gjitha.

Komisioni e ka për detyrë që këto vërejtje t'i marrë parasysh dhe ta rregullojë çështjen e tekstit që do të dërgohet ose do të vjen për miratim këtu.

Unë mendoj se ka vërejtje shumë parimore, përmbajtjesore dhe të drejta. Unë mendoj se ka edhe kërkesa që mund të dalin jashtë kornizës së kërkesës themelore për një rezolutë, por fundi i fundit për këtë duhet të vendos seanca e Kuvendit.

Natyrisht që ne jemi këtu përfaqësues politik edhe përfaqësimi politik është shumë i rëndësishëm, por unë nuk mendoj se propozimet destruktive që dalin ose nuk janë të përmbajtura në tekst, dalin jashtë tekstit nuk do të ndihmojnë këtu shumë.

Sigurisht do të vijnë edhe pika të tjera të rendit të ditës, kur ne kemi çfarë të themi.

Unë i bëj ftesë të gjithë atyre që kanë bërë vërejtje parimore t'i përgjigjen ftesës së kryetarit të komisionit ad-hoc që është për rezolutën dhe t'i sjellin propozimet e tyre të sakta, qoftë me shkrim apo edhe të vijnë ose të shkojnë në diskutim.

Unë do të shkoj në atë diskutim edhe të shohim që në një periudhë sa më të shkurtër ta harmonizojmë një tekst i cili megjithatë, pa marrë parasysh rëndësinë formale, ligjore të rezolutave të Kuvendit të Kosovës., edhe pse fatkeqësisht deri më tani nuk është zbatuar asnjë rezolutë e Kuvendit të Kosovës.



Unë mendoj se kjo rezolutë do ta ketë një vlerë më të madhe përmbajtjesore, joformale edhe sigurisht do të jetë një dokument në të cilin do të mbështeten institucionet e Republikës së Kosovës edhe në veprimet e tyre të mëvonshme në lidhje me këto çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Shumë të nderuara familje të të pagjeturve, familje të dëshmorëve që jeni të pranishëm në këtë seancë,

Të dashur qytetarë të Kosovës,

Të nderuar kolegë,

Këtu e kam një mocion procedural të Lëvizjes Vetëvendosje të datë 3 gusht të vitit 2015, dhe në arsyetimin e këtij mocioni procedural është që Kuvendi i Kosovës ta miratojë një rezolutë për gjenocidin e Serbisë në Kosovë. Pra, janë bërë katër vjet prej kur e kemi dorëzuar këtë mocion procedural.

Pra, në hollësi argumentohet se çfarë ka bërë Serbia në Kosovë. Krimet e Serbisë, gjenocidin, krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës e kështu me radhë. Dhe, në fund kemi propozuar një rezolutë, pika e parë e së cilës thotë, pra po flasim për vitin 2015.

Pika e parë (1) thotë: Qeveria e Republikës së Kosovës t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për trajtimin e krimeve të kryera nga aparati shtetëror, ushtarak, policor e paramilitar i shtetit të Serbisë të kryera mbi popullin shqiptar të Kosovës gjatë periudhës së viteve 1998-1999.

Pika e dytë (2) thotë: Obligohet që të krijohet një institucion shtetëror i cili i mbledhë të gjitha faktet e këtyre krimeve të luftës, dokumentet, argumentet që ne i posedojmë si shtet i Kosovës.

Kurse pika e pestë (5) e kësaj rezolute të Vetëvendosjes thotë se krejt kjo punë, bile edhe pas mbledhjes së fakteve edhe padia kundër Serbisë të ndodhë deri në janar të vitit 2017. Pra, kjo punë të kryhet krejt deri në janar të vitit 2017.

Zoti Reçica, ju nuk e keni mbështetur këtë rezolutë. Ky është fakti i parë.

Fakti i dytë. Partia Demokratike e Kosovës e ka udhëhequr Ministrinë e Drejtësisë nëpërmjet ministres së saj Dhurata Hoxha.

Dhurata Hoxha si ministre e Drejtësisë e ka mbyllur institucionin më të rëndësishëm të Kosovës sa i përket argumentimit të krimeve të luftës. E ka mbyllur Institutin e Krimeve të Luftës.

Zyrtarë të këtij institucioni, së bashku kam qenë një konferencë me këta zotërinj kur kanë dalë dhe kanë deklaruar, kanë dëshmuar që ky institucion nuk e ka kryer as gjysmën e punës dhe është mbyllur.

Unë mendoj që institucioni për krimet e luftës është mbyllur me vendim politik.

Ky institucion i ka penguar Serbisë dhe ky institucion e ka penguar dialogun me Serbinë, kjo është arsyeja pse është mbyllur, politika dhe pushteti mban përgjegjësi për mbylljen e këtij instituti shumë të rëndësishëm.

Nën tre, ne këtu edhe mund bëjmë performansa, po atje ku është vendi i vërtetë, atje ku bëhet drejtësia, te Pallati i Drejtësisë, atje duhet treguar sa keni vullnet politik për të gjykuar krime lufte e për të ndjekur krime lufte.

E unë mendoj që edhe drejtësia ka lidhje me politikën në kuptimin e vullnetit, kur ke vullnet politik, i ke 30 prokurorë, e kur nuk ke vullnet politik për krime lufte, i ke veç tre, e ke një departament të shkretë, për krime të luftës, atje ku është vendi, jo këtu, po atje ku është vendi, në Pallat të Drejtësisë, atje e keni lënë shkretë që 19 vjet.

Nën katër, ky presidenti juaj, në një deklaratë shumë interesante ka pas thënë që bile marrëveshja përfundimtare me Serbinë mund të ndodhë edhe duke i amnistuar krimet e luftës, me vesh të mi e kam dëgjuar.

Aq kompromise të mëdha e aq marrëveshje historike, sa edhe po bëka të amnistohen krimet e luftës. Janë deklaratat publike. Domethënë, po bëka të përfshihen në kompromis edhe krimet e luftës.

Dhe, e pesta, zonja dhe zotërinj,

Pajtohem që më mirë vonë se kurrë. Se krimet nuk vjetrohen kurrë, dhe sidomos këto që janë më të rënda, me vrasje, me dhunime, me krime të luftës, me gjenocid, këto nuk vjetrohen kurrë.

Mirëpo, për besë, edhe koha është me rëndësi. Nuk mund të thuash, se 20 vjet kemi fjetur e tash na ra në mend, e para.

E dyta, nuk është se nuk ka pasur propozime të tilla për t'u kryer kjo punë, po kurrë nuk është kryer, e po kryhet bash tash. Prapë, më mirë vonë se kurrë, mirëpo unë mendoj që edhe për 20 vjet pse nuk ka ndodhur, dikush në këtë vend duhet të marrë përgjegjësi. Faleminderit!

**KRYETARI:** Ju kisha lutur, për arsye se vullneti dhe nderja më e madhe te ne ndodh më tepër mes nesh se sa me atë që e kemi përballë Serbinë.

Ju kisha lutur të përmbahemi në këtë pjesën ku jemi, për faktin se kujtesa dhe memoria është administrative, ka në Kuvend çfarëdo iniciative që ka pasur që 20 vjet.

Asnjëherë s'ka pasur ndonjë iniciativë serioze, e cila është proceduar nga gjashtë deputetë, ta themi këtu, do të thotë se gjashtë deputetë iniciojnë çdo gjë edhe sot kur po flasim, kjo është iniciativë vetëm në Kuvend, ta keni parasysh. Kisha pasur dëshirë, në qoftë se ka mundësi, se po e shoh se ka njëfarë ndjenje të fuqishme për kacafytje mes vete, kisha pasur dëshirë që kjo seancë të orientohet, të përmendet më shumë Serbia dhe kriminelët e luftës në Serbi, e t'i lëmë të gjitha seancat e tjera pastaj për ballafaqimin mes nesh, po kjo është çështje e seancës.

Unë vetëm si kryesues kisha shkuar tutje, a po insistoni me çdo kusht.

Atëherë zoti Reçica, replikë!

ELMI REÇICA: Zoti Konjufca, reagova sepse nga bankat tuaja reagoi një deputete, tha pse s'e keni themeluar para Gjykatës Speciale...

KRYETARI: Ka ankesa për shkak të mikrofonit, i nderuar deputet, afrohu.

ELMI REÇICA: Mos m'i regjistroni, pra, këta sekonda.

Nga banka juaj u tha që pse nuk është votuar një rezolutë e tillë para Gjykatës Speciale. Unë po them edhe një herë, ti e përmende gushtin 2015. Unë këtu në këtë sallë, në këtë foltore e kam propozuar një rezolutë, e cila e dënon gjenocidin serb, është pika 2, më 27 mars 2015. Ju nuk e keni votuar atëherë, kjo është e vërteta. Çka kishte ndodhur pastaj, ta kishim parë, e vërteta është se në pikën 2, saktësisht edhe po e lexoj të asaj rezolute: "Kuvendi i Kosovës shpreh shqetësimin se me kalimin të më shumë se një dekade pas përfundimit të luftës Çlirimtare të Popullit të Kosovës gjenocidi dhe krimet e luftës ndaj popullatës së Kosovës nuk janë ndëshkuar", e tjera, këtë desha ta sqaroj.

KRYETARI: Glauku, kundër-replikë!

GLAUK KONJUFCA: Sa i përket vullnetit politik, ju kurrë nuk keni paraqitur në këtë Kuvend rezolutë, e cila e dënon gjenocidin e Serbisë në Kosovë, për arsye se kjo është konsideruar që e pengon dialogun.

Për sa kohë ka qenë Hashim Thaçi drejtues i dialogut me Serbinë, në këtë Kuvend nuk ke guxuar asgjë të votoni, e kam fjalën për juve, mazhorancën. Sa ka qenë shef i dialogut, diçka me të cilën ti ke mundur ta cenosh dialogun me Serbinë nuk është propozuar në këtë Kuvend prej juve.

Çdo rezolutë që ju e keni propozuar, sa i përket Serbisë, nëse ne e kemi kundërshtuar ndonjëherë, ka ekzistuar vetëm për një arsye. Nuk ka pasur rezolutë që ju nuk e keni propozuar e ku nuk është shkruar fjalia që dialogu me Serbinë të vazhdojë, të trashet edhe më shumë, të thellohet edhe më shumë, e kështu ...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Vetëm pak.

Para se të flisni, për faktin se jemi duke u orientuar, a ka mundësi veç pak vëmendje. Ky vend as ne nuk do të ishim në Kuvend në qoftë se populli i Kosovës s'e kishte çliruar këtë vend. Ushtria Çlirimtare e Kosovës, po populli i Kosovës, se ndryshe nuk ishte çliruar. Po mos e ndani ju, ne, se edhe pastaj ka një gjeneratë, s'i dihet ku ke qenë ti Elmi, ku ka qenë Glauku në vitet 1998-1999, ka për secilin, pse po shkoni aq larg. Shkoni sot në 2019-tën e keni këtë çka e kemi rend dite dhe të futemi në debat.

Ministër, a po e dëshiron fjalën, a e lëmë ke kaq. Shkurt, të lutem.

**MINISTRI ABELARD TAHIRI:** Desha t'i jap disa informacione sa i përket këtij instituti që e përmendi Glauku, Instituti për Hulumtimin e Krimeve të Luftës.

Ky institut është themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në vitin 2011, Galauk dhe realisht, asnjëherë nuk ka arritur të përmbushë mandatin e vet, pse?

Dhe, e para, unë e kam transformuar në Departament të Drejtësisë Tranzicionale dhe jo ministrja Dhurata Hoxha.

E para, ky institut, në momentin kur jam emëruar ministër i Drejtësisë, kërkesë imja e parë ka qenë të më afrojë një shifër të viktimave të luftës të vitit 1998-1999. Imagjino, pra prej qershorit të vitit 2011 deri në vitin 2018 kanë punuar dhe nuk kanë një shifër të saktë të viktimave në Republikën e Kosovës!

Asnjë dokument, asnjë shkronjë të vetëm nuk e kanë sa i përket masakrës së Reçakut, Izbicës, Rezallës, masakrës së Dubravës, Krushës së Madhe e Krushës së Vogël, masakrës së Hasit, Studimes, Suharekës, pra kurrfarë informacioni këtu s'kanë. Absolutisht mendoj që këta njerëz, ky ekip, sepse s'ka qenë institut, sepse institutin nuk mund ta shuash me vendim të Qeverisë, instituti themelohet me ligj, ky ka qenë një ekip, i cili e ka pasur një mandat për hulumtimin, grumbullimin e materialeve që lidhen me luftën e vitit 1998-99 dhe realisht nuk kanë mundur ta përmbushin një mandat të tillë dhe tash, imagjino, të dhënat që i kemi nga ky institut që sot i ka lënë, për shembull, një prej çështjeve, një prej dokumenteve, ku është dërguesi i këtyre

dokumenteve thotë që disa dokumente që kanë ardhur për krime që ka ndodhur në rrethinën e Prishtinës, dërguesi i këtyre është Ali Beka me shokë.

Qysh mund të merren serioze dokumente të tilla, edhe publikime të tilla. Pra, nuk kemi pasur të bëjmë me punën e mirëfilltë të një instituti dhe pikërisht ka qenë shumë e nevojshme që të organizohet dhe të themelohet Departamenti për Drejtësi Tranzicionale, të cilën e kemi bërë dhe jemi duke e funksionalizuar.

Pra, ky institut ka publikuar fotografi, dëshmi, të cilët qytetarë të ndryshëm prej vullnetit të mirë i kanë sjellë, siç është kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, Rufi Suma, apo kryetarët e tjerë të komunave që kanë pasur në institucione të tilla. Pra, nuk kemi të bëjmë me një institut të mirëfilltë për hulumtimin e krimeve të luftës, për punën e pesë personave, të cilët realisht ajo çka kanë lënë mbrapa, lë shumë, shumë për të dëshiruar. Nuk po dua t'i fajësoj, ata e kanë marrë një mandat të tillë, nuk kanë mundur ta realizojnë dhe nuk mund të vazhdosh tutje, sepse është shumë joserioze. Pra, një institut për hulumtime të krimeve të luftës të mos ketë të dhëna për Izbicën, për të gjitha ato masakra që i përmenda tetë vjet pune, është e papranueshme.

Nuk mund ta tolerosh, mbi të gjitha puna e tyre, këta njerëz kanë qenë të punësuar me kontrata mbi shërbime të veçanta, imagjino, as nuk ka qenë i rregulluar siç duhet statusi i tyre.

Pra, ne sot po e rregullojmë pikërisht këtë problem, këtë çështje dhe nuk është mungesë vullneti politik, pra pikërisht është vullneti politik edhe në 2011 që iu ka afuar këtyre njerëzve e që s'kanë ditë ta bëjnë punën dhe sot po e riorganojmë këtë departament. Faleminderit!

**KRYETARI:** Sarandë, po e shoh insistimin tënd, dy deputetë i largova, Milaim Zekën për publik dhe Ganës e Bekimit ua largova fjalimin në mirëkuptim. Po, urdhëro, për shkak të specifikës.

Sarandë, unë për shkak të një të kaluarë ta jap fjalën, po kisha pasur dëshirë... Sarandë, merre fjalën. Jo, nuk po ia jap askujt, të falënderoj për mirëkuptimin, nuk ka asnjë deputet të lajmëruar më. Saranda u tërhoq, Bekim, tërhiq edhe ti, nuk ka asnjë.

Ju kisha lutur për mirëkuptim, edhe për shkak të publikut dhe për shkak të familjarëve.

Pati shumë propozime për ndërhyrje në projektrezolutën, për të arritur një harmonizim për ta vënë në votim, unë e ftoj prapë të njëjtin komision, pasi do t'i vazhdojmë pikat e radhës, që edhe një herë të takohen mes veti, ta formalizojnë projekt-rezolutën dhe përfundimisht ta vej në votim sot gjatë kësaj seance. A mund të shkojmë kështu?

Zoti Sherifi, propozimi im është kështu, si iniciues, të lutem, zoti Sherifi, fjala për ju.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Pikërisht këtë desha ta propozoj në fund të debatit që menjëherë sapo të mbyllet debati rreth kësaj pike, anëtarët e komisionit të mblidhemi dhe të përfshijmë ato çështje, të cilat u ngritën dhe, siç u tha edhe kolegu Kurteshi, janë parimore, për të cilat arrijmë pajtueshmëri të plotë, se e pasurojnë rezolutën dhe të kthehemi pastaj këtu në seancë për ta votuar.

Këtu u thanë disa gjëra të mira pa dyshim, jo se nuk na ka shkuar neve ndërmend, sepse aty janë biseduar shumë çështje, për shembull, janë ngritur çështjet edhe në komision, me orë të tëra kemi biseduar, prej 1912 e deri në ditët e sotme, por ne jemi përqendruar në gjenocidin e kryer serb në vitet 1998-99. Prandaj na kanë pamundësuar kthimin mbrapa.

Armend Zemaj e ka përmendur disa herë, e ka ngritur çështjen edhe të helmimeve, një anëtar tjetër të shfarosjes së shqiptarëve në territore që sot janë etnikisht të pastra me serbë, po kanë qenë etnikisht të pastra me shqiptarë. Mirëpo, ajo do të përbënte pastaj një rezolutë për historinë mes shqiptarëve dhe serbëve, pra për gjenocidin e serbëve ndaj shqiptarëve ndër vite, ndër dekada në histori.

Ne jemi përqendruar në atë çka na ka mandatuar Kuvendi, të bëjmë një rezolutë që konstaton gjenocidin serb në Kosovë gjatë luftës, përkatësisht viteve 1998-1999.

Prandaj, ju lus që të gjitha ato propozime që hyjnë në kuadër të këtij koncepti, nëse përfaqësuesit e tyre në grup në komision i kanë marrë, tash menjëherë i thërras, të mblidhemi së bashku dhe të përpiqemi ato të cilat janë të harmonizueshme, t'i harmonizojmë, të tjerat le të na mirëkuptojnë, se nuk është se nuk duam, por nuk hyjnë në kuadër të konceptit që ka paraparë rezoluta, për të cilën kemi biseduar me ditë dhe me orë të tëra me anëtarët e tjerë të komisionit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar iniciues!

Ndërkohë, në një moment më të duhur, e tërheq Komisionin ad-hoc, ka mundësi edhe më vonë, nuk ka rëndësi, sa po e shoh ne do të jemi bukur gjatë sonte në seancë, deri kah mesi natës. Faleminderit!

#### **4. Formimi i Komisionit shtetëror për dokumentimin e krimeve të luftës të regjimit serb në Kosovë**

Të nderuar deputetë,

Propozimi për formimin e Komisionit shtetëror për dokumentimin e krimeve të luftës të regjimit serb në Kosovë u është shpërndarë deputetëve.

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, z. Mufera Shinik.)*

KRYESUESJA: Propozuesi, zoti Kadri Veseli, e paraqet dhe e arsyeton propozimin. Urdhëroni, kryetar!

KADRI VESELI: Faleminderit!

Sot në mëngjes isha në vendin ku ruhen qindra pako me rroba të qytetarëve tanë të vrarë e masakruar nga forcat e shtetit serb gjatë luftës në Kosovë.

Pashë një bluzë fëmije, mund të ketë qenë 7-8 vjet, me miki-mausin e shpuar nga predhat. Pashë një bluzë po ashtu të grisur të një gruaje të dhunuar dhe e masakruar. Pashë edhe opingat e një loke mbi 100-vjeçe, Zade Dragaj, po ashtu e vrarë.

Do të thotë, fëmijë, të rinj, pleq, gra, burra, të gjithë të vrarë për një qëllim të vetëm dhe veç një arsye, pse nuk ishin si ata, nuk ishin serbë, do të thotë vetëm pse ishin joserbë. Shumica e absolute e tyre, 99.9%, ishin shqiptarë.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Anëtarë të Qeverisë,

Shumë të nderuara shoqata të familjeve të pagjetura,

Ju përshëndes, ju falënderoj për vendosmërinë tuaj, së pari pa qenë të vendosur sigurisht se sot ndoshta nuk do të vinim te ky moment.

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kjo është një seancë të cilën shumë gjatë e kanë pritur qytetarët e vendit tonë.

Kanë mbetur më pak se një muaj, kur vendi ynë kremton 20-vjetorin e çlirimit përfundimtar nga sundimi njëshekullor serb.

Në këto 20 vjet liri, vendi ynë ka shënuar të arritura të mëdha. Ato janë të përmasave historike.

Kemi shpallur pavarësinë, kemi ndërtuar bazat e një shteti demokratik, kemi ngritur ekonominë e vendit dhe mirëqenien e qytetarëve, ndërsa vitin që shkoi themeluan edhe ushtrinë e Kosovës.

Edhe si popull i sulmuar, kemi pranuar çdo çmim që na është kërkuar, duke iu përgjigjur çdo pretendimi për aktakuzë, në Kosovë e në Hagë. Kemi krijuar edhe një Gjykatë Speciale. Kjo është pjesa e historisë, në të cilën nuk kthehemi prapa.

Por, ndonëse kanë kaluar 20 vjet, e megjithëse kemi shëruar shumë plagë të luftës, ato mbesin pjesë e pandashme e qenies sonë, si familje dhe si komb.

Dhe, plaga më e madhe është mungesa e drejtësisë për viktimat e gjenocidit, të cilin shteti serb e ushtroi mbi popullin tonë gjatë viteve të luftës. Lëndinat e fshatrave të Kosovës u kthyen në fusha të vdekjes, ndërsa trenat që bartnin njerëzit tanë të dëbuar me dhunë, bota i kishte parë vetëm në kohën e holokaustit të hebrenjve.

Trajtimi nga forcat ushtarake e policore serbe gjatë luftës për njerëzit tanë ishte çnjerëzor.

Mbi 1 milion shqiptarë u detyruan të bëheshin refugjatë, ose persona të zhvendosur.

13 535 veta u vranë. Në mesin e tyre, 1 230 fëmijë, përfshirë foshnja.

Mijëra gra u dhunuan. Kjo ishte arsyeja pse bota demokratike mori vendim të ndërhynte për ta ndaluar pikërisht këtë gjenocid. Përfundimi i luftës gjeti Kosovën me fatin e pazgjidhur të jo më pak se 6 057 personave.

Janë mijëra të vrarë, të masakruar, varrosur, zhvarrosur, dhunuar, përdhunuar, fyer e poshtëruar në mënyrën më mizore dhe sistematike nga shteti serb, politika serbe, policia dhe ushtria serbe.

Për të gjitha këto krime dihen me emra dhe mbiemra shumica e kryesve të tyre.

Dihet kush ishin kryetarët e komunave. Dihet kush ishin komandantët e njësive policore dhe ushtarake. Dihen njësitë ekzekutuese. Dihen vendet. Madje, dihen edhe orët e sakta të kryerjes së krimeve.

Ka dëshmi të bollshme. Ka fakte, dokumente, dëshmitarë. Të gjithë ata presin të flasin, të mos heshtet. Ata presin të dëgjohen, të mos harrohen. Ata presin të veprohet për t'i vënë para drejtësisë vrasësit e familjarëve të tyre, vrasësit e fëmijëve të tyre, dhunuesit.

Çdo shtëpi, çdo rrugë, çdo lagje, çdo fshat, çdo qytet e di dhe do të flasë! Sepse, të gjithë dhe gjithçka në Kosovë ishte target i gjenocidit serb, vetëm pse ishin shqiptarë.

Edhe sot, 20 vjet pas, ende nuk ka kërkim falje. Nuk ka distancim të shtetit serb.

Edhe ato pak procese gjyqësore që i ka organizuar shteti serb, kanë qenë improvizime për të mashtruar botën dhe realisht për t'i amnistuar kriminelët.

Sot, ne kemi ardhur në një situatë kur rrezikojmë seriozisht që tragjedia jonë më e madhe historike dhe mijëra e mijëra viktimat e saj të mbesin thjesht statistikë në ditë përkujtimesh.

A duhet të lejojmë që të ndodhë kjo? Sigurisht që jo!



Pra, qytetarët e Kosovës me të drejtë pyesin: A do të ketë drejtësi edhe për ne?

Deri në fundin e vitit 2017, drejtësia ndërkombëtare ishte e vetmja përgjegjëse për trajtimin e krimeve të luftës në Kosovë.

Kosova i ka besuar thellësisht drejtësisë ndërkombëtare, në gjithë këto vite.

Kemi besuar se krimet gjenocidale të kryera nga Serbia në Kosovë do të marrin përgjigjen e domosdoshme nga mekanizmat e kësaj drejtësie.

Por, ne sot ndjehemi thellësisht të zhgënjyer kur konstatojmë se kjo nuk ka ndodhur.

Edhe në shifrat e dënimeve, faktet janë tronditëse: Janë dhënë 189 vjet burgim për shqiptarët dhe vetëm 20 vjet burgim për serbët. Të dënuar në Kosovë janë: 34 shqiptarë, 4 serbë, 1 rom.

Të dënuar në Serbi për krime lufte në Kosovë janë: 15 serbë, 1 shqiptar dhe jemi qindra të tjerë shqiptarë me aktakuza të shtetit serb.

Të dënuar në Hagë: 6 serbë, 2 shqiptarë. Plus, ne e kemi edhe Gjykatën Speciale. Brenda në Kosovë, njëri pas tjetrit, kanë dështuar UNMIK-u, EULEX-i dhe bashkë me ta, edhe institucionet tona, që duke besuar te drejtësia ndërkombëtare, kanë neglizhuar detyrat e tyre ligjore në këtë drejtim.

Në anën tjetër, Gjykata e Hagës për krimet në ish-Jugosllavi e ka lënë në gjysmë drejtësinë për krimet kundër njerëzimit, të kryera nga shteti serb në Kosovë.

Edhe në rastet e përfunduara, ka ndodhur që krerët e gjenocidit kanë marrë dënime shumë minimale.

Disa prej tyre tanimë janë liruar dhe ditët e fundit i kemi parë duke marrë pjesë në paradat ushtarake, të cilat Serbia i organizon për ta kërcënuar rajonin. Dhe, për çudi, përveç Shteteve të Bashkuara të Amerikës, pjesa tjetër e botës demokratike hesht. Hesht Bashkimi Evropian, institucioni që nuk do të duhej të heshte.

Është një heshtje që na kujton vitet kur Milosheviqi valëviste flamujt e luftës dhe bota bënte sikur nuk e shihte.

Apo, e shihte Milosheviqin si shpëtimtar të vetëm të paqes dhe historia pastaj tregon se ai u shndërrua në kërcënimin më të madh të paqes. Këtë javë, të nderuar deputetë, unë kam përgatitur një letër drejtuar institucioneve më të larta të Bashkimit Evropian, në të cilën adresoj

indiferencën e Bashkimit Evropian mbi atë që çfarë ka ndodhur në Serbi, gjuha e urrejtjes dhe demonstrimi ushtarak, i cili ka ndodhur drejtpërdrejt ndaj Kosovës nga shteti serb i drejtuar nga një kriminel i dënuar për krime lufte.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në vend se të shikojë nga e ardhmja, Serbia po nxjerr përpara skenarët e së kaluarës, dhe kjo ka një arsye pse ndodh. Arsyeja është se Serbia nuk e ka marrë dënimin e merituar për krimet që ka kryer në Kosovë gjatë luftës. Është inkurajuar nga qasja toleruese e derisotshme e BE-së për këtë. E them këtë, se edhe deri më sot, Serbia, vendi kandidat për BE, tolerohet nga BE-ja të derdhë qindra miliona euro, çdo vit, edhe për strukturat kriminale në Kosovën tonë. Por, në Kosovë është inkurajuar edhe nga kacafytjet tona të brendshme, që më shumë ngjallen ta fusin njëri-tjetrin në burg, se sa vrasësit e kombit të tyre. Prandaj, sot është në nderin e këtij Kuvendi që të merret vendimi që drejtësia për këto krime të ndodhë, për shumë arsye. Në radhë të parë, për viktimat e gjenocidit. Në radhë të dytë, për të garantuar se këto krime nuk do të përsëriten më. Në radhë të tretë, për paqen e qëndrueshme në Rajon dhe në Evropë.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Të dashur qytetarë të Republikës sonë,

Sikur jeni në dijeni, në ditët e fundit unë kam dalë me iniciativën që shteti ynë të fillojë procesin e mbledhjes dhe dokumentimit të dëshmive të gjenocidit serb në Kosovë. Puna që është bërë deri më tash ka qenë fragmentare, e paorganizuar mirë, e pamjaftueshme. Koha po kalon dhe ne po rrezikojmë të humbim dëshmitë dhe dëshmitarët. Kam propozuar që të nisim këtë proces dokumentimi, i cili në një fazë tjetër do të pasohet nga përgatitja e akuzave për kriminelët në një tribunal ndërkombëtar. Vështirë që të shkojmë drejt partnerëve tanë të huaj dhe të kërkojmë ndihmë për një gjykatë potenciale ndërkombëtare për krimet e serbëve, nëse Kosova s'bën gjë për vete, për çështjen e krimeve dhe dokumentimit të së kaluarës. Prandaj, kam propozuar një seri nismash konkrete, në kuadër të drejtësisë tranzicionale për të zbardhur të kaluarën dhe vënë kriminelët para përgjegjësisë.

1. Kam propozuar ndërtimin e një Muzeu të Gjenocidit, të ish-Fabrika e Tjegullave, i cili do të zhvillojë veprimtari në pesë fusha. Ai do të shërbejë për përkujtimin e krimeve, dokumentimin dhe arkivimin e fakteve, hulumtimin e tyre, edukimin e brezave të ardhshëm dhe gjetjen e shkaktarëve dhe përgatitjen e padive për ta. Do të ketë hapësirë përkujtimi në këtë Muze të Gjenocidit edhe për dëshmi nga krime kundër njerëzimit që janë kryer kudo në vende të tjera të botës.

2. Kam propozuar përcaktimin me ligj të një date përkujtuese të gjenocidit, si dhe ndërtimin e një memoriali për këtë tragjedi të popullit tonë. Nuk ka dyshim se datë referuese duhet të jetë gjithsesi njëra nga masakrat që ka ndodhur nga shteti serb në Kosovë, masakra më e madhe që ka

ndodhur brenda një dite, gjatë luftës në Kosovë. Kjo masakër, sipas të dhënave është Masakra e Vërbocit, e kryer më 30 prill 1999.

3. Kam propozuar shndërrimin e Stacionit të Trenit të Prishtinës në Muze të Dëbimit. Ky do të jetë një muze me eksponate, ekspozitë me fotografi, instalacione, video, objekte personale dhe vagonë konkretë të përdorur për deportimin e qytetarëve të Prishtinës.

Por, ajo që është më e rëndësishmja, është angazhimi ynë institucional, si institucioni më i rëndësishëm i demokracisë kosovare. Prandaj, unë vij sot këtu në Kuvend, për të ndërmarrë një tjetër nismë, më të rëndësishme se ato të mëparshmet, që është konkrete, operacionale, që lidhet me angazhimin tonë serioz në vënien e kriminelëve përpara drejtësisë dhe sigurimit të drejtësisë për viktimat. Propozimi im përfshin një proces ligjor dhe institucional, i cili do të kalojë nëpër disa faza deri në arritjen e ngritjes së Tribunalit ndërkombëtar për gjenocidin serb mbi Kosovën, duke filluar me themelimin e Komisionit shtetëror që bën konfirmimin, hulumtimin dhe klasifikimin e krimeve të luftës që kanë ndodhur gjatë luftës së fundit në Kosovë. Komisioni shtetëror qëllim kryesor ka mbledhjen e të dhënave dhe dokumentimin e krimeve të luftës që ka bërë Serbia gjatë luftës së fundit në Kosovë, më qëllim që krimet e dokumentuara të adresohen nga drejtësia vendore dhe ndërkombëtare. Po ashtu, propozohet që Komisioni shtetëror të ketë një mandat kohor të pakufizuar. Kuvendi i Republikës së Kosovës, në afat sa më të shkurtër, do të hartojë një ligj të veçantë që përkufizon kompetencat dhe mandatin e këtij organi ndërinstitucional, ndërsa Komisioni shtetëror do të hartojë një Rregullore të punës për Komisionin Shtetëror.

Kuvendi i Republikës së Kosovës do të propozojë një buxhet të veçantë në bazë të kërkesës së Komisionit shtetëror. Buxheti për këtë institucion është prioritet për shtetin e Kosovës.

Përbërja do të jetë kjo:

1. Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas detyrës zyrtare,
2. Nënkryetarët (bashkëkryesuesit): deputet i pozitës dhe deputet i opozitës,
3. Përfaqësues nga çdo grup parlamentar,
4. Përfaqësues nga Zyra e Presidentit,
5. Përfaqësues nga Komisioni Qeveritar për të Pagjeturit,
6. Përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, nga Ministria e Brendshme dhe Agjencia Kosovare e Inteligjencës,
7. Universiteti i Prishtinës,
8. Instituti i Historisë,
9. Instituti i Albanologjisë,
10. Këshilli Gjyqësor,
11. Këshilli Prokurorial,
12. Ministria e Drejtësisë,

13. Avokati i Popullit,
14. KMLDNJ-ja,
15. Përfaqësuesit e shoqatave të të pagjeturve,
16. Përfaqësuesit e shoqatave të dala nga lufta,
17. Përfaqësues të Organizatave Joqeveritare që janë marrë me dokumentimin e krimeve.

Puna e Komisionit shtetëror do të ndahet në 3 faza:

Faza iniciuese: Kjo fazë ka të bëjë me themelimin dhe funksionalizimin e këtij institucioni. Në fund të kësaj faze, Komisioni shtetëror duhet të jetë funksional me gjithë kapacitetet e tij. Rregullorja e Punës, si dhe Ligji i Veçantë miratohen në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë angazhohen në bazë të organogramit të propozuar. Të tri seksionet, në bazë të këtij propozimi, janë të operacionalizuara.

Faza e dokumentimit: Është faza më e ndjeshme e këtij institucioni. Ajo do të bëhet në bazë të kriterëve të qarta ndërkombëtare penalo-juridike për dokumentimin e krimeve. Është me rëndësi që gjatë kësaj faze Komisionit shtetëror t'i sigurohet buxhet i mjaftueshëm për operim. Kjo fazë fillon në momentin e parë që mekanizmat e këtij institucioni janë plotësuar me stafin dhe mjetet e duhura.

Faza e lobimit për krijimin e Tribunalit: Kjo fazë fillon të zbatohet në momentin e parë që Komisioni shtetëror i ka të gatshme raportet e krimeve të dokumentuara në bazë të kriterëve ndërkombëtare. Kjo fazë nuk do të pushojë së funksionuari edhe nëse Komisioni shtetëror e përfundon mandatin e tij, për të cilën është themeluar. Ministria e Drejtësisë dhe ajo e Punëve të Jashtme do ta kenë në vazhdimësi si përgjegjësi prioritare realizimin e objektivave të kësaj faze.

Përveç procedimit në gjykata deri në ngritjen e Tribunalit ndërkombëtar dhe arrestimin e kriminelëve të luftës, si Komision shtetëror, përmes të gjithë mekanizmave të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Qeverisë, të gjitha institucioneve, Presidencës, ky Komision shtetëror do të shkojë, të faktojë te çdo parlament në botë, te çdo mekanizëm politik, strategjik, te çdo mekanizëm i së drejtës humanitare, derisa të arrihet qëllimi final - drejtësia.

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë të Kosovës,

E kam përcjellë me shumë vëmendje debatin publik që ka nxitur ky propozim imi. I falënderoj si mbështetësit, ashtu edhe skeptikët. Çdo gjë në jetë është e vështirë të arrihet. Edhe liria për popuj, edhe drejtësia ndonjëherë.

As ne si komb nuk bëjmë përjashtim.

Por, ka një mendim te njohur që thotë: “Pesimistët shohin vështirësi në çdo mundësi, ndërsa optimistët shohin mundësitë në çdo vështirësi”.

Gjithë jetën kam qenë me ata që shohin mundësitë brenda vështirësive. Vetë Ushtria Çlirimtare e Kosovës erdhi nga ky përcaktim vizionar. Historinë e bëjnë vetëm ata që besojnë te vetvetja, e drejta dhe e vërteta e kombit të tyre. Ky besim ndërtohet kur të gjithë bëhemi bashkë rreth qëllimeve të mëdha të kombit. Unë ju ftoj që edhe sot të bëhemi bashkë për këtë qëllim të madh: qëllimin për të vendosur drejtësinë për krimet e shtetit serb në Kosovë. Këtë e presin mijëra familjarë të viktimave, shqiptarë të vrarë e të masakruar, gratë e dhunuara, nënat dhe baballarët që u janë vrarë fëmijët, e fëmijët që u janë vrarë prindërit e gjyshërit. Këtë e pret e gjithë Kosova.

Gjykata Ndërkombëtare që do të merret me këto krime, e kam thënë dhe dua ta ritheksoj edhe një herë këtu, është e mundur, është e domosdoshme dhe është pashmangshme.

Sot është dita që ky Kuvend të marrë një vendim, i cili i jep mundësi hapjes së kësaj epoke të këtij drejtimi. Së bashku. Si politikë. Si shtet. Si komb. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, kryetar! Tani e ftoj përfaqësuesin e Grupit Parlamentar LDK, shefin e grupit, zotin Avdullah Hoti, urdhëroni!

**AVDULLAH HOTI:** Faleminderit, kryesuese e Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar familje të të pagjeturve,

Sot po diskutojmë një çështje shumë të rëndësishme dhe shumë të ndjeshme për të gjithë ne, për të gjithë qytetarët e Kosovës. Kjo çështje duhet të zgjidhet përpara se të normalizohen marrëdhëniet ndërshtetërore me Serbinë. Kjo çështje është e ndjeshme në veçanti për familjet që ende nuk i dinë ku i kanë të afërmit e tyre, prandaj kjo temë duhet të trajtohet me ndjeshmërinë e nevojshme në Kuvend dhe gjithkund.

Lidhja Demokratike mbështet çdo nismë për dënimin e krimeve të regjimit serb. Aktivistë të Lidhjes Demokratike, bashkë me qindra aktivistë të shoqërisë civile, i kanë denoncuar para publikut dhe para bashkësisë ndërkombëtare arrestimet, rrahjet, vrasjet dhe masakrat e regjimit serb në momentet kur e kanë rrezikuar edhe jetën e tyre. Ne sot jemi në liri, ne flasim lirshëm, kemi institucionet e shtetit të pavarur të Kosovës. Prandaj, ne sot nuk duhet të dënojmë krimet e regjimit serb vetëm me deklarata populiste. Ne sot duhet të vëmë në lëvizje mekanizmat tonë shtetërorë për të gjykuar këto krime. A i kanë kryer detyrimet e tyre kushtetuese dhe ligjore institucionet tona të drejtësisë që kanë obligim të ngritin akuza dhe të dënojnë krimet e luftës, sigurisht se jo ose jo mjaftueshëm. Fakti që sot pas 20 vjetësh ne flasim për këtë temë, tregon qartë se këto institucione nuk i kanë kryer detyrat e veta.

Po le të flasim, të nderuar deputetë, dhe të analizojmë propozimin e zotit Veseli. Ata që ia kanë shkruar këtë propozim, edhe vetë zoti Veseli që e ka nënshkruar, tregojnë se mungojnë njohuritë elementare të funksionimit të institucioneve kushtetuese. Nëse e shihni përbërjen e Komisionit Shtetëror që parashihet të formohet, do të bindeni vetë. Si mund të themelohet një Komision shtetëror që kryesohet nga kryetari i Kuvendit e nga deputetët nga pozita dhe opozita, ku anëtarë janë Këshilli Gjyqësor e Këshilli Prokurorial, është Avokati i Popullit dhe institucionet e tjera të pavarura me mision për të konfirmuar, hulumtuar dhe klasifikuar krimet e luftës të regjimit serb në Kosovë. Cili nga deputetët këtu në sallë mund të bëhet gjykatës? Kush nga drejtësia ndërkombëtare, nga partnerët tanë strategjikë, me të cilët ne duhet ta themelojmë këtë tribunal ose nga qeveritë e vendeve të BE-së, do t'i besonte gjykimit të deputetëve për krimet e luftës në Kosovë. Prandaj, kjo qasje e zotit Veseli shpreh mungesën e kulturës institucionale lidhur me funksionimin e rendit kushtetues parlamentar. Qëllimi mund të jetë i drejtë, por sa i përket formatit dhe qasjes, ky propozim duhet të rishikohet plotësisht.

Të nderuar deputetë,

Kosova ka institucione të drejtësisë, ka Prokurori Speciale, Departament special në kuadër të Gjykatës Themelore që duhet të kryejnë obligimet e tyre kushtetuese. Kosova nuk mund të themelojë Tribunalin vetë, atë mund ta bëjë Këshilli i Sigurimit ose bashkë me Bashkimin Evropian, bazuar në një marrëveshje ndërkombëtare. Por, Kosova mund dhe duhet të dokumentojë krimet e regjimit serb. Ne duhet të fuqizojmë infrastrukturën ligjore për organet e drejtësisë dhe institucionet e tjera të pavarura publike dhe jopublike, për të konfirmuar krimet e regjimit serb në Kosovë dhe për t'i dënuar ato krime.

Konfirmimi i këtyre krimeve duhet të bëhet bazuar në standardet e drejtësisë ndërkombëtare. Prandaj, këtë punë nuk mund ta bëjnë deputetët, por institucionet kushtetuese përkatëse, prokurorët e specializuar që duhet të mbështeten nga të gjitha institucionet dhe organizmat përkatës në procesin e mbledhjes së provave për krimet e regjimit serb.

Të nderuar deputetë,

Familje të viktimave,

Qytetarë,

Propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së është që Kuvendi sot të formojë një komision, i cili përgatit propozim-vendimin që duhet të marrë Kuvendi lidhur me veprimet që duhet të ndërmerren nga të gjitha institucionet kompetente në Kosovë për dënimin e krimeve të luftës, fillimisht nga drejtësia vendore dhe mandej edhe nga drejtësia ndërkombëtare. Komisioni i përbërë nga të gjitha grupet parlamentare, brenda dy javësh duhet t'i propozojë Kuvendit një propozim-vendim, i cili duhet të detalizojë këto çështje: e para, ndryshimet legjislative që janë të nevojshme për të krijuar infrastrukturën ligjore, si dhe kapacitetet institucionale, për të ndjekur dhe dënuar kryerësit e krimeve të luftës edhe në mungesë. E dyta, këto ndryshime legjislative

duhet të përmbajnë detyrimet e institucioneve të drejtësisë të Kosovës për mbledhjen e provave që lidhen në mënyrë specifike me krimet e luftës.

Dhe, e treta, pas kryerjes së këtyre veprimeve nga institucionet e drejtësisë të Kosovës, propozim-vendimi duhet të përmbajë veprime strategjike të shtetit të Kosovës në rrafshin diplomatik për të kërkuar nga partnerët tanë strategjikë krijimin e Tribunalit ndërkombëtar për krime të luftës. Me këtë qasje ne tregojmë se kemi maturitetin e nevojshëm shtetëror për t'u marrë me këtë çështje që është e ndjeshme si në aspektin njerëzor, por është edhe komplekse shumë në aspektin e trajtimit nga drejtësia vendore dhe drejtësia ndërkombëtare.

Grupi Parlamentar i LDK-së do të mbështesë punën e këtij komisioni dhe do të angazhojë të gjitha kapacitetet e veta që janë të konsiderueshme për të përmbushur detyrimet e këtij komisioni. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Hoti! Fjalën e ka përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të PDK-së, Elmi Reçica, urdhëroni!

ELMI REÇICA: Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit!

Të respektuar përfaqësues të Shoqatës së familjeve të personave të pagjetur,

Kolegë të nderuar,

Qytetarë të respektuar të Kosovës,

Seanca e sotme pa dyshim se paraqet një nga momentet dhe njërën nga seancat më të rëndësishme të punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Përmbajtja e rendit të ditës së kësaj seance dhe vendim-marrja e deputetëve ndërlidhur me rendin përkatës shënon kthesën e madhe të domosdoshme të vënies në vend të drejtësisë dhe përgjegjësisë së vonuar prej 20 vjetësh të krimeve dhe gjenocidit të kryer nga shteti serb dhe forcat e saj policore, ushtarake, gjenocidale ndaj popullatës shqiptare dhe etnive të tjera në vitet e luftës në Kosovë. Edhe pas 20 vjetësh përfundimit të luftës apo krejt fare pak ditë, para 20-vjetorit të çlirimit të Kosovës, edhe më tej nuk kemi drejtësi dhe përgjegjësi për krimet e gjenocidit të Serbisë. Përkundër qindra e mijëra dëshmime faktike të krimeve të ndërmarra nga Serbia dhe forcat policore e ushtarake të gjenocidit, vrasjeve, dëbimit, përndjekjeve etnike e kombëtare, veprimeve çnjerëzore, shfarosjes, burgosjeve, torturave, vrasjeve të qëllimshme, burgosjeve të paligjshme, shkatërrimit të vuajtjeve të qëllimshme, dëbimit rreth zhvendosjes së qëllimshme nga vendi, shkatërrimit të gjerë dhe përvetësimin e pronës, dhunimeve seksuale ndaj grave, ndaj shqiptarëve në vitet e luftës '98-'99 në Kosovë.

Asnjëherë dhe në asnjë moment e në asnjë rrethanë nuk do të mund të ndërtohet paqja e qëndrueshme dhe pajtimi, përderisa nuk do të ketë drejtësi dhe përgjegjësi për krimet monstruoze dhe gjenocidin e tmerrshëm të bërë në Kosovë nga ana e shtetit serb.

Të nderuar deputetë,

Të nderuara zonja dhe zotërinj,

Të nderuar të pranishëm,

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës të shpreh respektin dhe gjithë përkrahjen për iniciativën për themelimin e një gjykate ndërkombëtare që do të trajtonte në mënyrë të paanshme dhe profesionale, me argumente konkrete krimet e luftës që Serbia i ka kryer në Kosovë. Në seancën e sotme janë vendosur për diskutim dhe vendim-marrje temat, të cilat vërtet do të mund të hapin rrugë që mijëra e mijëra viktima të krimeve të gjenocidit serb t'i japin drejtësi dhe përgjigje, duke e mbështetur rezolutën për gjenocidin, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës të ish-regjimit shtetëror serb në Kosovë.

Formimin e Komisionit shtetëror për krijimin e Tribunalit për gjenocidin serb në Kosovë, vendimin për ndërtimin e Muzeut të Gjenocidit të ish-Fabrika e Tjegullave. Vendimin për ndërtimin e memorialit të dëbimit të Stacioni Hekurudhor i Prishtinës dhe caktimin e Ditës së gjenocidit, janë krime dhe gjenocidi i kryer nga Serbia ndaj shqiptarëve dhe etnive të tjera, për të cilat duam t'i dokumentojmë ato përmes një gjykate, qoftë gjykatë e cila do të merret konkretisht me fakte dhe argumentet, të cilët tanimë i posedojnë ose ndërkohë mund t'i grumbullojmë, por duhet të jetë një gjykatë ndërkombëtare, një Tribunal ndërkombëtar, ngase janë gjëra që kanë të bëjnë me të vërtetën dhe historinë tonë. Serbia përmes një fushate të mirëplanifikuar, të organizuar dhe të institucionalizuar shtetërore ka kryer në mënyrë sistematike nga forcat policore ushtarake serbe në Kosovë mbi 12 mijë vrasje të civilëve shqiptarë të pambrojtur, shqiptarë dhe etnive të tjera, përfshirë boshnjakë, turq, romë, ashkalinj, egjiptian, në mesin e tyre edhe rreth 1 mijë e 300 fëmijë. U dëbuan dhe u përzunë nga shtëpitë e tyre mbi një milion shqiptarë, shkatërruan dhe dogjën mbi 1 100 vendbanime shqiptare, duke djegur e shkatërruar tërësisht mbi 200 000 shtëpi, lokale, biznese, fabrika, shkolla, biblioteka, monumente kulturore-historike, objekte shkencore fetare dhe shumë e shumë objekte të tjera. Janë zhdukur rreth 5 mijë njerëz, shumë prej tyre akoma janë të zhdukur dhe familjarët e tyre ende janë në kërkim të fatit të tyre.

Serbia dhe çështja e Serbisë nuk mund të zgjidhet pa i pasur këto fakte dhe pa u dënuar ata që i kanë kryer të gjitha këto krime dhe pa i dënuar ata që kanë dhunuar gratë tona. Serbia në vitet e luftës në Kosovës kreu mbi 100 masakra të llahtarshme ndaj popullatës së pambrojtur civile. Forcat serbe ishin përgatitur të spastronin çdo gjë shqiptare dhe të të tjerëve në Kosovë. Krimi dhe gjenocidi serb mbi popullatën shqiptare në Kosovë nuk kishte të ndalur. Ata vranë mizorisht fëmijë, gra të moshuara... Fushata e tyre e institucionalizuar synonte të shkatërronte dhe të digjte të gjitha, çdo gjë të gjallë që kishte në këto. Janë masakrat e tmerrshme që tronditën dhe përplotën njerëzit në mbarë Botën. Masakra e Prekazit që bëri bujë në gjithë Botën, Masakra e Jasharajve, Masakra e Reçakut, Masakra e Prellocit, ku forcat serbe kryen vrasjet e qëllimshme për eliminimin fizik të shqiptarëve duke vrarë e masakruar në mënyrë më barbare shumë e shumë shqiptarë të armatosur. Masakra e Izbicës, Krimet ndaj fëmijëve e grave, të moshuarve, masakra e Rezallës duke vrarë pamëshirshëm gjithashtu fëmijë, gra e pleq të pambrojtur, Masakra e



Krushës së Madhe, Masakra e Rogovës së Hasit, Masakra e Studimes, Masakra e Mejes, Masakra e Likoshanit, Qirezit, Abrisë, Lubeniqit, Suharekës, Kaçanikut, Malishevës, Podujevës, Gjakovës, Mitrovicës dhe dhjetëra e dhjetëra masakra të tmerrshme anembanë Kosovës.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Të vetëdijshëm se krimet dhe gjenocidi serb i kryer në Kosovë në vitet e luftës 1998-1999 nuk është trajtuar e adresuar, as nga udhëheqja vendore, as nga ajo ndërkombëtare në masë të duhur. Ju ftoj, që bashkërisht të mbështesim iniciativën e parashtruar në pikat e rendit të ditës së seancës së sotme dhe që të mundësohet të vihet drejtësia dhe përgjegjësia në vend përmes argumentimit dhe vërtetimit të krimeve të gjenocidit serb në Kosovë.

Ne këto ditë kemi pasur një delegacion të mëngjesit të lutjeve nga Kongresi Amerikan në krye me kongresmenin Rendi Hotgreen. Kemi takuar shumë personalitete, të gjitha personalitetet e Kosovës, por gjendja më e rëndë dhe më e dhembshme ka qenë kur kemi vizituar Qendrën për promovimin e të drejtave të grave në Drenas dhe Prekazi. Dhe, të jeni të sigurt që ata e kanë parë drejtpërsëdrejti atë çfarë ka ndodhur aty dhe jo rastësisht kanë insistuar dhe insistojnë që edhe Kongresi Amerikan dhe të gjithë të tjerët të jenë pjesë e vendosjes së drejtësisë, sa i përket krimeve serbe në Kosovë. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, zoti Reçica! Fjalën e ka përfaqësuesi i Grupit Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, Saranda Bogujevci. Urdhëroni!

**SARANDA BOGUEVCI:** Faleminderit!

Të nderuar familjarë të personave të pagjetur që jeni sot këtu me ne,

Të gjithë familjarët që kanë humbur më të dashurit e tyre gjatë luftës së fundit,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Deputetë,

Kur kalon... kur prekesh nga lufta, kisha dashur me thënë, edhe bëhesh qoftë viktimë, qoftë i mbijetuar, i asaj kohe, më e pakta që nevojitet përderisa proceset tjera kalojnë, është të trajtohesh me dinjitet, e para, nga të afërmit e tu po edhe nga shoqëria ku jeton. E për fat të keq, jo se nuk kemi arritur të krijojmë kushte për drejtësi në vendin tonë për këto familje, po as edhe nuk janë trajtuar me dinjitet ashtu siç duhet.

Të krijosh një tribunal ndërkombëtar janë disa procedura. Duhet të ketë një kërkesë në OKB, duhet një rezolutë në OKB që ta lejojë formimin e një tribunali ndërkombëtar e kjo merr kohë dhe lyp përkrahje. E para, nuk jemi anëtarë të OKB-së dhe e dyta kemi shtete pjesë të OKB-së, që nuk na përkrahin. Por, kjo prapë nuk do të thotë që ne nuk duhet të punojmë në atë drejtim. Nuk guxojmë të japim deklarata pa qenë të sigurt në këto procese, se kjo e kam parë që ka ngjallur shpresën e familjarëve dhe familjarët duhet ta dinë saktë çka ne mund të bëjmë dhe çka do të bëjmë në këtë drejtim. Për atë arsye duhet të jemi të sigurt në këta hapa.

Nëse e sheh procesin e tribunalit ndërkombëtar në Liban, kjo ka marrë pjesë diku rreth afër 4 vjet. E para, ka qenë kërkesë brenda OKB-së, janë bërë negociata në mes veti, pastaj është nxjerrë një rezolutë dhe tek pas katër viteve kanë arritur të themelohet, ku Libani e bën gjysmën e financimit për këtë tribunal dhe pjesën tjetër shtetet tjera, që kanë qenë të interesuara ta përkrahin.

Tjetra, Tribunali ndërkombëtar e ka një mandat të caktuar dhe dënon persona të caktuar, njëjtë qysh ka qenë Gjykata e Hagës për Krime të luftës për ish-Jugosllavinë, domethënë tash veçse ka përfunduar mandati. Është me rëndësi të ndërtohen procese që çojnë deri te drejtësia për familjet. U përmend instituti, formimi i institutit, domethënë themelimi i institutit me ligj është shumë me rëndësi, për shkak se në këtë institut duhet të jenë njerëz që janë ekspertë të fushës, që e dinë se si shkon procesi për dokumentimin e verifikimin e të dhënave të krimeve të luftës. Mendoj që është e padrejtë të thuhet se “nuk është bërë punë në institut...” në fakt, instituti ka arritur të bëjë aq punë sa ka mundur me resurset që i ka pasur. Edhe stafi i institutit ka njohuri dhe ka pasur trajnime të mjaftueshme dhe e di punën e vet.

Projektligji për themelimin e institutit është gati, statuti është gati, rregulloret janë të gjitha të punuara dhe këtë Ministria e Drejtësisë duhet ta dijë, për shkak se këto janë brenda këtij institucioni. Nuk mundemi ne si deputetë, e përmendi edhe kolegu Hoti, të merremi me hulumtime për krime të luftës, nuk e kemi atë ekspertizë asnjëri, as nuk e ka shoqëria civile e as nuk e kanë familjarët. Duhet institucion që merret specifikisht vetëm me këtë çështje, që e bën dokumentimin dhe e bën arkivimin dhe e kemi një adresë të caktuar. Nëse nuk është bërë mjaftueshëm deri më tani, ishte dashur kjo tash e tutje të bëhet. Duhet të fuqizohen institucionet e vendit. Kam përmendur edhe herëve tjera, Policia, Prokuroria nuk mund të funksionojmë me një prokurorë që përveç krimeve të luftës merret edhe me çështje të tjera. Nëse ne i fuqizojmë institucionet tona që i kemi në vend, që merren me këtë çështje, mendoj se kemi bërë një punë të madhe, po edhe do të ketë më shumë seriozitet edhe nga përkrahja ndërkombëtare në këtë drejtim, që ne të shkojmë dhe të arrijmë të ndërtojmë, qoftë gjykatë të vendit, qoftë tribunal ndërkombëtar. Në fakt, të dyja mund të bëhen.

Përderisa nuk i rregullojmë çështjet tona të brendshme kemi me pas vështirë. E kemi vështirë tani të marrim të dhëna të sakta brenda institucioneve tona. Askush nuk është që të mos ketë, qoftë gjykatë vendore, qoftë ndërkombëtare, për krime të luftës, po rrugëtimi deri te formimi i këtyre gjykatave është tepër me rëndësi dhe lus që secili ta mendojë së pari çka domethënë kjo për familjet. Nuk guxojmë asnjëri të japim premtime, të japim fjalë të mëdha, pa qenë të sigurt në këto procese, se kjo ju jep shpresë familjarëve e familjarët janë duke jetuar qe 20 vite me këtë shpresë.

Është thënë shumë herë, ndërkombëtarët i kanë pasur punët në dorë. Po, për një pjesë të tyre edhe ua kemi dhënë atë të drejtë, edhe tjetra, si vend kemi pasur mundësitë, i kemi pasur

kompetencat që që 20 vjet më e pakta që ka mundur të bëhet është dokumentimi i krimeve të luftës në Kosovë, jo vetëm në njerëz, por edhe dëmet tjera që i janë bërë vendit.

E pata ndërmend të mos e përmend, por e kam të rëndësishme. Kam kaluar nëpër procese gjyqësore tash e njëzet vjet. As edhe një herë unë nuk e kam pasur përkrahjen e vendit tim. E kam pasur përkrahjen e një vendi tjetër, e kam pasur krahë një vend tjetër që më ka marrë edhe është kujdesur për mua. Unë po dua që vendi im të jetë krah i familjeve në këtë vend, të cilët nuk e kanë mundësinë që e kam pasur unë. Duhet të bëhen punët drejtë dhe t'i kemi njerëzit e fushës që i kuptojnë edhe e dinë këtë. Kemi sa të duash njerëz brenda vendit që janë shkolluar jashtë në këtë drejtim edhe që mund të japin shumë kontribut. Mund ta lexoni edhe propozimin që më herët e pashë se është publikuar në "Kosovo 2,0" prej Robert Muharemi, ku tregon specifikisht çka mund të bëjmë ne si vend karshi... domethënë që të mund ta padisim Serbinë për gjenocid. Domethënë, ka njerëz, veç duhet me i dëgjua edhe duhet me marrë iniciativë për me ua dhënë mundësinë për të bërë diçka.

Përderisa ne nuk i fuqizojmë institucionet tona kurrkush s'ka me na marrë seriozisht edhe s'do të mund të bëjmë kurrgjë, qysh nuk kemi bë që 20 vjet.

Duhet patjetër instituti të themelohet, nëse doni me më shti me besua që përnjëmend e keni seriozisht këtë muhabet edhe po doni me bo diçka atëherë merruni me i ndërtua institucionet tona që me mbërri me i gjykua krimet e luftës në Kosovë. Edhe një aspekt tjetër që desha ta përmend, rëndësinë e gjykatës vendore. Tribunali ndërkombëtar nuk i gjykon të gjitha krimet e luftës në Kosovë. Gjykata e vendit që merret me krimet e luftës ka me pas mundësinë për sa kohë që është e nevojshme me i gjykua krimet e luftës.

Duhet ta dimë sigurt çka po dom të bëjmë dhe ku po shkojmë. Nuk mundemi veç me ide. Edhe një çështje tjetër, se veçse u bë temë sot. Ju kisha lut që të keni kujdes në mënyrën që mos me lënë me ndodh ajo çka ndodhi më herët me fotografi. Është tepër me rëndësi që çdo viktimë, çdo familjar të trajtohet me dinjitet. Nuk guxojmë të lejojmë më gjëra të tilla. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, deputete! Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të AAK-së, zoti Ahmet Isufi.

**AHMET ISUFI:** Faleminderit, kryesuese! Unë në shenjë të mirëkuptimit ia kisha kalua fjalën shefit të Grupit Parlamentar të Nismës, meqë ka me shkua me e harmonizua rezolutën e pastaj mund ta marr fjalën pas tij.

**KRYESUESJA:** Faleminderit për mirëkuptim! Urdhëroni shefi i Grupit Parlamentar Nisma Socialdemokrate.

SHERIF BILALLI: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Faleminderit koleg Isufi!

Unë kërkoja që të dal ta them fjalën time para juve dy grupeve më të mëdha, për faktin se po shkojmë t'i harmonizojmë vërejtjet dhe sugjerimet e rezolutës me kërkesë të familjarëve, sepse duan që të votohet, të kenë mundësi të jenë prezentë kur të votohet rezoluta para se ata të shkojnë dhe janë lodhur. Kjo ishte kërkesë e tyre. Prandaj edhe kërkoja që të mbajmë një konsultë me anëtarët e Komisionit ad hoc.

Tash po i kthehem pikës së rendit të ditës.

Mendoj që të gjithë jemi të vetëdijshëm që shumë punë që është dashur të bëhen brenda këtyre 20 vjetëve nuk është bërë dhe po, kritika qëndron se së paku mbledhjen e provave dhe dokumentimin kemi mundur ta bëjmë, askush nuk na ka ndaluar dhe fakti se nuk na kanë ndaluar dhe nuk e kemi bërë nuk do të thotë që nuk duhet ta bëjmë tash e tutje.

Pa marrë parasysh kush është sot në pushtet dhe kush në opozitë, kush nesër në pushtet dhe kush në opozitë, beteja a lufta për mbledhjen e provave për ndjekjen e individëve e atyre që kanë ushtruar krimin, e kanë kryer krimin, dhe atyre që e kanë urdhëruar, pra shtetin, e kanë planifikuar dhe urdhëruar, pra shtetin e Serbisë, nuk duhet të përfundojë kurrë. Nazistët gjermanë ndiqen edhe sot e kësaj dite, edhe pse në moshë të shtyrë, 80, 85 e 90 vjeç. Ju e dini kemi storie të ndryshme televizive ku u kap një në Brazil, u kap një në Argjentinë e kështu me radhë. Por Gjermania ka pranuar përgjegjësinë menjëherë pas luftës, për faktin se Gjermania e sotme u pushtua nga aleatët e atëhershëm dhe si rezultat përmbysja e regjimit nazist mundësoi ndjekjen dhe dënimin e kriminit të gjenocidit të Gjermanisë. Mirëpo, Izraeli që është ndjerë si vend, ose komb i persekutuar dhe i cili ka qenë cak i nazistëve nuk e ka ndaluar luftën kundër nazistëve, pa marrë parasysh se Gjermania ka pranuar fajësinë dhe ka pranuar të marrë edhe përgjegjësinë.

Pra, ajo që ne duhet të bëjmë, mos ta ngatërrojmë dënimin e atyre që kanë kryer, sepse ndonjë kriminel mund t'i ikë drejtësisë, mund të vdesë, mund të zhduket, por jo Serbia. Ajo që ne po bëjmë me rezolutën, ajo që do të bëjmë pastaj me veprimet e gjykatave vendore, ajo nuk zëvendësohet dhe nuk mund të jetë zëvendësim për asnjë gjë tjetër apo tribunalet nuk mund të jenë zëvendësim për gjykatat. Ministri i Drejtësisë, nuk qenka këtu, e di, ju deputetë e dini që kemi amendamentuar, e kemi në procedurë Ligjin e Kodit Penal ku do të mundësohet dënimi në mungesë për të gjithë ata që kanë kryer krime gjatë luftës.

Pra, nëse ai instrument do t'u jepet në dorë sistemit të drejtësisë tek ne, sigurisht se prokurorët dhe gjykatësit do ta kryejnë punën e tyre, por deri më tani ligji i ka pamundësuar ata që të bëjnë dënimet në mungesë. Tash këtu qëllimi i dokumentimit, i krijimit të këtij mekanizmi për dokumentimin nuk është i keq, është i mirë si qëllim. Mendoj se ka hapësirë për t'u krijuar një komision që së bashku nga të gjitha grupet parlamentare, ashtu siç e bëmë rezolutën, të ulemi

dhe të shohim mënyrat më të mira, se si qëllimit të mirë t'ia bashkëngjisim edhe format dhe mekanizmat më të duhur përmes të cilave do të mund të vazhdojë dhe të kryhet kjo punë.

Në parim ne mbështesim këtë iniciativë që duhet të krijohen mekanizma që grumbullojnë prova. Nuk bëhet fjalë sepse këtu po dëgjohet se deputetët nuk mund të zëvendësojnë apo komisionet nuk mund të zëvendësojnë sistemin e drejtësisë. natyrisht që nuk mund ta zëvendësojnë dhe nuk është besoj as qëllimi këtu, por komisioni më shumë besoj nuk dëgjova, por shpresoj që të jetë ashtu, që ka për qëllim të nxisë grumbullimin e provave, pastaj sistemi i drejtësisë për secilin rast veç e veç do të gjykojë se kush është fajtor, kur është kryer, në çfarë rrethanash është kryer? Ku është përgjegjësia e shtetit të Serbisë? Ku është përgjegjësia e pjesëtarëve të Policisë, të Ushtrisë apo të shërbimit sekret të Serbisë.

Pra, në parim i japim mbështetje iniciativave. Kemi dilemat tona sa i përket tribunalit ndërkombëtar, sepse kam frikë se duke pritur Tribunalin ndërkombëtar mund të shkojnë vite e dekada, ndërsa po qe se këto prova ua dërgojmë gjykatave vendore, prokurorisë dhe gjykatave vendore ato mund më shpejtë, përmes amendamentimit të ligjit të ri, përmes mundësisë që rastet t'i gjykojnë në mungesë të akuzuarit t'i gjykojnë ë mungesë, do të kemi mundësi që shumë më shpejtë të vijmë tek aktgjykimet fajësuese në shkallë të parë dhe në shkallë të dytë. Edhe nëse ndonjëherë Bota demokratike beson që Kosova është duke e tepruar me gjykime në mungesë, atëherë le ta krijojnë një gjykatë ndërkombëtare dhe le t'i marrë edhe një herë të gjitha rastet në shqyrtim. Ne nuk mund ta ndalojmë askënd që të krijojë mekanizma përmes të cilëve pastaj do të rishqyrtonte aktgjykimet.

Por, unë mendoj që detyrë e komisionit do të duhej të ishte grumbullimi i provave apo në një mënyrë një zëvendësim i atij, që tash u tha se paska qenë një ekip, jo një institut. Shumë mirë, deri më tani e kemi ditur që është institut, për vite të tëra, në mos për dekada. Tash e morëm vesh që është ekip, tash le ta formojmë pra një institut, le t'i grumbullojë këto dhe për secilin rast le të fillojnë le të ngritën aktakuza, le të shpallen aktgjykime, qoftë fajësuese, qoftë aktgjykime shfajësuese, le t'i mbetet kjo prokurorisë dhe gjykatave për të dhënë verdiktin final. Dhe nëse Serbia nuk i dorëzon, sepse deri më tani ajo ka zgjedhur që nëpërmjet mohimit t'i mbrojë kriminelët e krimet, pra "mohoj që kam bërë krime dhe fakti që unë mohoj, nuk kanë kë e dënojnë, sepse nuk kam kryer krime..." Pra, një herë e kemi për detyrë që përpos t'i grumbullojmë ato prova, provave duhet t'u bashkëngjiten aktgjykimet. Vetëm përmes aktgjykimeve do të lëvizë Bota, të jeni të bindur. Nëse nuk do të ketë aktgjykime fajësuese me prova të cilat ne jemi ende dëshmitarë të gjallë, ju këtu dhe shumë përjashta të cilët i kemi përjetuar këto. Kemi familjarë të cilëve fëmijët ua kanë marrë nga gjiri, nga prehri, nga shtëpia. Sot kemi mjaftueshëm prova. Kushdo që thotë se nuk ka prova për t'u dëshmuar gjenocidi serb në Kosovë, ai ose nuk e njeh definicionin e gjenocidit, ose nuk besoj që të ketë qëllime të tjera, përpos mungesës së njohurive.

Prandaj, le të ecim përpara, ta miratojmë rezolutën si bazë, mbi bazën e së cilës pastaj do të mund të derivonin shumë dokumente tjera, pse jo edhe ligje, nesër një ligj për gjenocidin të kryer në Kosovë? Pse jo përmes aktakuzave dhe aktgjykimeve të konfirmohet ai gjenocid përmes të cilit Kuvendi i Kosovës ka konstatuar në rezolutën e saj, e kështu me radhë... Pra, në parim jemi dakord por mendojmë që duhet të përfshihen të gjitha grupet parlamentare që të japin kontributin e tyre se si është më së miri, që idesë së mirë, qëllimit të mirë t'i bashkëngjiten edhe format dhe mekanizmat e duhur. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Sherifi! Zonja Pantina, besoj që nuk ka problem nëse e marr tash menjëherë fjalën zoti Isufi. Urdhëroni!

AHMET ISUFI: Faleminderit, zonja kryesuese!

Të nderuara shoqata të familjeve të pagjetura dhe ju shoqata të tjera, që jeni marrë me të gjitha këto krime që kanë ndodhur në Kosovës e që jeni munduar t'i zbardhni.

Unë konsideroj që në angazhimet e deputetëve për të pasur një rezolutë, e cila do të dënonte gjenocidin serb, i cili ka ndodhur në Kosovë, është folur mjaftë. Prandaj, nëse ne vazhdojmë edhe më tutje vetëm të numërojmë dhe të përmendim ngjarje që kanë ndodhur në Kosovë e kanë ndodhur në të gjitha territoret. Ja këtu për shembull e kemi afër Grashticën, Makofcin, e kemi Llashticën, Lladovën, Zhegrën e... domethënë i gjithë territori i Kosovës ka qenë i sulmuar me pasoja të krimeve dhe të gjenocidit. Prandaj, nuk duhet vazhdimisht t'i përsërisim. Përkundrazi, tash duhet të marrim vendime që të zgjidhet kjo çështje, duke i marrë të gjitha të dhënat të cilat mund të dokumentojnë krimin dhe gjenocidin që ka ndodhur në Kosovë. Normalisht që tash jemi në pjesën më pragmatike. Konsideroj dhe s' duhet të mbajmë shumë fjalime, por duhet ta themelojmë Komisionin, i cili duhet të mbledhë të gjitha të dhënat të cilat çojnë drejt formimit të një tribunali, i cili mund t'i gjykojë krimet dhe me këtë rast gjenocidin serb që ka ndodhur në Kosovë.

Formimi i tribunalit mund të bëhet, sepse ka përvoja të shteteve të ndryshme që kanë pasur rrethana të përafërta me të Kosovës. secili vend i ka specifikat e veta, por mund të gjendet një rrugë e cila çon drejt krijimit të një tribunali, edhe duke bashkëpunuar me mekanizmat e bashkësisë ndërkombëtare të cilat e mundësojnë një gjë të tillë. Dhe po ashtu, duke konsideruar se ne e përkrahim këtë iniciativë, unë nuk po dua të zgjatem më shumë, sepse nuk ka nevojë për një elaborim më të madh. Së paku me fjalë, për njëzet vjet me radhë kemi diskutuar për këtë çështje, e sidomos nuk duhet t'i maltretojmë familjet të cilat vërtet çdo njeri që ka ndjenjë njerëzore, bashkëndjen me ta edhe ka nevojë të lëshohemi në veprime konkrete, të cilat mundësojnë të gjitha veprimet për zbardhjen e fatit të të pagjeturve, për themelimin e një gjykate që do të dënonte krimet dhe gjenocidin që ka ndodhur në Kosovë dhe shteti serb ta marrë dënimin e merituar.

Edhe atë ditë që janë tubuar të gjitha institucionet, shoqatat, këtu në këtë Parlament, kanë thënë që është marrë kjo iniciativë pavarësisht interesave, pavarësisht presioneve që mund të bëhen për shkaqe politike, duhet të themelohet një komision shtetëror, i cili do të mundësojë zbatimin e të gjitha detyrave që i merr për të pasur një tribunal ndërkombëtar. Më në fund të zbardhet çështja e të gjitha atyre që ka ndodhur në Kosovë. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit! Tani ftoj përfaqësuesin e GP të PSD-së, znj. Shqipe Pantina. Faleminderit për mirëkuptim!

**SHQIPE PANTINA:** Faleminderit kryesuese!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuara familje të personave të pagjetur,

Të nderuara familje të dëshmorëve,

Qoftë këtu në sallë, qoftë jashtë salle që e përcillni nëpër shtëpitë tuaja. Janë edhe 23 deputetë që po presin për të marrë fjalën për këtë pikë të rendit të ditës. Kam frikë se shumica e këtyre fjalimeve do të jenë përsëritje të njëra-tjetrës, ku do të renditen ngjarjet që kanë ndodhur përgjatë historisë, luftës, gjenocidit që është kryer këtu në Kosovë. Pra do të jenë kryesisht fjalime patriotike, folklorike e kështu me radhë. Prandaj, ne do t'ju kursejmë nga këto fjalime. Ajo çka ne po propozojmë, ose mbështesim, sepse u tha edhe më herët, është që të krijohet një komision parlamentar, e i cili do të shtjellonte më tutje këtë ide, e cila si ide nuk është ndoshta ide e keqe. Megjithatë nuk është e zhvilluar, nuk është e shtjelluar si duhet. Dhe në konsultim edhe me grupet e tjera shoqërore, qoftë me shoqatat e dala nga lufta, qoftë me ekspertë të fushave, qoftë me përfaqësues të institucioneve, disa prej të cilave janë renditur edhe këtu, do të mund të nxirrnim pastaj një propozim, i cili propozim do të mund të vinte në Kuvend për t'u votuar dhe pastaj do të vazhdohej tutje.

Kështu që ne e mbështesim idenë. Do të japim propozimet tona për punën që do të bëjë ky Komision dhe në fund do të mbështesim edhe propozimin që e sjellë Komisioni, nëse ai është i harmonizuar dhe natyrisht paraqet një konsensus të të gjitha grupeve politike, por edhe në shoqëri. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit deputete! Fjalën e ka shefi i GP 6+, z. Albert Kinolli,

**ALBERT KINOLLI:** Faleminderit e nderuara kryesuese!

Të nderuar kolegë,

Pa dashur t'i përsëris ato që i thanë kolegët e mi të nderuar, dëshiroj të jem i shkurtër dhe i qartë. Që ne si GP 6+ e kemi shqyrtuar me kujdes të veçantë këtë material dhe dua të them se ne si grup parlamentar 6+ e përkrahim iniciativën e krijimit të Tribunalit për gjenocidin serb në Kosovë, dhe po ashtu përkrahim propozimin për ndërtimin e Muzeut të Gjenocidit, do të ishte fabrika e tjegullave. Si dhe propozimin për ndërtimin e memorialit të dëbimit te Stacioni

hekurudhor i Prishtinë. Si dhe kontributin tonë do ta japim përmes punës në komisionin shtetëror.

Dhe për fund, dëshiroj të them, të shtoj diçka, e cila nuk është në tekst. Në faqen 2, te pasuesi i dytë, te rreshti i parë, ku thotë rreth 90 për qind e popullsisë shqiptare u detyruan të bëheshin refugjatë, ne propozojmë, duke pasur parasysh faktin se kanë qenë të dëbuar nga Kosova edhe mijëra pjesëtarë të komuniteteve boshnjak, turk, rom, ashkali dhe egjiptian. Që në këtë pasus ku shënon rreth 90 për qind të popullsisë shqiptare u detyruan të bëheshin refugjatë, t'i shtohet edhe komunitetet si: boshnjak, rom, turk, egjiptas dhe ashkali. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Islam Pacolli.

**ISLAM PACOLLI:** Faleminderit kryesuese!

Kolegë të nderuar,

Media,

Familje e të pagjeturve që gjendeni sot këtu, sot tërë ditën na keni dëgjuar.

Sot jemi këtu në një përkrahje, një vendim të rëndësishëm. Ajo që kisha dashur të bëjë thirrje para se të hyjë, që kjo mos të jetë vetëm rezolutë, po të jetë vendim, që të jenë vendim që ajo duhet të bëhet, e jo vetëm rezolutë, që ne ende të sillemi a do të realizohet a jo. Prandaj, kisha pasur dëshirë që të kthehet në vendim, dhe atëherë ne do të kuptohemi që e kemi përnjëmend.

Fillimisht dua të them se ata të cilët bënë krime në Kosovë ndaj popullit shqiptar dhe minoriteteve të tjera, janë pikërisht ata që sot udhëheqin politikën serbe në Serbi. Prandaj, çfarë paqe po duam ne? Ne sot duhet të kërkojmë të drejtën tonë. Ne mos të harrojmë që ata nuk janë duke u sjellë vetëm në Serbi, po edhe në territorin e Republikës së Kosovës dhe ka asi shumë. Prandaj, ne sot duhet të nxjerrim një vendim për themelimin e Gjykatës në harmoni me aleatët ndërkombëtarë. Ne pa aleatët ndërkombëtarë kam frikën që nuk do të kenë rezultat, prandaj dua të shohë këtë rezolutë që deri më tani të kuptohet si dhe çka. Çka përfshin? A do të kenë edhe gjykatës ndërkombëtarë?

Këto sot u bë koha shumë, tërë ditën. Ka plot edhe kolegë të tjerë, nuk dua të zgjatem shumë, po dua të shoh që kjo nuk është vetëm fjalë, po ne të marrim vendim sot dhe ta zgjidhim këtë çështje njëherë e përgjithmonë. Edhe pse është jo e vonuar, është shumë e vonuar, por ne më mirë sot se kurrë. Prandaj, unë i përgëzoj për këtë iniciativë, e përkrah fuqishëm, por le të jetë vendim.

**KRYESUESJA:** Faleminderit deputet! Fjalën e ka deputeti Arben Gashi.

**ARBEN GASHI:** Të nderuar deputetë,

Sot kemi para vetes një çështje të një rëndësie jashtëzakonisht të madhe për Kosovën. Çështje që ka njëzet vjet që sillet nëpër institucionet e Kosovës.



Kërkesa për formimin e komisionit shtetëror për formimin e Tribunalit për gjenocidin serb në Kosovë. Megjithatë, fatkeqësisht edhe para kësaj një kërkesë të tillë, të një rëndësie nacionale, ne si deputetë kemi paqartësi se çka në të vërtetë kërkohet me këtë propozim. A përbën një realizim për dhomat e specializuara të gjykatës për krimet e luftës apo një rivalizim të saj. Për të konkluduar çkado, ne duhet të thellohem në shumë në problematikën që e kemi përpara.

Historia nuk fillon sot dhe ngjarjet kanë një kronologji. Gjatë periudhës njëzetvjeçare në Kosovë ka pasur iniciativa të ndryshme nga faktorët politikë vendorë dhe ndërkombëtarë, por iniciativa që rrallë kanë dhënë produkt. Ndër të tjera, te institucionet vendore në Kosovë, kemi parë iniciativa, siç ka qenë iniciativa për krijimin e komisionit shtetëror për dëmet e luftës, iniciativë që rezultoi të jetë një dështim dhe pa asnjë produkt në interes të vendit.

Iniciativa e dytë po ashtu e Qeverisë Thaçi ishte ajo për themelimin e Institutit për krime të luftës, institut ky i themeluar në v. 2011 dhe me mision të përfunduar në v. 2018. Megjithëse me mision të përmbyllur, ne ende nuk e kemi qartë një raport pune të këtij instituti për të gjeturat e tij, si bie fjala: sa raste janë identifikuar, sa raste janë proceduar, me cilat prokurori dhe gjykata janë proceduar, sa raste janë gjykuar, sa raste janë dënuar.

Angazhimi i radhës i institucioneve të Kosovës ishte edhe formimi i një komisioni për verifikimin e viktimave të dhunës seksuale të luftës. Proces ky që sikurse edhe proceset e tjera është karakterizuar me mungesë të theksuar të rezultatit dhe të adresimit të pyetjeve thelbësore siç është rasti i identifikimit, procedurat dhe gjykatat ku ato çështje janë trajtuar.

Në vitin 2017, tashmë nga pozicioni i Presidentit, z. Hashim Thaçi themelon ekipin përgatitor për Komisionin për të Vërtetën dhe pajtimin. Ngjashëm me ekipet e tjera, edhe ky ekip nuk ka për qëllim të vërtetën dhe pajtimin, sepse në esencë propozuesi nuk e kupton as procesin e as funksionimin e duhur të tij, po kërkon me çdo kusht që nëpërmjet këtij Komisioni të gjejë një formë për të anashkaluar përpjekjet potenciale për krimet e ndodhura në Kosovë. Në anën tjetër, ndodhet bashkësia ndërkombëtare me veprimet e saj dhe mosveprimet e veta po ashtu lidhur e të gjitha proceset apo nismat në Kosovë.

Menjëherë pas lufte, institucionet ndërkombëtare të drejtësisë të gjykatave të UNMIK-ut, kishin krijuar sistemin e tyre për të trajtuar krimet e luftës. Megjithëse rezultati i punës së tyre del të ketë qenë i pamjaftueshëm për të gjykuar apo të dënuar disa nga krimet e kryera. Dhe këto kryesisht janë fokusuar ndaj komandantëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për dyshimet kundrejt tyre kryesisht për krimet ndaj shqiptarëve.

Gjithashtu, çka është po ashtu thelbësore, nuk ka fare ndjekje dhe gjykim të krimeve të ushtrisë, policisë, strukturave paramilitare dhe organeve të tjera serbe në Kosovë.

Tutje, me krimet e luftës në Kosovë është marrë edhe Tribunali Ndërkombëtar i Hagës për krimet e luftës në ish-Jugosllavi. Ky tribunal gjykoi dhe dënoi disa zyrtarë të lartë serbë për krimet e luftës në Kosovë, si dhe gjykoi dhe gjeti të pafajshëm disa nga komandantët kryesorë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Megjithatë ky tribunal nuk u mor me krimet e tjera serbe në Kosovë në asnjë fazë të procesit dhe për më tepër sugjeroi që krimet e niveleve më të ulëta duhet të merren sistemet përkatëse vendore të drejtësisë.

Tashmë vjen periudha e Misionit Evropian të Sundimit të Ligjit të njohur si EULEX. Po ashtu, për aktivitet bazë ka pasur trajtimin e krimeve të luftës dhe të pasluftës në Kosovë. Duke ndjekur, gjykuar dhe dënuar në pjesë të konsiderueshme të ish-komandantëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për krime lufte. Kësaj radhe të akuzuarit dhe të dënuarit ishin kryesisht të dyshuar për krime ndaj popullatës civile shqiptare. Përsëri nuk evidentuam përpjekje dhe dënime për krimet e institucioneve dhe strukturave kriminale serbe ndaj shqiptarëve dhe të tjerëve në Kosovë.

Paralelisht me Misionin e EULEX-it, një mision tjetër u iniciua për hetimin e krimeve të luftës dhe të pasluftës. Kësaj radhe nga një raportues i Këshillit të Evropës, mision që për bazë kishte një raport të titulluar, trajtimi çnjerëzor dhe trafikimi me organe njerëzore në Kosovë. Pra, i njohur si raporti i Dik Martit. Ky raport u shoqërua me debate të mëdha edhe në arenën ndërkombëtare. Individit që rezultoi të përmendet gjithandej në raport, në atë kohë Kryeministër i Kosovës, duke dashur të dëshmojë pafajësinë e tij, kërkon hetim ndërkombëtar dhe gjykim të pavarur ndërkombëtar. Kjo kërkesë materializohet tutje me dhomat e specializuara për krimet e luftës në Kosovë, që do të funksionojnë me ligjet e Kosovës, jashtë territorit të Kosovës, me trupë ndërkombëtare të gjyqtarëve, prokurove, hetuesve dhe zbatuesve të dënimit.

Historiku si më sipër duhet të na shërbejë si alarm për iniciativa të tilla të tjera. Tashmë para nesh kemi një rezolutë dhe po ashtu një propozim, i cili krijon më shumë të panjohura sesa ofron zgjidhje. Ne kurrë nuk kemi pasur një raport si Kuvend i Kosovës dhe përfaqësues të popullit për të ditur më saktësisht se çka ndodhi me Komisionin për dëmet materiale të luftës, çka ndodhi me Komisionin për krimet e luftës, çka ndodhi me Institutin për hulumtimin dhe dokumentimin e krimeve të luftës? Çka ndodhi me Komisionin për pajtimin dhe të vërtetën? Çka ndodhi dhe pse gjykatat, prokurorët e Kosovës nuk e proceduan asnjë rast për krime të luftës? Çka ndodhi me gjykatat e UNMIK-ut e EULEX-it në Kosovë që gjykuan dhe dënuan vetëm udhëheqës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të cilët u gjykuan dhe u dënuan kryesisht për krime ndaj civilëve shqiptarë.

Përfundimisht, sot po kërkohet të krijohet një komision shtetëror krejtësisht politik për krimet e luftës, komision që do të detyrohej të drejtohej nga kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe që do të ishte tërësisht politik.

Nëse historiku i mësipërm na tregon diçka, është që të kemi dyshime të mëdha se fati i këtij Komisioni politik do të jetë i njëjtë me komisionet e tjera.

Disa pyetje që vlerësoj se duhet të adresohen nga ky tribunal janë: ky tribunal do të jetë ndërkombëtar apo vendor? Cila do të jetë baza ligjore? Ku do të jetë i vendosur? Hetuesit, prokurorët, gjyqtarët do të jenë vendorë apo ndërkombëtarë? Kush do t'i financojë? Si do të realizohen ftesat për intervista për të dyshuarit serbë? Si do të zbatohen vendimet për arrestim? Kush do t'i zbatojë vendimet e mundshme të dënimeve? A do të ketë gjykime dhe dënime në mungesë si pasojë e pamundësisht të realizimit të prezencës fizike të të dyshuarve? A do të ketë qasje në dëshmitë, faktet që janë marrë prej hetuesve të Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës për krime të luftës në ish-Jugosllavi deh çfarë bashkëpunimi do të kishte ky komision me ta, tashmë kjo gjykatë e mbyllur? Çfarë metoda do të përdorë për t'i detyruar organizatat ndërkombëtare, përfshirë Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës të bashkëpunojë dhe të dorëzojë në dëshmi? Nëse nuk do të ketë vullnet për bashkëpunim.

Për përfundim, vlerësoj se faza implementuese nuk do të ndodhë normalisht edhe një dekadë. Iniciuesit e kësaj nisme e dinë fare mirë që ky tribunal nuk do të funksionalizohet të paktën edhe dhjetë deri 15 vjetët e ardhshëm. Për pasojë, ku është dirjiteti i kësaj nisme? Nëse njerëzve u jepet shpresa pa kurrfarë substance? Përderisa një nismë e duhur, duhet të mendohet tutje më thellësisht, jo vetëm për punën dhe proceset drejt krijimit, e më pas funksionalizimit të një tribunali të tillë, duke qenë një temë e ndjeshme duhet pasur kujdes dhe shumëfish me komunikimin e këtyre nismave apo popozitetin që secila viktimë dhe secilit person t'i ofrohet një pasqyrë reale për punën e këtij tribunali dhe për rezultate potenciale. Prandaj, unë si deputet i Kuvendit të Kosovës pres përgjigje në të gjitha këto pyetje dhe dilema që mendoj se i ka secili deputet, secili qytetar i Kosovës. faleminderit!

*(Drejtimitin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)*

**KRYETARI:** Faleminderit! Safete Hadërgjonaj, urdhëro!

**SAFETE HADËRGJONAJ:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar familjarë të personave të pagjetur,

Shoqata të cilat jeni sot këtu të pranishëm,

Të nderuar familjarë të cilët nuk jeni këtu prezentë me neve,

Ne që jemi dëshmitarë të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të sakrificës së popullit tonë gjatë vitit 1998-99, ne që jemi dëshmitarë të vuajtjeve dhe dhimbjes që përjetuan pas luftës me mijëra familjarë, ne që çdo ditë i dëgjojmë rrëfimet e familjarëve tanë për vrasjet e bëra para syve të tyre, për dhunën që e përjetuan në luftë, ne që i dimë dhimbjet e familjarëve tanë për njerëzit e tyre të dashur që u kanë munguar tash e njëzet vite, e dimë sa vlerë ka të dënohen ata që kryen krimin mbi njerëzit e pafajshëm, të pambrojtur, mbi gratë e fëmijët, mbi pleqtë e plakat që u vranë dhe u dogjën në shtëpitë e tyre. Sot, kur po shqyrtojmë Propozim-rezolutën për gjenocidin e krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës të ish-regjimit shtetëror serb në Kosovë, po formojmë komisionin shtetëror për krijimin e Tribunalit për gjenocidin serb, e kemi të vështirë të përshkruash të gjitha rastet që për njëzet vjet më radhë të kanë rënduar ndërgjegjen nga pamundësia për t'u dhënë përgjigje të gjithë atyre njerëzve që të kanë rrëfyer historitë e tyre të dhimbshme për krimet që i përjetuan, për masakrat që i panë me sytë e tyre mbi njerëzit e tyre, që kishin vetëm një kërkesë, të dënohen kriminelët, të dënohet gjenocidi mbi popullin e vuajtur e të pafajshëm, të dënohen ata që bënë krim e që kanë emër dhe mbiemër.

Sot dua të flas për masakrën e 27 prillit 1999, për tmerrin që përjetuan aty me qindra familjarë që nga kolonat e gjata të njerëzve që po dëboheshin për Shqipëri, u ndan 376 persona që u vranë dhe u masakruan e humbën pa gjurmë në Luginën e Mejës. Dua të flas për historinë e vrasjes së Ibër Rexhës e dhjetëra bashkëfshatarëve të tij në fshatin Dorbrosh. Për Hajdar Kuçin e Bekë Shabnaj që në pronat e tyre afër Manastirit të Deçanit më 6 maj 1989 u vranë e u masakruan. Dua të flas për fëmijën 15-vjeçar Faton Vishaj, që u shpëtoi nga paramilitarët nga duart e gjyshes dhe e vranë në masakrën e Belegut më 27 mars 1999. Dua të flas për Nife Balajn 73-vjeçare që u vra dhe u dogj në shtëpinë në Carrabreg, për Mone Balajn 70-vjeçare që u dogj në shtëpinë e tyre më 1 qershor të vitit 1989 në masakrën e bërë në fshatin Carabreg. Duhet të flas për profesorin tim të gjuhës angleze, njeriun me shumë kulturë, të nderuar e të respektuar Nijazi Ferizi nga fshati Kodrali, që e vranë e masakruan dhe e hodhën në pusin e ujit të pijes në fshatin Strelc i Ulët. Dua të flas sot për 247 dëshmorët e vrarë në frontet e luftës në Deçan, për 169 të vrarët e tjerë të komunës së Deçanit, për 89 të pagjeturit, për dhjeta gra e vajza që përjetuan dhunën në heshtjen e tyre që vret, e që janë brengë e përditshmërisë së 20 viteve të jetës në liri.

Por sot dua të flas më shumë për masakrën më të rëndë që ndodhi në komunën e Deçanti, për masakrën e 29 e 30 marsit të vitit 1999 në fshatin Beleg. Si kudo në Kosovë, forcat ushtarake, policore serbe duke mos qenë në gjendje që të ballafaqohen drejtpërsëdrejti me luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, u janë vërsulur masës së pambrojtur shqiptare, duke vrarë gra, vajza, fëmijë, pleq e plaka. Për ta ishte më e lehtë të vrasin civilë të paarmatosur, t'i dëbojnë nga shtëpitë e tyre, t'i dhunojnë e t'i masakrojnë sesa të përballen me frontet e luftës, me luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe me forcat aleate të mbarë botës që na dolën në mbrojtje.

Në fshatin Beleg ishin të strehuar familjarë nga disa fshatra të komunës së Deçanit. Ata në ditët e netët e 29 e 30 marsit përjetuan tmerrin. Forcat policore të prira nga Zoran Gjurishiqi kanë

zhvilluar ofensivën e egër ndaj popullatës së Irzniqit, duke vrarë Himë e Tahir Dervishaj, kanë rrëmbyer Hajdar e Tahir Dacin, kanë vrarë plakun Hajdar Dërvishaj 72-vjeç, Zeqë Drëvishaj 66-vjeç dhe Shkurte Dervishaj 44-vjeçe në shtëpinë e tyre. Pastaj kanë kaluar në fshatin Beleg e për dy ditë kanë vrarë e kanë masakruar, e kanë dhunuar njerëzit në shtëpitë e tyre. I kanë vrarë e masakruar 46 njerëz. 27 të vrarë ishin të strehuar aty nga fshatrat e tjera, kurse 19 të vrarë ishin po të këtij fshati. Edhe sot e kësaj dite, 33 të vrarë janë të pagjetur, ngase trupat e tyre të pajetë janë rrëmbyer nga duart e familjarëve të tyre, edhe pse të vrarë, dhe i kanë dërguar kushedi ku nëpër Serbi, familjarët e të cilëve nuk janë ndalur kurrë së kërkuari tash e njëzet vjet. U vra dhe u masakrua profesori i nderuar Nezir Vishaj, njeri me shumë vlera atdhetare. Vrasja makabre është bërë në shtëpinë e tij, në praninë e familjarëve të tij. Trupi i tij është masakruar dhe në fund është djegur.

Naim Vishaj është vrarë në praninë e fëmijëve dhe gruas së tij. Trishtimin që e kanë përjetuar fëmijët e tij, që i kishin kapur babin të tyre dorën në momentin tragjik, e kanë në memorien e tyre çdo ditë. E rrëfejnë me të tjerët. Kanë kërkuar avokat për ta denoncuar krimin. I janë drejtuar gjykatave, por kot. Krimineli që e vrau babanë e tyre është i lirë.

Daut Aliçkaj është vrarë në prani të familjes së tij. Janë vrarë fëmijët Faton Vishaj e Hasan Mazrekaj, që janë marrë me dhunë nga duart e nënave të tyre. I është rrëmbyer familjes dhe është ekzekutuar djali i vetëm i familjes Gëzim Vishaj.

Të gjithë dëshmitarët e këtyre vrasjeve e thonë hapur se vrasësi i të gjithë këtyre të vrarëve në prezencën e familjeve të tyre, ka emër e mbiemër, është Zoran Gjurishiçi, që ka jetuar në një fshat aty afër në Deçan, në një fshat të Deçanit, në Prapaçan, i cili ka pasur pozitë udhëheqëse në policinë e Deçanit.

Janë vrarë edhe Shaqë Binakaj, Hysni Binakaj, Jetmir Mazrekaj, Qazim Hulaj, Sadri Zukaj, Shefqet Belegu, Shaban Kadrijaj, Ali Kadrijaj, ku trupat e tyre janë gjetur pas luftës dhe janë varrosur.

Janë vrarë edhe ende trupat e tyre janë të pagjetur edhe të 33 njerëzve të pafajshëm civil të cilët kanë qenë në këtë fshat: Zymer Binakaj, Brahim Zukaj e Hamit Zukaj, Rexhep Neziraj, Faton e Fatmir Vishaj, Ramë Kilaj, Sadri e Mujë Vishaj, Mal Vishaj, Zenel Vishaj, Hazir Zukaj, Shaban Nitaj, Nekë Binakaj, Hajdar e Ali Mazrekaj, Bashkim e Afrim Hadërgjonaj, Xhevdet e Muhamet Hadërgjonaj, Mehmet e Xhevdet Tolaj, Xhevat Tolaj, Misin Tolaj, Arif Mazrekaj, Isa Tolaj, Sahit, Hasan e Sundim Mazrekaj, Naim Tolaj, Ragip Morina, Beqir Dervishaj, Tafë Dinaj, Smajl Ukëxhaj dhe Haxhi Kadrijaj.

Ku janë këta 33 të pagjetur? Kush kreu dhunimet në fshat, mund ta thonë kriminelët që kryen vrasje e që dhunuan në format më kriminale njerëzit në shtëpitë e tyre. A ta kanë emër. E thonë njerëzit që e kanë përjetuar krimin e që kanë shpëtuar e që i kanë parë me sytë e tyre.

Pra, ata njerëz e kanë pësuar nga dajaku i tyre dhe e kanë marrë plumbin nga ata. Policët: Vukmir Miriqiqi, kryeshef i MUP-it të Deçanit Zoran Mikiqi nga Dashinoci, komandanti i stacionit policor në Deçan Zoran Gjuriqishi, Sllavko Llabani e shumë të tjerë, të cilët janë të identifikuar nga dëshmitarët e shumtë dhe nga të mbijetuarit e masakrës.

Sot, me dhjetëra gra dhe vajza shqiptare të Rrafshit të Dukagjinit që përjetuar aktin më çnjerëzor, dhunën, jetojnë në heshtjen e tyre që vret, çdo ditë mbi ndërgjegjen e gjithsecilit, për t'i denoncuar, gjetur e dënuar kriminelët.

Deklaratat autentike të tyre për tmerrin që kanë përjetuar para tytave tyre armëve të sofistikuara serbe dhe në Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Deçan, si dhe autoriteteve të Tribunali të Hagës, janë dëshmia më e mirë e krimit dhe e gjenocidet të bërë në këtë fshat.

Përkundër asaj që ekipet e hetuesisë së pari nga UNMIK-u, pastaj nga EULEX-i, ishin marrë me rastin me krimeve makabre në këtë fshat, duke mbledhur dëshmi të shumta, qoftë deklaratat e dëshmitarëve të drejtpërdrejt të prezantuara edhe në Tribunalin Ndërkombëtar të Hagës, por edhe autopsinë e bërë të kufomave të krimit, deri më tash asnjë kryerës i masakrës nuk është hetuar. Nuk është arrestuar. Nuk është dënuar.

Kanë bërë padinë familjarët tek UNMIK-u e EULEX-i...

**KRYETARI:** Ju kisha lutur, regjia. Regjia, të lutem mos ua ndërprit deputetëve, veç kur ka polemika.

**SAFETE HADËRGJONAJ:** Kanë bërë padinë familjarët tek UNMIK-u, tek EULEX-i, po nuk është bërë asnjë hap në këtë drejtim.

Unë i kam këtu me vete 22 kallëzime penale të bëra nga Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Deçan, që i janë drejtuar prokurorisë. Prokurori publik i bën kallëzimet penale në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës në Prishtinë.

Kush s'mund të na thotë se çfarë ka ndodhur me këto kallëzime penale kundër Draganit që ka kryer vepra krime. Kundër Danilov Gjuriqit që ka jetuar në fshatin Prapaqan. Kundër Gjorgje Danilloviqit, Davor Mijatoviqit, Milosh Stojkoviqit, Jovan Zeqoviqit, Zhita Çokoviqit, Vojo

Spasiqit, Novak Vlahoviqit e shumë e shumë të tjerëve, kundër të cilëve janë mbledhur me dhjetëra e dhjetëra dëshmi dhe janë bërë me dhjetëra-dhjetëra kallëzime penale të tjera.

Të nderuar deputetë,

Këto dhe krime të tjera të natyrës gjenocidiale duhet ta marrin dënimin. Ne duhet ta bëjmë punën tonë, në mënyrë që të gjitha këto krime të marrin dënimin të cilin e kanë merituar të gjithë ata të cilët i kanë bërë.

Për ta dënua krimin nuk është vonë asnjëherë, por të heshtet para krimit është mëkati më i madh që mund ta bëjmë.

Pa u dënua gjenocidi që është bërë mbi popullatën e pambrojtur në Kosovë, vështirë është të gjendet paqja e qetësia në rajon. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Të nderuar deputetë, për mbarëvajtje të seancës, do t'ju pyesja se a është në rregull që në orën 19:00 të shkojmë në pauzë?

Në orën 19:00 do të fillojë pauza dhe atëherë do të shkojmë. Vetëm të jemi korrektë, pastaj e vazhdojmë në orën 21:00. S'mundemi më herët, po ka reagime.

Atëherë, fjalën e ka Sami Kurteshi. Albin, nuk jeni ju vallahi. Po mos merrni zjarr, unë po flas çfarë po flas këtu. Ngadalë veç pak se e keni ngatërruar krejt. Shumë të rrezikshëm bre ju. Samiu po e tërheq fjalën a po?

Për hir të publikut, veç ta shohin se Sami Kurteshi e ka kërkuar fjalën, pastaj janë Ilir Deda, Xhevahire Izmaqi, Blerta Deliu, Sala Berisha-Shala, Mexhide Mjaku-Topalli, Sami Kurteshi, Shkumbin Demalijaj, Zenun Pajaziti, Milaim Zeka, Hajdar Beqa, Luljeta Veselaj-Gutaj, Nait Hasani, Albin Kurti, Driton Selmanaj, Albulena Haxhiu, Arbërie Nagavci, Fatmire Kollçaku, Bekim Haxhiu, Time Kadrijaj, Haxhi Avdyli, Andin Hoti.

Time Kadrijaj, fjala për ju.

**TIME KADRIJAJ:** Faleminderit, kryetar! Kush s'bën zhurmë e merr fjalën. Desha shkurt, se ka prej mëngjesin që po e laborojmë edhe po diskutojmë për një çështje që vërtetë është rëndësishme së veçantë.

E thanë të gjithë edhe po dua që ta përsërisë, që është shumë vonë, po më mirë vonë se sa kurrë.

Janë çështje të rëndësishme edhe për gjenocidin që u diskutua më parë, kemi shumë fakte. Kemi shumë histori, dhe unë mendoj se duhet të hiqet stigma për këto. Secili që mund të kontribuojë

me fakte, me dëshmi, pra që ta dëshmojë atë që Serbia ka kryer gjenocid në Kosovë, ata duhet ta dokumentojnë.

Ndërkaq, kur të formohet ky komision, të gjitha ato fakte, të gjitha ato dëshmi të dorëzohen në këtë komision, në mënyrë që të bëhet dhe të argumentohet me sa më shumë fakte gjenocidi që është kryer.

Ka shumë masakra dhe jemi në përvjetorë të tyre, pra jemi në muajin kur kemi shumë përvjetorë të masakrave që janë kryer anekënd Kosovës. Gjithashtu, jemi në muajin kur kemi përvjetorë të historive të ndryshme. Të rënies së dëshmorëve. Sot e kemi përvjetorin ku është kujtuar Ukshin Hoti dhe shumë të zhdukur të tjerë të masakrave të tjera.

Andaj, ju lutem që të mos e zgjasim, po edhe njëherë bëj kërkesë që kushdo që ka ndonjë fakt ose ndonjë dëshmi ta heqim stigmën dhe t'i grumbullojmë këto fate, në mënyrë që ta kemi një pasqyrim të qartë për krimet që i ka bërë Serbia në Kosovë.

**KRYETARI:** Faleminderit! Radhën e ka në bazë të partive, Albin Kurti. Ta keni parasysh, radhitjen s'e përcaktoj unë. Në mënyrë elektronike si e keni vendosur.

**ALBIN KURTI:**

Qytetarë të Republikës,

Deputetë të Kuvendit,

Të nderuar familjarë të të pagjeturve dhe të dëshmorëve e martirëve të kombit,

Krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit, krimet e agresionit dhe gjenocidi janë mbi të gjitha krime të shtetit, janë krime të shtetit të Serbisë, që vetëm në luftën e fundit i vrau mbi 10 000 civilë të pambrojtur e të paarmatosur në Kosovë. Për krimet gjatë shpërbërjes së ish Jugosllavisë, Tribunali i Hagës ka vepruar çerek shekulli deri më datën 31 dhjetor të vitit 2017, dhe, gjatë kësaj periudhe janë mbajtur 10.800 ditë gjykimi, kanë qenë 4.650 dëshmitarë dhe 161 individë janë akuzuar. Nuk kishte rehabilitim as të përafërt dhe as drejtësi për viktimat krahasuar me përmasën e krimit.

Janë dënuar 72 serbë me 1.140 vjet burg pa përfshirë këtu edhe 6 serbë të Bosnjës dhe Hercegovinës që janë dënuar me burgim të përjetshëm, 20 kroatë me 284 vjet burg, 5 boshnjakë me 42 vjet burg, një shqiptar me 13 vjet burg dhe një maqedonas me 12 vjet burg. Nuk janë dënuar dhjetëra mijëra ekzekutorë të qindra mijëra viktimave. Mbi të gjitha, nuk u dënuan dy kryesorët: Milosheviqi dhe Stanishiçi.

Në Kosovë, prokuroria menjëherë pas luftës ka akuzuar një shqiptar, Lulzim Ademin, i cili më pastaj u pat arratisur nga burgu. Katër aktakuza ishin kundër serbëve, 3 prej tyre janë arratisur,



dhe, një aktakuzë kundër një malazezi, i cili më vonë është liruar, krejt kjo për një periudhë 20 vjeçare. Deri para dy viteve, në Kosovë 106 veta janë akuzuar për krime lufte - çdo i katërti është dënuar, çdo i treti është liruar, çdo i katërti është në arrati e çdo i gjashti në proces.

Në periudhën 9 vjeçare të UNMIK-ut (2000-2009) kishim pesëmbëdhjetë (15) aktakuza për tridhjetë e tre (33) serbë: nëntë (9) janë liruar, një (1) është dënuar, njëzet e tre (23) janë arratisur nga burgu në Mitrovicë. Në periudhën e EULEX-it (2009-2016), shtatë (7) aktakuza për nëntë (9) serbë: gjashtë (6) prej tyre janë liruar, ndërkaq tre (3) janë dënuar. Kurse, për periudhën 17 vjeçare në Serbi (1999-2016), kishte katër (4) aktakuza kundër shqiptarëve: me ç'rast njëzet (20) persona janë akuzuar e njëri është dënuar me 13 vjet burg.

Gjykata Speciale në Serbi për krimin e organizuar dhe krimet e luftës, e cila është themeluar më 1 korrik të vitit 2003, pra pak muaj pas vrasjes së ish kryeministrit serb Zoran Gjingjiq, që u pat vrarë më 12 mars të vitit 2003, pra më 1 korrik 2003 është themeluar kjo gjykatë, dhe, prapa grilave kanë përfunduar vetëm 160 serbë për katër luftërat e ish Jugosllavisë. Për diku rreth 160.000 të vrarë, janë burgosur rreth 160 serbë me vendim përfundimtar, thua se secili prej tyre i ka vrarë nga 1.000, pa përfshirë këtu shkatërrimet, torturat e përdhunimet.

Viktimat nuk janë statistika, as kriminelët nuk janë statistika, por duhet t'i shohim edhe statistikën për ta kuptuar përmasën e drejtësisë, apo, më mirë të themi, të padrejtësisë. Drejtësia retributive për viktimat mungoi, po ashtu edhe drejtësi reparative nuk pati. Me fjalë tjera, as kriminelët prapa grilave dhe as rehabilitim për viktimat. Plagët e hapura, viktimat po i shërojnë vet, ashtu si munden e ashtu si dinë pa mbështetjen dhe ndihmën e shtetit. Është e domosdoshme që Kosova ta ketë një hartë të detajuar mbi të gjitha krimet e luftës se ku, çka, si dhe ndaj kujt u ushtruan ato krime para 20 viteve.

Ne sot e kemi marrë një letër nga kryetari i Kuvendit, karakterin e të cilës nuk jam në gjendje ta kuptoj plotësisht, por t'ju them të drejtën nuk jam optimist, meqenëse fillimi nuk ishte i mbarë e vështirë të jetë më tej ecuria.

Gjithçka filloi kohë më parë, me një adresim në Kuvendin e Kosovës ndaj shoqatave të të pagjeturve, por aty në ulëse në rend të parë e kishim edhe kryeprokurorin e shtetit, Aleksandër Lumezi, e madje e kishim edhe kryesuesin e Këshillit Prokurorial, Bahri Hyseni, të cilin të gjithë e njohim mirë nga ato përgjimet "Pronto", dhe, të cilët dëgjonin një fjalim për një fillim të ri a thua se nuk janë në detyrë, e cila ka obligime e përgjegjësi shumë të mëdha.

Pra, nuk ka kurrfarë kuptimi që kryetari i Kuvendit të mbajë fjalim para kryeprokurorit të shtetit dhe kryesuesit të Këshillit Prokurorial dhe të pres duartrokitjet e tyre. Ata njerëz paguhen me taksat e qytetarëve të Republikës së Kosovës për drejtësi të paqes e të luftës, për drejtësi për

krimet e paqes e krimet e luftës, për drejtësi për krimet politike e për krimet ekonomike. E, nuk janë atje që të jenë këtu si dëgjues të fjalimeve të organeve të tjera shtetërore.

Në këtë letër, duket qartë se kërkohet formimi i komisionit për dokumentimin e krimeve të luftës të regjimit serb në Kosovë, mirëpo më pas, kur shpjegohet se çka quajmë krime të luftës, i referohet vetëm regjimit të egër të Slobodan Milosheviqit. Ky është gabim shumë i madh.

Lufta s'ishte vetëm kohën e Milosheviqit, dhe, nuk ishte problem vetëm regjimi i egër i Milosheviqit, se njëfarë regjimi aspak të butë e kemi edhe sot në Kosovë. Nuk është problem regjimi, po shteti. Ato kanë qenë krime të shtetit, dhe, ky shtet, po, mund ta themi se ishte Serbia, por realisht nuk ishte vetëm Serbia. Ishte Jugosllavia, ishte Jugosllavia e Zhablakut! Dhe, krime nuk ka bërë veç Jugosllavia e Zhablakut e vitit 1992 (kushtetutës së saj), krime ka bërë edhe Jugosllavia e AVNOJ-it e vitit 1943, krime ka bërë edhe Jugosllavia e Versajës.

E, para Jugosllavisë së Versajës, krime ka bërë edhe Serbia e kohës së Kongresit të Berlinit, dhe, Serbia e kohës së dy luftërave ballkanike. Pra, kur themi lufta dhe krimet e luftës të Serbisë në Kosovë, kurrsesi nuk guxojmë që këtë ta kufizojmë vetëm në luftën e fundit e aq më pak vetëm në, siç thuhet këtu, regjimin e egër të Milosheviqit.

Mandej, thuhet që 1 milion kosovarë, më shumë se gjysma e popullsisë, ishin detyruar të largohen nga Kosova. Kjo mbase është përkthyer nga anglishtes, "forced to flee", se ne themi ishin dëbuar. Pse "detyruar të largohen"? E, unë besoj që këto tekste nuk do të duhej t'i shkruante dikush tjetër së pari. Janë disa tekste që duhet t'i shkruajmë vet së pari e mandej le t'i përkthejnë të tjerët. Nuk është mirë që këto tekste të na i shkruaj dikush tjetër e ne t'i përkthejmë në shqip. Prandaj, po them që nuk jam optimist me një fillim të këtillë.

Dhe, tjetra, unë besoj që është gabim të figurojë në dokumentacionin tonë të ardhshëm, që uroj të aprovohet e të jetë i drejtë, e i saktë, e i mirë siç po japim edhe kritikën tona, faza e lobimit për krijimin e tribunalit. Fjala 'lobim' edhe fjala 'tribunal' në të njëjtën fjali nuk shkojnë.

Do llobojmë për anëtarësime në organizma ndërkombëtare, nuk mund të llobojmë për një tribunal që është për krimet e luftës në Kosovë. Pra, shprehja lobim tregon mungesë elementare të seriozitetit e të sinqeritetit. Kjo është çështje drejtësie e gjyqësie, institucioni e shteti, sovraniteti e republike. Nuk mund të jetë tribunal i formuar me lobim. Unë nuk besoj që në fund do të mund të themi...

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Mufëra Shinik.)*

KRYESUESJA: Regjia, të lutem fjalën!

ALBIN KURTI: Nuk do të mund të themi në fund se ja u themelua tribunali për krimet e luftës si rezultat i lobimit të këtyre organeve apo atyre personave. ‘Lobim’ dhe ‘tribunal’ në një fjali nuk bën.

Më tej, është e qartë për bindjen time, se një pyetje duhet shtruar: pse duhet të humbas kohë shteti i Kosovës deri sa të kuptohet që VETËVENDOSJE! kishte të drejtë? Pse duhet të humbas kohë shteti? Nga dialogu joparimor me Serbinë te Gjykata Speciale për Kosovën, nga dënimi i krimeve të Serbisë te bllokimi i mallrave të Serbisë, po del që kemi pasur të drejtë. Janë humbur mbi 10 vjet. Pse duhet humbur edhe 10 vjet tjera për t’u rikthyer te argumentet e Lëvizjes VETËVENDOSJE!?

Nuk e votuat reciprocitetin me Serbinë më 7 dhjetor 2011, dhe, e votuat ‘Zajednicën’ e marrëveshjes Thaçi-Daçiq më 26 qershor 2013, dhe, amnestimin e kriminelëve serbë në veri më 11 korrik 2013. Kur me trupat tanë ne kemi bllokuar mallrat e Serbisë në Merdarë dhe në Dhe të Bardhë më 14 janar 2012, na e keni ndërsyer njësinë speciale të Policisë së Kosovës kundër.

Na keni rrahur e burgosur për mallrat serbe, për t’i ruajtur marrëdhëniet e presidentit aktual me Daçiqin e Vuçiqin, që ky t’i thotë Vuçiqit “we are not problematic guys”. A e kuptoni paradoksin? Në njërën anë bashkë me Vuçiqin, “we are not problematic guys”, e në anën tjetër hajde tash projektligj e komision për gjenocid të Serbisë në Kosovë! Nuk na marrin seriozisht edhe ata që na e duan të mirën, se lere më ata që na e duan të keqen e po dëshmojnë se janë armiq të njëjtë të vjetër tanë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Milaim Zeka. Urdhëroni!

MILAIM ZEKA: Faleminderit, zonja kryesuese!

Më vjen keq që duhet t’i them disa fjalë, drejtuar kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, zotit Kadri Veseli, i cili sikur të na thërriste disa prej deputetëve në zyrën e tij, këto mendime që po i them këtu ia kisha thënë në katër sy, gjashtë sy, dymbëdhjetë sy.

Ai thotë se ne do të llobojmë, ndërkohë që kryetari i Parlamentit nuk ka lobuar as ndër deputetë për një iniciativë të tillë.

Nuk është pronë e asnjë individi dhe partie politike as Muzeu i Gjenocidit, as tribunali, as gjykata, as instituti, as asgjë hiç. Kjo është lojë me neve familjarët e të zhdukurve, në mesin e të cilëve është edhe nëna Hajrie e imja.

Unë nuk do të flas për masakrën e Abrisë, ku ia kanë mbushur me gjak cucllën e bebes të familjes Delijaj dhe ia kanë lënë bebes shtatëjavëshe në gojë, cucllën me gjak të nënës së vet.

E njëqind masakra të tjera. Nuk do flas këtu për vrasjen e shkrimtarit të madh, e drejtorit tim Ymer Elshanit e as drejtorit Hamit Krasniqi të gjimnazit 'Luigj Gurakuqi' të Klinës, por do të ndalem te tema, pse kemi ardhur këtu në këtë ditë të zezë.

Kemi ardhur këtu të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, sepse klasa politike e Kosovës ka heshtur kur UNMIK-u e mbylli një gazetë ditore me emrin Dita, pse gazetarja Gjylie Rexha, e zbuloi që një kriminel kishte bërë vrasje. Dhe, u mbyll gazeta e ne heshtëm.

Ne heshtëm kur Pranvera e fshatit Beleg, 16-vjeçare, e para femër shqiptare e intervistuar nga kamera ime dhe e transmetuar në televizionin më të fuqishëm botëror BBC, dhe në televizion suedez, pa maskë në fytyrë, doli dhe tha që nënat tona në Beleg të Deçanit na kanë mbuluar me pleh e bajga që të mos na përdhunonte policia e ushtria dhe na morën e na përdhunan 48 orë në prezencë të babës e të vëllait dhe na i kanë djegur gjokset me cigare, e këta politikanë heshtën dhe e bënë histori historinë e Vasfije Krasniqit, sepse u interesonte edhe përdhunimi i femrave për vota politike e për propagandë politike.

Ne heshtëm këtu kur një avokate e njohur shqiptare në Evropë e bindi klientin e vet, një serb, i cili pranoi të dalë para kamerave televizive dhe tha që ne i kemi marrë dhe i kemi bluar e i kemi shtruar asfalt trupat e shqiptarëve, ne heshtëm sepse nuk ishte momenti që ne për vota të bëjmë diçka e të flitet e të merren vota e të dilet këtu e të thuhet që ne do të bëjmë tribunal ndërkombëtar. Ne heshtëm duke e ditur që kurrë nuk do të bëhet tribunal ndërkombëtar kur Ministrinë e Drejtësisë kjo klasë politike e ka stërbushur me njerëz të UDB-së, të cilët na kanë rrahur, na kanë torturuar, na kanë fyer e na kanë poshtëruar edhe në kohën e Rankoviqit, edhe në kohën e Titos, e kanë rrahur familjen time, më kanë torturuar mua, e kanë torturuar Lajçin, e kanë torturuar Kurteshin, plot ju që jeni këtu deputetë dhe ata sot i kemi prokurorë dhe gjykatës, të cilët i ka vendosur kjo klasë politike, se po do të bëjë drejtësi.

Krimineli nuk ka identitet, krimineli nuk ka rëndësi a është shqiptar, a serb, a rom, a suedez, krimineli është vetëm kriminel dhe kjo klasë politike, kur u ka konvnuar kanë lënë në krye të Policisë së Kosovë edhe njerëz të UDB-së dhe policë famëkeq, të cilët deri në bombardimet e Milosheviqit kanë punuar në Policinë e Slobodan Milosheviqit.

Ne duam të bëjmë drejtësi, ne duam të bëjmë Muze të gjenocidit, na që nuk e përkrahim një qytetar të Gjakovës që i ka mbledhur 2500 faqe me fotografi e me dokumente për gjenocidin serb në Gjakovë, ne duam të bëjmë drejtësi kur në shkollat tona, në tekstet shkollore nuk mësohet as zero, zero, zero një për qind as për luftë, as për gjenocidin serb në Kosovë. Ne do të bëjmë drejtësi? Jo. Ne do të bëjmë hajgare dhe hajgaret tona a e dinë pse do të ndodhin? Sa herë që ne nuk do të mendojmë për historinë e fëmijëve tonë, sa herë që ne nuk do të mendojmë për 10 vjet, 20 vjet, 50 vjet, po do të mendojmë për momentumin, sot për nesër, hajde flasim sot për nesër.

E di çdo kush prej jush, më së mirë e dinë juristët këtu, me Albulenë, me Vjosë, me Armend, zoti Gashi e pati brilant fjalimin, që Tribunali bëhet vetëm kur një anëtar i Këshillit të Sigurimit ose anëtarët e Këshillit të Sigurimit marrin iniciativë e nxjerrin në Këshill të Sigurimit, në Organizatë të Kombeve të Bashkuara dhe i thonë shtetit serb, ja ku është Tribunali për krime. Ore, diçka unë veç habitem.

Kadri Veseli nuk ka pasur nevojë të konsultohej me njeri gjallë në këtë botë, pos me Hajredin Kuçin, veç ta pyeste Hajredinin qysh na e kanë bërë ndërkombëtarët kulaçin e Gjykatës Speciale, edhe ai i kishte treguar, kështu e kanë gatuar, kështu e kanë pjekur, kështu na e kanë futur në gojë sikur çuranëve në ditën e Bajramit kur ia 'rtrashim ata duçat në gojë me miell të kollomojtë'.

E tash, ne e kemi yrnekun qysh na e kanë bërë Gjykatën Speciale, ata që kanë pranuar që të bëhet një Gjykatë Speciale etnike, e cila do të dënojë vetëm krimet e shqiptarëve në raport me serbët nuk mund të bëjnë një drejtësi, të cilën ne po e kërkojmë.

Tjetra, u fol shumë për institutin, u fol për atë institutin e famshëm të drejtësisë, të cilin e ka krijuar Hajredin Kuçi. Po a e dini pse u krijua ai institut, oj Vjosë, të zbutet papunësia, aty vetëm kanë punësuar njerëz, aty e kanë punësuar Zejnullah Grudën, i cili në jetë të vet nuk ka dalë dy minuta nga zyra, aty kanë punësuar njerëz të marrin nga një rrogë, po jo njerëz sikur Fitnete Ramosaj, shikoni librin e të ndjerës Fitnete, kjo është sa 100 institute që ka mbledhur dëshmi e fotografi për krimet e policisë dhe ushtrisë serbe në Kosovë.

Në këtë vend, të dashur qytetarë të Kosovës, asnjë iniciativë që ka shkuar në drejtim të mbledhjes së fakteve nuk është përshëndetur nga krerët politikë të këtij vendi. Pse, sepse kanë qenë dy ëndrra të mëdha të këtyre njerëzve, ëndrra e parë të krijojnë një Republikë të Burdushit, që s'i bie fije askush dhe ëndrra e dytë, edhe më e madhe se ëndrra e parë, ka qenë të pasurohen e të bëhen multimilionerë, njerëz të cilët kurrë në jetën e vet nuk kanë pasur rrogë nga asnjë shtet, as nga ish- Jugosllavia, por rrogën e parë e kanë marrë nga politika e këtij vendi.

Prandaj, mbi bazën e kësaj, edhe pse unë do ta votoj, do ta votoj se është si iniciativë dhe ide brilante, jam 100% i bindur, sikurse e kam emrin Milaim, që ky tribunal kurrë nuk do të krijohet. Tribunal vendor po, por jo ndërkombëtar. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ilir Deda.

**ILIR DEDA:** Të dashur përfaqësues të familjeve të pagjetura, Si i zgjedhur i qytetarëve në këtë vend dua t'ju kërkoj falje që jeni duke marrë pjesë sot në një hajgare të madhe, e cila nuk ka të bëjë aspak me drejtësinë në këtë vend, e cila nuk ka të bëjë

aspak me fjalë të mëdha, të cilat po krijohen apo cilat janë përdorur dhe e cila është aq joserioze, sa që e sheh Kosovën si një bashkësi lokale, e jo si një shtet të pavarur.

Përndryshe, një digresion në fillim, sepse kësaj do t'i kthehem në fund. Derisa ne këtu flasim, Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë vendosur sanksione ndaj të gjithë atyre njerëzve në politikë që janë të përfshirë në rastin Pronto, rastin Vizat italiane, rastin e ikjes nga Burgu i Dubravës, rastin Toka, rastin Apeks dhe raste të tjera.

E pse e përmenda tash, me këtë do ta përmbyll fjalimin në fund.

Tash, pse po them që qasja të cilën kryetari i Kuvendit e ka sjellë këtu është absolutisht joshitetore, është individuale, është partiake, por nuk ka të bëjë asgjë me atë çka ka ndodhur para 20 vjetëve. Sepse, një shtet serioz, i cili me të vërtetë e ruan dinjitetin e vuajtjes së vet, plagët e gjalla, e fuqizon gjykatën vendore për krime lufte, e themelon një prokurori speciale për krime lufte. Ne nuk kemi së pari as mandat, as bazë ligjore e asgjë tjetër që të krijojmë një komision shtetëror. Kuvendi nuk e bën atë punë, e para.

E dyta, janë dokumentuar shumica e krimeve të cilat janë bërë në Kosovë, emrat e të vrarëve dihen, emrat e atyre të cilët kanë dhënë urdhër dihen, po nuk ka pasur interesim. A e dini pse nuk ka pasur interesim? Tash do t'ju tregoj logjikën e mosinteresim deri sot.

Sepse logjika e mosinteresimit ka qenë kjo. Në vitin 2011, Qeveria e PDK-së e formon Institutin për Krime Lufte.

Vitin e kaluar Qeveria e PDK-së e heq Institutin për Krime Lufte, sepse njerëzit të cilët i ka punësuar PDK-ja nuk e kanë kryer punën e vet, e para.

E dyta, të harmonizohet me iniciativën e kotë të Presidentit të Republikës për krijimin e Komisionit për Dokumentim e Pajtim, ata Institutit për Krime Lufte e zhvlerësojnë në ekip për Drejtësi tranzicionale. E a e dini çka do të thotë Drejtësia tranzicionale? Masat juridike dhe jojuridike të zbatuara për adresimin e trashëgimisë të abuzimit të drejtave të njeriut dhe pjesë e këtyre masave janë ndjekja penale, komisioni i të vërtetës, programet e reparacionit dhe reforma të ndryshme institucionale.

Domethënë, ata që e kanë degraduar vetë çështjen të cilën sot po na mbushin me fjalimet, a e dini qysh po sillen, thua se jemi në vitin 2001, 20 vjet kanë kaluar prej luftës, në e paçi seriozisht fuqizojeni Gjykatën për Krime Lufte, ndani buxhet qysh duhet dhe ky Kuvend e themelon Prokurorinë Speciale për Krime Lufte, duke e rikthyer Institutin për Krime Lufte me njerëz profesionistë, të cilët të gjitha të dhënat të cilat ekzistojnë i marrin në institucione.

A nëse duam, tash po kthehem te ajo pjesa e parë, pika e parë për gjenocid që ne po themi do të aprovojmë një rezolutë.

Një shtet serioz nëse do ta padisë Serbinë për gjenocid, le të shkojë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Zonja e zotërinj,

Viktimat te ne do të kenë qetësi në momentin kur në shtetin tonë punohet me mend. A diçka po ju garantoj: ata të që janë të përfshirë në rastin Pronto, në dhënien e vizave italiane, në ikjen e Burgut të Dubravës, Toka, Apeksi, e të tjera, janë pa mend dhe s' mund të sjellin drejtësi në këtë vend. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit!

Fjalën ka kërkuar zoti Bilall Sherifi, kryetar i Komisionit ad-hoc për hartimin e rezolutës.

**BILALL SHERIFI:** Faleminderit, e nderuar kryesuese e Kuvendit!

Unë vetëm desha t'ju informoj që me kërkesë edhe me insistim edhe të familjarëve, për shkak se janë lodhur, që rezoluta të votohet para pauzës, dolëm, e harmonizuam, disa nga vërejtjet dhe sugjerimet i kemi përfshirë dhe tani në emër të Komisionit ju lus që t'i thirrni deputetët që janë në objekt, të kthehen këtu dhe ta votojmë para se të shkojmë në pauzë, do të kisha thënë tash brenda pesë apo gjashtë minutave ne jemi të gatshëm të paraqesim rezolutën dhe të hyjmë drejt në votim. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Regjia, biri ziles, votimi formal, para orës 19:00 votimi i rezolutës. A jemi për? Faleminderit!

Kryetari i Komisionit ad hoc për harmonizimin e rezolutës, zoti Bilall Sherifi e ka fjalën. Urdhëroni!

**BILALL SHERIFI:** E nderuar kryesuese!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar familjarë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Pas debatit të gjerë dhe pothuajse shterues, ne kemi arritur t'i përfshijmë disa nga sugjerimet që u dhanë nga deputetët.

Sa për njoftim, koleges Osmani i janë marrë disa sugjerime, ajo që tha se kompetencat janë të ndara, bashkë i paskemi pasur të Kosovës dhe Serbisë, ka qenë version i vjetër, unë nuk di qysh ju ka rënë në dorë, sepse versioni i fundit ka qenë i ndarë, kanë qenë ashtu siç e thatë edhe ju, ka

qenë një gabim teknik. Kështu që tani jam gati të prezantoj në vija të përgjithshme atë që komisioni dhe ju së bashku kemi rënë dakord.

Pra, siç e dini, rezoluta përmban aktet ndërkombëtare, normat ndërkombëtare, konventat, protokolle të ndryshe, ato nuk do t'i lexoj këtu edhe për shkak të kohës, edhe për shkak se kemi rënë dakord si komision që nuk ka nevojë të lexohen, vetëm do të saktësoj se Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65.1 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenit 52 të Rregullores së Kuvendit, në seancën plenare të mbajtur më 15 prill ka formuar Komisionin ad hoc...

KRYESUESJA: Qetësi, ju lutem, deputetë kolegë!

BILALL SHERIFI: ...për harmonizimin rezolutës për gjenocidin e kryer në Kosovë, ky komision i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës të miratojë këtë rezolutë për gjenocidin e kryer serb në Kosovë.

Dhe, siç thashë, në marrëveshje me komisionin këtu para jush dhe para publikut do të lexojmë vetëm pjesën përmbajtësore, për të mos e ngarkuar shumë fjalën e paraqitjes.

Pra, duke u nisur nga faktet se viti 2019 shënon 20-vjetorin e përfundimit të luftës në Kosovë dhe 20-vjetorin e kryerjes së krimeve nga forcat e armatosura të RFJ-së, Serbisë dhe Malit të Zi, sidomos ato serbe, gjatë fushatës së programuar, planifikuar dhe të instaluar shtetërore, me qëllim zhdukjen e shqiptarëve dhe ndryshimin e dhunshëm të pjesës etnike të Kosovës, duke dëbuar rreth 1 milion shqiptarë, duke vrarë rreth 12 mijë civilë të pambrojtur, kryesisht shqiptarë, përfshirë edhe pjesëtarë... kërkoj falje se edhe unë fillova të lexoj versionin e vjetër, kërkoj falje se jemi të ngarkuar e të lodhur, sepse i kemi bërë ato ndryshimet që i keni propozuar ju.

Duke u nisur nga fakti se viti 2019 shënon 20-vjetorin e luftës në Kosovë dhe krimet e kryera nga forcat e armatosura të RFJ-së, Serbi dhe Mali i Zi, sidomos ato serbe, të fushatës së programuar, planifikuar dhe të institucionalizuar shtetërore me qëllim shfarosjen e programuar, të planifikuar dhe të institucionalizuar me qëllim dhe ndryshimin e dhunshëm të përbërjes etnike të Kosovës, duke dëbuar rreth 1 milion persona, pra këtu është ndryshimi me kërkesë edhe të disa deputetëve, duke vrarë rreth 12 000 civilë të pambrojtur të të gjitha etnive: boshnjakë, turq, romë, ashkalinj, shqiptarë dhe sidomos dhe kryesisht shqiptarë, në mesin e të cilëve 1 392 fëmijë, mbi 800 prej tyre nën moshën 5-vjeçare dhe 1 739 gra.

Gjatë periudhës '98-'99 forcat serbe kryen në Kosovë rreth 100 masakra kolektive të evidentuara ndaj popullsisë së pambrojtur civile në Kosovë, kryesisht shqiptarë, me shkatërrime të vendbanimeve e shtëpive, duke vrarë në mënyrë mizore fëmijë, gra dhe të moshuar. Madje, duke i djegur të gjallë në prani të tjerëve, si në Likoshan, Qirez, Prekaz, Libeniq, Fortesë, ish-



Bellacërrk, Rancë, Shtime, Kleçkë, Shalë e Bajgorës, Çiçavicë, Gullboc, Abri e Epërme, Lubeniç, Reçak, Ura e Rakovinës, Leshan i Suharekës, Reznik, Vushtrri, Mitrovicë, Tërnavë, Podujevë, Skënderaj, Kotlinë të Kaçanikut, Podujevë, Celinë, Fortesë, Goden, Randobravë, Kurshë e Vogël, Krushë e Madhe, Tërrnje, Suharekë, Padalisht, Mamushë, Dardhishtë, Gjakovë, Izbicë, Matiqan, Podujevë, Belek të Deçanit, Dumnicë e Epërme, Mitrovicë, Llashticë e Gjilanit, Burim, Bellanicë, Pastel, Lubeniç të Pejës, Gjakovë, Nagac, Kralan, Prishtinë, Qupevë e Epërme, Popovë e Podujevës, Rezallë, Kokaj të Gjilanit, Përroi i Rakocit, dhe Lagjja e Re në Kaçanik, Lubishtë e Hasit, Fshati i Vjetër Ferizaj, Mitrovicë, Sllovi dhe Lipjan, Skënderaj, Mitrovicë sërish, Qikatovë e Vjetër, Poklek, Paklek i Vjetër, Poklek i Ri, Hade, Ribar i Vogël, Devë të Gjakovës, Bërrnicë e Epërme, Hallaq i Vogël, Makoc, Grashticë, Nakaradë e Fushë-Kosovës, Dragaqin, Suharekë, Koliq, Mejë dhe Korrnicë, Gustë, Dobrosh, Korrenicë, Vërboc, Nabërgjan, Studime, Bukosh, Pejë, Korishë, Qyshk, Pavlan dhe Zahaq, Carallukë, Burg i Dubravës, Vushtrri, Vushtrri, data të ndryshme, dy masakra, Lagjja Tusus Prizren, Familja Gërxhaliu, Mitrovicë 8 qershor '99, Familja Balaj në Pejë.

Gjatë luftës së viteve '98-'99 në Kosovë forcat e RFJ-së, Serbi dhe Mali i Zi, sidomos të Serbisë, ushtruan dhunë seksuale ndaj rreth 20 mijë personave, kryesisht gra dhe vajza shqiptare, të cilat përjetuan vuajtje të mëdha, traumatizëm të rëndë dhe plagë të pashlyera psikologjike. Gjatë luftës së viteve '98-'99 në Kosovë forcat e armatosura të RFJ-së, Serbi dhe Mali i Zi, sidomos të Serbisë, dëbuan nga shtëpitë e tyre mbi 1 milion shqiptarë, në të shumtën e rasteve duke konfiskuar çdo dokument identifikimi personal, dokumente të automjeteve dhe çfarëdo dokumenti tjetër me qëllim të shkatërrimit të dëshmimeve për identitetin e tyre dhe përkatësinë shtetërore. Në funksion të fshehjes së krimit dhe të shmangies nga përgjegjësia e drejtpërdrejtë në kryerjen e gjenocidit, institucionet shtetërore të RFJ-së, Serbi dhe Mali i Zi, sidomos të Serbisë, zhvendosën me forcë në territorin e Serbisë mijëra civilë shqiptarë të të gjitha moshave, të gjallë dhe të vrarë. Përveç një numri të caktuar që u kthyen të gjallë pas përfundimit të luftës, pasi kishin përjetuar trajtime çnjerëzore nëpër burgjet e Serbisë, mijëra kufoma civilë shqiptarë të masakruar, të varrosur e të zhvarrosur dhe të rivarrosur për të humbur gjurmët e krimit janë gjetur në varreza masive anembanë Serbisë. Edhe 20 vjet pas përfundimit të luftës në Kosovë, shteti serb vazhdon të fshehtë të vërtetën për fatin e mbi 1 600 personave, të cilët vazhdojnë të mbeten të zhdukur me forcë gjatë luftës në Kosovë.

Duke ndjekur parimin e 'tokës së djegur', me qëllim të shkatërrimit të bazës ekonomike, zhdukjes së jetesës historike, zhdukjes së bazës njerëzore të ekzistencës për ekzistencën dhe siguri, forcat e armatosura të RFJ-së, Serbi dhe Mali i Zi, sidomos ata serbe, shkatërruan 100389 objekte banimi, 88101 objekte përcjellëse, 358 ndërtesa shkollore të shkatërruara tërësisht apo pjesërisht nga gjithsej 700 mijë e 215 objekte fetare: xhami, tyrbe, teçe dhe kisha katolike. 123 objekte shëndetësore dhe mbi 190 shtëpi kulturore, biblioteka dhe ndërtesa administrative, e tjerë. Duke rikujtuar se Gjykata Penale Ndërkombëtare për Ruandën i cilësoi dhe i dënoi dhunimet seksuale ndëretnike si 'akte gjenocidi', për shkak të faktit se dhunimi paraqet cenim të

rëndë të integritetit fizik dhe mendor të viktimës, neni 2, paragrafi b i Konventës për parandalimin dhe dënimin e krimit të gjenocidit cilëson si forma të gjenocidit edhe cenimin e rëndë të integritetit fizik ose mendor. Krimi i gjenocidit, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës, si krime tejet të rënda që godasin tërë komunitetin ndërkombëtar, nuk vjetërsohen kurrë dhe si të tilla nuk mund të mbesin të pandëshkuara. Është obligimi i çdo shteti që t'i sjellë para drejtësisë të gjithë kriminelët dhe përgjegjësit e krimeve të pandëshkuara.

Është obligim i çdo shteti që t'i sjellë para drejtësisë të gjithë kriminelët dhe përgjegjësit e krimeve ndërkombëtare. Kuvendi i Republikës së Kosovës, duke hedhur poshtë si të papranueshme të gjitha marrëveshjet politike që janë bërë mes Gjykatës Penale e Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë dhe Qeverisë së Serbisë për të ndryshuar kualifikimin e dhunimeve seksuale, si një nga elementet konstituive të krimit të gjenocidit, konstaton se vrasjet e fëmijëve, të grave, të moshuarve, personave civilë në përgjithësi, kryesisht shqiptarë, gjatë luftës së viteve '98-'99 në Kosovë përbën krim të gjenocidit në kuptimin e përkufizimit të gjenocidit në Konventën për parandalimin dhe dënimin e krimit të gjenocidit. Dëbimi i shqiptarëve, spastrimi etnik i Kosovës përbën krim të gjenocidit dhe shkelje të rëndë të Konventës për parandalimin dhe dënimin e krimit të gjenocidit. Zhdukja me forcë e civilëve shqiptarë përbën krim kundër njerëzimit dhe shkelje të rëndë të Deklaratës së Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e personave nga zhdukja me dhunë. Dhuna seksuale në konfliktet e armatosura, pra në luftë, përbën krim të gjenocidit në kuptimin si përkufizohet gjenocidi me Konventën për parandalimin dhe dënimin e krimit të gjenocidit.

Pas përfundimit të luftës në Kosovë nuk është bërë asnjë dënim politik i krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit dhe krimit të gjenocidit të kryer nga regjimi serb në Kosovë. Ndërsa, institucionet politike dhe të drejtësisë në Serbi vazhdojnë të mohojnë krimin e gjenocidit në Kosovë dhe rrjedhimisht refuzojnë riparimin e dëmeve të shkaktuara. Krimet sistematike të kryera nga regjimi serb janë bërë me qëllim të shfarosjes së popullit shqiptar në Kosovë, prandaj përbën krim të gjenocidit. Pranimi i krimit të gjenocidit kundër shqiptarëve në Kosovë përbën një akt thellësisht humanitar, që lehtëson përballimin e dhembjes për të mbijetuarit e gjenocidit dhe nderon kujtimin e viktimave të gjenocidit. Më 15 janar 1999 forcat serbe kryejnë aktin gjenocidal në Reçak, gjatë të cilit u masakruan 42 civilë shqiptarë. Ky akt monstruoz mobilizoi komunitetin ndërkombëtar për t'i dhënë fund politikës së gjenocidit në Kosovë dhe për këtë qëllim organizoi Konferencën Ndërkombëtare për Kosovë në Rambuje. Faktin që regjimi serb refuzoi zgjidhjen paqësore të çështjes së Kosovës dhe e vazhdoi politikën e gjenocidit kundër shqiptarëve në Kosovë, ndërhyrjen ushtarake të NATO-s për t'i dhënë fund krimit të gjenocidit ndaj shqiptarëve në Kosovë dhe për të ndaluar krizën e madhe humanitare të shkaktuar nga forcat e RFJ-së Serbi, Mali i Zi, sidomos nga Serbia, Kuvendi i Kosovës shpall 15 janarin Ditë të përkujtimit të gjenocidit ndaj shqiptarëve të Kosovës.

Kuvendi i Kosovës kërkon nga shteti i Serbisë të pranojë faktin se ky shtet në kundërshtim të plotë me Konventën për parandalimin dhe dënimin e krimit të gjenocidit të datës 9 dhjetor '48, dhe duke shkelur rëndë Konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949 dhe të protokolleve shtesë të këtyre konventave, ka kryer krime të luftës, krime kundër njerëzimit dhe gjenocid në Kosovë në periudhën e vitit 1998-'99. Ta ndriçojë plotësisht fatin e të gjithë atyre që ende konsiderohen të zhdukur dhe të pagjetur nga forcat e RFJ, Serbi dhe Mali i Zi, sidomos Serbi, gjatë luftës në Kosovë 1998, 1999, por edhe më herët. Të sjellë para drejtësisë përgjegjësit e krimit të gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës në Kosovë '98-'99. Të riparojë ato dëme të gjenocidit, të krimeve kundër njerëzimit dhe krimet e luftës ende mund të riparohen. Të shprehë vendosmërinë e vetë që përmes masave në nivel kombëtar dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar të sigurohet ndëshkimi i atyre që kanë planifikuar, kanë kryer, apo kanë nxitur të kryejë gjenocidin, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës në Kosovë.

Kuvendi i Kosovës, duke pasur parasysh faktin se mohimi i krimit të gjenocidit, krimit kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës konsiderohet si fyerje më e rëndë që mund t'u bëhet viktimave të këtyre krimeve, familjarëve të tyre dhe tërë kombit ndaj të cilit është ushtruar gjenocidi, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës. Duke u nisur nga fakti se informimi i drejtë dhe i gjithanshëm është kusht i domosdoshëm kundër negacionizmit si tërësi e qëndrimeve dhe i shpjegimeve të dhëna për të mohuar dhe shkatërruar vërtetësinë e gjenocidit në Kosovë të kryer nga forcat e RFJ, Serbi dhe Mali i Zi, sidomos Serbi, në periudhën e luftës '98-'99, kërkon nga të gjitha institucionet politike dhe shkencore në Kosovë që të angazhohen maksimalisht për ndriçimin e tërësishëm të gjenocidit në Kosovë dhe të sigurojë përkrahje politike për njohjen e faktit se shqiptarët e Kosovës ishin viktimat e gjenocidit. Duke rikujtuar me shqetësim se përpjekjet për të mohuar apo për të arsyetuar krimin e gjenocidit, siç është e definuar me Konventë dhe është e etabluar si i tillë sipas të drejtës ndërkombëtare mund të rrezikojnë dhe të minojnë luftën kundër mosndëshkimit, pajtimit dhe përpjekjeve për të parandaluar gjenocidin, ndërmerr nismën për përfshirjen në Kodin Penal të Republikës së Kosovës si vepër penale lejimin, arsyetimin, mohimin, minimizimin e gjenocidit, krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit të kryera në Kosovë nga forcat serbe ndaj popullsisë shqiptare në Kosovë. Faleminderit!

Me qaq ju kërkoj që ta hidhni në votim, e nderuar kryesuese dhe kërkoj që deputetët ta votojnë rezolutën e miratuar nga komisioni. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, kryetar! Tani votojmë rezolutën që e paraqiti z. Bilall Sherifi, kryetar i Komisionit ad hoc për harmonizim të rezolutës.

Në sallë janë 79 deputetë, ju e dini që nuk keni të drejtë ta merrni fjalën pas kryetarit. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Regjia votojmë. Votojmë tash!

Faleminderit! Në votim morën pjesë 79 deputetë, të gjithë janë për, kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

Kuvendi e miratoi Rezolutën për gjenocidin e kryer serb në Kosovë. Faleminderit!

Edhe një votim e kemi. Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për Projekt-rezolutën në lidhje me krijimin e këndit e kurajës.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatitet për votim. Votojmë tash!

Në sallë janë 79 deputetë. Në sallë janë 80 deputetë, kanë votuar 77, të gjithë janë për, nuk ka kundër, nuk ka abstenim.

Kuvendi e miratoi Rezolutën në lidhje me krijimin e kundërt të kurajës.

Deri në orën 21:00 pauzë. Faleminderit!

\* \* \*

*Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës*

*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.*

XHEVAHIRE IZMAKU: ...edhe të tentojë t'i mohojë krimet e kryera e krimet e planifikuara. Pse them të planifikuara, do të flas edhe në fjalimin tim. Sepse kam qenë një kohë të gjatë edhe dëshmitare, edhe pjesë e disa hulumtimeve të pasluftës për këto krime për në rajonin tim, pra në komunën time në Vushtrri.

Sot njëzet vjet kam qenë një gazetare e luftës dhe dëshmitare e shumë e krimeve e vrasjeve të kryera në një komunë me 70 mijë banorë, për të cilat ngjarje atë kohë raportoja në Radion 21, si gazetare, pra gjatë periudhës së luftës. Jam dëshmitare e shumë vrasjeve dhe torturave që i kam parë me sytë e mi, për dy muaj, nga shtëpia ime ku ishim të mbyllur, sepse ishim skaj rrugës, dhe as nuk guxonim të provonim të iknim e as të rrinim nuk ishte e lehtë. Kam parë fatkeqësisht nga dritarja e shtëpisë sime, meqenëse pra ishim vetëm disa metra larg rrugës ku kishte një punkt policor, policët serbë, policë që i kemi njohur pra në komunë të Vushtrrisë që janë lindur dhe janë rritur aty. Duke i rrahur djemtë edhe burrat deri në vdekje, të gjithë ata civilë, asnjë i armatosur. Civilë që i zinin duke ecur rrugës, sepse ishin të detyruar të dilnin për të gjetur sadopak ushqim, sepse kishin mbetur pa ushqim, pa barna, dhe shumicën e kohës gratë dilnin, kinse për t'u shpëtuar më lehtë punkteve serbe, por u pa se s'ka qenë e lehtë, sepse dhunimet ndodhën në të gjithë vendin e ndodhën edhe në komunën time, kanë ndodhur edhe para syve tanë.

Kurrë s'do ta harroj një skenë të cilën e kam shikuar nga dritarja e shtëpisë sime, ishte një nënë, një fqinje e imja, familja Hoxha, nënë e cila e kishte marrë lajmin se djali i saj ishte vrarë dhe për dy ditë kufoma po i rrinte në rrugë. Një djalë i ri 20-vjeç mbështetur për muri, u vra, siç ishte duke ecur rrugës në pikë të ditës, në punkt policor. Nëna, fqinja ime me një karrocë bosh që ecte lagjes sime dhe merreni me mend ajo nënë shkoi e mori djalin e vdekur, i cili po rrinte për dy ditë mbështetur për një muri i vrarë, një djalë e ri. Ajo nënë e cila veç pak ditë ka që ka vdekur, e mori djalin e vrarë, e vendosi në karrocë, e mbuloi me batanije, edhe sikur donte ta mbante ngrohtë edhe ashtu të vdekur.

Një fqinje tjetër e imja, 17-vjeçare, një mëngjes maji ishte vjedhur nga dy policë dhe u gjet e dhunuar dhe e vrarë po atë ditë. Këshilli për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtat e Njeriut në Vushtrri, në krye me profesorin e nderuar Sabit Kadriun, njëherësh dëshmitar për këto krime në Hagë, i cili këto krime të ndodhura i dokumentoi edhe para kriminelit Millosheviq në komunën në të cilën jetoja e punoja.

Pra menjëherë ditë e parë pas luftës nuk pushoi asnjë ditë, po menjëherë në ditën e parë të çlirimit nisi të mbledhë fakte e dëshmi për krimet të cilat ishin ende të freskëta. Realisht, ende gjenim gjurmë të njerëzve të masakruar, pra kam qenë vetë një prej atyre të Komisionit dhe e

kujtoj si sot masakrën në shtëpinë e bashkëqytetarit tim të ndjerë Kahrman Pasomës, ku dhjetëra djem të rinj, shumica familje qytetare, që edhe në ditët e luftës kishin qëndruar në shtëpi, sepse s'kishin ku të shkonin, pra ishin në shtëpi të veta. U morën fjetur dhe u masakruan në mënyrën më mizore, e kufomat e tyre mezi u kthyen nga Serbia pas 15 vjetësh. Pra, për këtë krejt këto sigurisht që ende ka nevojë të flitet derisa t'i adresojmë në mënyrën siç ne do të bëjmë pra si Kuvend së bashku, me themelimin e një tribunali dhe nuk do të heshtim tutje, se po shihet që askush nuk do të merret me to, nëse ne nuk merremi.

Më 22 maj jemi nxjerrë për pushkatim 30 mijë banorë në varrezat e qytetit në Vushtrri. Dhe aty dihet që NATO kishte reaguar me kohë. Përndryshe, as unë e as ata bashkëvendës të mi, nuk ishim as sot për të dëshmuar e as për të jetuar. Përmbi 30 qytetarë, krejt djem të rinj e burra, po edhe gra e vajza të reja, u morën atë ditë nga policia serbe, pra me dt. 22 maj. U dërguan në këtë shtëpi dhe aty u vranë, fatkeqësisht edhe u masakruan shumë prej tyre, u hodhën edhe në bunarë.

Menjëherë pas luftës, bashkë me një ekip të Këshillit dhe KFOR-in, në cilësinë e gazetares kam qenë vetë në atë shtëpi, e kam parë me sytë e mi atë tmerr. Thonj e flokë e sy të nxjerrë, e sigurisht që s'kam ardhur në vete një kohë të gjatë, sepse edhe tani është shumë e vështirë kur e kujtoj, sepse as 200 metra larg asaj shtëpisë ku kisha banuar një pjesë të luftës, kisha qëndruar edhe vetë, dhe shumicën prej këtyre njerëzve i kam njohur, i kam pasur miq, i kam pasur fqinj.

Krejt këto fakte me emra për personat të cilët i kanë kryer i kemi dëshmuar me emra, pra emër e mbiemër, pra ky ka qenë polici që ka qenë në këtë ngjarje dhe janë dorëzuar në Eulex. Edhe po flas si përfaqësuese e një popullate e cila ka për të kërkuar pa ndalur drejtësi për 587 viktimat civile që janë vrarë me planifikim në Vushtrri, bashkë me masakrat e tjera në gjithë Kosovën. Kurrë Vushtrria s'ka për të harruar masakrën e fshatit Studime, ku vetëm për një natë, më 2 maj, u vranë 117 civilë, të rrethuar në kolonë, duke ecur drejt qytetit, sepse fshatrat ishin mbushur, bukë nuk kishte, bombardimet vinin nga të gjitha anët. U vranë djem e fëmijë në sy të nënave. Edhe të tjerët ku gjenden? Në mesin e tyre ishte edhe dhëndri im i ri 24-vjeçari Afrimi, i cili po e sillte motrën shtatzënë në qytet dhe po tentonte të shkonte në mal, sepse s'kishte siguri të rrinte në qytet për djemtë e rinj. Në një ditë shumë normale për botën siç është kjo sot, një ditë maji, në komunën e Vushtrrisë me dt. 31 cak i ushtrisë dhe policisë kriminale u bë një familje, familja e bashkëvendësit tim, të nderuar Seladin Gërxhaliut. Në mëngjesit e 31 majit, policia serbe hyri në familjen e Seladin Gërxhaliut dhe vrau pa dallim pleq e të rinj e fëmijë, deri në moshën 3 vjeç. Fëmijë të cilët ishin fjetur nën jorgan. Dhe ata që tentuan të fshiheshin si 3-vjeçar nën jorgan që të mbulohehin dhe të fshiheshin nga plumbat dhe nga ajo masakër. Po nuk arritën. Ata u vranë një nga një. Njëri prej tyre kishte mbetur me sy çel, dhe kur ushtarët e UÇK-së hyrën t'i marrin kufomat menduan që ishte gjallë, po as ai nuk ishte gjallë, ishte pa gjysmën e kokës, pra fëmija tri vjeç. Këta policë dihen në komunën e Vushtrrisë, janë dorëzuar të gjitha këto fakte dhe fatkeqësisht jo që s'është marrë dikush me to, mirëpo për njëzet vjet kur është perkujtuar kjo masakër, me përjashtim të ambasadës amerikane, kurrë një herë asnjë zyrë nuk e pati guximin së

paku të vijë edhe të solidarizohet me ato familje të cilat i kanë përjetuar këto tmerre. Pra, ftesat i kanë pasur, i kanë ditur, janë ngjarje të njohura.

Si ngjarje si këto, unë jam e vetëdijshme që ka në gjithë vendin tim, andaj konsideroj që sot ka qenë shumë e rëndësishme që të ndodhin edhe këto fjalime, të përsëriten edhe këto ngjarje, edhe pse janë të ndijshme. Mirëpo ne së bashku, populli ynë e krijoi këtë histori edhe së bashku ne duhet ta ndërtojmë edhe këtë tribunal. Sepse ndryshe sigurisht si deputetë nuk do të na e falë as neve historia, po mendoj që nuk është vonë, është koha e duhur, që bashkë të bëjmë diçka të mirë, edhe të dalin në shesh emrat e kriminelëve, të dënohen kriminelët dhe të vazhdojmë përpara me shtetndërtim.

Unë ju falënderoj për vëmendjen. Faleminderit Kryetar! Kaq kisha.

**KRYETARI:** Faleminderit! Ju falënderoj për kontributin, diskutimet. Unë e pata edhe një konsultim me grupet parlamentare, do ta vazhdojmë. Shkumbin, po në qoftë se e kryen edhe ti, se kryetarët e grupeve. Ua çova sekretarin. Atëherë pra kërkoj falje, po mendova që u konsultuam me shumicën. Hajde Shkumbin. Shkumbini, pastaj ishte Dardani, por ishte kërkesa e grupeve parlamentare. Unë mendova se konsultimi ishte me të gjitha, që për shkak edhe lodhjes, pastaj të vazhdohet ditën e hënë seanca, po tash le të... Shkumbin Demalijaj. Ju kisha lutur veç pak. Shkumbin, a ka mundësi para se të flasësh.

Ju jeni deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kjo nuk ka të bëjë me asgjë tjetër jashtë këtij Kuvendit. Në qoftë se ka ndonjë lojë, pavarësisht cila ka qenë përgjegjësia, nuk është e këtij Kuvendi, cila ka qenë, për faktin... jo, jo, ideja dhe përgjegjësia e diçkaje sido që ka qenë. Ne tash as nuk po mund të futemi sot. Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk merr përgjegjësi edhe në qoftë se pavarësisht çka do që ka ndodhur. Për faktin se qëllimi i iniciativave është çështje krejt tjetër. A, në qoftë se ka dikush, unë e vazhdoj seancën, nëse e merr përgjegjësinë, edhe le të na tregoj si e zgjedh pastaj. Thjesht!

Shkumbin! Vetëm se ideja e krimeve të gjenocidit serb, çfarëdo që kishte mundur të ketë qenë, nuk duhet të ngatërrohet. Kjo është ajo që po dua tua them. Urdhëro, zoti Demalijaj.

**SHKUMBIN DEMALIJAJ:** Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Kolegë deputetë,

Përfaqësues të mediave,

Jemi dëshmitarë të asaj që ndodhi sot. Mirëpo, në qoftë se do të mund të ndodhte një lajthitje ndaj dikujt që e dimë që është personi më vjetër në Kuvend, e që është një zonjë e nderuar deputete, unë konsideroj se nuk duhet të na demotivojë asgjë në raport me atë që ka ndodhur para 20 vjetësh në Kosovë.

E dini se kjo zonjë e nderuar, që sonte dikush po mundohet ta demotivojë punën e Kuvendit. Ta demotivojë popullin. T'i demotivojë ata njerëz që kanë kaluar ato ankthe, unë ju them se kjo deputete e nderuar është njëra prej atyre që ka kaluar nëpër atë ankthe në kohën për të cilën po flasim.

Edhe në qoftë se mund të ndodhë një element më i vogli që mund të lajthitet dikush, ajo nuk është pjesë e asaj që ne marrim vendime deh rezoluta. Kisha pasur dëshirë të them se duhet ta dimë se kthim prapa nuk ka në këtë që kemi hyrë. Varret i kemi të freskëta, të gjithë e dimë se ku i kemi varret. Plagët i kemi të freskëta, të gjithë e dimë ku i kemi plagët.

Janë mbi 20 mijë femra të dhunuara, e fatkeqësisht ne nuk guxojmë ta kthejmë këtë se kush po fiton në një debat. Ta dini mirë, kemi marrë përgjegjësi dhe nëse është nevoja kryetar edhe tri javë s'dalim nga këtu.

Mund të lajthitemi, të gjithë gabojmë, po me arsyetimin ndoshta më të mirin sepse krimet duhet të flasin gjithmonë dhe jo të fshehën. Duhet të publikohen krimet. Kemi raste ku vetëm sa për t'u dukur si VIP, po shkojmë dhe po dalim me fotografi edhe më të errëta nëpër Evropë e nëpër botë, edhe po themi; bravo. E kur në pyetje fshehja e krimit, kjo nuk arsyetohet me asgjë.

Unë i jam mirënjohës çdonjërit, po edhe shumë raste kur po shoh këtu sonte duke lexuar për ngjarje të ndryshme, është mirë që janë faktuar nëpër prokurori të ndryshme, po mos ta marrim vetën njëjës.

Unë u lëshova në këtë pjesë meqenëse gjatë kohës së pauzës ndodhën shumë gjëra, por nuk kam dashur që ta përsërisë dikë lidhur me këtë çështje, po për një masakër që një bashkëqytetar i komunës sime, që quhet Fadil Krasniqi i cili është nga fshati Prapaçan, e ka numrin e telefonit 044/478-023, po e them për mediat, ka pritur shumë kohë që të flasë për një masakër që ka ndodhur në Rozhajë.

Ndryshe, ne po flasim vetëm për masakrat që kanë ndodhur të Kosovës. Thirret tavolina e zezë, ku ushtria jugosllave, serbo-malazeze, qytetarët që janë larguar nga Podujeva, Mitrovica, pjesa qendrore e Drenicës, po edhe të Dukagjinit që kanë mundur të mbërrin nëpërmjet Novi Pazari, kanë dalë atje edhe kanë mbërri në Rozhajë, janë selektuar edhe janë marrë kinse që t'i largojnë me autobus si refugjatë, edhe nuk dihet më për fatin e tyre.

Ky zotëri i nderuar, është rrahur me çekiç edhe ka mbetur aty një kohë të gjatë, derisa disa policë të Rozhajës që janë të komunitetit boshnjak dëshmojnë lidhur me këtë çështje, sepse kur po flasim për masakrat edhe për njerëzit që na i kanë bluar, nuk po na dhemb në shpirt, po ndoshta po na dhemb një defekt i vogël.



Unë po i jap edhe këta dëshmitarë të kësaj masakre që i ofron zoti Fadil Krasniqi, e ata janë: Shemso Dedejiq, Hajro Shabotiq, Remzo Kalaq, Mirsad Shkrelj, Rashid Muriq dhe Feka Kurtagiq. Pra, janë njerëz me emra e mbiemra që janë të gatshëm, janë policë, njerëz të sigurimit të brendshëm që sot jetojnë në një Republikë të ndarë nga Serbia e që është Mali i Zi.

Për këtë arsye e dhashë numrin e dëshmitarit edhe kisha pasur dëshirë dhe i kisha lutur mediat, njerëzit që dëshirojnë të shkojnë, t'i afrohen këtij njeriu sepse edhe sot nuk qëndron mirë me shëndetin e tij, meqë i kanë rënë me çekiç në kokë duke menduar se ka mbetur i vdekur.

Unë kisha kaq kryetra, dhe kisha pasur dëshirë që për këtë temë të mos ndalemi kurrë, sepse ne po kthehemi kundër vetvetes ashtu siç ka dëshiruar edhe Serbia, e cila po mundohet që t'i mohojë atë që kanë ndodhur. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Dardan Molliqaj e ka fjalën.

**DARDAN MOLLIQAJ:** Përshëndetje për të gjithë.

Unë nuk besoj që ka kushte që të vazhdohet, thua se asgjë nuk ka ndodhur. Po ashtu besoj fuqishëm që as nuk jam më atdhetar dhe më i moralshëm ose më i mirë se asnjëri prej juve këtu në sallë, absolutisht, e them me përgjegjësi.

Por, është papërgjegjësi totale, institucionale të vazhdojë Kuvendi i Republikës së Kosovës, pa e qartësuar pozicionin. Ky institucion shumë shpejt mund të kërkojë nga AKI që ta konfirmojë një informatë të tillë, e cila tashmë është tek shumica e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

I kemi dy deputete të Kuvendit të Kosovës të dy subjekteve të ndryshme, të cilat në mënyra të ndryshme kanë kontribuar edhe kanë qenë objekt i persekutimit nga Serbia. Pra, janë dëshmitare të gjalla se çfarë ka bërë Serbia.

Po, ne nuk guxojmë për faktin që këto të dy deputete të nderuara, njëra e ka paraqitur rastin e tjetra e ka konfirmuar që familja ka kërkuar që të hiqet ky njoftim, që është Saranda Bogujevci, e cila nuk është këtu, është gabim yni që krejt ato krime që i ka bërë Serbia në Kosovës, për herë po flas, s'kam folur kurrë, vij nga fshati Beleg, ku janë vrarë dhe janë masakruar më shumë se 40 veta.

Pra, kurrë në jetë s'kam folur për këtë masakër. Janë dhunuar më shumë se 10 gra në atë fshat, kurrë s'kam folur, vetëm e vetëm që ta respektoj dinjitetin e viktimave.

Nëse Kuvendi i Kosovës nuk nxjerrë deklaratë me anë së cilës distancohet edhe e bartë përgjegjësinë, sepse ka ndodhu në këtë seancë, kryetar i Kuvendit, njëra në korridor, tjetra këtu,

dhe Kuvendi i Kosovës, të gjitha grupet parlamentare duhet të distancohen derisa ta sqarojë AKI-ja dhe organet tjera.

Për shikim të parë është manipulim çfarë ka ndodhur. Për atë që e pamë ne që s'jemi ekspertë është rrenë. Megjithatë, s'po guxoj të lëshohem si të tjerët dhe po ua lëmë institucioneve kredibile. Ndërkaq, Kuvendi i Kosovës duhet të nxjerrë deklaratë për shtyp ku e mbështesin të gjitha grupet parlamentare, me anë të së cilës distancohen nga dy deklaramet e të dyja deputeteve.

Ndërkaq, nëse dalin të pavërteta e të dyjave, unë personalisht edhe besoj që edhe Kuvendi i Kosovës, duhet të kërkojë përgjegjësi morale dhe të dyja të japin dorëheqje edhe nëse është gabim, edhe nëse paqëllim, sepse krimet që i ka bërë Serbia në Kosovë, nuk guxojmë t'i diskreditojmë në asnjë institucion.

Nuk është fjala këtu e një deputeti. Nëse ne nuk reagojmë, i bie që pajtohemi. Nuk dua ta gjykoj asnjëherë, sepse kanë bërë të dyja më shumë se unë, pakrahasimisht më shumë se unë e ndoshta se shumica jemi këtu.

Por, fakti që ke bërë njëherë diçka, edhe fakti që s'e ke bërë prapë me qëllim, por e ke bërë gabim, nuk guxon të na dëmtojë neve si shtet, e aq më shumë viktimat.

Kështu që unë po kërkoj që të mos vazhdojë kurrfarë debati. Kryetari i Kuvendit t'i thërrasë shefat e grupeve. Të nxirret një deklaratë, të votohet dhe Kuvendi të distancohet nga ky akt, dhe në të njëjtën kohë t'ju bëhet shkresë institucioneve të sigurisë që të konfirmohet, dhe në momentin që konfirmohet që është e pasaktë, të dyja deputete e nderuar të cilat i kanë dhënë shumë këtij vendi, duhet t'i lirojnë vendet në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe t'i kërkojnë falje Kosovës, dhe t'u kërkohe falje viktimave.

Më besoni, nëse është kështu, është jashtëzakonisht problem ajo që ka ndodhur. Kështu që të mos gabojmë tutje. Të mos i kthejmë shigjetat ndaj njëri-tjetrit, po të veprojmë kolektivisht, pavarësisht dallimeve politike me një deklaratë të përbashkët si institucion. Kjo pra, është e vetmja rrugë e drejtë për Kosovën.

Nuk po paragjykojmë asgjë, po e presim përgjigjen. Por, jo të shkojmë në shtëpi sonte pa e marrë këtë vendim, dhe as të vazhdojmë thua se nuk ka ndodhur asgjë. Faleminderit!

**KRYETARI:** A ka mundësi veç pak! Po e vërej, po kërkojnë ndërprerjen e seancës, unë u mundova pastaj në të njëjtën kohë edhe diskutime.

Diçka që duhet të jetë shumë e qartë; çfarëdo që të jetë, si do që të jetë, për çka ky Kuvend nuk merr përgjegjësi. Ajo që është kryesore, distancim edhe dënim deri në fund ka veç për gjenocidin e Serbisë në Kosovë.

Nuk duhet të lejojmë, të tolerojmë as të mendojmë, pavarësisht asaj se çfarë do qëllimi që është, të ikim nga primati i idesë për t'u dënuar gjenocidi serb në Kosovë. Kjo është ajo e cila kërkohet.

Për pjesën tjetër, të cilën ju e thatë, do të ishte në mënyrë disfatiste, pra në qoftë se ka diku një bombë të tillë dhe një luftë të tillë speciale të hidhet.

Unë tash nuk jam në gjendje, as të konstatoj e as të flas për diçka që kam qenë i painformuar edhe e cila mund ta supozojë të vërtetën apo të pavërtetën. Por, diçka ka të vërtetë edhe kjo na mbanë të gjithëve të gjallë dhe të fortë, se jo menjëherë ta kthejmë shpinën; Serbia ka kryer gjenocid. Serbia ka kryer dhunime. Serbia ka kryer vrasje. Dihet se kush i ka kryer.

Dëgjoni, nëse ka ndodhur një gabim i tillë, sigurisht se do të dalin edhe dhjetëra e qindra dëshmi pas ditës së sotme.

Edhe në këtë seancë edhe jashtë kësaj seance. Me dokumente të faktuara, ku dëshmohet se Serbia ka kryer dhunime. Do të dalin me emër dhe mbiemër. Nuk është një, janë me dhjetëra dëshmi që janë kryer dhunime.

Unë nuk e di a është ajo a nuk është, vetëm se di që janë kryer me dhjetëra dhunime, me emra e mbiemra. Po ua jap fjalën se do të flas edhe publikisht, do të kërkoj që t'i sjellin edhe do tua sjell këtu në seancë, ta ruaj privatësinë, por me emra e mbiemra do dëshmohen krimet e Serbisë.

Kjo është ajo që është kryesore. Gjenocidi serb, krimet serbe, dhunimet serbe kanë ndodhur. Se a është ajo fotografi a nuk është, asnjëri prej nesh që jemi këtu edhe pesë vjet s'mund t'i bëjmë ekspertizë. Është AKI-ja që duhet ta shikojë.

Dy deputete të cilat kanë folur, ndjej keqardhje shumë të madhe për rastin e të dyjave. Të dyja janë të lënduara shumë edhe nuk është mirë që të jenë më objekt të diskutimeve në këtë seancë. S'është mirë të jenë fare, pavarësisht asaj qysh ka qenë. Kjo është ajo që po dua ta them.

A dëshironi që ta ndërpresim seancën dhe ta vazhdojmë ditën e hënë? Ditën e hënë, në orën 10:00, vazhdon seanca. Faleminderit!

\* \* \*

*E hënë, 20 maj 2019*

*Vazhdimi i mbledhjes, e filluar më 16 maj*

*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, zoti Kadri Veseli.*

KRYETARI: Të nderuar deputetë,  
Jemi në vazhdimin e seancës.  
E ftoj nënkryetarin të zërë vendin tim.

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.)*

KRYESUESI: Kryetari i Kuvendit e ka fjalën.  
Ju lutem, kolegë, zini vendet!

KADRI VESELI: Të nderuar deputetë,  
Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,  
Pas asaj që ndodhi të enjten, si iniciues i kësaj seance, si kryetar i Kuvendit, dua t'i them disa fjalë për iniciativën e themelimit të Tribunalit ndërkombëtar për gjenocidin serb në Kosovë, për foton dhe reagimin.

Si komb i shtypur, ndrydhja dhe dyshimi në vetveten na ka përcjellë gjatë dhe shumë.

Për idenë e krijimit të këtij tribunali kam pritur edhe hezitime e goditje, që në politikë nganjëherë mund të jenë normale.

Por, nuk e kam pritur një qasje të tillë brutale mes nesh, duke menduar në respektin ndaj një sakrifice të madhe dhe fatin real të kombit tonë, që të gjithë pa përjashtim e kemi pasur.

Të premtën, në zyrën time, erdhi një nga familjarët e personave me plagë të luftës dhe i mllëfosur me debatin rreth kësaj iniciative, e bëri një pyetje të drejtë: Pse ne shqiptarët tha, kryetar, jemi kaq të pamëshirshëm ndaj njëri-tjetrit dhe të fortë për hakmarrje, ndërsa para të huajve dorëzohemi me lehtësi?

E tha këtë, i mbërthyer nga frika se do të mund të dështonte kjo iniciativë për t'i vënë para drejtësisë kriminelët serbë.

Nëse jo shteti, ai ishte i vendosur që individualisht, si familjar, ta çojë deri në fund rastin e tyre, sepse s'do të pranohet të heshtë derisa drejtësia të vihet në vend.

Nëse duam ta pranojmë të vërtetën, jo vetëm tash për këtë ndërmarrje historike, por edhe gjatë viteve '90 ne ishim vetë dëshmitarë të një mentaliteti të tillë dyshues dhe mohues.

Sot, dua ta sjell këtu një copëz rrëfimi personal të këtij përjetimi.

Kur ne, që më vonë u njohëm botërisht si Ushtria Çlirimtare e Kosovës, endeshim në fillim të 90-ave, nëpër vende të ndryshme të Kosovës, për shkak të këtij mentaliteti përballeshim me situata jo fort të lehta në vendin tonë, nga njerëzit tonë.

Më 1992, në Runik të Skenderajt, në kulmin e terrorit nga policia serbe, njërit prej pjesëtarëve tanë iu desh ta shkrepnte një breshëri automatiku për ta parandaluar sulmin drejt nesh me sëpatë nga një civil shqiptar.

Ai nuk e paramendonte se shqiptarët ishin angazhuar në rezistencë të armatosur.

Më 1993, në Gucat të Malishevës, bashkë me Nait Hasanin, në gjysmë të natës, mezi ishim zhbllokuar nga vreshtat, sepse civilët tanë, të cilët na u desh t'i pyesnim për rrugën, u organizuan të kontrollonin çfarë kishim në rimorkion e vogël.

Ata nuk e besonin se shqiptarët ishin angazhuar në rezistencë të armatosur.

Në vitin 1996, teksa po udhëtonim në magjistralen Deçan-Gjakovë, bashkë me Luan Haradinajn e Avni Nurën, mezi kaluam rrugën e fshatrave Jasiq-Voksh, sepse fshatarët kureshtarë donin të na kontrollonin barrën në samar të kalit.

Atyre nuk ua merrte mendja se shqiptarët ishin angazhuar në rezistencë të armatosur.

Më 1997, në Ratkoc të Rahovecit, të uniformuar, për t'i ikur dekonspirimit, na është dashur të kamuflohem në bashkëbisedim me fshatarët që atë pasdite vjeshte kishin dalë për të vjelë rrush.

Rrëfimi bëhet edhe më tronditës me një ndodhi reale në prill të vitit 1998, pas daljes publike të UÇK-së dhe rënies së Komandantit Legjendar Adem Jashari me tërë familjen e tij.

Disa studentë kishin ardhur në zonat e luftës, pasi kishin dëgjuar se UÇK po endej hapur në Drenicë, por nuk e kishin besuar këtë. Kishin ardhur vetë për t'u bindur.

Dhe, kur panë ushtarët e UÇK-së, me armë e të uniformuar, njëri prej studentëve kolapsoi emocionalisht. Ai dhe shokët e tij nuk e kishin besuar se kishte shqiptarë që rrokin armët për t'u angazhuar në rezistencë të armatosur ndaj Serbisë.

Mos harroni: Kjo ishte një ngjarje e ndodhur pas 5 marsit të vitit 1998!

Njësoj na kishte ndodhur edhe një muaj më herët, kur në Nikoliq të Krumës së Shqipërisë, teksa qëndronim në konakun e Sali Jakut, kolapsoi emocionalisht një ndërmarrës nga Gjlani, mbështetës yni i madh, kur pa Xhevë e Fehmi Lladrovcin, Bekim Berishën, Agim Bajramin, Korbin e Ismet Jasharin dhe disa prej nesh që ende jemi gjallë, të veshur në uniforma ushtarake dhe armatosur për të hyrë në Kosovë.

Të nderuar deputetë,

I ndava këto rrëfime me ju, për të thënë se askush nuk besonte se kishte shqiptarë që guxonin ta luftonin Serbinë, e cila konsiderohej një prej ushtrive më të forta në Evropë.

Sipas atij paragjykimi, gjithçka dhe gjithkush mund të ishte prapa rezistencës së armatosur kundër policisë dhe ushtrisë serbe, vetëm shqiptarët jo.

Aq të fuqishme ishin frika dhe dyshimi.

Në fillim ishim pak.

Na besuan pak.

Besimi shkoi duke u ngjallur dhe duke u rritur, e bashkë me të edhe mbështetja.

Sot, kur nga kjo distancë shikojmë të kaluarën, del se djemtë dhe vajzat të këtij vendi e luftuan një prej ushtrive më të forta në Evropë, dhe bashkë me partnerët e mundën atë.

Kosova u çlirua, shpalli pavarësinë, bëri shtetin dhe në fund formoi edhe ushtrinë e saj.

Të dashur qytetarë

Ky mentalitet i dyshimit njëjtë po na përcjell edhe sot, kur jemi në prag të një vendimi të madh për të kërkuar drejtësi për viktimat e gjenocidit serb në Kosovë.

Që nga dita kur kam filluar këtë iniciativë, njësoj janë shfaqur dilema, frikë e hezitim.

Dhe, si të brishtë që jemi, na erdhi si bombë fotoja!

Atë ditë, Flora Brovina bëri një gabim shumë të rëndë.

Dr. Flora është vetë viktimë e gjenocidit serb. Flora dhe sjellja e saj, sado që është gabim shumë i madh, është edhe pasojë e atij gjenocidi serb.

Reagimet pastaj kanë mundur të jenë më të balancuara dhe më të përmbajtura me Flora Brovinën, si individ, duke marrë parasysh rrethanat e saj jetësore dhe kontributin e saj.

E jo tentuese për ta linçuar, ose edhe më keq, nxitur si komplot të qëllimshëm politik.

Sa për temën, dhunimet gjatë luftës në Kosovë janë fakt i ditur botërisht.

Nuk na duhej një foto, as qindra për ta dëshmuar këtë. Sepse, qindra gra të dhunuara ende presin drejtësinë për të dëshmuar!

Të nderuar deputetë

Realiteti i tragjedisë sonë kombëtare gjatë vitit 1998-1999 nuk ka qenë akt i ndarë dhe as i kufizuar!

Ky ishte një përjetim gjithënational, që u krye me një platformë, program, organizim dhe ekzekutim nga shteti serb në shumicën e lagjeve, fshatrave dhe qyteteve të Kosovës.

Gjenocidi serb ka ndodhur në të njëjtën formë dhe me të njëjtin skenar kudo në Kosovë, si në Likoshan, Studime, Rezallë, Mejë e Vërboc e gjithandej nëpër Kosovë.

Ai është përcjellë me dëbime, dhunime, poshtërime, çnjerëzime, pa dallim, për burra, gra, fëmijë e pleq.

Gjurmët dhe dëshmitë e këtij gjenocidi janë kudo. Në çdo familje. Në çdo lagje, fshat e qytet të Kosovës.

Për këtë ka dëshmi, fakte dhe dëshmitarë të bollshëm.

Dëshmi që kanë njerëzit e Kosovës, por edhe gatishmëri për të dëshmuar, nëse krijohen kushte ligjore - siç do të jetë Komisioni shtetëror, si bazë për inicimin e Tribunalit ndërkombëtar për gjenocidin serb mbi Kosovë.

Por, para se ta adresoj edhe një herë çështjen e fakteve, më lejoni t'ua përgjigjem disa dilemave që janë ngritur ndaj kësaj iniciative.

Pse tani kjo iniciativë për tribunalin?

Institucionet e Kosovës patën marrë vendim për të filluar një veprim të tillë që në vitin 2011, duke ngritur një institut, pothuajse menjëherë pas përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur.

Nga ky institut dhe në bashkëpunim me prokuroritë dhe gjykatat tona, është dashur të ketë veprim konkret, dokumentim dhe procedim adekuat ligjor sidomos për disa nga masakrat që shteti serb kreu në Kosovë. Kjo nuk ka ndodhur!

Përveç kësaj, me përfundimin e Misionit të EULEX-it, në vitin 2017, u shuan shpresat e qytetarëve kosovarë për drejtësi vendore dhe ndërkombëtare.

Ata u lanë thellësisht të zhgënjyer.

Mesazhi që doli nga kjo sjellje ishte se epilogu i gjenocidit do të ishte heshtja. E heshtja nënkuptonte vetvetiu edhe lënien e tyre në sirtar.

Nëse kësaj i shtohet edhe mohimi politik, jo vetëm nga shteti serb që kreu gjenocidin në Kosovë, por edhe nga disa ndërkombëtarë - që kishin pasur mandat për ta vënë drejtësinë në vend, tregohet qartësisht shpërfillja dhe fyerja që na bëhet si komb.

Për të konkluduar se Tribunali ndërkombëtar, sado vonë, është një thirrje, kërkesë, logjikë dhe domosdoshmëri që të ndodhë. Sa më parë. Për t'i hapur perspektivë një epoke të re pajtimi dhe paqeje në Ballkan!

A mund të ngrihet ky tribunal?

Dilema tjetër.

Kam konsultuar juristët më të mirë të Kosovës, të vjetër e të rinj, me përvojë dhe shkollim shembullor, në Kosovë dhe universitete në Perëndim. Por, dhe ekspertë me renome ndërkombëtare.

Jo vetëm është e mundur ngritja e këtij Tribunali për gjenocidin serb në Kosovë, por është e pashmangshme, nëse shteti i Kosovës është serioz dhe i vendosur në veprimet e duhura institucionale dhe ligjore.

A është kjo iniciativë tentim për t'i ikur Gjykatës Speciale?

Gjykata Speciale në Kosovë, që nga dita e parë e inicimit e deri më sot, përcillet paralelisht me dy agjenda kryesore: ajo e vërtetimit të drejtësisë për pretendimet e ngritura dyshuese për krime të UÇK-së dhe ajo e prapaskenave të Serbisë, e cila tenton t'i balancojë krimet dhe ta përmirësojë imazhin e vet në botë.

Për të gjithë ata që mund të kenë dilema: Iniciativa për ngritjen e Tribunalit për gjenocidin serb në Kosovë nuk lidhet fare dhe asgjë me Gjykatën Speciale.

Para së gjithash, për arsye shtetërore.

Çdo veprim paralel, neutralizues ose mohues i Gjykatës Speciale, në këto rrethana mund ta dëmtojë edhe më shumë shtetin tonë, kombin tonë, vetë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.



Gjykata Speciale është themeluar nga ky Kuvend. Ky është fakt i pakthyeshëm më!

Ajo duhet ta kryejë punën e vet paanshëm dhe profesionalisht.

Tribunali ndërkombëtar për gjenocidin serb në Kosovë, po ashtu, duhet të ndodhë, për faktin se i hap Evropës, rajonit dhe Kosovës e Serbisë një perspektiv të re dhe premtuese.

Ka dilema për fakte, a ka fakte të mjaftueshme që arsyetojnë iniciativën për ngritjen e Tribunalit ndërkombëtar për gjenocidin serb në Kosovë?

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kosova ka fakte, dëshmi dhe dëshmitarë të bollshëm.

Duke u nisur nga e vërteta që e kemi parë dhe përjetuar vetë ne, familjet tona, kombi ynë.

Nëse ky Kuvend sot merr vendim për themelimin e Komisionit shtetëror, që pastaj do të merret me hapat për inicimin e themelimit të Tribunalit ndërkombëtar për gjenocidin serb në Kosovë, Kosova ka aq shumë dëshmitarë të gatshëm për të dëshmuar, përfshirë edhe ata që kanë marrë pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në këto krime.

Po flas për kryerësit e tyre të penduar! Po flas për ata që kanë parë masakrat, dinë për to, kanë qenë pjesë e tyre, që janë marrë me varrime, zhvarrime e bartje kufomash.

E them me përgjegjësi të plotë: Kosova ka dëshmi! Kosova ka shumë dëshmi! Kosova posedon shumicën dërrmuese të dëshmimeve që faktojnë gjenocidin serb. Kosova ka të dhëna të mjaftueshme për të dëshmuar planifikimin, organizimin dhe ekzekutimin shtetëror të gjenocidit serb mbi shqiptarët dhe joserbët në Kosovë. Formën si ka ndodhur, kohën, vendin e saktë dhe kryesit e tyre. Një për një mund të dëshmohen, faktohen dhe dokumentohen.

Kosova ka pothuajse në tërësi, si dokumente, planet ushtarake dhe policore serbe, platformën, bartësit e tyre dhe ekzekutuesit e këtyre krimeve makabre. Kosova ka fakte, dokumente nga arkivat serbe, se si janë tentuar të fshihen gjurmët e krimeve shtetërore serbe nga krerët politikë e ushtarakë edhe pas luftës në Kosovë. Kosova ka edhe lista të ekzekutimeve të shqiptarëve, të dokumentuara me dëshmi zyrtare serbe. Shumë nga këto dëshmi i ka pasur në dispozicion edhe UNMIK-u dhe Tribunali i Hagës, të dorëzuara nga Kosova para shpalljes së pavarësisë.

Të nderuar deputetë,

Ditën e enjte më është kërkuar që ndoshta mirë është ta lëmë këtë punë, nga grupime parlamentare. Kjo punë s'do të ndalet. Kosova ka pothuajse gjithçka dhe di çdo gjë që ruhet në arkivat e shtetit serb. Brezat e kaluar, e as brezat e ardhshëm nuk do të na falin nëse ne lejojmë që detyra jonë kombëtare dhe historike të shembet përballë inateve partiake dhe interesave

ditore. Çështjet ndër breza zgjidhen kur zgjidhim mosmarrëveshjet brenda brezit tonë. Duke kujtuar të kaluarën dhe duke shikuar të ardhmen, drejtësia kërkon që ne të merremi vesh në të tashmen. Sot dhe këtu, se cilët janë fajtorët për vuajtjet që na u shkaktuan mizorisht, mund të tregojë puna e tribunalit, por se kush është përgjegjës për themelimin ose mosthemelimin e tribunalit, do të tregojnë sot votat tuaja. Ne duhet t'u përgjigjemi thirrjeve të drejtësisë dhe thirrjeve për drejtësi. Ne e kemi obligim këtë, Milaim, dëgjo me vëmendje. Ne sot mund të hapim rrugën për themelimin e një tribunali që i bën drejtësi të kaluarës, përmbush përgjegjësinë e sotme dhe krijon kushtet për paqe të qëndrueshme në të ardhmen. Fakte, dëshmi, dokumente, dëshmitarë ka boll. Ju tani vendosni vetë nëse do t'i thoni 'po' iniciativës për themelimin e Tribunalit ndërkombëtar për gjenocidin serb në Kosovë, apo t'i thoni 'po' heshtjes, shpërfilljes dhe mohimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Avdullah Hoti. Urdhëro!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit për fjalën!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Pas unifikimit për rezolutën për gjenocidin serb në Kosovë, motivet e përfitimit politik e personal nga kjo seancë e Kuvendit të Kosovës e dëmtuan rëndë kauzën tonë dhe të mijëra veprimtarëve për 20 vjet me radhë për zbardhjen dhe dënimin e krimeve dhe gjenocidit të regjimit serb në Kosovë, në veçanti para botës demokratike.

Në vend që kryetari i Kuvendit të ftonte grupet parlamentare për konsulta, për veprim të përbashkët, ai vraponte skutave të Prishtinës dhe i dënonte ashpër kriminelët serbë para kamerave televizive. Kuvendi i Kosovës, familjet e viktimave dhe të gjithë qytetarët e Kosovës janë shokuar me këto sjellje. Askush nuk u ka borxh politikanëve që janë kurthuar në korrupsion, nepotizëm dhe në keqpërdorime të shumta, të përdorin fatkeqësitë që i ka populli i Kosovës për përfitimet e tyre politike.

Të nderuar qytetarë,

Sot shteti i Kosovës vuan nga sundimi i treshes Thaçi-Haradinaj-Veseli. Thaçi e ka bërë kauzë të tij ndarjen e territorit të Kosovës me Serbinë me qëllim të arritjes së marrëveshjes përfundimtare me Serbinë që vetëm atij i intereson një marrëveshje që askush nuk e pranon, por që i duhet atij personalisht për arsye që vetëm ai i di. Haradinaj qeveris me emër të PAN-it, i mbështetur nga bandat kriminale, publikimi i takimit që paska ndodhur me Radojçiqin dhe zyrtarët e shtetit serb për formimin e qeverisë dhe koordinimin e veprimeve në dëm të shtetit të Kosovës, janë fyerje për secilin qytetar të Kosovës.

Zoti Veseli, i cili është shef i PAN-it dhe përgjegjës për këtë qeverisje me bandat kriminale, me fjalimet e tij në dy ditët e fundit u mundua të relativizojë dëmin që ai, deputetja e tij dhe partia e tij i kanë bërë kauzës së mijëra veprimtarëve që kanë punuar për dy dekada për të dëshmuar krimet e regjimit serb para botës demokratike. Me veprimin e tij është dëmtuar arritja më e madhe e kohëve të fundit që ishte dëgjimi në Kongresin Amerikan për krimet e dhunës seksuale gjatë luftës, e organizuar me iniciativë dhe përkushtim të pashoq nga presidentja Jahjaga. E vërteta është, të nderuar deputetë, të nderuar qytetarë, që krimet e regjimit serb kanë ekzistuar dhe do të dëshmohen, por e vërtetë është gjithashtu se këto krime janë duke u përdorur për qëllime politike.

Të nderuar qytetarë,

Kjo gjendje nuk duhet të vazhdojë më tutje, Kushtetuta e Kosovës duhet të respektohet nga të gjithë, jo vetëm nga opozita, jo vetëm nga LDK-ja, integriteti territorial i Kosovës duhet të respektohet pa përjashtim, para së gjithash nga presidenti, Qeveria e Kosovës nuk guxon të bashkëpunojë me krimin dhe bandat e as të dakordohet me zyrtarët serbë se çfarë veprimi do të ndërmarrin në Kosovë dhe viktimat e luftës nuk guxon askush t'i përdorë për qëllime politike. Kjo seancë e Kuvendit nuk ka kuptim të vazhdojë më tutje, orkestruesi dhe zbatuesit e këtyre zhvillimeve duhet të marrin përgjegjësinë edhe politike, edhe morale e ligjore. Organet e drejtësisë duhet të bëjnë punën e tyre me efikasitet dhe të pandikuar, sepse u kanë borxh viktimave dhe qytetarëve të Kosovës, ia kanë borxh shtetit të Kosovës, i cili ua ka dhënë besimin për të vendosur drejtësinë në këtë vend. Ne ftojmë opozitën dhe të gjitha forcat politike në Kuvend për të dakorduar veprimet kushtetuese dhe veprimet demokratike që duhet të ndërmarrin për të ndaluar degradimin më tutje të institucioneve të shtetit të Kosovës. Faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)*

KRYETARI: Faleminderit! Jemi në seancë, për hir të qytetarëve nuk do të ketë reagim, vetëm dëshirova këtë pjesën, pasi jemi para qytetarëve, duhet pasur korrektësi, ndershmëri edhe para publikut. Dardan Sejdiu është dëshmitar, përpjekjet e mia, në fakt hiç më larg për ta konfirmuar se nuk është e vërtetë çka tha zoti Hoti, para gjysmë ore, ashtu Dardan, a, kemi qenë, kam ftuar të gjithë kryetarët e grupeve parlamentare, nuk ka ardhur, do të thotë. Përpjekjet e mia janë që nga fillimi të jem korrekt që t'i thërras, të konsultohemi, por le të mbetet në ndërgjegjen morale tuajën. Thjesht, kështu qëndrimi ishte i jashtëzakonshëm, bile aty ishte korrekt për qëndrimin tuaj.

Shkojmë, Milaim Zeka. Atëherë, veç pak Milaim, të lutem. Glauku! Po lirisht, vetëm se unë po u referohem edhe kryetarët e grupeve parlamentare që ishin prezentë ju thirra, do të thotë a është e vërtetë, veç trego, bëhu burrë, a është e vërtetë a jo, më fal që të thashë bëhu burrë, bëhu deputet dinjitoz.

AVDULLAH HOTI: Unë ju kisha lutur të përmbaheni nga kualifikimet, unë ju referova nevojës që ka pasur ky Kuvend dhe grupet parlamentare për t'u koordinuar plotësisht para një muaj ditë për këtë iniciativë. Takimi që ju keni kërkuar në mëngjes sot, keni kërkuar koordinim për të dalë nga kjo situatë. Ju duhet të merrni para se gjithash përgjegjësinë politike e morale si kryetar i Kuvendit, si kryetar i PDK-së për këtë çështje. Kjo është e vërteta.

KRYETARI: E vërteta është, a të kam ftuar, a jo? Se publiku dëshiron ta di, vetëm a të kam ftuar a jo sot? Të lutem thuaje po ose jo, këtë s'po më intereson këtë pjesën tjetër për përgjegjësi, secili është, të mos e rëndojmë seancën, a të kemi ftuar, a jo, të lutem?

AVDULLAH HOTI: Në fjalimin tim iu referova nevojës që kemi pasur të koordinohemi të gjitha grupet parlamentare për këtë iniciativë, të cilën gjë nuk e keni bërë, por e keni bërë nëpër skuta të Prishtinës para kamerave televizive, dhe doli si doli. Sot në mëngjes ju keni ftuar, por nuk ka nevojë të konsultohemi tani për këtë çështje për të dalë nga situata, tani është kjo seancë e Kuvendit që vendos se si të shkojmë më tutje.

KRYETARI: E kryer! Skutat e Prishtinës janë qendra e Prishtinës. Glauk, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Qytetarë të nderuar,

Nuk ka shpjegim tjetër të qëndrueshëm pse krimet e Serbisë nuk janë trajtuar deri tash, as nga UNMIK-u e as nga EULEX-i që 20 vjet në Kosovë, përveç mungesës së trysnisë nga përfaqësuesit tonë, nga përfaqësuesit e Kosovës.

Që 20 vjet me radhë këta pushtetarë për sa kohë e kanë kalëruar pushtetin në rehati, kurrkujt nuk i ra në mend për krimet e Serbisë. Krimet e Serbisë kanë filluar t'i përmendin vetëm pak javë përpara se të dalin aktakuzat e Gjykatës Speciale, siç dihet. Që 16 vjet në Kosovë, e më shumë, nuk na ka ndodhur që të dëmtohet një kauzë kaq e rëndësishme, si përpjekja për argumentimin e gjenocidit dhe krimet e luftës të Serbisë, sikur me seancën e 16 majit. Po t'ia kesh dhënë një laps Serbisë në dorë edhe t'i thoshte dikush qysh kishe mundur në mënyrën më të keqe ta dëmtosh një diskutim për krimet e luftës edhe për gjenocidin, ajo e kishte vizatuar bash qysh ka ndodhur më 16 maj. Prandaj, unë mendoj që pas 16 majit në këtë shtet dikush duhet të japë llogari, edhe unë po e kursej Flora Brovinën, ashtu qysh tha kryetari i Parlamentit, sepse po them që ai që duhet të japë dorëheqje është vetë kryetari i Parlamentit. Nuk mund të vazhdojmë më me këto struktura politike, të cilat çdo gjë që po e prekin me dorë, po e prishin.

Edhe kjo ideja e Tribunalit ndërkombëtar unë mendoj që është tallje me viktimat dhe popullin tonë, sepse ne të gjithë e dimë sa krime ka pasur, të gjithë e dimë saktë cilat kanë qenë krimet, po e dimë në të njëjtën kohë, qysh krijohet një Tribunal ndërkombëtar. E thanë edhe shumë deputetë

në seancën e 16 majit, një Tribunal ndërkombëtar krijohet nga OKB-ja. E në dialogun me Serbinë kurrë nuk është ngritur çështja e mosndëshkimit të krimeve të Serbisë. Unë nuk kam parë kurrë prej politikanëve që e kanë përfaqësuar Kosovën në dialog me Serbinë që prioriteti i pakontestueshëm është mosndëshkimi i krimeve të Serbisë, kurrkush nuk e ka përmendur.

Unë po them që prej vitit 1999, tash po bëhen 20 vjet prej çlirimit të Kosovës, po ta kishit pasur ju prioritet edhe po t'i kishit përmendur shpesh krimet e Serbisë sa e keni përmendur në Bruksel liberalizimin e vizave, unë mendoj që ishin kryer deri tash gjykimet e krimeve të Serbisë. Qeveritarët tanë problemi kryesor është që nuk e kanë në fjalor termin “drejtësi”, në raport me ndërkombëtarët, në raport me Serbinë, fjala kryesore nuk ka qenë fjala “drejtësi”, fjala kryesore ka qenë “pajtim” dhe “kompromis”. Këto dy fjalë i kam dëgjuar shpesh në Bruksel, a fjalën “drejtësi” nuk e kam dëgjuar kurrë. Ky është mentaliteti politik i qeveritarëve tanë. Sa i përket kësaj që cilat krime kanë ndodhur në Kosovë, rasti i Vasfije Krasniqit dhe dëshmia e argumentimi i saj në Kongresin Amerikan, është deklarata më e fuqishme, dëshmia më e fuqishme se çka ka ndodhur me rastet e dhunimit të grave në Kosovë nga forcat policore, ushtarake dhe paramilitare të Serbisë. Dëshmia e Vasfije Krasniqit është më e fuqishme se 1 000 fotografi, e kjo është e pafalshme, kur në Kosovë për krimet që i ka bërë Serbia ekzistojnë së paku 2 000 deri 3 000 fotografi, të gjitha të vërteta. I kemi 2 000 deri 3 000 fotografi të argumentimit të masakrave, të vrasjeve, edhe të fëmijëve, edhe të grave. Dhe prej 2 000 deri 3 000 fotografi të shkosh edhe të gësh një fotografi fals e ta dëmtosh kauzën kaq shumë, kjo me të vërtetë do përgjegjësi të jepet këtu në Kuvendin e Kosovës. Se kjo seancë nuk mund të vazhdojë sikur asgjë nuk ka ndodhur.

E tash ejani ta krijojmë një konsensus për krimet që i ka bërë Serbia. Ne i dimë krimet që i ka bërë Serbia. Nuk ka nevojë konsensus mes neve për krimet që i ka bërë Serbia. Ne që njëzet vjet jemi duke folur për krimet që i ka bërë Serbia, ama është me të vërtetë pafytyrësi të kërkosh tribunal prej OKB-së, kur vetë në Kosovë nuk i kemi gjykuar krimet nga Serbia. Kur për njëzet vjet nuk e kemi shtyrë përpara ligjin e gjyimit në mungesë, që kriminelët serbë të gjykohen edhe pse nuk jetojnë në Kosovë, të ndëshkohen ata për krimet që i kanë bërë. E kush e ka pasur përgjegjësinë për këto që nuk paskan ndodhur deri tash? Ata që e kanë qeverisur Republikën e Kosovës që njëzet vjet. Këta e kanë përgjegjësinë pse nuk kanë ndodhur këto gjëra. E tash tribunal prej OKB-së. Kjo është me të vërtetë joserioze.

Ne kemi nevojë për ato që i ka shpjeguar Albulena në seancën e kaluar, edhe bashkë me ato që janë pozicion edhe i Lidhjes Demokratike të Kosovës. Parlamenti nuk mund të bëjë asgjë më shumë sesa të krijojë një grup i cili i jep vullnet politik, inkurajim, edhe udhëzime sesi institucionet t'i kryejnë detyrat e veta me Kushtetutë. Ne kemi gjykatë e cila i gjykon krimet e luftës në Kosovë, jo gjykatë e veçantë, po kemi kompetencë kushtetuese. Edhe krimet e luftës, i kemi edhe në Kodin Penal edhe krejt të përshkruara me ligje, edhe me kompetenca të

institucioneve të cilat kanë të drejtë t'i gjykojnë krimet e luftës edhe duhet gjykuar. Edhe kjo nuk ka ndodhur që njëzet vjet. E kë duam ta akuzojmë ne?

Kështu që, unë propozoj: dhënia e llogarisë, dorëheqja sot është e nevojshme. Nëse jo, ne jemi edhe në koordinim edhe me Lidhjen Demokratike të Kosovës. Mendoj që nuk duhet të rrimë në një seancë të tillë, e cila udhëhiqet prej njerëzve, të cilët bash çka po prekin me dorë, po e prishin në mënyrën më të mundshme. Ne nuk duam të jemi pjesë e kësaj.

KRYETARI: Memli Krasniqi, se ndërkohë s'e ka kërkuar fjalën më herët. Ngapak reagoni edhe në mënyrë elektronike ju kisha lutur.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Meqenëse seanca kishte mbetur në gjysmë dhe kishte nga ajo që u tha më herët një renditje, nuk isha i sigurt sesi do ta zhvillojmë, por meqenëse kërkesa e opozitës qenka për diçka të papritur, atëherë do të them edhe unë diçka. Edhe pse realisht nëse e kanë dëgjuar me vëmendje, atë që e thatë ju në fjalim, unë nuk kam shumëçka t'i shtoj fjalës suaj, vetëm se nuk do ta kisha besuar që edhe sot e kësaj dite në Kuvend të Republikës së Kosovës, njëzet vjet pas luftës të dëgjojmë deklarata që i dëgjuam tash. Është vështirë të gjesh fjalë për ta klasifikuar këtë mentalitet hezitues, edhe këtë mentalitet të ikjes së përgjegjësive. Të thuash se është i turpshëm, është pak më shumë është i frikshëm. Për mua sot është e frikshme qëndrimi i dy partive në Kuvend të Kosovës, i Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe i Lëvizjes Vetëvendosje, mos të guxojnë të marrin përgjegjësinë që u takon si deputetë për iniciativë të dënimit të gjenocidit të Serbisë. Verbërimi që këtyre njerëzve ua ka dhënë etja për pushtet, ua ka marrë arsyen totalisht. Këta njerëz edhe viktimat, edhe gjenocidin serb, edhe krimet e luftës e krimet kundër njerëzimit i kanë më të parëndësishme sesa gjetjen e mundësisë për ta rrëzuar Qeverinë dhe për të ardhur në pushtet. Dhe kjo realisht është vështirë edhe të klasifikohet çka i bie.

Kërkesa e LDK-së dhe e Vetëvendosjes për të mos votuar iniciimin e Komisionit që do t'i jep drejtim themelimit të Tribunalit për gjenocidin serb në Kosovë, edhe pse mund të tingëllojë e rëndë, po në këtë moment është marrje e anës të atyre që njëzet vjet e kanë mohuar këtë gjenocid. Çka mund të jetë tjetër kur për herë të parë në Kuvend të Kosovës vjen një iniciativë për të themeluar një tribunal që tenton t'i sjellë drejtësi mijëra e qindra mijëra viktimave, edhe ti dy parti politike opozitare i ke kundër.

Kjo u jep mundësi veç për të festuar mohuesit e krimeve të gjenocidit në Kosovë, sepse sot mesazhi politik që ua dha LDK-ja dhe Vetëvendosja është që Kuvendi i Kosovës nuk e voton një tribunal që përfundimisht do të kishte qëllim t'i jepte drejtësi dhe t'i japë përgjigje ligjore gjenocidit dhe krimeve që kanë ndodhur në Kosovë gjatë luftës.

Seriozisht mund t'i tingëllojë dikujt patetike, po unë personalisht nuk di qysh mund ta shohë veten në pasqyrë një deputet që sot do ta bllokojë dhe ta shuajë iniciativën për themelim të një tribunali për drejtësinë e viktimave të Kosovës që kanë pësuar nga lufta dhe nga gjenocidi serb.

E dëgjova dhe më vjen keq që ikën prej seancës, qysh kanë ikur edhe njëqind herë të tjera prej përgjegjësishë, qysh kanë ikur edhe njëqind të tjera preja atij mandati që u kanë dhënë qytetarët e Kosovës. Ikën se pata qejf të flas me ta pak, po veç erdhën, i lëshuan do fjalë dhe ikën. Se Avdullah Hoti tha kemi nevojë për koordinim. Për çfarë koordinimi o Avdullah Hoti? Të koordinohemi a ka ndodhur gjenocidi në Kosovë a s'ka ndodhur a? Mos ke ndonjë dyshim zotëri? Duhet të koordinohemi ne të vendosim a është gjenocid a s'është gjenocid? Çfarë koordinimi je duke lypur? Ndoshta na e jep përgjigjen në ndonjë konferencë për shtyp se e ke pasur zanat kështu njëfarë vakti, veç t'i thuash dy llafe edhe të shkosh mandej të përgjigjesh tjetërkah.

Unë nuk po mund të besoj që sot ne po ua japim këtë lloj mesazhi qindra e mijëra viktimave të gjenocidit serb që janë në çdo centimetër të këtij vendi. Po u japim mesazh që Kuvendi i Kosovës, deputetët që i kanë zgjedhur këta njerëz nuk janë në gjendje të pajtohen që në Kosovë ka pasur gjenocidin, edhe që duhet munduar me krejt fuqinë që e kemi të sjellim drejtësi për këta njerëz. Seriozisht qysh është e mundshme të vijmë ne në këtë derexhe. Ky Kuvend të vjen në këtë derexhe. Qysh është e mundur të thuash jam deputet i popullit të Kosovës, edhe të thuash jo s'ka nevojë për tribunal ndërkombëtar, jo s'mund të bëjmë tribunal ndërkombëtar. T'u thuhet që s'kemi për të votuar tribunalin për shkak të inatit politik që e kemi me njëri-tjetrin, kjo as tallje nuk është. Kjo duhet gjetur një fjalë të re në fjalorin shqip, në gjuhën shqipe për ta klasifikuar, për ta kualifikuar.

Çfarë arsyetimi është ai sot të thuhet valla jemi vonuar ne, e sot s'është e nevojshme ta bëjmë. Po, jemi vonuar, absolutisht jemi vonuar, krejt ne e dimë që jemi vonuar. Njëzet vjet jemi vonuar se kemi besuar në drejtësinë ndërkombëtare, para së gjithash në drejtësinë ndërkombëtare. Dhe kjo drejtësi ndërkombëtare nuk e ka dhënë efektin e vet, as afërisht nga ajo që duhet ndodhur. Dhe tash çka të themi? Valla njëzet vjet kaluan, hajt s'po e bëjmë hiç. Ky qe arsyetimi i Glauk Konjufcës. Shefi i Vetëvendosjes tha s'duhet bërë tribunalin, se s'e kemi bërë qe njëzet vjet. Më mirë mos ta bëjmë hiç pasi s'e kemi bërë deri sot. Çfarë arsyetimi është ky? Sikur të themi s'po e shpallim pavarësinë në 2008-ën, se jemi vonuar që s'e kemi shpallur në 2000-tën. Nëse s'është bërë deri sot, d.m.th. po e lëmë krejt. Me nis me na tregu këtu këshilla ligjore, kemi të drejtë s'kemi të drejtë. Më fal, a ka pasur të drejtë Ushtria Çlirimtare e Kosovës të themelohet ndonjëherë? Kë e keni pyetur ju kur e keni themeluar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës? Ligjin, a? Mos keni pasur ndonjë këshillë ligjore dhe jeni konsultuar me juristë për të luftuar për lirinë e popullit të juaj? A kjo është logjika a? Të konsultohesh me juristë me pa a kemi të drejtë të kërkojmë drejtësi për vete. Çfarë logjike ka kjo more? Sinqerisht mund t'ju tingëllojë emocional, po nuk jam duke e ndier veten mirë të jem deputet sot i një Kuvendi ku gati gjysma e deputetëve,

të opozitës të gjithë ata i ikin për shkak të verbërisë që ua ka dhënë etja për pushtet, ikin ta bllokojnë një seancë me arsyetime më banale të mundshme, që s'kisha besuar që mund t'i dëgjojë, edhe nuk votojnë ta themelojnë një iniciativë që mund ta prodhojë një tribunal që kërkon drejtësi për viktimat e gjenocidit serb në Kosovë.

Sinqerisht është vështir edhe të flasësh, edhe të thuash çkado, sepse kjo nuk ka asnjë logjikë. Po një send jam i bindur, edhe ju kisha lutur zoti Kryetar dhe ju kisha lutur juve kolegë deputetë që jeni këtu. Këtë iniciativë që po e kundërshton LDK-ja e Vetëvendosja, ne s'duhet ta ndalim. Mosbesimi që ata e kanë për drejtësi dhe për këtë tribunal është shumë më i vogël e shumë më i dobët se nevoja që ka ky vend dhe këta qytetarë për drejtësi. Është shumë më e vogël besoj edhe se vullneti politik që e kemi për ta themeluar këtë tribunal. Prandaj, le të jetë në nderin e tyre, po kushdo që del kundër kësaj kërkesë për drejtësi për viktimat, unë jam i bindur kanë për të përfunduar në anën e turpit. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Zoti Sejdiu, në emër të partisë, zoti Molliqaj në emër të Partisë Socialdemokrate.

**DARDAN MOLLIQAJ:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit!

Besoj që tema e cila ka qenë në seancën e kaluar, ndonëse është nisur me vonesë, ndonëse është nisur me protagonizëm, ka qenë temë që i tejkalon këto dy të parat. Si të tillë, ne si Parti Socialdemokrate edhe jemi sjellë konform kësaj. Por ajo çka ne si Parti Socialdemokrate nuk pajtohemi në asnjë mënyrë, është ta trajtojmë thujse asgjë nuk ka ndodhur në seancën e fundit. Mendojmë që është përgjegjësi institucionale, politike, besa edhe morale. Dhe insistimi i Kryetarit të Kuvendit, i koalicionit qeverisës, ose i PDK-së në këtë rast, se partitë e tjera nuk i dëgjojnë ende. Të vazhdosh thujse nuk ka ndodhur kurrëgjë, e dëmton pikërisht nismën për të cilën po flasim.

Këtu ka dy rrugë, o është përgjegjësia individuale e Flora Brovinës, për të cilën të gjithë ky Kuvend edhe krejt Kosova e di çka ka bërë dhe ka respekt, por njerëzit japin përgjegjësi edhe për gabime të cilat nuk janë as të qëllimshme dhe as nuk kanë motive përfituese. Ose është përgjegjësi e grupit parlamentar dhe Partisë Demokratike që s'e ka menaxhuar mirë deputeten. Se unë dëgjoja eksponentë të PDK-së që po thonë një fotografi e tillë është paraqitur publikisht edhe në vitin 2012 nga deputetja Flora Brovina. Aq më shumë pra është përgjegjësi e juaja. Dhe nëse ideja e juve është për t'i mbështetur për muri partitë e tjera se ja është qysh po themi ne, ose hiç, është gabim. Dhe a e di ku e keni dallimin ju me të tjerët? Ju po pretendoni që e vërteta përfundon me juve, ndërsa ata e kanë që e vërteta fillon me ata. Jeni dy anë e të njëjtës medalje, edhe duhet sa më shpejt ta kuptoni nëse doni ta sillni diku.



Memli, arsyeja pse ka ardhur situata kështu, është pikërisht edhe i Partisë Demokratike të Kosovës. Qysh po e duan këta pushtetin, ashtu ju e keni mbajtur pushtetin me çdo kusht. Memli kur të duash merri videot, edhe fjalimi i Glauk Konjufcës është fjalimi yt deri dje. Fjalimi yt është fjalimi i Glauk Konjufcës deri dje. Veç i keni ndërruar. Ai thoshte përpara mos e vetni bashkësinë ndërkombëtare, drejtësi ç'drejtësi, ju thoshit nuk bën se tash UNMIK-u, EULEX-i, ky tjetri, tash ti e ke ndërruar. A po e kuptoni që jeni e njëjta medalje me dy anë. Dhe nëse e ke përnjëmend, rrugën e ke plotësisht gabim. E s'po ta mohoj qëllimin, as motivin, po rrugën e ke si ti, si kryetari i Kuvendit krejtësisht gabim dhe nuk jeni duke kontribuar për ta votuar Kuvendi i Republikës së Kosovës. Nuk ka këtu veç ti i ke fajet e unë i kam krejt mirë. Aq më shumë për shkak se ju jeni në pushtet dhe keni qenë në pushtet për më shumë se dhjetë vjet. Mos u sillni që sot u qova, edhe më ra në mend, edhe sot e kam mirë. përgjegjësinë që e ke pasur keq dhjetë vjet duhet ta marrësh seriozisht, e për ta marrë seriozisht duhet besuar, e për të besuar duhet ta shoh që e ke përnjëmend. E unë s'po e shoh që e keni përnjëmend.

Në dy mënyra mësojnë njerëzit; nga përvojat e të tjerëve, që i bie nëpërmjet leximeve, filmave, historisë dhe e dyta nga përvoja personale. Ju të PDK-së jeni duke u mësuar nëpërmjet përvojës personale. Mirë është dhe kjo, po dëmet janë shumë të mëdha.

Prandaj, nuk ka kuptim kjo sesi jeni duke u sjellë dhe nuk ka kuptim çfarë jeni duke bërë. Në të njëjtën kohë, unë sot e pashë një lajm edhe u gëzova goxha shumë, që më në fund kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës e kishte kuptuar që të bëhet opozitë dhe të rrezohet kjo Qeveri, duhet të flitet me partitë opozitare.

Madje, ai nuk e kishte llogaritur edhe Alternativën për të cilën besoj se ajo duhet të thirret. Pra, ai kishte vendosur që t'i ftojë në takim liderët e dy partive të tjera opozitare, e që është mirë.

Por, nëse mendon që në njëren anë të thirren e në anën tjetër të veprohet njëanshëm pa e dëgjuar ende se çfarë ka për të thënë Partia Socialdemokrate, ai vetëm sa është duke ia bëtë gropën vetes.

Në vend se të gëzohet opozita, edhe të thotë se pa votat tona, për shkak se Lista Serbe po e dimë se ku e ka pozicionin, kjo Qeveri s'mund të bëjë asgjë, ata qohen e ikin.

Që një vjet ditë ikin, dhe që një vit ditë po ashtu kurrfarë rezultati s'kanë.

Unë e ftoj edhe LDK-në edhe Vetëvendosjen që të kthehen në seancë dhe t'i qesim kërkesat tona si opozita qysh ne e shohim, dhe ta kushtëzojmë ndryshimin e kërkesave që i ka paraqitur kryetari i Kuvendit të Kosovës për këtë çështje.

Ngase në parim po thonë se të gjithë pajtohemi, a po? E nëse pajtohemi të gjithë, pushteti s'ka qare pa na dëgjuar kur ne e kemi për interesa të përgjithshme. S'po them për interesa tona.

Kështu që, propozimet e mia janë dy: E para është që, ose PDK-ja vetë ose Flora Brovina vet, nuk e di si merren vesh, duhet të marrin përgjegjësi për këtë punë.

Më vjen keq, nuk kam pretendime se është bërë me qëllime të caktuara, po efekti dhe dëmi është konkret, dhe nuk mund të themi se ka bërë gabim dhe ditën e mirë. E dyta, është që Kuvendi i Kosovës duhet të distancohet nga këto qëndrime që janë bërë, ngase janë bërë në Kuvend. Dikush po thotë se, jo. Kuvend është i gjithi, nuk është veç salla plenare.

Ne të gjithë së bashku duhet të themi që e vërteta e Kosovës është kjo, dhe ka qenë pa përgjegjësi individuale të dikujt, ose një grupi parlamentare.

Tjetra është që LDK dhe Vetëvendosje, nuk guxojnë që për inati ose për interesa ta lëshojnë këtë seancë dhe të mos e votojnë që në Kosovë të ketë kërkesë për drejtësi. A unë jam i bindur që mund ta bëjmë tribunalin, po unë dhe PSD-ja jemi të bindur që Kosova duhet të ketë kërkesë për tribunal. Kjo është përgjegjësia jonë.

Ne duhet të angazhohemi që të bëhet tribunali, po nuk guxojmë të themi, për faktin që s'bëhet ne as nuk shprehim. Kuvendi, partitë politike janë për ta shprehur vullnetin politik. Mundësisht edhe ta materializojnë nëpër institucione, po s'guxojmë që të mos e shprehim.

Të gjitha ata që fshihen pas mungesës së rezultatit, ata po duan që ta shfrytëzojnë momentin që ta godasin dikë. Kështu që kërkesat e Partisë Socialdemokrate janë të qarta, kërkojmë përgjegjësi ose individuale ose grupe, sepse grupi juaj parlamentar duhet ta sqarojë me deputeten.

Kërkojmë që Kuvendi i Kosovës të marrë qëndrim për atë që ka ndodhur, dhe po ashtu kërkojmë që dy partitë tjera opozitare të kthehen në këtë seancë dhe t'i dakordojnë pikat, dhe përkundër interesave dhe inateve ta sjellim situatën në votim të kësaj çështjeje.

Ndërkaq, sa i përket rrëzimit të kësaj Qeverie, edhe këtu në Kuvend publikisht PSD-ja prapë ju fton. Nëse duan që ta rrëzojnë këtë Qeveri LDK dhe Vetëvendosje, ejani ta bëjmë strategjinë e brenda këtij viti rrëzohet.

Nëse nuk e kanë përnjëmend që ta rrëzojnë, po e kanë veç për të bërtitur dhe vajtuar, le të vazhdojnë se edhe një vit tjetër do të mbetet kjo Qeveri. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Memli Krasniqi, kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës e ka fjalën.

**MEMLI KRASNIQI:** Faleminderit!

Po replikoj me Dardanin, meqenëse m'u referua drejtpërdrejt disa herë.

Dardan, unë besoj që edhe ti edhe secili deputet edhe qytetarët e dinë që në këtë sistem politik, mandati i secilit deputet është i lirë, është i lirë, është personal.

Andaj, besoj që ti edhe kolegët tuaj e dini më së miri këtë punë, që veprimet politike nganjëherë pa e arsyetuar në asnjë minutë, përkundrazi veprimin e zonjës Flora Brovina, janë individuale dhe për këtë nuk mund të marrë qëndrim grupi parlamentar drejtpërdrejt, sepse sikur të ishte ashtu, do duhej që Grupi Parlamentar i Vendosjes të merrte vendim për mandatet tuaja, kur keni krijuar grup të ri, edhe pse s'krahsohet absolutisht me këtë, mos e keqkuptoni.

Unë nuk pajtohem me vlerësimin tuaj që i kemi ndërruar rolet. Unë mendoj që neve dikush mund të thotë se ka evoluar vlerësimi, por për një arsye të thjeshtë, nëse ne kemi pasur një qasje më konstruktive në kuptimin e besimit që e kemi pasur për shumë vite me radhë te drejtësia e EULEX-it edhe në fund që kjo nuk ka ndodhur.

Ja, ta zëmë, ju nuk i keni besuar EULEX-it. Ndoshta e ke pasur më mirë. Po flas për drejtësinë ndërkombëtare, tek pjesa e trajtimit të krimeve të luftës, fakti që ne sot e dimë që ata s'kanë bërë as afërisht sa duhet, e mos të flasim për drejtësinë ndërkombëtare, deri te Tribunali i Hagës.

Çfarë të themi tani ne? Të themi se s'po bëjmë asgjë prapë. Mund të ketë qenë vlerësimi ose besimi i tepruar, por sot nëse e dimë që diçka përfunduar dhe s'ka dhënë asnjë rezultat, mua ma merr mendja që është obligim edhe përgjegjësi e jona që t'i ndërmarrim veprimet për të cilat tashmë botërisht ekzistojnë edhe dokumentet.

Ndryshe, sot ka qenë në plan themelimi i atij komisioni i cili i jep rrugë tribunalit.

**KRYETARI:** Urdhëroni, zoti Molliqaj!

**DARDAN MOLLIQAJ:** Unë nuk kërkova asnjëherë që PDK-ja t'ia marrë mandatin dikujt, ngase e di që s'mundet.

Për mua është e rëndësishme, nëse PDK e cilëson që kjo është papërgjegjësi individuale dhe po ashtu të dihet se çfarë kërkon PDK-ja, se prapë jemi te kërkesat. Ne nuk mund ta detyrojmë që as Flora Brovinën e as Dardanin e as Memlin që të japë dorëheqje ose të rrijë në Kuvend, po, po ashtu ne marrim qëndrime politike dhe kërkesa politike, tërë kohën dhe secili.

Kështu që, mos u shmangni, ose merrni përgjegjësinë grupore...prisni, Memli, ose barteni atë dhe bëjeni kërkesën ngase atëherë e shohim që e keni përnjëmend.

Po dëshironi që ta tejkaloni këtë çështje.

Ja ku është dallimi Memli, këtu në Grupin Parlamentar të PSD-së, asnjëri prej nesh nuk i ka besuar drejtësisë ndërkombëtare në mënyrën sesi ka ardhur. Ju i keni besuar, në anën tjetër ka pasur që s'i kanë besuar. A e din se ku është dallimi sot?

Atëherë s'i kemi besuar drejtësisë ndërkombëtare, e sot...

**KRYETARI:** Regjia, ua lejon fjalën. Ju ka thënë në fillim të seancës. Deri sa s'ka polemika, ka parime ua lejon fjalën.

**DARDAN MOLLIQAJ:** Pra, dallimi Memli është këtu që Partia Socialdemokrate ose grupi, edhe sot, njëherë s'i ka besuar si të themi, drejtësisë ndërkombëtare, ndërsa sot është këtu që të votohet kërkesa për tribunal.

E për këtë unë po them që ju jeni dy anët e së njëjtës medalje. Vetëm i ndërroni rolet. Sa herë ta gjuash paranë lartë, ajo herë del në njërin dhe herë në anën tjetër. Këtu e ke problemin.

Prapë, kur po thua, çfarë të bëjmë sot. Jo se nuk po të shoh që e ke përnjëmend as sot. Po e shoh që prapë për shkak të përvojës personale je duke mbërrirë këtu. Nëse e ke përnjëmend, nevojitet një reflektim më thellë.

Po i bie që dikush tjetër s'e ka pasur përnjëmend as atëherë.

Nëse po dëshironi që ta bëni përnjëmend kërkesën e Kosovës, nuk është kjo qasje veç duke u sharë. Nuk jeni ju në pozitë që t'i shani të tjerët. Për këtë po them, nuk përfundon e vërteta me juve, sikurse nuk nisë e vërteta me dikë tjetër.

Kur e bën dikush një gabim, pa qëllime të këqija ndjehet pak keq dhe e ulë pak kokën, dhe kur bën kërkesë ndaj tjerëve ju thotë, mirë e keni pasur.

Ju po dëshironi të thoni, mirë e kemi pasur atëherë, dhe mirë e kemi sot. Jo. Sepse kështu keni qeverisur gabim. Edhe kështu sot, jeni duke ia pamundësuar Kosovës që ta votojë tribunalin.

Prandaj, kërkesat tona janë të qarta dhe po i përsërisë prapë; o përgjegjësi kolektive e PDK-së, ose distancim i PDK-së ndaj deputetes dhe kërkesë për dorëheqje. Qëndrim institucional i institucioneve të Kosovës për atë që ka ndodhur, dhe kthim i opozitës në Kuvend për këtë çështje dhe votimin, sepse Kuvendi i Kosovës duhet të nxjerr kërkesë për drejtësi në Kosovë ndaj viktimave. Faleminderit!

**KRYETARI:** Urdhëroni, zoti Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Pavarësisht që po duket që po flasim për gjëra të ndryshme, nëse duam që t'i analizojmë, në goxha do pika përputhemi Dardan. Problemi është që ne e kemi nisur krejt që ta dëgjojmë njëri-tjetrin, po të mos marrim vesh.

Ju po kërkoni qëndrim politik të PDK-së, e ai qëndrim është dhënë të enjten, menjëherë.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës është Kadri Veseli, i cili ka mbajtur konferencë për shtyp për atë punë. Ai e ka dhënë në mënyrën më të qartë qëndrimin që as s'kemi dituar asgjë për atë veprim dhe as nuk e mbështesim, përkundrazi e kundërshtojmë.

Ndryshe, nëse duhet që të bëhet kështu reduktues në qasje, veprimi i zonjës Brovina më shumë sesa PDK-në s'e ka dëmtuar askënd në kuptimin politik. A e ka dëmtuar kauzën për drejtësi? Edhe atë e dimë. Pa qëllim. Pa dyshim pa qëllim, por dëmin ne e dimë. E dini edhe ju, e di secili.

Pra, qëndrim PDK-ja ka dhënë për këtë punë. A duhet që çdo ditë të dalë kryetari ose nënkryetari ose si shef grupit ose dikush tjetër të t'i përsërisë. Ai qëndrim është valid. E a thënë i pari i PDK-së.

Pajtohem, historia as nuk fillon e as nuk përfundon me neve. Me asnjërin prej nesh këtu. Edhe kushdo që mendon se historia përfundon me ta ose fillon me ta. E ka gabim, edhe është i destinuar për dështim herë-kurdo.

Thatë, nuk i pranoni gabimet. Unë veç sa fola pak më herët, thash ndoshta e kemi pasur gabim vlerësimin tonë. E thashë. Absolutisht është e mjaftueshme që të mund të ndërrohet një qasje në një moment.

Nëse ju prisni që një proces do të sjellë një rezultat edhe nuk ta sjellë atë rezultat, atëherë mund të vlerësosh që ke qenë gabim në vlerësimin tënd. Por, kjo nuk do të thotë që duhet të mbesësh peng tërë jetën pastaj i asaj. Mund të ndryshosh, në kuptimin e qasjes.

Dhe, sot cila është qasja? Kërkesa që të themelohet një komision gjithinstitucional me një përfaqësim më të gjërin e mundshëm që mundet, e kemi të gjithë dokumentacionin, dhe t'u jepet kohë që ata të vijnë me propozimet se si të themelohet tribunali, dhe ja po pajtohem.

Duke e menduar, ta zëmë fundin, qysh tha ta zëmë Glauku, jo s'mund ta bëjmë tribunali, domethënë të dorëzohemi në start në këtë punë, ta zëmë që është e vërtetë, unë besoj që mund të ekzistojë një mundësi dhe besoj që do të ekzistojë mundësia në një të ardhme jo shumë të largët. Por, tani as mos të bëjmë kërkesë? Kështu që këtu po pajtohem.

Ne mund ta themelojmë një komision, i cili në emër të institucioneve të Republikës së Kosovës do të kërkojë themelimin e një Tribunali ndërkombëtar, dhe duhet ta bëjmë atë punë. Jemi vonë?! Po, jemi vonë 20 vjet, por kemi besuar që 20 vite se EULEX-i, Tribunali i Hagës, ky ose ai do ta kryejnë këtë punë. S'e kanë kryer. Tash, çfarë të bëjmë?

Me logjikën e LDK-së dhe të Vetëvendosjes duhet ta lëmë këtë punë.

Unë nuk besoj që duhet ta lëmë këtë punë, përkundrazi, unë mendoj që ne duhet ta qojmë përpara.

Qëllimi është i mirë. A po? Qëllimi është i drejtë. Është obligim. Atëherë, ta shtyjmë përpara. Si të mendohet fundi, jo valla nuk bëhet edhe ta lëmë këtë punë. Andaj, është krejtësisht normale që të kërkohej që të ketë mbështetje ky proces.

Unë kurrë s'do të besoja që edhe kjo kërkesë për tribunal bëhet, si të themi, element në lojën e politikës ditore. Singërisht s'do të besoja. Mund të më thoni naiv, por s'do të besoja.

S'do të besoja që LDK-ja, Vetëvendosja edhe kërkesën për drejtësi të viktimave të gjenocidit serb në Kosovë, do ta bëjnë një letër që digjet lehtë në luftën ditore politike.

Urdhëroni bre, rrëzojeni Qeverinë, njëqind herë ju kemi thënë. Nëse jeni të zotët ejani. Keni mjaft vota që të inicioni mocionin. Që një vit flisni për mocion dhe nuk guxonit të vendosni nënshkrime. Po s'është rendi që guxonit ju të bëni diçka në këtë drejtim, as LDK dhe as Vetëvendosje.

Po ejani nëse e keni ndërmend, niseni më. Provojeni. Mirëpo, jo ta bëni pjesë të kësaj lufte Tribunalin për gjenocidin serb në Kosovë. Kjo për mua është e pakuptimtë dhe paarsyeshme. Edhe e turpshme, e thashë.

**KRYETARI:** Faleminderit! Dardan, a e dëshiron fjalën? Faleminderit! Po, fjalën e ka Ahmet Isufi, kryetar i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

**AHMET ISUFI:** Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Për neve është e pakuptueshme se si u lëshua seanca nga dy partitë opozitare, sepse nuk dihej a e lëshuan seancën pse nuk vazhdoi debati i lënë përgjysmë nga mbledhja e kaluar, apo pse u mbajt për një fjalë e s'u pajtuan me të, a s'kanë besim që mund të bëhet tribunali, i cili është iniciuar në këtë Parlament. Është dashur bile së paku ta dimë çka është qëllimi i tyre për ta kuptuar pse u lëshua seanca.

Megjithatë, unë po kthehem te tribunali dhe mund të them pse ekzistojnë këto hezitime, ku ne kemi raste kur shtete të caktuara kanë iniciuar çështje të cilat kanë pasur të bëjnë me drejtësinë dhe në rastin e atij iniciimi, sepse dikush është dashur ta iniciojë, kanë ndodhur edhe tribunale ndërkombëtare.

Kemi madje edhe individ që kanë ngritur çështje të caktuara dyshimeve dhe kanë krijuar gjykatë, duke u bazuar në të dhënat që i kanë ofruar.

E kemi edhe rastin e Gjykatës Speciale që Dik Marti e ka iniciuar, e pastaj e dini në çfarë nivelesh ka kaluar në raporte ndërkombëtare, deri edhe në imponim të krijimit të kësaj gjykate edhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Domethënë, duhet shikohen modelet, të cilat u kanë shërbyer edhe të tjerëve për të krijuar një gjykatë të tillë dhe jo apriori të mohohet ose të hezitohet për krijimin e një gjykate të tillë.

Ne e konsiderojmë që duhet ta vazhdojmë punën si Parlament me pika të përcaktuara që i kemi, me formimin e Komisionit shtetëror, i cili pikërisht do të gjejë rrugën për formimin e një Tribunali ndërkombëtar, e që unë shumë besoj që po të jemi seriozë në këtë punë, me gjithë mekanizmat në Kosovë që ekzistojnë, por edhe ata ndërkombëtarë mund ta iniciojmë, sepse një e dhënë faktike që ekziston para gjithë botës është se gjenocidi ka ndodhur në Kosovë, krime monstruoze kanë ndodhur në Kosovë, janë faktuar jo vetëm nga ne, por edhe nga shumë organizata të ndryshme ndërkombëtare që e kanë përcjellë edhe gjendjen e luftës në Kosovë. Është keq të mos tentosh edhe më tutje, edhe pas 20 vjetëve të krijosh një gjykatë, e cila do të dënonte krimin, gjenocidin në Kosovë dhe kriminelët do t'i sillte para drejtësisë, sepse krimi nuk vjetrohët, në gjithë botën është një veprim i cili ndodh. Prandaj, unë nuk e di pse ka hezitim në këtë drejtim. Vetëm duhet të gjendet mënyra, të shihen modelet që janë përdorur deri më tani dhe të krijohet një gjykatë, e cila do t'i sillte kriminelët para drejtësisë.

Dhe, një gjë nuk duhet ta harrojmë. Kurrë pa e nisur dikush një punë, nuk ka mundur të përfundohet me sukses. Prandaj, është nisur në këtë Parlament, e ka përkrahjen e institucioneve të Kosovës, ka pasur edhe një takim me të gjitha instancat e drejtësisë, madje edhe me shoqatat, të cilat deri tani janë marrë me të pagjeturit, me shumë mekanizma, të cilët mund të ndihmojnë në këtë drejtim.

Dhe, kryetar, duhet të vazhdohet puna, e keni përkrahjen e plotë të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e keni përkrahjen e Qeverisë dhe të kryeministrit Haradinaj dhe duhet të vazhdohet, sepse po flasim për diçka që ka ndodhur në Kosovë, e turp është për neve nëse ndalemi dhe nuk e kryejmë këtë punë ashtu siç e meriton edhe drejtësia, por ashtu siç e meriton edhe populli i Kosovës që ka vuajtur e po vuan edhe më tutje nga pasojat e luftës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Bilall Sherifi, në emër të Grupit Parlamentar Nisma Socialdemokrate.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Përshëndetje po ashtu për familjarët, sërish sot janë këtu, ju përshëndes përzemërsisht.

Po filloj aty ku e lamë, arsyeja e të enjtes, për çka u ndërpre seanca me publikimin e asaj fotografia nga deputetja Flora Brovina.

Nuk besoj që dikush këtu në sallë dhe jashtë e ka mbështetur një veprim të tillë të deputetes. Kemi dëgjuar nga të gjithë deputetët, pa marrë parasysh nga vijnë, nga mazhoranca apo nga opozita, kemi dëgjuar familjarë të viktimave, kemi dëgjuar madje edhe viktima vetë duke e ngritur zërin kundër kësaj mënyre të panevojshme për të dokumentuar krimin e gjenocidit, sidomos dhunimet në Kosovë. Por nuk dëgjova këtu atë që desha ta dëgjoj nga deputetët, ta lavdërojmë dhe ta ngremë ndoshta edhe në qiell këtë mënyrë të reagimit të shoqërisë sonë, pse jo.

Jemi një shoqëri e pjekur, përmes këtij reagimi, përmes këtyre formave të refuzimit të kësaj mënyre për të dëshmuar krimin e gjenocidin në Kosovë kemi dëshmuar se jemi një shoqëri që nuk e duam gënjeshtren, që edhe nëse na përfilllet, na del në sipërfaqe, ne e refuzojmë atë.

Përkundër asaj që Serbia si shtet shërbehet vetëm me gënjeshtër, me manipulime për të mbuluar të vërtetën e krimit të gjenocidit në Kosovë. Kjo neve na bënë, duhet së paku të na bëjë krenarë si shoqëri, jo tani të fillojmë të akuzojmë veten se e paskemi dëmtuar në ato përmasa sa që qenka e pamundur tani të kërkohet drejtësi, kjo është gabim.

Unë dhe gjithë ju e dimë që ka qenë një gabim që e ka dëmtuar, por jo në ato përmasa sa që tani më të ndalemi dhe të mos e kërkojmë fare drejtësinë, është gabim, përkundrazi.

Kjo duhet të jetë një arsye shtesë që edhe më me ngulm të kërkojmë drejtësi sa i përket ndëshkimit të krimeve të gjenocidit të ushtruar nga shteti i Serbisë në Kosovë.

Kaq sa i përket asaj dhe natyrisht që dikush duhet të marrë përgjegjësi, unë jam shumë i vetëdijshëm që përgjegjësia është politike dhe morale, nuk ka tjetër përgjegjësi, siç u tha këtu në seancë.

Po tash të dalim te tema kryesore, për çka edhe është thirrur kjo seancë.

Nëse Serbia thotë nuk kam bërë krime në Kosovë, ne themi është bërë vonë, atëherë i bie që duhet ta lëmë krejt këtë punë.



Unë mendoj që, siç u tha edhe nga shumë kolegë, jo vetëm që është nuk është bërë vonë, po duke pasur parasysh përmasat e krimit, unë mendoj që tani nëse ndalemi mund të bëhet vonë. Tani nëse dekurajohemi nga veprimet, të cilat u kritikuan, mund të bëhet vonë.

Unë do të përpiqem të elaboroj sipas këndvështrimit tim qëndrimin e Nismës rreth tribunalit.

Nuk e di a do të mund t'ia imponojmë botës krijimin e tribunalit, nuk e di. Sepse të gjithë e dimë që janë edhe forcat e tjera, të cilat kanë fjalë rreth atij tribunali. Po një gjë e di që nëse ne e miratojmë ligjin, Kodin e procedurës penale, pra e kalojmë këtë iniciativë, me përmirësimet, me shtesat e nevojshme, me heqjet e tepricave që mund të ketë aty, në bashkëpunim me grupet parlamentare, nëse ne këtë iniciativë e miratojmë, e kalojmë edhe ligjin, Kodin Penal, ku na mundëson dënimin në mungesë të dyshuarve për krimin e gjenocidit në Kosovë.

Atëherë të jeni të sigurt që me aktgjykimet e shkallës së prerë kurdo që ato të vijnë, të gjitha gjykatat e botës mund të shndërrohen në tribunal për të kërkuar drejtësi në Kosovë.

Nëse ata nuk do të pranojnë të ndërtojnë një tribunal, të gjitha gjykatat do të mund të shndërrohen në tribunal. Si mund të ndodhë kjo, si mund të bëhet kjo?

Cilido kriminel që dënohet nga një gjykatë i një vendi në botë, do të jetë i kërkuar për t'u arrestuar në të gjitha vendet, kudo që ai lëviz, përpos në Serbi. Ajo faza në Serbi pastaj mund të vijë më vonë dhe secili shtet që e kap një kriminel, që e arreston një kriminel, i cili është i gjykuar për krime të luftës në Kosovë, do të jetë i detyruar ose ta ekstradojnë në Kosovë, ose t'ia bëjë gjyqin nga gjykatat e veta.

Janë një nga efektet që mund të krijojë ligji që pres shumë shpejt në Kuvend ta miratojmë dhe kriminelët mund të flenë qetë nëse kanë një aktgjykim nga një gjykatë në Kosovë për krim të kryer gjatë luftës, qoftë për dhunime, qoftë për krime kundër gjenocidit.

Pra, 100 e kusur vende, mbi 100 shtete të botës, të gjitha gjykatat e tyre ose do t'i gjykojnë ose do të detyrohem të ekstradojmë, po nuk mund aq thjesht t'i lirojnë të shkojnë të qetë në shtëpitë e tyre.

Kjo sa i përket këndvështrimit të Nismës se pse është i domosdoshëm insistimi që të kërkohet drejtësi për krimin e gjenocidit të Serbisë.

Mirëpo, kjo nuk është e tëra që ne e kemi për detyrë të bëjë, sepse shpeshherë e dëgjoj një këndvështrim që mendoj që nuk është i mjaftueshëm. Të dënojmë kriminelët që i kanë zbatuar urdhra, që i kanë kryer krimet është njëra anë. Të kërkohet drejtësi, të përgatitet shteti për të akuzuar Serbinë për planifikimin, hartimin dhe zbatimin e gjenocidit në Kosovë, këto janë dy

çështje të ndryshme. Madje, për këtë dytën nuk ka, jo vetëm që nuk është vonë, po jemi në kohë, sepse asnjë shtet nuk mund të përgatitet që brenda një periudhe aq të shkurtër të përgatitet padinë për gjenocid. Madje, jo vetëm përgatitja, të jemi të qartë, padia e një shteti për gjenocid kërkon edhe analizën e gjeopolitikës botërore.

Pra, duhet të ketë parasysh edhe gjendjen politike, gjendjen në të cilën ndodhet bota, a ke aleatë të cilët ta mbështesin një gjë të tillë apo nuk ke aleatë. Ne të gjithë e dimë që Kroacia e ka humbur pikërisht për faktin se kohën e ka pasur të gabuar, momentin e ka pasur të gabuar, jo të qëlluar, për ta ngritur padinë. Le t'i ndajmë fazën e përgatitjes për të provuar gjenocidin dhe fazën e ngritjes së padisë shtetit të Serbisë dhe të akuzave për ata që kanë kryer krimet, duke filluar nga komandantët e policive, të komunave, nga kryetarët e komunave, për nga përgjegjësia politike, e kështu me radhë. Shiheni, për shembull, absurdin që ndodh.

Përderisa shkojnë edhe terrorizojnë që nga UNMIK-u, EULEX-i, Gjykata Speciale një Kosovë të tërë për të kërkuar, për të marrë në pyetje dëshmitarët, për të gjetur se kush paska qenë përgjegjës për një shtëpi atje në një mal diku, ku ka qenë në kontroll të UÇK-së, për t'ia ngarkuar përgjegjësinë komanduese, i kanë me emër, me mbiemër përgjegjësinë komanduese të gjithë komandantëve të Stacionit të Policisë në Prishtinë. Le ta ngrenë aktakuzën, pse s'e ka ngritur EULEX-i për nga përgjegjësia komanduese aktakuzën për komandantin e Policisë së Prishtinës për të gjitha ato dëbime, për të gjitha ato vrasje, për të gjitha ato masakra që ka ndodhur nën juridiksionin e tij, në territorin ku ai e ka pasur komandën. Por kërkonin policin i cili i ka vëra dhe thoshin polici është fshehur në Serbi dhe nuk mund ta gjejmë, për me ngritë aktakuzën.

Pra, edhe nga çka do të bëjmë, a i kemi mbi 300 masakra, ky vend e ka për detyrë shpejt 300 aktakuza t'i përgatitë edhe 300 aktgjykime t'i mbajë e t'i dënojë të gjithë ata kriminelë që kanë hartuar dhe kryer këto krime, nuk është mungesë, nuk ka mungesë provash këtu. A është masakra këtu, a flasin varret aty, a janë dëshmitarët aty, a janë eshtrat e tyre, a janë rrobat e tyre të gjetura. Krejt çka duhet është të merren emrat e atyre që kanë udhëheq këtë, të ngrihen aktakuza dhe nëse duan të vijnë të mbrohen, le të vijnë të mbrohen, nëse nuk duan, gjykata ka për detyrë të shpallë aktgjykim dhe pastaj, nëse ata nuk duan një tribunal të vetëm, le të bëhen të gjitha gjykatat e botës tribunale që do të ndjekin krimet e Serbisë të kryera në Kosovë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Albert Kinolli, urdhëro!

**ALBERT KINOLLI:** Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Ministër,

Kolegë deputetë,

Familjarë të nderuar,

I nderuar kryetar,

Ne si Grup Parlamentar +6 edhe në seancën e kaluar e kemi dhënë qëndrimin tonë sa i përket këtij procesi. Ne mendojmë se nevojitet prapë edhe një herë ta përsërisim, pasi u gjendëm në një situatë të tillë.

Sa i përket këtij procesi të gjithë jemi të vetëdijshëm se nuk ka shqiptar edhe nuk ka kosovar, i cili nuk i është gëzuar një iniciative të tillë për themelimin e një tribunali, e cila do ta binte drejtësinë në vend dhe kryesit e veprave kriminale do t'i dënonte edhe ata do të marrin dënimin e merituar.

Ne si Grup parlamentar 6+ sinqerisht në këtë pamje dhe me këto që sot e përjetojmë jemi të shqetësuar dhe bashkëndejmë edhe me familjet e viktimave, të cilët janë sot të pranishëm sot këtu tek ne dhe gjithë qytetarëve të Kosovës, të cilët sot sytë i kanë të drejtuar kah Kuvendi i Republikës së Kosovës, i cili sot është pritur të marrë një vendim jashtëzakonisht të rëndësishëm, së paku ata që kanë bashkëndjerë dhe janë frymëzuar dhe frymëzohen nga shqiptarët dhe kanë bashkëndjerë me të gjitha dhimbjet, të cilët i kanë pasur këta familjarë dhe këto familje.

Andaj, edhe një herë dëshiroj të konfirmoj se Kuvendi e ka përkrahjen e plotë të Grupit Parlamentar 6+, sikurse edhe deri më tani dhe në këtë rrugëtim do të ecim së bashku, pa marrë parasysh se çka do të na dalë përpara në këtë rrugë, çfarëdo sfide, sikurse i kemi përballuar deri më tash së bashku, do t'i përballojmë edhe më tutje dhe këtij procesi do t'i shkojmë deri në fund së bashku.

Edhe një herë po e përsëris qëndrimin e Grupit Parlamentar 6+, përkrahja jonë nuk do të mungojë, ne jemi përkrah jush edhe në këtë proces. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Grupet parlamentare përfunduan, e thirra Milaimin, po e bëj një shkëputje, pastaj vazhdojmë me diskutues të grupeve parlamentare.

**MILAIM ZEKA:** Faleminderit, kryetar!

Po e filloj me peshoren politike, jo patriotike, sepse ne jemi politika, jemi deputetë. Sa është dëmi që ka shkaktuar fotografia e publikuar nga ana e Flora Brovinës dhe sa është dëmi i shkaktuar në opinion nga ana e shefit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zotit Avdullah Hoti, i cili edhe pse dalin video incizimet në Mitrovicë se janë duke u rrahur me grushte e me boksa, ky ka fytyrë të dalë e të thotë unë nuk kam qenë fare prezent në Kuvendin e Lidhjes Demokratike në Mitrovicë. Se ju tanë po grini kështu sallata, a po kupton, po i bini rrotull, andej-këndej. Po tash më vjen keq që Avdullahu nuk është këtu të ballafaqohem unë me të. Do të thotë, kur një njeri, profesor universitar, ish-ministër, shef i grupit parlamentar del e rrenë qëllimshëm, imagjinoni vuajtjet e Flora Brovinës, torturat nëpër burgje, humbja e memories, dridhja kur fol për gjëra të cilat ajo vetë i ka përjetuar dhe që është marrë me të gjitha këto poshtërsi dhe fyerje që na i ka bërë regjimi shqiptaro-serb.

Prandaj, po them që dëmi politik është i barabartë kur njeri rren publikisht, kur janë incizimet, kur del edhe kryetari i Degës së Lidhjes Demokratike në Mitrovicë edhe thotë po, ka qenë Avdullah Hoti prezent. Hajde tash besoni ju çka del ai edhe flet këtu në foltore.

Të paktën njeriu kur rrenë ose bën një gabim, duhet pasur kurajën të dalë këtu dhe të kërkojë falje.

Unë të vetmin gabim, zoti kryetar, të vetmin gabim që e shoh të partisë që ju e përfaqësoni dhe tëndin si kryetar është që ju është dashur të kërkonit falje dhe të mos e bëni asnjë koment. Nuk ka këtu kurrfarë dritare të komenteve, kërkim falje opinionit të brendshëm dhe të jashtëm, kërkujmë falje për veprimin e Flora Brovinës, por më falni, disa deputetë këtu, edhe 200 vjet jetë t'i kenë, 200 vjet, nuk mund t'i afrohen te thembra Flora Brovinës.

Flora Brovina nuk është personalitet i brendshëm 11 mijë kilometra. Flora Brovina është personalitet botëror, edhe ato shoqata që janë çuar me këmbë të para e të mbrëma ta fyejnë Flora Brovinën, e dimë ne se çfarë keqpërdorimesh bëjnë të fondeve që i marrin nga bota perëndimore duke u thirrur në viktimat e dhunës të luftës. Janë pikërisht këto organizata që i janë gjuajtur në shpinë Flora Brovinës, që e ka nxjerrë atë shifrën 20 mijë të përdhunuar të luftës, Pse? Më thoni ju pse? Veç të marrin sa më shumë fonde nga bashkësia ndërkombëtare. Mund të jenë 21 mijë, mund të jenë 15 mijë, mund të jenë 2 mijë, po këta ia kanë futur një shifër atje, e tash këto kanë fytyrë, moral e kurajë të dalin edhe t'i gjuhen në shpinë një njeriu, të cilën unë e konsideroj si nënën time, një njeriu të cilën unë e kam shoqëruar edhe në vizita të saj në vende të ndryshme të botës, ku bota perëndimore deri në Shtetet e Bashkuara të Amerikës flet me shumë respekt të lartë për Flora Brovinën.

Kjo ishte e para, kryetar, mos m'i hani minutat, se do të fjalosem edhe me ty sot pak.

E tash, të kalojmë te kryetari, më the Milaim, dëgjo me vëmendje. Unë, kryetar, e kam trurin e digjitalizuar dhe jo kur flet ti në Kuvend, po edhe deklaratat kur i jep t'i përcjell, për dallim prej teje që po udhëton pak shumë, herë shkon në Venecia, herë andej, herë këndeje e nuk më dëgjon çka flas, por po të them diçka.

Unë jam shumë krenar deri te Zoti për të kaluarën tënde dhe të gjithë djemve dhe vajzave që kanë qenë të rreshtuar në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, pa asnjë dilemë, pa asnjë dilemë. Por, zoti kryetar, sot kur fole për përjetimet e tua dhe për ato pritrat që ua kanë bërë disa shqiptarë. Unë në foltoren e këtij Kuvendi, po edhe kur kemi folur privatisht, po edhe në studio televizive me mijëra herë e kam thënë që kanë qenë pikërisht shqiptarët ata të cilët na kanë rrahur, na kanë torturuar, na kanë fyer e na kanë poshtëruar prej kohës së Rankoviqit e deri sot.

Zoti kryetar,

Janë shqiptarët, po t'i them me emra e mbiemra, janë shqiptarët, duke filluar prej Xhafer Qorrit...

KRYETARI: Milaim, të lutem, me emra nuk është mirë për ty.

MILAIM ZEKA: E pse me emra, jo valla, fort mirë është për mua, hiç mos u mërzit.

KRYETARI: Milaim, t'u kisha lutur, për shkak teje dhe neve.

MILAIM ZEKA: Po të kishe folur ti me emra, e të mos ua kishe dhënë shtagën disa budallenjve këtu, nuk t'u kishin gjuajtur ty në shpinë.

KRYETARI: Jo, jo, të lutem...!

MILAIM ZEKA: Jo, s'ka jo, jo. Kur do njeriu mejdan, hajde bëjmë mejdan, si të donë, dalim e u tregojmë edhe kush e ka pasur pseudonimin Bego në UDB, edhe kush e ka pasur Zhuti, edhe kush e ka pasur Mango, e tash çohet në këmbë të mbrëma e në këmbë të para e na shet patriotizëm, ti vetë i ke lazduar, kryetar, se kur u çua ai Isa Mustafa, e krejt fushatën e ka bërë duke thënë se më ka vlarë SHIK-u, së fundi keni bërë koalicion me LDK-në dhe e keni bërë çervish Qeverinë.

Unë me një njeri, i cili mua më akuzon për vrasje, ma prek familjen dhe më prek në çështje kombëtare, po të m'i sjellë në thes eshtrat e nënës Hajrie që e kam të zhdukur, me të nuk bëj koalicion, po edhe Serbia të kthehet mbrapa, unë me ta nuk bëj koalicion.

Kryetar, duhet mbajtur parimet, jo të sjellim gjendjen si sot, të tallen njerëzit me gjenocidin, të tallen njerëzit me një iniciativë, pavarësisht besojmë a nuk besojmë.

Unë personalisht nuk besoj që do të arrijmë të bëjmë një Tribunal ndërkombëtar, po iniciativën e përshëndes, iniciativën e votoj dhe ne përmes kësaj iniciative mund ta sensibilizojmë çështjen tonë që është e mykur, që është e mbuluar me hi.

Zoti kryetar,

Unë të bëj thirrje edhe një herë. Meqenëse kohët e fundit po merr iniciativa. Ka qenë një prift në Afrikën Jugore, me emrin Desmon Tutu, atë e kanë bërë si kryetar të një komisioni për pajtim brenda për brenda Afrikës Jugore. Një njeri i cili nuk ka dashur të bëjë luftë civile mes afrikanëve të bardhë edhe të zi. Zoti kryetar, ne e kemi pasur një lëkurë, të gjithë kemi qenë të bardhë, por duhet ditur kush ka qenë faqezi në këtë vend. Duhet ditur, zoti kryetar, kënd e ke në gjykatë prokuror e gjykatës të Speciales, duhet ditur kush ta ka bërë bërlllok mbi bërlllok Ministrinë e Drejtësisë, duke filluar prej Nekibe Kelmendit që i ka futur ata që na i kanë hequr

edhe thonjtë në burg, ata që na e kanë djegur edhe me cigare dritën e syrit, ata që na kanë marrë e na kanë çuar edhe te Përroi i Keq të na pushkatojnë prej qelive tona numër 19, këtu keni të burgosur se çfarë torturash na kanë bërë, edhe u kënaqshin, lezetin më të madh e kanë pasur kur na e shanin Republikën e Kosovës, kur na e shanin Shqipërinë, kur na e shanin djepin që na kanë përkundur nënat tona. E, sot ata i ke nëpër institucione, sot i ke njerëzit në polici të shtetit, krerë shumë të lartë që kanë punuar deri në bombardime. Sot, e ke, për shembull, e ke pasur deri pardje Reshat Millakun kryeprokuror që e ka dënuar motrën e jaranit tënd që e ke kryetar në Ferizaj. E, unë kam folur, e ti je paraqitur më i edukuar se unë, kryetar, po nuk je, as nuk je më i civilizuar se unë, bile te civilizimi edhe më hiç. Mos u bë modest me faqezinj, mos u bë modest me ata që, mbaje mirë në mend këtë këshillë që po ta jap, ndoshta kurrë s'jam më deputet, kryetar, mbaje në mend një këshillë: këta faqezinj kanë urrejtje patologjike ndaj teje, e ndaj meje, e ndaj të gjithë neve.

Edhe toka po u bë bashkë me qiell, këta kurrë nuk na falin që ua kemi vvarë nënën Jugosllavi, e motrën Serbi, kurrë, kurrë. Këta edhe ëndrrat i shohin serbisht, kryetar, e ti do të bëhesh jaran me ta? Ti do të thuash: “Hajt se për hir të kaluarës ka qenë, s’ka qenë, ne do të vazhdojmë”, me kënd do të vazhdosh? Me ata që na i kanë lënë nënat tona duke vajtuar për neve, e na kanë përzërë në ekzil kah 20 vjet deri jemi kthyer në luftë, me ata që na kanë spiunuar 24 orë, me ata që na i kanë dhunua nëpër dhomat e hetuesisë gratë tona, motrat tona, me ata ne do të bëjmë koalicion e do të paraqitemi të civilizuar, jo, kryetar. Prandaj, të lutem edhe një herë, kur u thua nganjëherë ‘kam me ju ngi në SHIK’, mos guxofsh ti ‘me i ngi, thirrëm një ditë, kallëzomë, unë i ngij qitu, dal në foltore’, sepse as nuk ua kam frikën. Një ëndërr ma kanë realizuar dëshmorët e kombit, edhe ata martirët e vvarë, kryetar, e kam pasur veç një ëndërr, të shkel 2 minuta në Prishtinë i gjallë. A m’u ka realizuar kjo ëndërr, unë e shoh veten të vdekur vetëm që flas me zë, po edhe kufoma ime do të jetë frikësuese për krejt UDB-asht, për krejt spiunët, për krejt faqezinjtë që ia kanë nxirë jetën kombit shqiptar rrafsh 50 vjet. Këta, kryetar, na kanë burgosur pse ne e kemi dëgjuar Radio Tiranën, këta, kryetar, neve na kanë burgosur pse e kemi lexuar librin e Shote Galicës, këta, kryetar, na kanë burgosur pse kemi kënduar një këngë patriotike, e sot ne duam të bëjmë koalicion me ta, kurrë përjetë, kurrë absolutisht. Faleminderit, por unë iniciativën si deputet i Republikës së Kosovës e përkrah, edhe iniciativën për ndërtimin e Muzeut e kam një këshillë edhe këtu, ulu bisedo me studentët, më është dukur brilante ideja e tyre që Muze i gjenocidit të bëhet kisha serbe në oborin e Universitetit të Prishtinës. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Daut Haradinaj, urdhëro!

**DAUT HARADINAJ:** Thënë të drejtën, kryetar, nuk e pata ndërmend të flas, por më stimuloi pak Milaimi. Gati 90% pajtohem me të krejt çka tha, veç për një gjë nuk kisha pasur qejf të pajtohem, sepse ne e dimë shumë mirë që në luftën e fundit viktimat kanë qenë shqiptarët dhe viktimat ka adresë, krimi ka adresë, regjimi, dihet botërisht që regjimi serb me të gjithë artilerinë, me të gjitha mjetet s’ka kursyer asnjë gjë çka do që ka qenë e shqiptarëve.

Pjesë ndoshta të atij regjimi ka mundur të jetë edhe ndonjë individ i caktuar te krimi, ne mund t'i sjellim edhe ata para drejtësisë. Po flasin disa kolegë është vonë, është herët, ne nuk mund t'i ikim faktit që deri në shpalljen e pavarësisë UNMIK-u të gjitha kompetencat ekskluzivisht për krime lufte i ka pasur në dorë, edhe me ardhjen e ISO-s dhe EULEX-it, po ashtu domethënë misioni EULEX e ka pasur ekskluzivisht përgjegjësitë e ndara, kompetencën për krimet e luftës dhe ne jemi dëshmitarë këtu, nuk kemi shumë ditë që pikërisht këta djem u shpallën disa të pafajshëm, disa u liruan, siç është rasti i gjeneralit Sylejman Selimi, Samisë e shumë shokëve të tjerë. Pra, në vend që ata të merren me drejtësi, ata u kthyen në një aparat persekutimi për disa individë që ata i kanë parë pengesë. Të mos harrojmë që edhe pak ditë e kemi masakrën e Dubravës. Hiç nuk duhet të jesh shumë jurist e të shohësh, 117 janë të verifikuar vetëm për një ditë që janë ekzekutuar dhe forma e ekzekutimit të këtyre djemve ka qenë prej aparatit, i cili ka pasur për detyrë t'i ruajë këta njerëz, sepse kanë qenë rob lufte, sistemi i asaj kohe domethënë nuk i ka kursyer, në duart e veta, në institucionet, siç është quajtur atëherë, për shembull, korrektuese ose ku di, unë i ka ekzekutuar plot 117 shqiptarë.

Dhe, sot e kanë përvjetorin, nëse s'gaboj 2 ose 3. Pra, kur thonë është vonë ose është herët, nuk është vonë, akoma për Luftën e Dytë Botërore sillen para drejtësisë plot 70 e sa vjet u bën, edhe sot e kësaj dite kemi raste kur sillen para drejtësisë njerëzit që kanë bërë krime. Unë krejt çka kisha kërkuar, edhe prej VV-së, edhe prej LDK-së të kthehen në seancë e ta shohin këtë mundësi të mirë për t'i bashkuar energjitë tona, forcat tona dhe t'i jepet mbështetje krijimit të komisionit. Se si do të realizohet ose si do të implementohet në të ardhmen, ne këtu bashkërisht do ta shohim, po në rast se ne dështojmë sot për ta krijuar këtë komision, atëherë me të vërtetë nuk e di çfarë mesazhi do të çojmë edhe te fqinjët tanë, të cilët me siguri sot janë duke u gëzuar fort. Unë e di që shumicën e grupeve parlamentare, edhe opozitare, kemi njerëz, të cilët e kanë kaluar këtë torturë, sidomos në Vetëvendosje kemi shumë emra, të cilët e kanë kaluar aparatit e Milosheviqit dhe nuk besoj, pikërisht lideri i VV-së, Albin Kurti, ka qenë nën ato aparatura, në ato tortura që i ka kaluar edhe vetë dhe unë mendoj që ai personalisht duhet të dalë publikisht dhe të insistojë të kërkojë drejtësi. Nuk mundet një fotografi e publikuar ta zhvlerësojë gjithë atë krim që e ka bërë Serbia në Kosovë, pavarësisht a pajtohemi ne a s'pajtohemi, a ka qenë veprim i duhur a s'ka qenë, unë mendoj që krimet serbe në Kosovë e meritojnë drejtësinë dhe e kemi rastin të mos dorëzohemi, të mos tërhiqemi e të shkojmë deri në fund.

Dikush e kupton sot, dikush nesër, por duhet të bëjmë thirrje publike të gjitha institucionet e Kosovës, Parlamenti, institucionet e drejtësisë, shoqëria civile, mediat t'i denoncojnë edhe publikisht krimet që kanë ndodhur e t'i bëhet thirrje edhe opozitës të bashkohet sot, sepse kjo del jashtë agjendës partiake ditore, se unë mendoj që pas 50 vjetëve Kosova nuk do të ndalet së kërkuari drejtësi për viktimat e veta. Faleminderit!

**KRYETARI: Faleminderit! Blerta Deliu-Kodra, urdhëro!**

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuara familje të të pagjeturve,  
Të nderuar kolegë deputetë,  
Përfaqësues të mediave që sot jeni në këtë sallë,  
Të nderuar mysafirë që po na ndiqni sot.

Natyrisht që edhe unë në vazhden e diskutimeve të kolegëve të mi do të shpreh keqardhjen time të thellë që në një ditë kaq të veçantë dhe specifike, veçanërisht për ata që janë familjarë të të pagjeturve, e që i kemi sot në këtë sallë, partitë opozitare zgjodhën që t'i braktisin punimet e këtij Kuvendi, në një moment kur ne po mundohemi të shënojmë një kthesë të rëndësishme, në radhë të parë për viktimat. Konsideroj se ky veprim i opozitës është ofendim për familjarët, për qytetarët e vendit dhe për ata që kërkojnë drejtësi, e të cilët nuk janë të paktë. Megjithatë, unë do të ndalem te diskutimi im, të cilin sot e kam përgatitur, në të cilin kam edhe dokumente faktike, të cilat do t'i deklaroj para mediave dhe para qytetarëve të Republikës së Kosovës. Është diskutuar gjatë edhe gjatë javës që e kemi pasur, javës së kaluar dhe ka pasur edhe diskutime të shumta të kolegëve deputetë, të cilët e kanë kërkuar fjalën, prandaj të nderuar kolegë deputetë, mund edhe të përsëritëm.

Për mua seanca e sotme është njëra ndër seancat më të rëndësishme të viteve të fundit, jo vetëm për shkak të përmbajtjes së saj, por edhe për shkak se kjo seancë besoj shumë se do të jetë kthesë e mbarë që do t'i japë fund mosndëshkimit të krimeve serbe në Kosovë, e të cilat, e thashë, që nuk janë të pakta.

Deputetët e Kuvendit të Kosovës javën e kaluar morën një vendim të rëndësishëm duke votuar rezolutën për gjenocidin serb të kryer në Kosovë, e cila është vetëm një pikë e parë drejt qëllimit final, për të cilin kemi shumë punë bashkë që të gjithë. Gjatë të gjitha diskutimeve u tha se nisma është e vonuar, dhe për këtë po pajtohemi të gjithë, po pajtohem edhe unë që kanë kaluar 20 vjet dhe jemi të vonuar. Po të gjithë jemi të vetëdijshëm që për 20 vjet me radhë krimet e pretenduara të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kanë qenë objekt i trajtimit edhe i drejtësisë nga shumë institucione, përfshirë këtu Tribunalin e Hagës, UNMIK-un, EULEX-in dhe Dhomat e Specializuara.

Të nderuar kolegë deputetë,

U përmend nga shumë deputetë edhe çështja e votimit të Gjykatës Speciale dhe po do të flas edhe për këtë çështje, sepse të jeni të bindur se vendimi për votimin e saj ka qenë njëri prej vendimeve më të rënda, më të vështira dhe vendimeve më të dhimbshme në historinë time si deputete e Parlamentit të Republikës së Kosovës. Kemi votuar për Gjykatën Speciale me premtimet dhe sigurimin e miqve tanë dhe të partnerëve se ky proces do të jetë i drejtë, i paanshëm dhe i ndërtuar tërësisht mbi bazën e dëshmive kredibile. Kemi votuar pro Gjykatës Speciale të imponuar nga nevoja që të zbatohet një obligim ndërkombëtar të Kosovës dhe për të dëshmuar se jemi partnerë kredibilë, i cili zbaton dokumentet ndërkombëtare të cilat ratifikohen



në këtë Kuvend. Mbi këtë bazë, Partia Demokratike e Kosovës i ka dhënë mbështetje themelimit të Gjykatës Speciale, mbi këtë bazë, të nderuar kolegë deputetë, kam votuar edhe unë, kanë votuar edhe kolegët e mi të Partisë Demokratike të Kosovës. Madje, ka pasur të atillë, të cilët kanë drejtuar gishtin pikërisht kah deputetët e Partisë Demokratike të Kosovës, pikërisht kah ata, të cilët e bënë luftën duke thënë se të njëjtit po i frikësohen drejtësisë ndërkombëtare apo se eksponentë të PDK-së nuk po e votojnë këtë gjykatë, meqë mund të jenë në listat e të dyshuarve dhe do të ftohen nga gjykata. Kemi votuar, sepse një raport, të cilin e kemi injoruar si shoqëri dhe si institucione, një raport të Dik Martit, është bërë dokument zyrtar dhe ka kaluar në Këshillin e Sigurimit.

Të nderuar kolegë deputetë,

Por çka ka ndodhur me krimet mizore të Serbisë? Çka ka ndodhur me gjykimin e kriminelëve që kryen masakrën e Rezallës, të kriminelëve që kryen masakrën e Izbicës, të Studimes, të Abrisë, të Poklekut e Reçakut, masakrën e Mejës, të Prekazit, të Krushës e shumë e shumë masakra të tjera në gjithë Kosovën. Do të sjell para juve faktet, sepse mendoj që seanca e sotme para së gjithash është seancë në të cilën ne do të flasim me fakte dhe dëshmi konkrete, dhe dëshmitarë të shumtë pjesë e këtyre dëshmimeve janë edhe vetë dokumente zyrtare të shtetit serb, njëra prej të cilave është dokumenti të cilin do ta shpaloj para juve që lidhet me masakrën e Rezallës, të Ribarit, të Harilaqit dhe me masakrën e Lubeniqit. Në dokumentet serbe të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës të kohës së luftës thuhet se, citoj: “Në javën e parë të prillit të vitit 1999 kapiteni Kërsmantović dhe majori Çorbiq, në fshatin Rezallë kanë gjetur 30 deri në 40 trupa të vrarë. Këta të vrarë janë parë nga gjyqtari hetues i asaj kohe në Gjykatën e Mitrovicës, Boguljub Paunović. Paunović me grupin hetimor kanë shkuar në Rezallë, nuk i kanë prekur trupat dhe kanë refuzuar ekshumimin e tyre, sepse kanë thënë se mund të dëmtohen. Më 19 prill të vitit 1999 gjykatësi tjetër hetues i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Blagoje Miletiq, po ashtu ka refuzuar të japë urdhër për ekshumimin, por ka dhënë urdhër që në vendin ku janë varrosur të vrarët, të hidhen edhe 80 cm dhe, sepse siç thuhet shprehimisht “radilo u vodovorini”. Fjala, pra është për rrezikun që vendi i varrezave të zbulohet nga erozioni i ujërave. Miletiq ka kërkuar që rastin ta marrë në shqyrtim ushtria, përkatësisht dy oficerët e lartshënuar, të cilët unë i përmenda në këtë procesverbal.

Në të njëjtin dokument flitet për masakrën e kryer në fshatin Ribar i Vogël dhe Halaq i Vogël, më 18 dhe 19 prill. Aty janë 45 trupa, 29 në Ribar të Vogël dhe 16 në Halaq të Vogël. Sipas dokumentit serb, trupat u janë dhënë familjarëve për t'i varrosur. Masakra tjetër për të cilën flet dokumenti, të cilin unë e kam, është masakra e Lubeniqit. 73 njerëz janë vrarë në xhaminë e fshatit, në bazë të informacioneve, trupat e tyre pas 20 ditësh janë varrosur në varrezat e myslimanëve në Pejë.

Të nderuar të pranishëm, besoj shumë si dëshmi si këto për masakrën e Rezallës dhe masakrave të tjera anekënd Kosovës kanë edhe shumë qytetarë të këtij vendi, prandaj unë e vlerësoj shumë

seancën e sotme. Megjithatë, në vend të distancimit të shtetit serb nga krimet që kanë ndodhur, ne kemi një situatë edhe më të rënduar, jo vetëm në raport me viktimat, në raport me familjarët e tyre, por edhe në raport me vetë shtetin e Kosovës. Në vend të dënimeve të kriminelëve të shtetit serb, shteti serb ka vendosur që në krye të institucioneve serbe të sigurisë t’i vendosë figurat, të cilat kanë qenë të përfshira në masakrat më të rënda ndaj civilëve të pafajshëm, në vend të ndëshkimit, këta kriminelë vazhdojnë të promovohen e të nderohen nga shteti serb. Besoj që secilin në këtë sallë e kujton edhe një dokument tjetër të publikuar nga Fondi për të Drejtën Humanitare, nga zonja Natasha Kandiq, i titulluar “Dosja Lubisha Diković”, e ku detaje dhe përgjegjësi kishte pikërisht gjenerali serb për zonën e Drenicës dhe krimet që janë kryer nga Brigada 37. Fondi akuzon drejtpërdrejt se pikërisht gjenerali Diković nuk i kishte penguar krimet e rënda kundër civilëve në Kosovë gjatë viteve ‘98-‘99. I njëjti kishte hedhur poshtë akuzat, duke i quajtur si sulme ndaj ushtrisë serbe dhe kishte paditur pikërisht zonjën Kandiq për dëmtim të imazhit të tij. Përsëri në janar Fondi publikon raporte për varrezat masive në Rudnicë, afër Rashkës, ku brigada e tij dhe Diković akuzohen si përgjegjësit kryesorë për bartjen e trupave të qindra civilëve të vrarë nga fshatrat e Drenicës. Diku 57 ishin gjetur në ato varreza masive, përfshirë edhe civilë të pushkatuar në Çikatovë të Vjetër.

Menjëherë pas këtij publikimi në shkurt, shefi i tanishëm i stafit të ushtrisë serbe kishte pranuar urdhrin “Hero kombëtar” me vendim të Presidentit të atëhershëm Tomislav Nikoliq, urdhri më i lartë, i cili mund t’i jepet një ushtaraku në Serbi. Heshtja e institucioneve të drejtësisë karshi krimeve serbe dëshmon tani se deri tani s’ka pasur asnjë hetim serioz të organeve të drejtësisë në Serbi. Banorët e Rezallës, bashkëfshatarët e mi, kanë dorëzuar edhe kallëzim penal për dyshimet e vrasjes së 41 personave në Rezallë. Rrustem Rrukolli, njëri prej familjarëve të të masakruarave, ka dorëzuar madje edhe padi konkretisht ndaj komandantit serb Diković dhe Dejan Randelović, por ende nuk kemi asgjë. 20 vjet pas luftës kur kujtojmë masakrat më mizore që janë kryer mbi popullsinë e pafajshme, kur kujtojmë deportimin dhe dëbimin masiv që u është bërë qytetarëve të vendit, në vend të drejtësisë, kur kujtojmë krimin dhe përdhunimin e mijëra grave dhe vajzave, ajo e cila po ndodh tani është një përpjekje edhe më e theksuar e Serbisë për të relativizuar gjithë atë që ndodhi, duke tentuar që të barazojë krimin. Jemi dëshmitarë të një gjuhe ekstreme të elitës politike serbe në raport me Kosovën, ku ka një përpjekje serioze për ta retushuar historinë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuara familje të të pagjeturve,

Shoqëria jonë, institucionet e Republikës së Kosovës, ndonëse e thashë se jemi shumë të vonuar, duhet të kemi kurajën që të bëhemi bashkë për të përmbyllur këtë kapitull të rëndë të së kaluarës sonë historike. Pa e mbyllur si duhet këtë kapitull, pa pasur drejtësi për viktimat dhe dënim për kriminelët, nuk do të arrijmë të ndërtojmë asnjëherë një kapitull të së vërtetës sonë. Shoqëria jonë këto ngjarje nuk do të duhej t’ia lejojë harresës, prandaj janë të domosdoshme këto nisma, jo vetëm për memorien tonë kolektive, por edhe për të edukuar brezat e rinj, për të distancuar ata

dhe shoqërinë tonë nga gjuha raciste e dhunës, nga gjuha e urrejtjes, gjuhë kjo e cila çoi drejt gjenocidit të shqiptarëve në Kosovë.

Prandaj, një nismë si kjo, edhe pse e vonuar, nuk do duhej të shihej asnjëherë si nismë e pamundur, duhet të ketë vullnet nga të gjithë deputetët, edhe ata deputetë, të cilët e braktisën sot sallën e Kuvendit që të bëhemi një zë për të ndërtuar mekanizimin më kredibil që t'i adresonte, t'i hetonte, t'i procedonte e do t'i gjykonte të gjitha pretendimet e mundshme. Lehtësia me të cilën diskutuan disa nga kolegët deputetë karshi kësaj iniciative më habit shumë. Janë shumë të tillë, të cilët kanë qenë skeptikë në momentet më vendimtare të Kosovës, ka pasur të atillë, të cilët nuk kanë besuar te lufta dhe bërja e Kosovës shtet i pavarur dhe sovran, ka pasur të atillë, të cilët asnjëherë nuk kanë besuar te nismat e para të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ka pasur të atillë, të cilët kanë shprehur dyshimet në momentet kyçe dhe në momentet vendimtare të vendit. Nisma e sotme dhe jo vetëm e sotme, nisma e javëve të fundit e zotit Veseli që parasheh rezolutë për gjenocidin, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës, formimi i Komisionit shtetëror për krijim të Tribunalit për gjenocid serb, Muzeu i gjenocidit serb e deri te Memoriali i Dëbimit mund të krijojnë një momentum të ri, për të kthyer vëmendjen ndërkombëtare te Kosova. Ideja për krijimin e një tribunali, edhe pse e vonuar, konsideroj se është njëra prej ideve më të vlefshme, ky vend do të duhej të ketë një ditë specifike dhe të shënuar për të përkujtuar krimin e ndodhur, do duhej të ketë një muze që do të shërbejë si institut, që do të ndihmojë në krijimin e memories sonë kolektive.

Hapi i parë është krijimi, është vetë klima e krijuar në vend dhe një Komision shtetëror në përbërje të gjithë aktorëve të shoqërisë civile, të partive politike, të atyre të cilët janë prekur më së rëndi nga lufta, që në mënyrë graduale ne si Kosovë dhe si institucione të ndërtojmë një momentum të ri. Ne sot i vëmë vetes një objektiv që kërkon nisma të shumanshme dhe që bëhet me modelimin e vendeve, të cilat kanë kaluar nëpër të njëjtin proces. Është kërkesë shumë legjitime dhe e drejtë e shtetit të Kosovës, është kërkesë legjitime e vetë qytetarëve të Kosovës, është kërkesë legjitime dhe e drejtë e të gjithë atyre, të cilët janë prekur më së rëndi nga gjenocidi dhe krimi serbë. Kosova dhe qytetarët e saj nuk humbin asgjë nëse e marrin një nismë si kjo. Përkundrazi, kjo nismë mendoj shumë se vetëm e ofron Kosovën më afër drejtësisë. Prandaj, po flas edhe në emër të familjarëve të mi, po flas edhe në emër të atyre, të cilët sot nuk janë në mesin tonë, besoj që është momenti i duhur që pozitivë e opozitë t'i lëmë anash këto ndasi, të cilat u reflektuan sot dhe t'i japim mbështetje nismës për të kërkuar drejtësi dhe për të dënuar kriminelët një herë e përgjithmonë.

**KRYETARI:** Muharrem Nitaj e ka fjalën, vjen pastaj, regjia! Zafir Berisha e ka fjalën.

**ZAFIR BERISHA:** Faleminderit, kryetar!

Fillimisht duhet të kërkoj kështu që të shpreh një shqetësim që një gabim aksidental ta lërë nën hije gjithë përpjekjen, iniciativën për të pasqyruar atë që ka ndodhur gjatë luftës, por edhe para

luftës në Kosovë dhe unë po mendoj se dy subjektet opozitare duhet menduar më kthjellët kur është në pyetje Kosova. Sido që të jetë, është qëndrimi i tyre dhe për këtë do ta vlerësojnë qytetarët, do ta gjykojnë, por si deputet, si subjekt politik mendojmë se pavarësisht kohës së gjatë që ka kaluar, është mirë t'i rikthehemi një situatë që edhe mijëra vjet do të jetë e paharruar. Një fjalë popullore thotë: "Në rast se pitja është ngrënë, tepsia ka mbet", unë po mendoj se janë të kota përpjekjet edhe të Serbisë edhe të mbështetësve të Serbisë për të thënë se në Kosovë nuk ka ndodhur asgjë, sepse janë mijëra e mijëra fakte që demantojnë gjithë ata zëra, por edhe ministrin e Drejtësisë që para disa ditësh në një televizion, duke përmendur disa masakra se nuk ka asnjë rresht të shkruar dhe asnjë fakt. Kjo nuk qëndron. Fakte ka me mijëra edhe për ato masakra që i ka përmendur dhe mjafton vetëm të lexohet libri i heroinës Fitnete Ramosaj, dhe aty përpos fakteve të shkruara, ka edhe fakte me fotografi.

Unë mendoj se ne nuk duhet të ngutemi me deklarata nga pozicionet që jemi për të mundur të prezantohemi para opinionit si të moderuar, sepse situata në të cilën ka kaluar Kosova dhe qytetarët e saj, mendoj se duhet të thuhet troç dhe të shkruhet e zezë në të bardhë.

Një pjesë e madhe e deputetëve jemi përjetues të drejtpërdrejtë të asaj që ka ndodhur në Kosovë. U takojmë edhe familjeve të cilat kemi qenë të atakuar nga soji për të cilin foli Milaim Zeka, por në këtë rast nuk mendoj se jemi në gjendje, jemi në situatën që ne t'i shtrojmë komoditet vetvetes dhe ta harrojmë të kaluarën, për hir të një pretendimi të natyrshëm që kemi si shtet dhe si qytetar të Kosovës.

Mendoj që gjenocidi serb në Kosovë duhet në mënyrë institucionale të luftohet. Pavarësisht dilemave që kemi në realizimin e kësaj, unë mendoj se me guxim dhe vendosmëri mund të arrihet çdo objektiv të cilin ia vënë seriozisht institucionet e Kosovës vetes, e veçanërisht Kuvendi. E dimë sesi themelohen tribunalet, si iniciohen, por kjo ide unë po besoj se mund të arrihet në rast se thjesht kemi edhe një unifikim të forcave politike dhe qytetare në Kosovë dhe nuk merremi me dilemat dhe nuk hamendemi me ndonjë lëshim eventual që mund të ndodhë siç ka ndodhur edhe nga deputetja e nderuar. E kuptoj, e kam thënë edhe në një rast, në mënyrë simbolike, se autogoli është më i dhimbshëm se goli që ta jep kundërshtari, po nuk nënkupton kjo se ne thjesht duhet të demoralizohemi, dhe të gjithë atë potencial, gjithë ato argumente që i kemi, d.m.th. tash t'i lëmë nën hije të një lëshimi.

Natyrisht se e mbështesim edhe idenë e një muzeu. I përkas atij mendimi që muzeu të jetë me një vend që është edhe simbolikë e gjenocidit edhe kulturor, d.m.th. në kampusin e universitetit. Idenë e studentëve, thjesht për të lënë një pasqyrë për gjeneratat e ardhshme se çka ka ndodhur në Kosovë.

Unë dua të rikujtoj masakrën e Tusuzit, pra ata që e kanë bërë masakrën kanë emër dhe mbiemër. Po e them këtë për shkak se janë shprehur dilemat siç e thash se a kemi fakte, a ka gjëra të

shkruara rreth asaj që ka ndodhur në Kosovë. 27 burra dhe gra, fëmijë dhe pleq janë masakruar brenda dy-tri orësh më 26 maj '99, në lagjen Tusuz, një pjesë e qytetit të Prizrenit. Aktorët e asaj masakre dihen, d.m.th. kanë emër dhe mbiemër, janë njerëz të njohur për opinionin. Dhe, në rast se ne vazhdojmë me këtë mënyrë të merremi me tragjeditë që u kanë ndodhur qytetarëve të Kosovës, unë po mendoj se i lëmë komodë kriminelët në Serbi dhe kudo që janë të vazhdojnë jetën e tyre sikur nuk ka ndodhur asgjë.

Ne e dimë se në Kosovë me mijëra fëmijë janë masakruar nga ushtria dhe policia, nga aparati i dhunshëm i Serbisë. Ne duhet të rikthejmë kujtesën për ata fëmijë, për atë gjeneratë që sot kanë mundur të jenë deputetë, kanë mundur të jenë mjekë, inxhinierë, avokatë, kanë mundur të jenë gjyqtarë për ta zëvendësuar këtë sojin të cilin unë përmes edhe ligjit, i cili për fatin e keq që gjashtë muaj ka mbetur në sirtarët e Kuvendit, Ligjin për lustracionin, që në mënyrën njerëzore kam menduar që ata njerëz dalëngadalë duhet të largohen nga skena për shkak të kaluarës së tyre.

Sido që të jetë, në fund, edhe si subjekt politik, edhe si qytetar, edhe si deputet i kisha bërë apel të gjithëve, të bëhemi bashkë për ta luftuar të keqen e madhe që quhet Serbi dhe për ta gjykuar atë që ka ndodhur në Kosovë. D.m.th. gjatë luftës, por edhe para luftës. Përndryshe, ne nuk mund ta harrojmë se jemi në këtë situatë edhe si rezultat i papërgjegjësisë të individëve të caktuar në krye të institucioneve të cilët kanë menduar se duke i relaksuar marrëdhëniet me Serbinë mund të arrijmë diku dhe ta harrojmë të kaluarën. Unë e di që nga 2011-a kemi bërë një gabim në hapa në raport me Serbinë, d.m.th. jemi futur pa e pasur parasysh këtë të cilën po e diskutojmë ditëve të fundit. Serbia mbetet ajo që ka qenë, d.m.th. politikanët aktualë janë vazhdues të politikës gjenocidiale të Milosheviqit dhe si të tillë duhet t'i shikojmë edhe në hapat, edhe në ditët e ardhshme, duke përfshirë edhe atë që pritet të ndodhë në Paris, me ndërmjetësimin e Gjermanisë dhe Francës.

Serbia është ajo që ka qenë dhe derisa ne nuk e shikojmë të tillë, mund të bëjmë edhe gabime të tjera në të ardhmen. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit deputet! Fjalën e ka Muharrem Nitaj.

**MUHARREM NITAJ:** Faleminderit, nënkryetare!

Unë realisht më tepër e kisha nevojë të flas sa ishte kryetari i Kuvendit në drejtim të kësaj seance. Ai doli jashtë, sidoqoftë unë besoj që do ta marrë mesazhin.

Po dëgjojmë vlerësime të ndryshme sesi vlerësohet seanca e sotme si e jashtëzakonshme. Është për të ardhur keq sesi po zhvillohet kjo seancë, në çfarë rrethanash dhe me çfarë interesimi. Realisht unë do të doja të besoj, ose do të doja të më mirëkuptojnë kolegët deputetë që kjo seancë nuk do të duhej fare të ishte një seancë debati, po do të duhej të ishte një seancë rezultati.

Realisht pritjet po i keni shumë më të mëdha për opozitën sesa mund të ekzistojnë dhe nuk është mirë të llogaritet në opozitën, është mirë të llogaritet në shumicën parlamentare. Dhe është për të ardhur keq për të parë se cili është numri i deputetëve të cilët sot janë në seancë, dhe cilat janë gjasat që të prodhohet një rezultat, që d.m.th. nuk janë kurrfarë.

Është e vërtetë që i madh ka qenë gabimi i koleges deputete, Flora Brovina, mirëpo po harroni se i madh është edhe veprimi, i madh është edhe gabimi i veprimit të sotëm të opozitës, e cila braktisi punimet e Kuvendit dhe unë besoj pa vetëdije ka arritur të dërgojë një mesazh që është shumë problematik, dëshmimi i gjenocidit serb në Parlamentin e Kosovës, ose përpjekja për të pasur një qëndrim unifikues për këtë të vërtetë.

Realisht, mesazhi im për Kryetarin e Kuvendit, për shefat e grupeve parlamentare, për liderët e partive politike është që nëse e kanë vërtetë përnjëmend që të prodhojnë ose të nisin iniciativën për krijimin e një tribunali, atëherë duhet të merren vesh, duhet t'i sjellin deputetët në Kuvendin e Kosovës. Nuk duhet të flasin shumë, por duhet të prodhojnë rezultat. Kjo siç po ndodh sot, është për të ardhur keq. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit! Fjalën e ka zoti Enver Hoti.

**ENVER HOTI:** Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Kisha pasur dëshirë që kjo seancë të vazhdojë me mirëkuptimin e të gjithë kolegëve deputetë dhe grupeve politike sikur që ishte seanca e kaluar ku miratuam Rezolutën për gjenocidin serb të kryer në Kosovë, por ja që gjërat nganjëherë dalin nga situata të tilla, të cilat nuk janë të lakmueshme, dhe janë absolutisht të papranueshme, jo vetëm për ne, por edhe për të gjithë qytetarët e vendit e veçmas për ata njerëz të cilët janë të lënduar nga krimet dhe masakrat dhe nga torturat që i ka ushtruar në mënyrë sistematike shteti serb, ushtria, paramilitarët dhe policia serbe në Kosovë, e që janë të faktuara anekënd Kosovës.

Mendoj që krimet të cilat janë kryer në Kosovë, ne duhet të marrim dhe të mbështesim secilën nismë, të gjithë mekanizmat, institucione, qoftë deri te arritja e një tribunali, i cili do të bënte ndjekjen dhe dënimin e krimeve serbe. Faktet ekzistojnë, krimet janë kryer anekënd Kosovës si në Burim, Gollobuc, Paklek, Krushë, Mejë çdo kund, cep më cep të vendit, dhe janë të faktuara, janë të dokumentuara, janë të filmuara. Ka edhe dëshmitarë, prandaj kurrë nuk është vonë. Për të ngritur dilemën a është vonë apo jo për t'i ndjekur këto krime, duhet pyetur më së miri ata të cilët janë të lënduar, qytetarët, familjarët. Mijëra njerëz të cilët presin që njëzet vjet që të zbardhet e vërteta e atyre njerëzve dhe kriminelët të marrin dënimin e ndjekjen e merituar.

Mendoj që është momenti i fundit që ne të bashkohemi rreth kësaj teme dhe t'i japim një orientim të duhur institucional mekanizmave dhe një komisioni parlamentar i cili do të punonte shumë për ngritjen e institucioneve të cilat do të bënin ndjekjen e kriminelëve serbë. Faktet

ekzistojnë. Është jashtëzakonisht e papranueshme që të thuhet ku janë ato fakte, apo a i kemi të strukturuar apo të sistemuara.

Duhet të angazhohemi fuqishëm të gjithë dhe të gjejmë një rrugë të përbashkët e cila do të krijojë institucione dhe mekanizma të cilët do të kryejnë detyrën e vet. Ne bëjmë thirrje kolegët opozitarë që të vijnë dhe të marrin rolin e tyre që e kanë dhe të jemi të bashkuar në këtë temë, e cila po mendoj që jo vetëm që Serbia ndoshta e shikon nga një kënd tjetër, por edhe qytetarët tanë do të jenë të çuditur dhe të habitur me qëndrimin tonë që e kemi këtu.

Ajo që po ngrihet se sa ka gabuar një kolege e jona, unë do të them kështu: ka gabuar dhe është gabim. E kanë thënë kolegët tonë se ne nuk mashtrohemi dhe nuk i përkrahim ato qëndrime, ato gabime që dalin të mashtruara, por përballë asaj çka ka bërë Serbia më se një shekull në Kosovë, ai gabim është aq i vogël sa që nuk duhet të merret në një debat dhe në një kërkesë dhe në një qëndrim për të krijuar një institucion dhe mekanizma të cilët i dënojnë krimet serbe. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka zëvendëskryeministri, zoti Enver Hoxhaj.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit, zonja kryesuese!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Të nderuar anëtarë të familjeve të pranishëm në këtë seancë,

Kryetarë të shoqatave të ndryshme të të pagjeturve,

Nuk desha të flas dhe nuk dua që të jem kështu polarizues, sidomos në një situatë kur kolegët e opozitës nuk janë këtu. Po janë dy arsye pse do të duhej të ishim së bashku në një seancë të tillë, pavarësisht se kush është të pushtet dhe kush është në opozitë. Dhe nuk dua që ta luaj rolin e dikujt i cili i pajton anët, se në fund të fundit, partitë politike i marrin vendimet vetë dhe grupet parlamentare i marrin vendimet vetë, por së pari ka të bëjë me dinjitetin e viktimave. Kjo është një temë e cila në Kosovë nuk do fort sqarim të qartë, se krejt kemi qenë viktimë, por dikush ka paguar një çmim skajshmërisht të madh. Arsyja e dytë pse kolegët e opozitës do të duhej të ishin në seancë, dhe pse mospraninë e tyre e shoh si papërgjegjësi, ka të bëjë me diçka tjetër.

Po dua të dal prej debatit lokal këtu brenda në Kosovë. Se si ne e shohim këtë temë dhe çfarë mekanizmash ne krijojmë për këtë temë, ashtu do ta shohë bota. Ashtu do ta shohë bota. Dhe nëse ne nuk jemi unikë për këtë temë brenda në këtë Kuvend, natyrisht që edhe të tjerët do të kenë dallime në një temë të tillë. Sesi e shohim ne këtë temë sot, do ta shohë bota jo vetëm në 2019-tën, do ta shohë bota edhe më 2029.

Unë mendoj që ka do tema ku s'mund të pajtohemi, po ka disa tema ku është e dhënë, është e përcaktuar paraprakisht që duhet të jemi unikë. Unë mendoj që debati këtu është, edhe pse

iniciativën e ka marrë kryetari i Kuvendit dhe këto tash shpeshherë shihen nga një prizëm i ngushtë partiak.

Por më lejoni që t'ju jap dy-tri elemente sesi të shihet kjo një iniciativë edhe më e gjerë, është më e menduar. Është më e trajtuar. A duhet të ndodhë në 2019-tën, a do të duhej të ndodhë në 2009-tën kur ne kemi qenë në mbikëqyrje ndërkombëtare, shtet i pavarur, po kemi pasur mbikëqyrje ndërkombëtare. A do të duhej të ndodhë në '99-tën, 2000-tën, 2001-tën, kur ne kemi qenë entitet ndërkombëtar, nën mbikëqyrje të Kombeve të Bashkuara. Mund ta diskutojmë, por duhet ta kemi mbi të gjitha një dimension afatgjatë.

Kryetari i Kuvendit ka dërguar letër që të njihet gjenocidi i shtetit serb nga parlamentet e ndryshme të vendeve të ndryshme në botë, në Evropë dhe jashtë botës. Ka ndodhur ngjarje të gjenocidit në prag të Luftës së Parë Botërore dhe sot e kësaj dite në kuvendet, në parlamentet e ndryshme në Evropë, jashtë Evropës merren vendime që të njihet ajo që ka ndodhur në 1918-tën, s'po dua të hyj në detaje.

Deri sot është bërë temë mes shteteve për atë se çfarë ka ndodhur në fund të Luftës së Dytë Botërore.

Ka një iniciativë për themelimin e një muzeu të gjenocidit. Por, ka edhe disa iniciativa të tjera të cilat janë ndërmarrë në 2019-tën dhe në shumicën e vendeve, jo menjëherë pas luftës, aty ku ka pasur mundësi edhe pas luftës, edhe pas dhjetë vitesh, pas njëzet vitesh, pas 30 vitesh, kanë krijuar institucione sesi t'ia japin një dimension jo vetëm legal kësaj pune, po edhe një dimension politik dhe shoqëror.

Ne e kemi marrë një iniciativë po ashtu si Qeveri që do të duhej të vjen në Kuvend, që të parandalohet mohimi i krimeve që i ka bërë shteti serb. Dhe edhe kjo ka ndodhur jo menjëherë në 45-ën p.sh. në Evropë, po ka ndodhur në vitet '50-ta, '60-ta, '70-ta. Në disa vende të ish-bllokut lindor edhe krejt vonë, kështu që debati për aq sa është vonë, mund të jetë vonë, edhe ndoshta është shumë vonë. Por duhet ta kemi kontekstin ku do të jemi pas dhjetë vitesh, njëzet vitesh.

Mbi të gjitha, iniciativa për tribunalin dhe iniciativa që të ketë një komision, i cili i heton rrugët ligjore sesi të bëhet kjo punë, i heton aleancat politike sesi të bëhet një tribunal i tillë, nuk do të duhej t'i thuhet paraprakisht jo në këtë Kuvend të Kosovës. Natyrisht Holokausti kur ka ndodhur dhe dihet se kur është mbajtur edhe Gjyqi i Nurnbergut, po Adolf Ajhmanin e kanë gjykuar në Izrael tek në vitin 1960. Dhe në shoqërinë e Izraelit dhe në atë se çka ka ndodhur gjatë Luftës së Dytë Botërore më shumë ka pasur efekt në vitet '60-ta gjykimin e Ajhmanit sesa shumë procese gjyqësore të cilat janë mbajtur më herët.



Kështu që debati për atë që është vonë, mendoj që nuk është i domosdoshëm. Duhet të mendojmë se ku do të jemi me këtë temë, po mbi të gjitha, unë i kisha ftuar të gjithë që duhet të jemi së bashku në këtë temë, edhe mbi të gjitha për dinjitetin e viktimave, por edhe për faktin sesi ne e shohim këtë temë, do ta shohin ata jashtë territorit të Republikës së Kosovës. do ta shohin në Ballkan, do ta shohin në Evropë, do ta shohin edhe në botë. Dhe këtu mendoj që kolegët prej opozitës e kanë kësaj here shumë shumë gabim dhe i kisha ftuar që të kthehen dhe të jemi së bashku për një temë të tillë. Unë nuk dua t'ju referohem atyre se nuk dua mbi të gjitha për këtë temë ta polarizoj, po dua ta kem një dimension dhe një gjeografi globale se për çka jemi duke folur. Ne jemi të pavarur falë vullnetit tonë politik, falë sakrificës sonë, falë organizimit tonë politik, falë luftës së UÇK-së, po mbi të gjitha për shkak të asaj që kauza jonë ka qenë kauzë për dinjitet njerëzor, për të drejta të njeriut, për spastrim etnik.

Kosova është bërë e pavarur në 2008-ën, por themeli i asaj pavarësie me një plan më global ka ndodhur me 24 mars të 1999-ës, kur kanë rënë bombat e para në Jugosllavi dhe në Beograd. Dhe nuk duhet asnjëherë për një temë të tillë ta kemi vetëm një qasje lokale, kush e mori iniciativën, kush-cili tha, kush-cili që në pushtet nuk e bëri këtë, po duhet ta kemi një dimension më afatgjatë se ku po dua të lëvizim për këtë temë.

**KRYESUESJA:** Faleminderit, zëvendëskryeministër! Fjalën e ka deputetja Luljeta Veselaj-Gutaj.

Regjia, të lutem fjalën!

**LULJETA VESELAJ-GUTAJ:** E nderuar kryesuese e seancës!

Të nderuar familjarë të personave të pagjetur,

I nderuar zëvendëskryeminsitër i Republikës së Kosovës, z. Hoxhaj,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Dua të filloj me skepticizmin dhe kundërshtimin e opozitës, të shoqëruar me mungesën e vullnetit për të miratuar një nga iniciativat më të rëndësishme dhe më të qëlluara që ka ndërmarrë këto njëzet vite Kuvendi i Republikës së Kosovës lidhur me krimet e luftës në Kosovë, të kryera nga agresori serb, e që këtu po flitet dhe po diskutojmë për krijimin e tribunalit për gjenocidin e Serbisë në Kosovë.

Ky reagim dhe ky lëshim i seancës nga ana e opozitës tregon qartë papërgjegjësi institucionale të tyre dhe njëkohësisht nënkupton mbështetjen ndaj kundërshtarëve të kësaj iniciative. Përgjegjësia për krimet e luftës, gjykimet e krimeve të luftës në Kosovë ngelen pezull për shkak të mungesës së vullnetit të institucioneve ndërkombëtare të drejtësisë të cilat ishin në Kosovë dhe që kishin ndarë këtë kompetencë ekskluzivisht si çështje juridike të tyre, që të ndërmarrin të gjitha masat e duhura për të vënë në pah drejtësi.

Eksponentët e krimit dhe gjenocidit nga aparaturo e shtetit të Serbisë në luftën e fundit në Kosovë janë të njohur, kanë emër e mbiemër, kanë adresë të caktuar. Disa janë edhe pjesë e qeverisjes aktuale në Serbi, por që asnjëherë nuk dolën para drejtësisë dhe nuk morën dënimin e merituar për krimin e bërë në Kosovë. Nga agresori serb në Kosovë kanë ndodhur masakra të cilat e kanë tronditur edhe botën, duke filluar nga masakra e Reçakut, Mejës, Verbovcit, Studimes, masakra e Suharekës, Izbicës, Rrezallës, Krushës së Madhe, Krushës së Vogël, Tusuz e Korishë të Prizrenit, Tërnjë, Rogovë të Hasit, Xërxe, Celinë, Bellacerkë dhe gjithandej Kosovës. Në të gjitha rajonet e Kosovës kanë ndodhur krime kundër njerëzimit, duke vrarë dhe masakruar njerëz të pafajshëm, fëmijë, gra shtatzëna, pleq, e shtuar të gjitha këtyre krimeve, edhe më rëndë dhe më shumë po rënkon dhe po bëhet edhe më e madhe dhimbja e familjeve dhe të gjithë neve, kur ende e dimë që kemi mbi 1 600 persona ende të pagjetur.

Faktet e gjenocidit të tërë të 26 marsit të vitit 1999 janë ende të freskëta në muret e lokalit ku u krye masakra e 48 anëtarëve të familjes Berisha në Suharekë, Vjollca, Shyhretja e Gramozi në atë kohë vetëm tetë vjet janë dëshmitarë të gjallë që i shpëtuan këtij tmerrri gjenocidal, ku u vranë dhe u masakruan familjarët e tyre, në prani të tyre, duke filluar nga fëmija nëntë muaj, aty kishte edhe gra shtatzëna, po kishte edhe pleq në moshë 100-vjeçare. Shumica e tyre ende nuk u janë kthyer mbetjet mortore në vendin e lindjes. Përjetimi i tyre i trishtë për mbijetesë tregon qartë krimin serb mbi popullatën e pafajshme të popullit tonë.

Një rast tjetër në Suharekë ishte i nënë Fetijes, ku edhe sot e kujtoj. Si e re, ajo para syve të saj e pa vajzën e saj të pushkatuar. Nuk e lejuan as ta marrin kufomën e vajzës dhe ta varrosë. Ata e pushkatuan vajzën dhe nënën e detyruan që të vazhdojë rrugën e dëbimit. E njëjta gjë ndodhi edhe në Sopi të Suharekës. Nënë Zarifes para syve të saj ia pushkatuan djalin. E shkreta deshi ta mbrojë djalin e saj 16-vjeçar Isakun. I doli në mbrojtje, por edhe kjo përfundoi aty para pragut të shtëpisë, e pushkatuar bashkë me të birin.

Kështu vazhduan ditë të tmerrshme në gjithë Kosovën, si në Krushë të Vogël, në Krushë të Madhe e gjithandej. Anashkalimi dhe mosgjykimi i krimeve dhe gjenocidit të ushtruar nga armata serbe militare, paramilitare të regjimit diktatorial në Kosovë, për çka edhe sot janë fakte dhe dëshmi të gjalla. Ende nënat tona, motrat dhe familjet tona rënkojnë nga abuzimet e kriminelëve e kryerësve të këtij gjenocidi dhe këtyre krimeve sot ata po jetojnë ende të lirë.

Konsideroj se ky është tmerrri dhe paradoksi i shekullit XXI, i cili po kërkon peshore të mirë të drejtësisë nga arena ndërkombëtare.

Kjo iniciativë shumë e qëlluar e kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, zotit Kadri Veseli, është shumë e rëndësishme për shoqërinë edhe për shtetin tonë, por njëkohësisht edhe për drejtësinë ndërkombëtare.

Kjo, trajton plagën më të madhe të shoqërisë sonë. Plagën më të madhe të familjeve tona që kanë përjetuar dhe po e përjetojnë këtë tmerr dhe këtë padrejtësi.

Një gjë duhet ta kemi të qartë të gjithë, se të gjithë kryerësit e veprave kriminale dhe spastrimit etnik, të vrasjes së mbi 13 500 civilëve, të dhunimit rreth 20 000 grave dhe vajzave, të gjithë këtyre njerëzve të aparatit të shtetit të Serbisë, duhet të ballafaqohen me drejtësinë.

Masakrat e Serbisë në Kosovës s'kemi për t'i harruar kurrë, por as kurrë s'kemi për t'i falur. Faleminderit për vëmendje!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputetja Sala Berisha-Shala. Urdhëroni!

**SALA BERISHA-SHALA:** Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit!

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Të nderuar ju të pranishëm që jeni këtu, anëtarë të familjeve të të pagjeturve,

Media,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Nuk ma ka marrë mendja që një çështje shumë e rëndësishme siç është themelimi i Tribunalit për gjenocidin serb, siç është muzeu i gjenocidit, siç është memoriali i dëbimit të mos i bëjë bashkë të gjithë këtu.

Po ashtu, mbi të gjitha kurrë nuk ma ka marr mendja se dënimi i krimeve dhe i gjenocidit serb nuk do të na bëjë bashkë të gjithëve në Parlament, jo vetëm pa dallim partie, po edhe pa dallim etnie.

Është komplet e pakuptimtë për dy partitë e mëdha opozitare, për mua është e pakuptimtë, që Vetëvendosje, LDK madje edhe Lista serbe, që sot nuk janë në Kuvend që ta dënojnë krimin dhe gjenocidin serb, sepse krimi dhe gjenocidi nuk njohin as parti e as etni.

Madje, në këtë rast, po dua ta përkujtoj që para pak ditësh u mbajt akademi përkujtimore për Masakrën e Poklekt, dhe përfaqësuesi i familjes Muçolli, doli mbi vetveten dhe kërkoi që të dënohet krimi dhe gjenocidi serb. Kërkoi që këtë ta bëjë më së pari Serbia dhe i gjithë etniteti serb, sepse nuk duhet të vazhdojmë që gjeneratat ta mbajnë mbi barrë, ku secili që të flasë serbisht t'i shkojë mendja se ky ka qenë kriminel.

Andaj, kriminelët kanë emra dhe mbiemra dhe kjo na lehtëson, pra i lehtëson edhe gjeneratat tona, gjeneratat e ardhshëm që të mos e mbajnë barrë këtë krim të rëndë të çmendurisë që ka ndodhur 20 vjet më parë, e që vazhdon e njëjta çmenduari që të mos dënohet ky krim dhe ky gjenocid.

Është shumë interesat se këto ditë, kur ka manifestime për një masakër të tmerrshëm siç është Masakra e Dubravës, disa parti politike nuk gjejnë forcë dhe të ulën këtu e ta dënojnë gjenocidin dhe krimin serb.

Të bësh opozitë, duke e penguar zbardhjen e krimin dhe të gjenocidit, kjo është plotësisht e pakuptimtë. Të bësh opozitë në këtë mënyrë, të shkon mendja se Serbia është këtu duke i joshur disa njerëz për pushet.

Më shkoi mendja në kohën e para 20 vjetëve, apo më shumë se para 20 vjetëve, në vitin '98, kur dikush nuk ka besuar se ne mund t'ia kthejmë pushkën Serbisë.

Doli nga një diskutues i opozitës këtu, se e keqja e Kosovës, është treshja Thaçi-Haradinaj-Veseli. Automatikisht të shkon mendja se kjo treshë ia ktheu pushkën Serbisë dhe e bëri bashkësinë ndërkombëtare që të jetë aleat në anën e Kosovës.

Tani, jemi dëshmitarë të asaj që në dy ditët që i lamë pas, në opinion publik ka vluar debati mbi një fotografi, dhe shkak i atij debati, jo si pasojë, për shkak të atij debati, opozita e lëshon seancën. Kjo i bie që për një plesht të digjet jorgani. Siç ndodh zakonisht, beteja politike filloi.

Partia Demokratike u mbajt përgjegjëse për këtë, ani pse publikimi i asaj fotoje, ishte një akt individual i deputetes.

U tha se kjo po i jep argument më shumë Serbisë. U tha se PDK, nuk e kishte hallin të krijojë një Tribunal për krime të luftës, por t'i fitojë disa poenë politikë, dhe se fotografia e rrejshme e zonjës, ia çjerri maskën asaj. E vërteta është ndryshe dhe krejt ndryshe.

Është ndryshe, sepse:

1. Deputetja Brovina ka bërë një gabim pa qëllim. Se ky ishte një gabimi qëllimshëm dëshmohet nga fakti se deputetja është aktiviste e kahershme që i kalon edhe përmasat e Kosovës së vogël, siç tha një koleg yni deputet më herët.

2. Publikimi i fotografisë ishte një akt personal i deputetes, sepse publikimi i saj nuk është miratuar në asnjë organ të Partisë Demokratike të Kosovës, dhe se deputetja nuk ka folur në emër të Partisë Demokratike të Kosovës.

3. Dhe, shumë e rëndësishme: Sipas Kushtetutës, mandati i deputetit është i lirë dhe nuk i nënshtrohet asnjë detyrimi politik apo partia, dhe ky përcaktim kushtetues duhet mbrojtur si parim dhe jo të përdoret si pamflet politik.

Kur u përshtatet politikisht, thonë, sa keq që partitë nuk i lënë deputetët e lirë, ndërsa kur u duhet për sulm politik, thonë, se partia ka përgjegjësi për çdo deputet të saj. Kjo është e pasaktë ligjërisht dhe e padrejtë moralisht.

4. Fotografia e zonjës nuk është përdorur në procedurat e asnjë organi zyrtar të shtetit të Kosovës. Me të nuk është bërë asnjë hetim, dhe mbi bazën e saj nuk është gjykuar dhe as dënuar askush.

Deputetja e ka bërë atë që e ka bërë brenda mandatit të saj si deputet, e që gëzon imunitet dhe liri të fjalës më të gjerë se çdo qytetar tjetër.

5. Partia Demokratike e Kosovës është partia më e madhe tashmë 10 vjet, dhe çka mendoni ju, se ajo mund të bjerë në një lajthitje të tillë me një fotografi të pa verifikuar dhe të flas në emër të Partisë Demokratike. Këtë nuk mund ta besojë as një fëmijë, e lëre më që mundohen ta traumatizojnë, ta manipulojnë opinion publik në mënyra të ndryshme.

6. Pas vërtetimit se fotografia nuk është e vërtetë, duhet ta dimë se mbi 13 mijë shqiptarë janë vrarë nga Serbia. Nuk e zhbën ajo fotografi një fakt të tillë.

Edhe pas vërtetimit se fotografia nuk është e vërtetë, nuk e zhbën faktin se 1600 shqiptarë mbesin të zhdukur nga forcat kriminale serbe. Edhe shumë fakte të tjera që i përmenden në mënyrë që të mos i numëroj. Pra, fakte që i parmendën edhe kolegët e mi.

Pra, të nderuar qytetarët të Republikës së Kosovës,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Iniciativa e kryetarit të Kuvendit të Kosovës, zotit Kadri Veseli, për themelimin e Tribunalit për krimet që shteti serb i ka kryer ndaj popullsisë civile gjatë luftës në Kosovë, kam pritur që do të përshëndetet dhe do të përkrahet nga të gjithë pa dallim.

Kjo është një nismë e guximshme dhe e qëlluar e kryetarit Veseli, dhe ne si përfaqësues të popullit, gjithsesi kam pritur që duhet ndoshta të mos zhvillojmë as debat, por menjëherë ta mbështesim dhe ta votojmë.

Jam thellësisht e bindur, se edhe pse kanë kaluar 20 vite nga përfundimi i luftës, ne nuk kemi arritur ta dëshmojmë si duhet dhe sa duhet krimin dhe gjenocidin që shteti serb ka kryer mbi Kosovën. Prandaj, na duhet me çdo kusht ky tribunal.

Kur them kështu, kam parasysh shumë fakte. Do t'i përmend vetëm sipërfaqësisht disa prej tyre. Për 20 vite në Kosovë drejtësia i injoroi tërësisht viktimat e luftës së Kosovës.

Disa procese gjyqësore ku kinse u dënuan disa serbë për krime, dolën farse dhe mashtrim në sytë e botës perëndimore. Nuk u tha dhe nuk u mbrojt dhe nuk u bë drejtësi në ato gjyqe.

Për 20 vite, jo vetëm që nuk u kapen dhe nuk u ndoqën kriminelët e vërtetë, por prokuroritë, hetuesitë dhe gjykatat e shumta, i ndoqën dhe i persekutuan luftëtarët e lirisë. Pra, i dënuan ata që e mbrojtën jetën dhe lirinë e qytetarëve të Kosovës.

Për 20 vjet, presioni politik mbi Kosovën ishte aq i madh, sa që edhe pas të gjithë atyre gjykatave, siç ishte ajo e UNMIK-ut e bazuar në fakte të Serbisë, më pastaj e EULEX-it, dhe në fund na detyruan që ta themelojmë edhe Gjykatën Speciale.

Duke e qenë se e shoh si shumë të qëlluar themelimin e këtij tribunali, unë sot gjej rastin që si deputete e njëjës prej zonave më të përgjakura nga lufta, siç është zona e Drenicës, t'i them disa fjalë.

Drenica si dhe e tërë Kosova edhe pas 20 viteve nga përfundimi i luftës, jeton me ankth e luftës. Nënata e Drenicës si dhe të gjithë Kosovës, ende i qajnë fëmijët e tyre tek varret, sepse për jetët e tyre kurrë askush nuk dha llogari.

Nënata e Drenicës dhe të Kosovës, ende i kërkojnë eshtrat e fëmijëve të tyre, sepse ata po tretën nëpër varrezat masive në Serbi.

Edhe pas 20 viteve, Drenica nuk e ka rrumbullakuar bilancin tragjik të viktimave të luftës, sepse të vrarët e Izbicës, Likoshanit, Qirezit, Prekazit, Abrisë, Poklekit, Çikatovës, ende nuk mund të gjejnë prehje ndër varre pa u dënuar kriminelët.

Që të mos përmend me numra viktimat e masakrave më të tmerrshme që kanë ndodhur në Evropë, qysh prej Holokaustit dhe Srebrenicës siç janë 24 anëtarë të familjes Deliu në Abri, të masakruar më 13 prill, pastaj, Poklek i Vjetër dhe Poklek i Ri, Çikatovë e Vjetër, Verboc, Shtuticë e të tjerë, kurrë askush nuk dënua për këto krime dhe kurrë nuk u zbardhen këto tmerre.

Të nderuar kolegë,

Sot do t'i rikujtoj dy intelektualë, dy viktima të terrorit e të gjenocidit të kriminelëve serb, që ndodhën në Drenicë, që po ashtu këta intelektualë ishin në mesin e viktimave tragjike të kryera nga shteti serb, këta janë; doktor Hafir Shala humanisti i pashoq të cilin shteti serb e kidnapoi dhe e zhduku në mënyrën më barbare në prill të vitit 1998.

Pra, serbët nuk zgjodhën askënd, madje as mantelbardhin e humanist, por as poetin Ymer Elshani, i cili të vetmen armë të tij e kishte penën dhe prejardhjen e gjakut që ishte nip i të madhit Fazli Graiçevci.

Më 17 prill të vitit '99, herët në mëngjes Ymer Elshani së bashku me gruan, fëmijët, nënën, babanë e bashkëfshatarët e tjerë tentojnë të hyjnë në Drenas, në Gllogovcin e atëhershëm, por policia gjysmë e asaj turme e kthen prapa.

Ymeri me familjari e tij, por edhe me bashkëfshatarët e tjerë strehohen në shtëpinë e Sinan Muçollit për t'i terur rrobat e bëra qull nga shiu që binte rrëke atë ditë me vetëtimat e bubullimave të pa ndalura.

Po atë ditë në orën 17:00, policët serbë kishin hyrë në shtëpinë e Sinan Muçollit në Poklek të Vjetër, dhe nga turma e strehuar aty, ku kishte edhe mjaft fëmijë, gra, pleq, kishin nxjerrë Ymer Elshanin dhe Sinan Muçollin dhe sapo i kishin nxjerrë jashtë, ishin dëgjuar krismat e automatikëve të cilët ua kishin shuar jetën mizorisht.

Pas kësaj, policia kishte hedhur bombë në dhomën ku qëndronin të strehuar të tjerët, rreth 57 persona. Ndërkohë, nëpër tymin që përshkonte krimin e paparë, një polic zbrazi breshëri plumbash nga automati në atë dhomë, ku mbeten të vdekur 53 persona, ku në mesin e tyre ishte edhe familja e Ymer Elshanit, gruaja dhe kate djemtë e tyre.

Të nesërmen, në një shtëpi aty afër, vritet edhe nëna e Ymer Elshanit, 75-vjeçare, e cila ishte motër e veprimtarit të shquar Fazli Greiçevci, i vrarë ky nga UDB-ja në vitin 1964.

Kjo tregon se kriminelët kishin dosje për të, edhe pse të vetmen armë, siç e thashë më herët, e kishte rrënjën e gjakut si nip i heroit Fazli Greiçevci dhe penën me të cilën shkruante.

Në të njëjtën ditë, poetin dhe nënën e tij i kishin hedhur në bunar.

I përmenda këta dy emra, Ymer Elshanin dhe Hafir Shalën, dy intelektualë, duke mos pretenduar që assesit t'i harroj edhe viktimat e tjera të shumta, sepse mendoj se fati i doktor Hafir Shalës dhe ai i poetit Ymer Elshani, është vetë fati i Kosovës së këtyre 20 vjetëve.

Gjaku i qytetarëve të pafajshëm kosovarë, ashtu si vetë ndërgjegjja e tyre, u tret, u humb, u dogj dhe u zhduk pa dhënë askush llogari. Për 20 vite Drenica ashtu siç edhe krejt Kosova, ka pritur drejtësi për viktimat e luftës.

Kosova e priti këtë drejtësi, por ajo nuk ndodhi. Drejtësi nuk u bë.

Sot, do duhej që të flisnim ne përfaqësuesit e popullit të Kosovës. Do duhej të flisnim, sepse ndërgjegjja jonë nuk do të jetë kurrë e qetë, pa u dënuar ata që na vranë.

Të nderuar,

Viti 2019 shënon 20-vjetorin e përfundimit të luftës në Kosovë. Nga përvojat historike mësohet se pas dy dekadash, vendet dhe shoqëritë e përfshira në luftë arrijnë pothuajse që plotësisht t'i shërojnë plagët dhe t'i rikuperojnë dëmet e saj, por në rrasnin e Kosovës çfarë ndodhi, për fat të keq as nuk u shëruan plagët dhe as nuk u rikuperuan dëmet e saj.

Dhe e gjithë kjo, për shkakun se shteti serb, kurrë nuk e pranoi krimin e kryer në Kosovë. Përkundrazi, gjatë këtyre dy dekadave Serbia vetëm vazhdoi agresionin e saj ndaj Kosovës, me të gjitha mënyrat dhe mjetet, kurse përpallë këtij agresioni ndërorgjegjia ndërkombëtare nëpërmjet misionëve të dështuara; UNMIK dhe EULEX, heshti deri në absurditet.

Krimi i madh serb mbi popullsinë civile shqiptare më '98 dhe '99, kurrë nuk u ndëshkua.

Të nderuar,

Drejtësia siç e thashë, nëpërmjet UNMIK-ut dhe EULEX-it hapur u tregua mospërfillëse ndaj viktimave shqiptare të luftës. Mbase nuk ka as edhe një rast të vetëm që një prokuror apo hetues i këtyre misionëve të ketë iniciuar hetime për ndonjë të prej masakrave që përmenda më sipër.

Edhe përfaqësuesit politik të këtyre misionëve u treguan të tillë. Asnjëherë nuk u kërkua nga Serbia, nuk u kërkuan hartat dhe dosjet e varrezave masive nëpërmjet të cilave do të mund të zbardhej e vërteta e fatit të më shumë se 1600 peronave të zhdukur.

Sikur të mos mjaftonte kjo mospërfillje ndaj këtij krimi të madh, prokuroritë dhe gjyqet e UNMIK-ut dhe të EULEX-it iu qepen pas ish-luftëtarëve të lirisë. Për 20 vite vazhdoi dhe vazhdon ende ndjekja e ish-luftëtarëve shqiptarë nëpërmjet shumë proceseve gjyqësore që kërkohet dhe po kërkohet me çdo kusht dënimi i tyre.

Në anën tjetër, dënimet drakonike që morën shumë ish-luftëtarë shqiptarë, gjatë këtyre proceseve gjyqësore, gati sa edhe nuk e ndërruan komplet bindjen e opinionit botëror për të vërtetën e luftës në Kosovë.

U krijua një situatë absurde. Nuk dihej më, nëse shqiptarët e Kosovës kishin kryer masakra në Serbi apo aparati shtetëror serb, mbi popullsinë e pafajshme në Kosovë.

Për 20 vite, situata degradoi aq shumë me këto procese gjyqësore sa që krimi i Serbisë ndaj shqiptarëve u hesht deri në mohim. Presioni ndaj Kosovës dhe ndaj shqiptarëve që aq i madh, sa që jo vetëm që kërkohet heshtja për krimin, por së fundmi u kërkua të krijoheshin trupa të tjerë përndjekës për ish-luftëtarët shqiptarë.



Nga ky presion i madh, institucionet e Kosovës, dikur u dorëzuan. Pa vullnetin e tyre, u detyruan të krijonin Gjykatën Speciale së bashku me Dhomat e Specializuara në të cilat pretendohet se do të gjykohen shqiptarët për krime lufte.

Sot jemi dëshmitarë sesi hetuesit dhe prokurorët e kësaj gjykate iu kanë kthyer dosjeve të UNMIK-ut dhe EULEX-it për t'i gjetur gjithsesi fajtorë shqiptarët. Por, për këtë heshtje deri në mohim të krimit të madh të shtetit serb mbi Kosovën, nuk janë fajtorë vetëm misionet ndërkombëtare, një pjesë të madhe të fajit e mbanë edhe institucionet dhe shoqëria kosovare, dhe kjo natyrisht që është e pafalshme.

Për ironinë e fatit tonë, për 20 vite u gjend askush që t'i sistemojë me kompetencë provat dhe dëshmitë e këtyre krimeve makabër. Për fat të keq drejtësia kosovare kurrë nuk arriti që të krijojë një dosje provash dhe dëshmish për krimin e shtetit serb, dosje me të cilat shteti i Kosovës do t'i kundërvihet agresionit të sotëm të Serbisë kundër procesit të shtetndërtimit.

Përballë këtij agresioni serb ndaj procesit të shtetndërtimit, ideja për themelimin e tribunalit për krimet e Serbisë në Kosovë, do të ishte më e pakta gjë që do të mund të bënim.

Edhe pse të vonuara, mendoj se institucionet e Republikës së Kosovës, duke angazhuar ekspertët më të mirë që ka Kosova, mund ta hartojnë dosjen për krimin shtetëror të Serbisë mbi Kosovën, për t'ia dëshmuar botës të vërtetën tragjike të Kosovës.

Me keqe qasje, me këtë ikje të dyja partive të mëdha nga Kuvendi, kur diskutohet, kur kërkohet të miratohet një ide jashtëzakonisht e mirë dhe një armë e fuqishme në duart e institucioneve të Kosovës, nuk mund të ecim përpara. Pastaj lind pyetja; kush detyrën e kujt po e bënë në Kosovë?

Zhurma për drejtësi në emër të mbrojtjes së privatësisë, në emër të vonës e tjera, duke anuar hapur partiakisht e jo kombëtarisht, duke stërholluar mendjehollësinë deri në këputje, kush mendon se e drejta mbrohet vetëm me drejtësi, atë do ta bindë koha e tij e pavërtetuar nga jeta e tij.

Kjo logjikë e gabuar e përcjellë tek opinioni, se kush tenton të kërkojë drejtësi do të injorohet, anatohet, sulmohet, të ndëshkohet pra, kush detyrën e kujt po e kryen në Kosovë.

Në vend se tyta të drejtohet nga Serbia dhe kriminelët që bënë gjenocid, ajo po kthehet nga vetvetja e jonë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Lufta për Kosovën ende nuk ka përfunduar. Ne duhet të jemi bashkë. Lufta për mbrojtjen e lirisë dhe pavarësisë dhe shtetndërtimit nuk ka përfunduar. Ne duhet që bashkërisht, politika, shoqëria

civile, mediat, që në këtë front të madh të mbrojtjes së kësaj lufte, ta harrojmë mërinë personale dhe inatet personale dhe egon për pushtet. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka Mexhide Mjaku-Topalli. Urdhëroni, deputete!

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, kryesuese!

Të nderua qytetarë,  
Familje të të pagjeturve,  
Kolegë deputetë,

Fjalimin tim po e filloj me fjalët e duam paqen, por e duam edhe drejtësinë sa do e vonshme që të jetë, dhe se vetëm drejtësia është rruga e paqes.

Njëzet vite pas luftës, shteti i Serbisë vazhdon me të njëjtat politika shoviniste kundër Republikës së Kosovës. Njëzet vite pas luftës, kriminelët serbë, vazhdojnë të jetojnë të lirë në shtetin i Serbisë, duke i shfrytëzuar benificionet më të larta shtetërore, dhe duke mbajtur mbi supe dekoratat e gjakut, krimit e dhunimit.

Sot është po e njëjta Serbi. Sot janë po të njëjtit politikanë, vetëm se tash me uniformë të kamufluar; në dukje uniformë civile, por brendapërbrenda me po të njëjtën egërsi shoviniste.

Sot, në Serbi kemi po të njëjtën strukturë qeverisëse e cila mbi vete mbanë autorësinë e tri luftërave të përgjakshme; në Kroaci, Bosnje, dhe Kosovë. Çuditërisht, akoma e përkëdhelur e Evropës. Madje, e trajtuar me një status special për të.

Për Serbinë, historia e luftërave ka qenë në vazhdimësi histori e krimeve, dhunimeve, dëbimeve masovike të popujve. Histori e gjenocidit mbi popujt e tjerë dhe fatkeqësisht edhe histori e shpërblimeve.

Për Serbinë, të gjitha këto luftëra kriminale janë histori suksesi. Histori, sepse pas çdo lufte, ata i kanë hyjnizuar kriminelët me bekimin e priftërinjve nëpër kisha, dhe lavdet që iu kanë thurur akademikët.

Në ndërdijen e shumicës së serbëve, hero është, Drazha Mihajloviqi, Vojvoda Singjeliq. Pastaj, heronj janë Arkani e Shesheli. Hero është Milosheviqi. Hero është L Lazarviqi, i cili i printe paradës ushtarake në Nish, paradës së paralajmërimit të luftërave të reja në Ballkan.

Ne, çuditemi sesi udhëheqësit e botë së civilizuar, sot presin nga kjo garniturë politike serbe maturi e racionalitet politik. Presin që promotorët e një politike kriminale të shndërrohen në aktorë paqeje.

A nuk ishte po ky Daçiq, zëdhënës i Qeverisë së Milosheviqit, i cili në vazhdimësi promovoi politikën gjenocidiale serbe në Kosovë. A nuk ishte po ky Daçiq, i cili përveçse i masakroi, ai i vret viktimat për së dyti, duke i quajtur terroristë.

A nuk është po ky Vuçiq që edhe sot pas njëzet vjetësh, Masakrën e Reçakut e quan të paqenë dhe të manipuluar, duke i vrarë për së treti këto viktime. A e sheh bota, se duke e amnistuar një politikë dhe një politikan të tillë, ajo në fakt është duke krijuar vrasës serik.

A nuk është kryetari i tanishëm Vuçiq, një ministër i Informimit në qeverinë e Milosheviqit, i cili publikisht deklaronte se; për një serb të vrarë, do të vriten njëqind boshnjakë.

Po ky Vuçiq, i cili festonte kur në Kosovë kryheshin masakrat. Po ky Vuçiq që dje ishte vënë në front kundër tërë botës së civilizuar. Tipat si Daçiq e Vuçiq mund që për një moment të bëhen kameleon, po kurrë nuk mund të dalin nga petku i ekstremizmit ortodoks dhe nacionalizmit të verbëruar.

Vuçiq, tha se rasti i vrasjes së pesë të rinjve serbë, i njohur si rasti Panda, ishte i planifikuar nga Serbia, por kjo deklaratë ngelet aty, sepse ky nuk mund të dalë jashtë petkut të bekuar nga klerikët ekstrem serbë.

Po ky Vuçiq dha premtime për dënimin e vrasësve të vëllezërve Bytyqi. Prapë kjo e mbetur vetëm në deklaratë. Po ky Vuçiq sa e sa vite është duke e qeverisur një Serbi me po ata të cilët bënë krime në Kosovë, dhe për botën e tij shoviniste është krejtësisht e natyrshme që nuk organizon gjyqe për shokët e tij kriminelë.

Jo, sepse ai kriminelët i konsideron si ideologë dhe trasues së formimit të tij.

Dua ta them një të vërtetë që mund të jetë e rëndë, dhe mund edhe të lëndojë pjesën e serbëve të ndërgjegjshëm dhe të evropianizuar.

Serbët në vitet '90-ta, në katër palë zgjedhje nacionale e kanë votuar Milosheviqin me mbi 50% të votave. Madje, duke e ditur qartë programin nacionalist të tij për krijimin e Serbisë së Madhe nëpërmjet luftës.

Kështu vepruan edhe në zgjedhjet e pasluftës, duke i dhënë votën po të njëjtit satrap dhe po të njëjtëve struktura. Edhe pasi u rrëzuar Milosheviqi, serbët votuan me po të njëjtën frymë, duke vazhduar për ta mbajtur në pushtet po të njëjtën garniturë politike, deri në ditët e sotme.

Një nacionalizëm të verbuar të kësaj të natyre e kanë përjetuar edhe vetë gjermanët në kohën e Hitlerit. Edhe ata me votë e kanë zgjedhur prijësin e tyre. Por, për dallim prej Gjermanisë, e cila pas përfundimit të luftës dhe shkaktimit të Holokaustit, u dënua dhe u detyrua t'i paguajë reparacionet e luftës.

Serbia jo që nuk u dënua për krime e dëbime e dhunime, por asaj i ofrohen edhe favore me integritet drejt BE-së.

Për krime kundër njerëzimit, Gjermania u ndëshkua rëndë, por ky ndëshkim ndikoi në emancipimin kolektiv të të gjithë gjermanëve.

Ata sot e kanë të ndaluar me Kushtetutën e Gjermanisë vendosjen e emrit Hitler, ata sot e urrejnë Hitlerin, e urrejnë, sepse akoma sot taksapaguesit gjermanë nga pagat e tyre paguajnë dëmet e luftës.

Politikanët në Serbi edhe sot pas 20 vjetëve të përfundimit të luftës akoma luajnë në letrën e nacionalizmit dhe radikalizmit, si metodë më e sigurt për të ardhur te votat e qytetarëve.

Ata garojnë se kush është më antishqiptar për të fituar vota në Serbi dhe sigurisht fiton ai i cili në programin e tij zgjedhor dhe në fjalorin e tij politik dëshmohet se është më antishqiptar.

Shtroj pyetjen. Pse akoma sot në Serbi është kjo frymë? Pse populli serb nuk përjetoi të njëjtin transformim ideologjik, siç e përjetoi populli gjerman pas Hitlerit? Fare thjesht, populli gjerman u ndëshkua, u dënua, sepse kishte bërë mëkatin kolektiv, populli serb nuk u ndëshkua, nuk u dënua për dëmet që u shkaktoi popujve përreth tij dhe si rrjedhojë edhe nuk u emancipua në masën sa t'i shohë gabimet e tij dhe të vetëkorrigjohet në rrugën drejt Evropës.

Popullit serb i duhet një terapi kolektive, jo për fajin e të gjithëve, po për fajin e shumicës. Shteti serb duhet të dënohet, ai duhet të paguajë reparacione të luftës dhe dëmet e shkaktuara në Kosovë.

Shteti serb ka plaçkitur Fondin Pensional, shteti serb ka ushtruar terror kolektiv, duke i dëbuar mbi një milion qytetarë, shteti serb ka djegur 60% të fshatrave e qyteteve në Kosovë, ata kanë vrarë mbi 13 535 civilë, kanë dhunuar 20 mijë gra dhe kjo peshë e përgjegjësisë dhe e dënimit duhet të bjerë mbi çdo qytetar të Serbisë.

Sot një i punësuar në Gjermani kur e merr pagën e tij të fituar me djersë sigurisht që e nxjerr një ofshamë duke mallkuar Hitlerin që sot, unë edhe pas 70 vjetëve paguaj për çmenduritë tua. Këtë duhet ta përjetojë edhe qytetari serb. Ai duhet ta përjetojë në lëkurën e tij peshën e përgjegjësisë kolektive për veprimet e politikave kriminale që i votoi vetë.

Nëse bota dëshiron ta emancipojë këtë popull, ajo së pari duhet ta dënojë Serbinë në listën e pagës së tij, duhet ta shohë shumë e pagës dhe minusët e tij për dëmet e shkaktuara në këtë luftë për pagat e 20 mijë të dhunuarave në Kosovë.

Në Serbi duhet të shpërthejë lufta e dy botëve, e serbit të ndershëm kundër atij që akoma e ushqen frymën e krimit dhe në këtë betejë është më se e sigurt se triumfon civilizimi.

Në të kundërtën, vetëmashtrimi duke ecur përpara pa ndëshkim të Serbisë ushqen dhe fuqizon një nacionalizëm edhe më ekstrem dhe sjell erë të luftërave të reja edhe më brutale, të atilla çfarë paralajmëroi gjenerali dhe kriminel i luftës Lazareviq, në paradën ushtarake të para disa ditëve në Nish.

Të nderuar deputetë,

Ne edhe 20 vjet pas luftës po jetojmë me plagët e pashëruara të shoqërisë tonë. Ne për çdo ditë ballafaqohemi me viktimat që shikojnë nga ne dhe presin se kur ne do të ndërmarrim një nismë për t'i vënë kriminelët para gjyqit të drejtësisë.

Shumë nga kriminelët serbë, Arkan, Milosheviq e të tjerë, kanë ikur nga kjo botë pa e përjetuar peshën e fajësisë, madje duke u përcjellë si heronj.

Shumë nga viktimat shqiptare tashmë kanë ikur nga kjo botë me dy sy të hapur, me njëri sy të hapur nga çudia se si bota bënë sehir nga tërë kjo padrejtësi, duke mos bërë as të vetmen hap për dënimin e vrasjeve e dhunuesve serbë, e me tjetrin sy se si bota na detyron neve që të bëjmë gjykata speciale dhe tribunale për dënimin e krimeve të supozuara nga ne shqiptarët.

Sot ne duhet të marrim nismën për vendosjen e drejtësisë në vend, kriminelët duhet të identifikohen, të ndiqen dhe të dënohen për krimet e tyre në Kosovë dhe të jeni të bindur se identifikimi i kriminelëve është fare i lehtë, vetëm duhet guxim dhe kurajë.

Vuçiqi e di se kush i ka vrarë vëllezërit Bytyqi, po ky e di edhe kush i vrau pesë të rinj në Pejë “Panda”, sot kemi argumente sa të duam.

Duhet vënë para drejtësisë drejtori i Burgut të Dubravës, Aleksadër Rakoçeviq, ai di për fatin e Ukshin Hotit. Dhe, po ashtu kush e bëri masakrën kundër 150 të burgosurve në Burgun e Dubravës.

Duhet vënë para drejtësisë Rajko Doder, Radovan Klariqi dhe Nebojsa Gjorgjeviqi, ata e dinë se kush i vrau me torturë më mizore të burgosurit Rexhep Bislimin, Cen Dugollin dhe Bilall Shalën. Dhe kështu me radhë do të zbulohen vrasësit e 1230 fëmijëve në Kosovë, vrasësit e 113 burrave në Krushë të Vogël, vrasësit e 32 civilëve në Përroin e Rokocit në Kaçanik, vrasësit e 15 civilëve në Kotlinë, vrasësit e 13 civilëve në Sllatinë të Lepencit, të vrarë në prani të familjeve të tyre, vrasësit e 10 civilëve në Gaqë dhe Bibaj të Ferizajt.

Drejtësia duhet t'i vejë në pranga kriminelët, të cilët kishin përpiluar listën e patriotëve që duhej vrarë e të cilën listë e vuri në zbatim më 24 mars 1999, duke i kidnapuar dhe vrarë intelektualët ferizajas Ali Shefik Sapahiun, gazetarin Haki Braha, patriotët Ismet Ramadani e Zenun Beqa.

Drejtësia duhet t'i vendosë prapa grilave ekzekutorët e 400 masakrave të bëra anekënd Kosovës.

Akti i vendosjes së drejtësisë duhet të konsiderohet si vlerë universale.

Në këtë proces ne dhe ndërkombëtarët duhet të jemi në partneritet të plotë, sepse nuk mund të kemi pajtim ndërmjet popujve pa u dënuar kriminelët.

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Ne sa më parë duhet t'i kryejmë obligimet tona si institucione, ta vëmë po ashtu në zbatim edhe strategjinë e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe t'i krijojmë dosjet e gatshme për të gjithë ata kriminelë, të cilët kanë mbetur të pandëshkuar deri më tani.

Ne kemi po ashtu edhe dëshminë e William Walker-it që tronditi botën perëndimore me deklarinimin e tij burror. "Ajo që pashë në Reçak është krim kundër njerëzimit, aty u vranë 45 qytetarë, pleq, të rinj dhe vrasësit e tyre dihen, dihen, sepse dihet struktura komanduese ushtarake që e mbulonte atë zonë".

Të nderuar të pranishëm,

Nuk mund ta përfundoj fjalën time pa e ngritur edhe një shqetësim timin përkitazi një foto të publikuar në një seancë të mëparshme që fatkeqësisht rezultoi që ishte jo e vërtetë.

Ne të gjithë e dimë se policia, ushtria e kriminelët serbë kanë kryer afro 20 mijë dhunime në Kosovë. Edhe kjo që u bë temë e diskutimeve, e reagimeve, ne të gjithë e dimë që ngjarja ka qenë e vërtetë.

Dihej me emër e mbiemër se cila femër e përjetoj atë fatkeqësi. Kjo domethënë se dhunim kishte, sa ajo pamje e prezantuar nga deputetja, kolegja jonë Brovina doli se nuk ishte e vërtetë, është një gjë për mua minore krahas të vërtetës së dhimbshme se kishte dhunim, kjo i ngjason

proverbit kur fshatari i thotë fshatarit: “Ja fërkemët e ujkut, e tjetri i pret, ore lëri fërkemet, po ja ku është ujku”.

Sikur ne kolegët të nderuar po i drejtohem opozitës, jemi të prirë që nismat e mbara të këtij Parlamenti dhe frontin unik për ndriçimin e fakteve dhe dënimin e kriminelëve e shndërrojmë në betejë të brendshme, e me këtë e humbim edhe drejtimin ku duam të shkojmë dhe nismën për tribunal.

Ne para vetes kemi një deputete, një humaniste, një të burgosur që përjetoi tmerret e luftës, i përjetoi mbi lëkurën e saj dhe për një gabim, të cilën çdo kush nga ne mund ta bënte, ne e linçojmë atë, madje e linçojnë edhe organizatat, të cilat thirren për mbrojtje të viktimave, të cilat edhe protestuan sot në mbrojtje të viktimave të luftës, duke harruar se po e bëjnë edhe një gabim, duke dhunuar po një viktimë të luftës, e cila bëri një gabim të rastësishëm në rrugën e saj të prezantimit të fakteve.

Viktimat e dhunës nuk janë të rrezikuara nga deputetja Flora Brovina, fundja, nga ky gabim mësuam shumë dhe e pamë edhe arsyen e bllokimit të kësaj seance nga kolegët tanë, e cila për mua është tejet e pakuptimtë.

Viktimat e dhunës seksuale janë të rrezikuara nëse drejtësia nuk i nxjerr kriminelët para gjyqit, viktimat e dhunës seksuale goditen e nëpërkëmbën kur ato ikin nga kjo botë pa u dhënë trajtimi dhe përcjellje dinjitoze, siç u bë me dëshmitaren e parë të dhunimit, zonjën tashmë të ndjerë Marte Tunaj, nën e një ushtari të UÇK-së dhe gjithashtu edhe grua e një ushtari të UÇK-së, e cila vdiq më 16 maj 2016.

Kujtojmë se nga dëshmia e saj kriminelin Milosh Jokiç u dënua më 20 vjet burgim.

Nëse ndonjëra nga viktimat e dhunës seksuale do të kenë qenë në përcjelljen e fundit të amshim të zonjës Marte Tunaj, ajo me siguri se do të jetë lënduar e vrarë si mos më keq.

Unë nuk kujtoj ndonjë reagim nga kolegët konform peshës së dhembjes për këtë grua trime nga komuna e Vitisë.

Të nderuar deputetë,

Sot mbase është një moment ku të gjithë ne nuk duhet të shikohemi se kush cilës parti i përket, e po të kishte pak frymë më humane, nuk duhet të shikoheshim edhe kush cilit nacionalitet i përket.

Ne sot duhet të jemi përkrah kauzës tonë për një nismë shumë sublime, për një rrugë të vendosjes së drejtësisë karshi viktimave, krimeve të bëra nga Serbia kundër popullit tonë.

Sot këtë kauzë duhet ta trajtojmë në një mënyrë të vetme.

Të gjithë deputetët duhet ta ndjejnë veten si nismëtarë të fillimit të procedurave për tribunal dhe 120 deputetë duhet të ishin dhe të jenë këtu votues të kësaj iniciative.

Kjo është mënyra për t'i nderuar viktimat e luftës, kjo është mënyra për t'i dridhur kriminelët e luftës.

Dhe, në fund, po kthehem te çështja që sot jemi mbledhur të diskutojmë për tribunalin. Ky tribunal duhet të ndodhë, andaj mendoj se si pjesë e Komisionit shtetëror duhet të jetë edhe për përfaqësues i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Peticione si dhe do të ishte mirë që kërkesa e drejtuar e institucioneve tona që Burgu i Prishtinës të shpallet Muze, sigurisht që do të ishte e rrugës të futet edhe në këtë agjendë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Shkumbin Demalijaj, urdhëro!

**SHKUMBIN DEMALIJAJ:** Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe pse është seancë e njëjtë, për të dytën herë po e marr fjalën, se po flasim për të njëjtën gjë, po për të dytën ditë.

Konsideroj se baza e kërkesës nga ju, zoti kryetar, për ndërtimin e këtij Tribunali ndërkombëtar edhe nëse nuk është e ndërtuar mbi bazën qenësore apo edhe ka gabime në bazën e kërkesës për harmonizim, kjo kërkesë ka bazë shumë të madhe, sepse shumë deputetë mendonin ta ndanin pjesën institucionale politike nga pavarësia politike që është gjyqësori.

Unë u them me të drejtë të gjithë kolegëve, në këtë rast edhe nga opozita që nuk janë këtu, sepse kjo bazë lind. Zotit Konjufca i duket shumë larg OKB-ja dhe thotë këtë gjë mund ta ndërtojë vetëm OKB-ja, jo ne. Ne kemi bazë ligjore edhe te OKB-ja. Nëse nuk mundemi institucionalisht apo në formën e raporteve që bëhen për Kosovën në OKB që na përfaqëson ambasadorja jonë atje, shpesh edhe kanë marrë pjesë mekanizmat tanë institucionalë.

Është bazë ligjore e mjaftueshme Rezoluta 1244, përderisa nuk kemi një bazë tjetër ligjore që na lidh me OKB-në, sepse s'e kemi arritur lartësinë e shteteve që na kanë njohur për të qenë pjesë e OKB-së.

Nëse nuk na lidhin Kushtetuta dhe ligjet tona, na lidhin konventat ndërkombëtare për krimet e luftës, këtë duhet ta dinë deputetët tanë juristë nga opozita që janë bërë kaq institucionalistë sa që nuk shohin tjetër gjë veç të merren me përmasa lokale edhe institucionale komunale.



Ai gjenocid i paparë që ka ndodhur në Kosovën tonë, pa qenë ne hiç pjesë e mekanizmave ndërkombëtarë, ka ndërhyrë edhe e ka pranuar atë gjenocid edhe sot jemi shtet, e sot duke funksionuar si shtet, nuk po mund të jemi pjesë e një baze të drejtësisë ndërkombëtare. Nuk di çka po mendojnë këta njerëz.

Hiç nuk na duhet vota e tyre, sepse po shihet haptazi se e kanë për një pushtet edhe për një pushtet veç për të qenë në pushtet, jo për të punuar dhe ta duan shtetin. Lidhja e tyre me LDK-në po na befason shumë, vetë opozita, nga Vetëvendosja. Ku janë 63 kallëzime penale, zoti Kurti dhe zoti Konjufca që ia keni bërë Isa Mustafës për qeverisjen lokale. A u keni shkuar deri në fund apo keni gënjyer ose kërkoni falje. Në atë pushtet ka marrë pjesë edhe zoti Hoti, është pjesë e atij kriminaliteti financiar që ka ndodhur aty, nëse ato padi, ato kallëzime penale kanë qenë të vërteta. Për 63 kallëzime penale keni fol një vit sa ka qenë Isa Mustafa në qeverisje. Sot marramendësisht çohet Avdullah Hoti dhe duke folur për PAN-in kur vjen puna te kryeministri e quan “bandë kriminale”, kriminel është vetë Avdullah Hoti. Çka ka bërë për Kosovën? Ku mund t’i thuash një kryeministri “bandë kriminale”? Ky zotëri është pjesë e të gjitha krimeve financiare që kanë ndodhur për ato që flasim sot edhe në postë, edhe në të gjithë mekanizmat, e shfrytëzon foltoren e Kuvendit për shkak se nuk mund të akuzohet. Ik prej këtu se ofendon dhe nuk mund të ballafaqohet me problemin, ia rikujtoj historikisht, për herë të parë Ramush Haradinaj u bë kryeministër nga vetë ideologu i tyre shpirtëror, Ibrahim Rugova. Ibrahim Rugova paska pas bashkëpunuar me bandat kriminale, Avdullah Hoti atëherë s’është marrë as me politikë, as s’e ka njohur kurrkush. S’di çka mendojnë këta njerëz!

Kryetar, e ke përkrahjen edhe të Aleancës, edhe timen personalisht, krimet duhet të zbardhen pavarësisht kush i ka bërë. Në qoftë se edhe shqiptarët kanë bërë krime gjatë luftës, e kemi thënë vetë, e kemi mbaruar një Gjykatë Speciale për këtë çështje, e sot po duam të ndërtojmë një tribunal, një kërkesë për t’iu drejtua bashkësisë ndërkombëtare, për t’i dënuar dhembjen shpirtërore të atyre mijëra viktimave që sot janë edhe të zhdukur, janë edhe të gjallët që i kanë depozituara ato kërkesa, flasin për çështje politike e konsum të brendshëm për çështje të votës. Unë konsideroj edhe diçka lidhur me Lidhjen Demokratike të Kosovës, këta njerëz duhet KQZ-ja t’i trajtojë në mënyrë ligjore, që tri herë ua ka legjitimuar kuvendet e tyre zgjedhore. Kjo parti nuk i duhet Kosovës ta quajë dikë kriminel, e vet me kriminalitet vijnë në pushtet dhe ndërtojnë udhëheqësit e tyre. E dini kuvendin e karrigeve të tyre, e dini kuvendin e tyre të djeshëm, e dini edhe kuvendin e fundit që e ka pasur Lidhja Demokratike e Kosovës, kur zonjat e nderuara, po flas Donika Gërvallën, Vjosa Osmanin me bandat e tyre i nxjerrin prej kuvendit me dhunë edhe nuk i lënë të marrin pjesë në kuvendet e tyre zgjedhore. Çfarë demokracie mund të prodhojë edhe çfarë të drejte mund të fitojë një subjekt politik që vjen me dhunë në pushtet brenda partisë së vet. Kjo është demokracia e tyre e brendshme. Unë nuk njoh diku demokraci që një kryesi e një partie vjen me dhunë në krye të asaj partie dhe i fol dikujt për kriminalitet edhe për demokraci. Këtë le ta dijë krejt bashkësia ndërkombëtare, ambasadorët e akredituar në Kosovë,

sepse ata njerëz që dikujt dinë t'i thonë "kriminel", të arriturat e tyre politike i kanë nëpërmjet rrugëve kriminale në vetë demokracinë e tyre të brendshme.

Unë kërkoj edhe një herë, se e kam thënë edhe fjalën atë natë lidhur me të gjitha çështjet, të gjithë mund të gabojmë gjatë jetës, por gabimi nuk është i regjistruar fare lidhur me madhësinë e këtij projekti kaq gjigand që po flasim. E tha gjenerali Daut Haradinaj, deputeti i nderuar, ne nuk i kemi pasur në dorë shtyllat e UNMIK-ut, nuk i kemi pasur në dorë EULEX-in, ata kanë ndërtuar gjithçka për neve. Vitin e kaluar e ka përfunduar misionin EULEX-i në Kosovë, ende këta njerëz nuk kanë arritur për dy gjykatës që i mungojnë Gjykatës Supreme, Dhomë e Veçantë për t'i çuar të drejtat legjitime të kërkesave të njerëzve që kanë bërë kërkesa për t'ua zgjidhë kjo gjykatë lidhur me çështjet pronësi juridike të tyre, për dy gjykatës nuk na funksionon Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme, për shkak se nevojitet për t'u ndryshuar ai ligj. Këta janë që për çdo ditë nuk e kanë problem a dëmtohet shteti për votën e tyre, por e kam edhe një kërkesë që është autokritikë, kryetar, kur kemi të bëjmë me çështje të tilla, kërkoj që koalicioni jonë PAN krejt deputetët le t'i ketë në sallë, e kryejmë vetë, pa fjalimet dhe pa dëshirat e tyre. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Andin Hoti, urdhëro!

**ANDIN HOTI:** Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Shumë të respektuar familjarë të të pagjeturve që jeni të pranishëm këtu dhe ata që nuk janë të pranishëm këtu,

Shumë të respektuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në fakt sot nuk ka se si të mos ndihemi të lehtësuar, sot ne familjarët e personave të zhdukur dhe të vrarë në luftën e fundit në Kosovë. Ne që sot ende vazhdojmë të paguajmë tagrin e lirisë.

Ne kemi dashur gjithmonë vetëm një gjë, e ajo është drejtësia. Ky tribunal i iniciuar nga kryetari i Kuvendit, zoti Kadri Veseli, na jep një shpresë që do të vijë një pjesë e drejtësisë në vend. Po kërkojmë dëshmi në këtë vend, unë mendoj që nuk ka nevojë të lypen as dokumente, asnjë lloj dëshmie, ka nevojë veç të ecet këta muajt e fundit nëpër Kosovë, nëpër fshatrat ku ka ndodhur gjenocidi, ku kanë ndodhur krimet dhe i ndjeni dëshminë e krimet, i ndjeni këto, s'ka nevojë asnjë dokument për këto. Nuk ka dëshmi më të madhe se sa masakrat që kanë ndodhur anekënd Kosovës, e dëshmi për to në fakt janë të mbijetuarit e atyre masakrave të tmerrshme që, për fat të mirë, ende jetojnë sot. Nuk ka dëshmi më të madhe se sa ajo nënë atje mbrapa që po e shoh që vazhdon ende sot të kërkojë fatin e birit të saj, ajo i ka dëshmitë, ajo vetëm duhet të dëgjohet, duhet të merret parasysh, ajo është zonja Nysrete Pllana. Nuk ka dëshmi më të madhe se sa marrja me forcë e babit tim nga Burgu i Dubravës nga shteti serb, nga nëpunësit e saj, domethënë nga institucioni më i lartë i një sigurie të një shteti. E dëshmi janë pikërisht këta nëpunës dhe drejtori i burgut që ende sot jetojnë të lirshëm dhe me privilegje diku në Serbi. Nuk ka dëshmi më të madhe se sa data e nesërme, në fakt, 19, 20, 21 të vitit 1999, kur është kryer gjenocidi, kur

është kryer masakra në Burgun e Dubravës. Nesër ne e kemi seancën për atë pikë dhe mjafton vetëm të lexohen librat nëse nuk keni qenë në atë kohë të pranishëm ose nëse nuk keni mundur ta dini këtë ngjarje, mjafton vetëm ta lexoni librin e masakrës të tmerrshme të Dubravës dhe nuk kemi nevojë për dëshmi të tjera që të shihet se Serbia vërtet ka kryer gjenocid në Kosovë, vërtet ka kryer krim që nuk është parë diku në botë.

Mbi këto dëshmi, në fakt, ka qenë edhe arsyetimi i bombardimeve të NATO-s mbi regjimin serb për të parandaluar shfarosjen e tërë shqiptarëve në trojet e tyre, po ua kujtoj dhe Bill Klintonin. Ndër shumë dëshmi e masakra që më 16 maj dhe sot u thanë nga kolegët e mi deputetë, nuk guxon të harrohet në asnjë mënyrë edhe masakra e Krushës së Vogël, nga e cila janë masakruar mbi 80% të meshkujve të një fshati, konkretisht 113 persona meshkuj të këtij fshati. Nga e cila kanë mbetur shumë gra dhe fëmijë pa burra dhe pa prindër. Nuk guxon të harrohet edhe masakra e tmerrshme e Krushës së Madhe, ku janë vrarë 241 persona, prej të cilëve 7 fëmijë, 5 femra dhe një grua shtatzëne, paramendojeni edhe gratë shtatzëna i kanë vrarë. Shtatë familje në atë fshat kanë mbetur pa asnjë mashkull, 148 gra kanë ngelur të veja, 510 fëmijë kanë mbetur jetim pa njërin apo të dy prindërit, mbi 900 shtëpi të djegura, duke përfshirë edhe objektet kulturore e fetare.

E nderuar bashkësi ndërkombëtare,

Plagët në këto vende janë ende të freskëta dhe mund të preken, mjafton që gjatë këtyre muajve: shkurt, mars, prill, maj, të jeni prezentë në ato vende dhe do të ndjeni gjenocidin, krimin makabër që ka ndodhur në Kosovë, dëshmi është edhe babai i djaloshit me dy zemra që dy policë serbë të uniformuar ia kanë nxjerrë zemrën me thikë për së gjalli vetëm për të përmbushur etjen e tyre kafshërore kriminele në sytë e babait të tij. Nuk mund t'i përmend të gjitha dëshmitë këtu, të gjitha masakrat që kanë ndodhur anekënd Kosovës, në Celinë, Fortesë, Pastasel, Brestovc, e anekënd edhe komunës së Rahovecit, ku numri total e kalon 806 persona të vrarë. Meqenëse marrëzja serbe sot 20 vjet pas po guxon ta mohojë krimin, të cilin e ka parë bota para 20 vjetëve, fjalët e mia dhe të secilit deputet këtu nuk janë tregime fantastike, dhe fatmirësisht në secilin prej këtyre masakrave ka të mbijetuar që janë dëshmitarë të gjallë të krimit të organizuar, të planifikuar dhe të urdhëruar nga forcat serbe.

Të nderuar qytetarë,

Po të nderuar dhe ju skeptikë dhe ju kundërshtarë të Tribunalit ndërkombëtar, të jeni të bindur, tribunali do të bëhet, drejtësia do të vihet në vend. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Mërgim Lushtaku, urdhëro!

**MËRGIM LUSHTAKU:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Të nderuara familje të prekura nga lufta, nga masakrat e shumta nga gjenocidi serb,

Familje të dëshmorëve, martirëve,

Familjarë të të zhdukurve,

Unë sot nuk kam dashur të flas, për arsye se edhe në këtë seancë javën e kaluar kemi miratuar një rezolutë për gjenocidin serb të kryer në Kosovë, por më shtynë disa kolegë deputetë se sot ku na duhet më shumë se kurrë një unitet për themelimin e një tribunali për gjenocidin serb të kryer nga ushtria dhe policia serbe ndaj popullatës shqiptare në Kosovë, është turp, madje edhe mendoj që unë që këto kundërshtime të ulen në këtë nivel politik, partiak, nuk është dashur kurrë të bëhet kjo.

Se ju sot kur ne e aprovuam rezolutën për dënimin e Serbisë që ka kryer gjenocid të popullatës kosovare. Është koha kur institucionet e vendit të merren në hapjen e dosjeve dhe të krimit të komunizmit, si dhe Ligjin për pastërtinë e figurave politike dhe publike në të gjitha institucionet. Po të ishte kryer kjo çështje në kohën kur është iniciuar dhe paraqitur në Kuvendin nga Partia Demokratike e Kosovës, para tre mandateve, sot do të ishte përkrahur iniciativa për themelimin e Tribunalit ndërkombëtar për gjenocidin serb në Kosovë.

Andaj, të nderuar kolegë deputetë, po mendoj dhe po kërkoj që të nxjerrim edhe të aprovojmë rezolutën për dënimin e krimeve të komunizmit, e cila është paraqitur shumë më herët në këtë Kuvend, por nuk është aprovuar asnjëherë. Në këtë rezolutë të futet kërkesa urgjente edhe Ligji për pastërtinë e figurës së zyrtarëve dhe bartësve të pushtetit në të gjitha institucionet e vendit. E përmendën edhe shumë kolegë deputetë se çfarë kanë qenë në gjendje të bëjnë ata, të cilët ishin mbështetur nga aparati shtetëror, atyre aktivistëve, liridashës, të cilët kanë kontribuar për lirin dhe çlirimin e vendit. E them këtë, sepse po të kishim figurat e pastra në këtë Kuvend, jam i bindur se sot nuk do të refuzohej kjo iniciativë. Në vend që të flasim për iniciativën për themelimin e Komisionit shtetëror për themelimin e Tribunalit ndërkombëtar të gjenocidit serb, ne duhet të flasim për partitë politike, të cilat po bojkotojnë këtë iniciativë me motive të ulëta, për politikë partiake.

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Gabimi i shfaqjes së një fotografie në publik nga kolegja jonë nuk duhet të merret si shkas i mosmbështetjes së iniciativës për një tribunal. Deputetja në fjalë kërkoi falje publike dhe ne edhe si deputetë, edhe si parti politike të gjithë jemi deklaruar se nuk ka qenë e mbështetur nga paria politike dhe ne të gjithë së bashku, bashkë edhe me deputeten në fjalë, kemi kërkuar falje për këtë gjë. Por, kjo kolege deputete nuk mund të rrijë peng i një gabimi dhe të refuzohen iniciativa jetike për Kosovën, për themelimin e Tribunalit ndërkombëtar për gjenocidin serb. U përmend edhe nga të gjithë kolegët deputetë, të gjitha këto masakrat, të cilat janë vetë dëshmi, edhe varrezat ku shkojmë në akademitë përkujtimore, kur shkojmë dhe i përkujtojmë dëshmorët, martirët e vrarë nga krimi dhe nga aparati shtetëror serb. Këto janë dëshmi që flasin vetë. Ne e

dimë shumë mirë që në Parlamentin Evropian në vitin 2018 është aprovuar rezoluta për dënimin e gjenocidit serb në Srebrenicë. Edhe atëherë është konsideruar se është vonë, po e dimë se gjenocidi dhe krimet e luftës kurrë nuk plaken, andaj ne duhet t'i kërkojmë që të zbardhet çdo krim, çdo gjenocid, çdo masakër që është bërë edhe në Kosovë.

Duke u nisur nga ky fakt që një gabim po merret si pretekst për mosmbështetje të iniciativës, na jep të kuptojmë se pastërtia e figurës është e domosdoshme, sepse njerëzit me figura të pastra, po e përsëris, do të dinim të ndanim problemet nga një problem i vogël nga ajo që është më unifikuese për një shtet. Nuk do t'i koktollisem për të mos marrë përgjegjësi, për të mbështetur iniciativën për themelimin e një tribunali. U bëj thirrje edhe një herë partive politike, që të jemi unikë në krijimin e një tribunali, të shikojmë metodat, mënyrat se si të llojmë që të formohet ky Tribunal ndërkombëtar dhe të llojmë që të formohet ky tribunal ndërkombëtar. Besoj që roli i tyre më i rëndësishëm është këtu në Kuvend dhe ta japin ata kontributin këtu për diskutim të mëtutjeshëm për zgjidhjen e këtij problemi. Qysh kemi qenë unik në miratimin e rezolutës për gjenocidin serb të kryer në Kosovë, duhet të jemi unikë edhe për mekanizmin për dënimin e këtyre veprave. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Bekim Haxhiu, urdhëro!

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar familjarë të të pagjeturve, të shoqatave,

I nderuar baca Bajram,

Nuk ka nevojë shumë që ne të mendojmë për krimet, edhe për argumentet. Një prej fakteve është mu baca Bajram, familjar i të zhdukurve, jo vetëm të luftës së fundit, por edhe të Luftës së Dytë Botërore. Kjo e përshkruan edhe historinë tonë sesi kemi kaluar, nga kemi ardhur këtu. Baca Bajram sot i kërkon eshtrat e të pagjeturve, familjarëve të luftës së fundit, po nuk i ka gjetur as ata të Luftës së Dytë Botërore. Si baca Bajram ka plotë familje në Kosovë që nuk i kanë gjetur eshtrat e familjarëve të tyre as në Luftën e Dytë, as në luftën e Shaban Polluzhës, e as në luftën e fundit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ka shumë argumente për krimet që kanë ndodhur në Kosovë. Prandaj nuk ka nevojë për asnjë improvizim. Thanë e deklaruan më që deklarimi i Flora Brovinës ishte një gabim. Po çka e shtyri Saranda Bogujevcin të thotë që më kanë thirrur familjarët e viktimës, po kërkojnë të hiqet fotografia. Kush e kishte thirrur? A regjisori, a aktori? Ju lutem! Pse po tentohet që kjo të përdoret për qëllime politike?

Ky tribunal nuk po bëhet për të drejtuar gishtin ne mes vete ndaj njëri-tjetrit. Mos të largohemi nga fokusi. Është gabim që shpeshherë deputetët bëjnë gabime të tilla, që kur ka tema dhe çështje të mëdha me interes të madh të publikut, tentojnë ata edhe subjektet e tyre të vendosen në pah.

Ata të jenë fokusi. Nuk duhet të jemi ne fokusi. Fokusi duhet të jetë dhe të orientohet drejt Serbisë, nga ku ka prodhuar të gjitha krimet në Kosovë.

Ju lutem kolegëve deputetë të opozitës, absolutisht kur të duan në cilindo moment që janë të gatshëm të matemi politikisht te zgjedhësit tanë, do të shkojmë te kutitë e votimit qysh shkuam dje. Edhe dje u treguam, të gjitha parti shqiptare politike dje dolën më pak se Partia Demokratike. Na patën lodhur me do sondazhe, jo ky sondazhi e ka qit të dytin, jo të tretin, të katërtin, jo të pestin. Ja sondazhi i popullit. Edhe kur të doni do të shkojmë te kutitë e votimit, por ju lutem është fyerje për të gjitha viktimat e luftës ta braktisin seancën kur dëshirohet të formohet Tribunali për krimet serbe në Kosovë, kur duhet të formohet komisioni shtetëror për këtë. Kur duhet të ketë unitet mes partive politike, partitë politike dëshirojnë të vijnë në pushtet duke përdorë viktimat e luftës. Të përdorë për disa vota, për disa poenë politikë. Po kërkohet koka e Flora Brovinës dhe e Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, duke e amnistuar ata që vërtet kanë prerë koka të fëmijëve në Kosovë, ata që kanë prerë e kanë vrarë shqiptarë tonë. Ata që vërtet me sopata kanë prerë koka të shqiptarëve në luftën e fundit. Kështu i amnistojmë.

Si nuk mund të formojmë tribunal ndërkombëtar? Po si u krijua Tribunali i Hagës për krimet e supozuara të UÇK-së? Ju lutem, kolegë!

Të nderuar deputetë,

Këta kolegët e LDK-së pas luftës kanë formuar një komision për hetimin e krimeve të luftës së UÇK-së, po këta sot nuk janë të gatshëm ta bëjmë një komision për krimet e Serbisë. E braktisin seancën. Këta të tjerët kanë sponsorizuar Dik Martin e David Filipin e u kanë përpiluar raport kundër UÇK-së, derisa e ka sjell Gjykatën Speciale në votim Parlamenti i Kosovës. E këtu kanë bërë lojëra pastaj. Këtë e kanë bërë vetëm me një qëllim, për largim nga skena politike të kreut të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe më pastaj si e kanë arritur qëllimin, d.m.th. prej kësaj janë tërhequr.

Ne e kemi votuar Gjykatën Speciale. U tha dje edhe nga Albini, u morën disa shifra që krimet në ish-Jugosllavi në luftërat e fundit janë shumica të pagjykuara. Numri të cilin e potencoi është shumë i vogël. Edhe pse ka pasur një tribunal ndërkombëtar të Hagës për këtë. Këto janë dy argumente që ne mundet shumë fuqishëm t'i përdorim për krijimin e tribunalit për gjykimin e krimeve serbe në Kosovë. Një, që tribunali i Hagës nuk ka arritur as dhjetë për qind të vendosë urdhërdhënësit dhe ekzekutorët e krimeve në ish-Jugosllavi. Dhe e dyta, ne kur kemi bërë një tribunal për krimet e supozuara të UÇK-së, tani e kemi një mundësi më shumë që vërtet ta bëjmë tribunalin për krimet serbe në Kosovë dhe tani të gjithë ata që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar krimet në Kosovë të dënohen me këtë tribunal dhe të mos mbetet asnjë krim në Kosovë i pagjykuar.

Ky është një argument më shumë për kolegët e opozitës se duhet të rrinë në sallë, e duhet të bëhemi bashkë ta votojmë. Nuk mundet këtë ta përdorë për qëllime politike, të thotë se ne nuk mund të bëjmë tribunal. Po mund të bëjmë tribunal. Nëse e bëjmë komisionin shtetëror dhe këtë komision shtetëror, ky komision shtetëror ka për mbledhur argumentet dhe këto ka për t'i prezantuar në çdo parlament të Evropës, edhe në Parlamentin Evropian, dhe pastaj të bëhet tribunali për krimet e Serbisë në Kosovë. Kështu mund ta bëjmë. Por jo të përdoren këto seanca për qëllime politike, edhe nga sekretari i dhunës i Vetëvendosjes që tani është bërë kameleon i pushtetit, herë të Shpendit, herë të Ramushit, edhe të thotë nëse jeni të gatshëm ne sot do ta bëjmë strategjinë për ta rrëzuar Qeverinë. Kur t'i keni votat, rrëzoheni Qeverinë. Por nuk mund t'i lëmë këto iniciativa, sepse kjo është argumenti më i fortë.

Pse nuk ka pasur deri sot rezolutë për gjenocidin serb në Kosovë, pse s'ka pasur tribunal? Sepse partitë politike kanë provuar çdoherë vetëm të përdorin çdo momentum për qëllime të pushtetit, për të marrë ca vota, për të ardhur në pushtet. Mund të vijnë në pushtet, por mund të vijnë me programe, po jo duke ofenduar sot. Jo duke injoruar viktimat e luftës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Për të qenë në fokus të temës dua t'ju marrë disa shembuj në zonën ku kam qenë gjatë luftës. Afër Mitrovicës, në vitin 1999, menjëherë pas fillimit të bombardimeve, njësitë policore dhe ushtarake, dhe njësitë enkas të ardhura për këtë qëllim 'Frenkit' në qytetin e Mitrovicës kishin paralajmëruar ikjen. Shqiptarëve u tha që duhet të iknit të braktisnit shtëpitë e juaja, sepse Kosova nuk është më shtëpi e juaja, nuk është vendi juaj, ju duhet të shkoni në Serbi.

Ata që nuk dëgjuan u vranë. Një dëshmi për këtë është masakra e Bajrit e njohur si te Kovaçët, ku për një natë u vranë 30 shqiptarë, të gjithë ata që kishin qëndruar në shtëpitë e tyre. Brenda asaj nate ishin djegur edhe 80 shtëpi dhe të gjithë ata që u zunë në shtëpitë e tyre u vranë. Kolonat e shqiptarëve të dëbuar nga Mitrovica në drejtim të Shqipërisë, pra gjatë aksit rrugor Mitrovicë-Skenderaj-Klinë dhe Gjakovë në drejtim të Prizrenit ishte varg i madh. Ishin detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre edhe ata që ishin invalidë, që nuk ishin të aftë. Një rast po jua marr shembull, në familjen që më ka rastisur ta takojë, familjen Tërstena. Familjarja apo kryefamiljari i tyre Elezi kishte bërë aksident në fillim të viteve '90-ta dhe gruaja me fëmijët e tij me karrocë, nga Mitrovica kishin arritur për 16 kilometra ta bartin me shumë vështirësi deri në fshatin Tërnavc, vendlindjen time. Aty nuk kishin mundur më. Kolona po ecte, policia po i kërcënonte dhe u detyruar ta vendosin në një shtëpi më të afërt, që ishte shtëpia e një kushëririt tim, Azizit. Kishin shkuar ata në kolonë, familja Tërstena deri afër Gjakovës dhe pastaj ishin detyruar të ktheheshin. Çka ndodhi me Elezin? Elezi në katin e dytë të shtëpisë, i paralizuar po rrinte vetëm. Për të mbajtur shpirtin e tij kishte gjetur një gotë të cilën e ofronte natën për të pirë ca ujë, sepse ditën nuk guxonte, sepse forcat serbe ishin shumë afër tij. Për nëntë ditë Elezi mbijetoi ashtu. Kur familja po kthehej tani nga Gjakova për Mitrovicë e shohin Elezin që qoshen e shtëpisë ende aty, po nuk kishin mundësi ta merrnin me vete. Shkojnë deri në Mitrovicë dhe kërkojnë nëse ka

dikush që mundet në fshatin Tërnavc ta marrin atë. Na kontaktuan familjarët e tij, përmes disa kushërinjve dhe ne ditën e dhjetë e vëzhguam tërë situatën për të shpëtuar Elezin. Me ushtarët e mi, hymë në shtëpinë e Azizit. U tmerrua kur na pa fillimisht Elezi, edhe ishte i dërmuar nga mungesa e ushqimit dhe ujit, dhe ishin forcat serbe shumë afër dhe mendoi që hyrën policia serbe edhe ta vrisnin. I treguam që jemi shqiptarë dhe që jemi të UÇK-së. E morëm me radhë deri në zonën tonë ku po strehoheshin në malet e Brusit e të Leskës afër 30 mijë shqiptarë që ishin detyruar të braktisnin shtëpitë e tyre nga Mitrovica dhe fshatrat përreth dhe nga Skenderaj dhe fshatrat e tjera. Elezin e bashkuam me familjen e tij, por fati i jetës e rëndoi edhe më shumë. Edhe në Zhabar ku ishte vendosur u detyrua të largohej nga policia dhe ushtria serbe dhe diku afër Pirqit një granatë kishte rënë në rimorkion e traktorit me të cilin po transportohej dhe kishte vrarë disa anëtarë të familjes së tij dhe Elezi ishte plagosur sërish.

Dua të marr shembull këtë moment dhe momente të veçanta si kjo për të dëshmuar që krime në Kosovë ka pasur në çdo hap, çdo pëllëmbë e këtij vendi është e lagur me gjak, prandaj ne nuk ka nevojë për asnjë improvizim, vetëm për argumentim të asaj që ka ndodhur në Kosovë.

Qytetarë të Mitrovicës të cilët ishin detyruar disa të shkonin për Shqipëri, disa të tjerë ishin kthyer nga Gjakova, disa nga fshatin Gremnik, në Skenderaj ishin ndarë burrat nga gratë. Burrat ishin internuar në shkollat afër aty, ishin burgosur dhe mbaheshin dhunshëm. Në një ditë ata merren mburojë e gjallë e ushtrisë serbe për të depërtuar në pozicionet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Jam dëshmitar i asaj që në pozicionet për tentativë për të depërtuar atje ku ishin të strehuar 30 mijë qytetarë shqiptarë në malet e Brusit e Leskës, po përpiquej që të viheshin deri atje policia dhe ushtria serbe duke përdorë shqiptarë të tjerë mburojë të gjallë. Ishin plot qytetarë të Mitrovicës dhe të Skenderajt, të burgosur që po detyroheshin si mburojë e gjallë, me qëllim që nëse ka ndonjë mjet si minë apo diçka tjetër, që të paktën shqiptarët të bien ose të tjerët.

Janë këto argumente të mjaftueshme të cilat e dëshmojnë gjenocidin e policisë dhe ushtrisë serbe në Kosovë, dhe shtetit serb në Kosovë, sepse kjo është bërë me planifikim, me organizim.

Mburoja e gjallë e përdorur në betejë, është e ndaluar me të gjitha konventat e luftës. Pra, konsiderohet si krim lufte. Kjo është e argumentuar nga ata të burgosur që ishin pjesë e kësaj mburoje të gjallë dhe të cilët i kanë dhënë dëshmitë e tyre në gjykata e UNMIK-ut dhe të EULEX-it. Përkundër kësaj, nuk pati asnjë rast të tillë të gjykimit.

Ramadan Ferizi, është njëri nga ata që u përdorë si burojë e gjallë në këtë rast. Ramadanin e kisha takuar në këtë ballafaqim në një distancë shumë të afërt. Ramadani kishte biseduar me eprorin që e ka udhëhequr këtë operacion ushtarak. Ramadani është gjallë dhe Ramadani mund të dëshmojë në çdo rrethanë.



Rastet si të Ramadanit e të familjes Tërstena ka shumë në Kosovë. Argumente sa të doni. Vetëm ju lutem kolegë të nderua deputetë, pozitë dhe opozitë, ejani e të bëhemi bashkë, sepse nuk ka qetësi shpirtërore për familjet e viktimave nëse nuk ka gjykim për kriminelët.

Mos shkoni tua kërkoni votën, t'ju thoni se ne do tua ndreqim Kosovën, do tua bëjmë më të mirë, e derisa zemrën po ua lëndoni me këtë braktisje të seancës këtu.

Ejani dhe kthehuni në seancë, të bëhemi bashkë e ta formojmë tribunalin, ta formojmë komisionin, sepse kriminelët, ata duhet të ndëshkohen dhe ne me unitetin tonë nuk do t'i lëmë të qetë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Deputeti i fundit i lajmëruar është Zenun Pajaziti.

**ZENUN PAJAZITI:** Faleminderit, kryetar!

Kolegë deputetë,

Përfaqësues të familjarëve,

Të shoqatave,

Qytetarë të nderuar,

Meqenëse unë mbeta i fundit në këtë debat, dhe meqenëse po ashtu debati ngeli përgjysmë ose mbeti keq pa një pjesët të deputetëve, pra të opozitës, unë po heq dorë nga një fjalim që e kisha shkruar.

Për më tepër, këto ditë, prej ditës kur doli në agjendë kjo pikë, kishte edhe tendenca ta trajtonin këtë çështje sikur një prej interesave tona më të ngushta. Madje-madje, shpeshherë edhe nëse përmendim, nxjerrim tregime tona, qoftë personale dhe familjare, na merret edhe sikur për poenë tonë ditorë politik.

Të jeni të sigurt që, ne si deputetë, besoj që jo vetëm ju, po edhe ju të tjerët nga vendet që vini, shpeshherë keni kërkesa të cilat janë shumë modeste, që të përmendim në përvjetorë të caktuar ata që kanë rënë, ata që kanë qenë viktimë e dhunës dhe gjenocidit serb, qoftë edhe në rastet të caktuara.

Pra, sa herë që ne përmendim, shfaqim një pjesë të tregimit tonë për gjenocidin serb në Kosovë, asnjëherë nuk bëjmë keq. E aq më tepër kur në 20-vjetorin e një periudhe që ka qenë sa e lavdishme aq edhe e trishtë për nga pasojat, për nga dhuna, për nga viktimat, për nga rëniet, kemi një iniciativë që ka të bëjë me një tribunal.

Edhe unë njëri nga ata që mendojnë se jemi vonë. Pra, nuk është se veç opozita po mendon. Debatet tona brenda Partisë Demokratike kanë qenë, disa herë brenda këtyre mandateve të fundit se duhet ta bëjmë.

Dhe, mendoj se në 20-vjetorin ia vlen që kjo iniciativë të na bëjë bashkë të gjithëve, deputetët e pozitës dhe të opozitës edhe të pakicave, të komuniteteve pakicë, që ta nxjerrim një rezolutë edhe ta bëjmë një mekanizëm i cili sadopak do të ndriçojë rastet dhe do ta ndriçojë dhunën dhe gjenocidin serb në Kosovë të kësaj periudhe.

Unë vij nga një regjion i cili për nga përmasat e luftës, madje luftës së fundit, kishte dallim nga regjionet tjera, por aspak për nga viktimat. Për nga numri i atyre që ishin viktimat të dhunës dhe gjenocidit serb në Kosovë.

Më vjen keq, se nuk e di edhe po ia qëllojmë nganjëherë kur flasim edhe me emra, por vetëm fshati Llashticë e Gjilanit është një rast unik në Kosovë për nga përfshirja dhe metodat e dhunës, përdhunimit, gjenocidit në format e saj në Kosovë.

Shpeshherë kemi kërkesë nga qytetarët atje, që të bëjmë më shumë për ndriçimin e këtyre rasteve.

Unë sot po e shfrytëzoj rastin t'i falënderoj të gjitha shoqatat. Të gjitha institucionet që kanë mbledhur argumente për këtë periudhë. Mund t'ju them që në Gjilan, menjëherë pas luftës, ka qenë një grup intelektualësh, avokatësh, veprimtarësh, të cilët kanë bërë një dosje, e cila për mendimin tim ende nuk është shfrytëzuar.

Ky është rasti që ta kemi një tribunal që të shfrytëzohen këto argumente për t'u nxjerrë para drejtësisë ata që bënë dhunë në Kosovë në gjithë territorin e Kosovës, kudo që ata kanë pasur mundësi.

Sot, jo vetëm si njëri prej deputetëve. Si një politikan i Partisë Demokratike të Kosovës e i koalicionit qeverisës, shfrytëzoj rastin si një ish-veprimtar t'i ftoj kolegët deputetë të opozitës të kthehen dhe të tregojmë një shembull të mirë, ta votojmë këtë tribunal.

Kjo nuk do ta zbehë një mendim dhe një kritikë që jemi vonë. Kjo madje, nuk do ta zbehë asnjë zemërim që mund ta kemi ndaj dikujt që bën një gabim. Madje as vullnetin për ta trajtuar një gabim të dikujt ose të një deputeti apo të një institucioni, që s'kemi bërë më shumë deri më tani.

Kjo madje nuk e zbeh aspak insistimin tonë që drejtësia të vijë në vend. Kjo madje, nuk e zbehë aspak ose në njëfarë mënyre nuk është edhe që na poshtëron pse kemi besuar aq shumë në drejtësinë ndërkombëtare për këto 20 vjet, e cila nuk ka bërë asgjë për ndriçimin e gjenocidit serb në Kosovë.

Kjo, veçse na bën të jemi më seriozë, dhe na bën bashkë për një kauzë e cila mbase do të na bëjë më të përgatitur për sfidat tjera që do t'i kemi në të ardhmen. Nëse kjo nuk ndodh, pra nëse

opozita nuk është bashkë me neve që ta votojmë, ta marrim një vendim të tillë për këtë, nuk besoj që do të jenë të gatshëm edhe për sfidat tjera që janë shumë të rëndësishme për vendin tonë në periudhën që do të vijë.

Po e lidhin edhe me Tribunalin e Hagës, por nëse është konstatimi që ky Tribunal është i dëmshëm për vendin tonë, hajde ta bëjë këtë që s'ka të bëjë me tribunalin, e tha edhe zoti Veseli, e u tha edhe nga shumica e atyre që e kanë trajtuar edhe në aspektin e drejtësisë. Pra, nuk ka ndonjë arsye që të mos na bëjë bashkë të gjithëve që ta bëjmë këtë tribunal.

Këtë ia kemi borxh qytetarëve tanë. Ua kemi borxh familjeve të të zhdukurve, familjeve të atyre që kanë qenë viktimë dhe janë viktimë e gjenocidit serb. Madje, më së shumti ia kemi borxh gjeneratave të ardhshme.

I ftoj edhe njëherë të gjithë kolegët që të bëhemi bashkë dhe ta vëmë këtë vepër, mbase të vonuar, por të mirë për drejtësinë dhe për të ardhmen, për kauzën e drejtë të së ardhmes së vendit tonë. Faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Mufëra Shinik.)*

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka kryetari i Kuvendit, zoti Kadri Veseli. Urdhëroni, kryetar!

KRYETARI: Faleminderit!

Nuk dal vetëm si kryetar i Kuvendit, dal edhe si iniciues i kësaj në bazë të një rregulle.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,  
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Sot në Kuvend nuk do duhej që të kishte parti politike, sepse kur janë vrarë njerëzit tanë, Serbia nuk i ka ndarë në parti.

Sot, pavarësisht çdo interesi apo inati është dashur të ketë pendim të mençur, të matur me qëllim vetëm të ardhmen. Kjo iniciativë nuk do të ndalet. As që mund ta ndalë dikush.

Për familjarët që janë sot në sallë e kam vetëm një mesazh, po edhe për ata familjarë tanë që kanë pësuar gjatë luftës së fundit në Kosovë, por jo vetëm gjatë luftës së fundit, të të gjitha luftërave që janë bërë edhe më herët; mos u shqetësoni, edhe kjo çfarë ka ndodhur sot, besoni është pasojë e vetë asaj çfarë ka kaluar populli ynë.

Ju si familjarë që jeni në sallë, edhe ata që nuk janë, është bërë një progres i madh, për faktin se sot po flasim të gjithë bashkërisht në Kuvend dhe jemi para një vendimi të madh.

Jam shumë i sigurt që me një vendosmëri të tillë, zëri juaj do të dëgjohet edhe në Kongresin Amerikan, edhe në Bundestagun Gjerman, edhe në çdo parlament të vendeve ku ka demokraci, ku i thonë jo mohimit të gjenocidit dhe krimeve kundër njerëzimit.

Bashkësia ndërkombëtare, edhe nga kjo seancë dhe nga këto situata të cilat kanë ndodhur gjithë këto ditë, që nga dita kur është hapur është hapur kjo iniciativë imja për Tribunalin ndërkombëtar, ta vlerësojë, ta mendojë shumë mirë për faktin se ajo ka investuar dhe po investon jashtëzakonisht shumë në shtetin tonë, Republikën e Kosovës, por edhe në regjion.

Është në interesin tonë të përbashkët, pikërisht në emër të këtij investimi, që edhe ne si klasë politike ta arrijmë që të kemi edhe dialog, edhe pajtim, edhe të ardhme, duke vënë në themel drejtësinë, të vërtetën edhe të gjithë bashkërisht të punojmë, qoftë Kosova për aq, edhe Serbia.

Kosova i ka kryer obligimet e veta. Inatet tona këtu apo interesat tona mund të jenë të brendshme, por Gjykata Speciale do të ndodhë, për aq sa Kosova kërkon drejtësinë e vet, Tribunali ndërkombëtar për gjenocidin serb mbi njerëzit tanë të pafajshëm duhet të ndodhë, dhe sa më shpejt aq më mirë.

Serbia do të përgjigjet për gjenocidin të cilin e ka kryer në Kosovë, për arsye se është shteti i vetëm i cili e ka kryer këtë gjenocid dhe është në interesin e këtij shtetit që të distancohet nga e kaluara e vet kriminale, gjenocidale dhe t'i sjellë ata dhunues, ata kriminelë, ata vrasës të cilët sot enden lirshëm nëpër Serbi, ndërkaq mund të jenë rrezik potencial edhe për vetë qytetarët serbë.

Unë për fund kam këtë thirrje për vëllezërit tanë të opozitës nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Lëvizja Vetëvendosje, është mirë të jeni në sallë kur të votohet. Kjo do të votohet.

Është mirë që edhe ju të jeni në sallë dhe ta votojmë bashkërisht.

Ju kam thirrur dhe do t'ju thërrasë çdoherë kurdo që të kërkon. Nëse jeni hidhëruar pse e kam filluar unë këtë iniciativë, unë jam i gatshëm t'ia bëjmë si të doni. Por, ajo që është kryesorja është që duhet të votohet.

Për mua si njeri, si qenie njerëzore e këtij vendi, por edhe si kryetar Kuvendi, e kam vendosur që nga dita e parë kur kam ardhur si kryetar i Kuvendit.

Për vëmendjen edhe të publikut, kur jam futur në hyrje si deputet, jam betuar para atyre fotografive të cilat kanë qenë jashtë, se s'do të mbeten jashtë. Kjo është arsyeja që në vitin e parë kur e kemi pasur mbledhjen për gjenocidin kanë qenë të pranishëm familjarët e të pagjeturve. Pra, ajo mbledhje është mbajtur në këtë Kuvend.

Për çdo vit, nën patronatin e Kuvendit të Republikës së Kosovës mbahet ky takim.

Jam marrë po ashtu me eksponatet e këtyre rrobave të cilat kanë mbetur në mëshirën e fatit. Sot, ato janë të trajtuara më denjesisht. Po ashtu, do të merrem deri në fund që edhe e drejta, e vërteta për këta njerëz të dihet saktësisht.

Unë jam rritur me këtë ndjenjë, për faktin se në vendin prej nga vij unë, e kam thënë disa herë publikisht, ka shumë varre. Ka shumë varre të cilat janë edhe anonime. Çdo ditë ndoshta, unë në fshatin tim Broboniq mundohem që të vendos gurë që të mos humbin shenjat e tyre. Kanë humbur.

Për aq sa jam edhe pjesë e një fati të tillë të përjetuar. Gjyshja ime i ka pasur tre vëllezër, të tre janë vrarë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Për aq sa jam edhe familjar i kësaj luftës së fundit, i goditur, por këtë edhe njëherë po e them, nuk e bëj për hakmarrje personale, as qëndrim personal.

Këtë e bëj për arsye se besoj në drejtësi. Besoj në të ardhme. Besoj në paqe. Besoj në fqinjësi të mirë edhe me Serbinë besa në një të ardhme, për arsye se popujt kanë luftuar edhe në vende të tjera, por ajo që është kryesore, Serbia është e obliguar që të paguajë për gjenocidin që e ka kryer mbi qytetarët tanë.

Dhe, po e ritheksoj edhe një herë, që kriminelët do të sillen para drejtësisë një për një, për faktin se ka dëshmi, dëshmitarë, fakte, dokumente të gjalla të cilat e vërtetojnë këtë krim edhe këtë gjenocid të Serbisë mbi qytetarët tanë në Kosovë. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, kryetar! Për vazhdimin e seancës do të njoftoheni nga Kryesia e Kuvendit. Mirupafshim!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)*

**KRYETARI:** Për vazhdimin e seancës do të njoftoheni shpejt, për arsye se kjo vazhdon, gjithsesi shumë shpejt. S'do të ketë vendim të Kryesisë, po do të vazhdojë. Vetëm ta keni parasysht.

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*